

IDEALI PËR TË JETËSUAR

ideali për të jetësuar

M.Fethullah Gylen

Sot, krejt faqja e dheut, nga njëri skaj në tjetrin, po trandet nën lloj lloj mundimesh, krizash e depresionesh nga më të ndryshmet. Shoqëritë janë të kaplura prej hutës në një rrjetë ecejakesh dërmuese e të pashpresa, ndër shqetësime të njëpasnjëshme morale, administrative, ekonomike.... Ndërsa vatrat e së keqes, që kanë në zotërim pushtet e fuqi, me zjarret e trazimit që ndezin në sa e sa forma, në sa e sa vende të ndryshme, bashkë me të sotmen, kërcënojnë edhe të ardhmen tonë. Po, po! Në botën e këtyre ditëve tona individët janë të sëmurë e të tronditur, çerdhja është e rrënuar dhe e trazuar, masat janë në kllapi e huti, përfaqësuesit e forcës e të dhunës janë mizorë e të pamëshirë; kurrkush nuk e di se kah po shkohet e ç'fat e pret njerëzimin. E pra, në këto kushte, që njerëzimi ta mbërrijë edhe një herë bregun e shpëtimit, nuk mund të bëhet tjetër veçse të vihet në jetë një ideal i lartë si *ideali për të jetësuar*. Një ideal që të jetuarit e shoh të lidhur ngushtë me të dhënit jetë, duke e gjetur çlirimin vetjak në çlirimin e të tjerëve...

M.Fethullah Gylen

ideali për të jetësuar



ideali për të jetësuar

ISBN: 978-9928-156-09-9



Çmimi: 700 Lekë / 6 Euro



M.Fethullah Gylen



Kolana
Shtamba e thyer

Në vend të kushtimit

Ardhja a mosardhja në jetë, mbërritja apo mosmbërritja e ekzistencës me identitet njerëzor nuk janë në dorën tonë; por vlerësimi dhe shtënia në dorë e këtyre mirësive, si dhe e lumturisë së të dyja jetëve, është një dhuratë hyjnore që i është falur vullnetit tonë.

Ndërsa njeriu, për ta vlerësuar këtë dhuratë hyjnore në mënyrën më të bukur, para së gjithash duhet t'i caktojë vetes qëllime të larta, të ndjekë ideale të shquara e madhore, të rendë pas pikësnyimesh të mëdha në vend që të jepet pas qëllimesh vogëlime. Në rastin e idealit për të jetësuar, që është njëri prej këtyre qëllimeve të larta, ai përbën më madhorin dhe më të lartin e idealeve që mishërohen në udhë të përfitimit të kënaqësisë së të Vërtetit Zot, sepse jeta e vërtetë është ajo që planifikohet duke menduar për njerëzit e të sotmes e të së ardhmes, e cila arrin idealizimin përmes qëllimit të të jetuarit për ta.

Sot, krejt faqja e dheut, nga njëri skaj në tjetrin, po trandet nën lloj lloj mundimesh, krizash e depresionesh nga më të ndryshmet. Shoqëritë janë të kapluara prej hutesës në një rrjetë ecejakesh dërmuese e të pashpresa, ndër shqetësime të njëpasnjëshme morale, administrative, ekonomike.... Ndërsa vatrat e së keqes, që kanë në zotërim pushtet e fuqi, me zjarret e trazimit që ndezin në sa e sa forma, në sa e sa vende të ndryshme, bashkë me të sotmen, kërcënojnë edhe të ardhmen tonë. Po, po! Në botën e këtyre ditëve tona individët janë të sëmurë e të tronditur, çerdhja është e rrënuar dhe e trazuar, masat janë në kllapi e huti, përfaqësuesit e forcës e të dhunës janë mizorë e të pamëshirë; kurrkush nuk e di se kah po shkohet e ç'fat e pret njerëzimin. E pra, në këto kushte, që njerëzimi ta mbërrijë edhe një herë bregun e shpëtimit, nuk mund të bëhet tjetër veçse të vihet në jetë një ideal i lartë si ideali për të jetësuar. Një ideal që të jetuarit e sheh të lidhur ngushtë me të dhënit jetë, duke e gjetur çlirimin vetjak në çlirimin e të tjerëve...

Për këtë arsye, sot ne, të gjithë së bashku, si qenie njerëzore, nuk kemi nevojë për asgjë më shumë sesa për breza të përsosur që të ushqejnë ideale kaq të larta. Në saje të këtyre zemrave bujare, që cilëndo race e ngjyre që t'i përkasin e në cilindo truall e gjeografi që të gjenden, ia dalin ta shohin krejt njerëzimin me ndjesinë e dhembshurisë, të shtrojnë porsit dheu nën këmbët e veta të ardhmen e vet në emër të lumturisë së të tjerëve, të trazohen porsit ajri e të qarkullojnë porsit gjaku në venat e në trupat e gjithkujt; të gurgullojnë porsit ujërat mbi përmallimet e ndezullitë, duke flladitur kraharorët e frymuar jetë anakënd, ne besojmë se depresionet shekullore do të marrin fund, vuajtjet do të shuhen, dhe fytyra e krejt njerëzimit do të qeshë sërish.

Ndër këta njerëz idealë, të cilët janë burimi i shpresës sonë në emër të së ardhmes, cilësitë parësore janë besimi dhe ndjenja e dashurisë që u buron prej atij besimi. Po, po! Ata e duan Allahun marrëzisht dhe nën krahët e kësaj dashurie të paanë ndiejnë një lidhje të thellë kundrejt të gjitha qenieve: fëmijët, si farëzat e së ardhmes, i ndiejnë e i përkëdhelin... Të rinjve u japin kurajë për të qenë edhe ata njerëz idealë duke u treguar veç qëllime të larta... Të moshuarit i nderojnë me respektin e vlerësimin më të thellë.

Ata, po ashtu, janë një shembull i përgjegjshmërisë më të plotë kundrejt shoqërisë në të cilën jetojnë. Për ta vënë në vend këtë përgjegjshmëri, flijojnë gjithçka që Allahu u ka falur, madje pa iu dridhur qerpiku i syrit... Ashtu sikurse nuk tremben e nuk tërhiqen prej kurrgjëje, nuk ia falin

zemrën asgjëje përveç Atij... Në sytë e tyre nuk ka as pasion të lumturisë, as frikë të trishtimit. Ata, në mënyrë që njerëzimi të fitojë lumturinë e përjetshme, janë të gatshëm edhe të digjen flakëve të ferrit. Po, po! Ata, për hir të idealeve të tyre, zemrat dhe gjithë ç'u do zemra, mallin e pasurinë e tyre, bijtë e pasardhësit e tyre, të sotmen e të nesërmen e tyre dinë t'i flijojnë me lehtësinë më të madhe dhe kundrejt përfitimeve e interesave të vogla janë kurdoherë të gatshëm të bëjnë zgjedhjet e veta për të arritur idealet më të larta.

Ata janë kalorës të përjetësisë. Por mbi kuajt e tyre ata nuk janë të vetëm. Sepse gjithsecili prej tyre është një kalorës që, përtej dashurisë, emocionit e pasionit të vet, merr edhe të tjerët në shalë të kalit për t'i mbartur drejt pafundësisë. Në këtë rrugë ku ata rendin, janë aq të lidhur pas kënaqësisë së Zotit të Vërtetë e në dobinë e njerëzimit, saqë furtunat e pasionit që vijnë e u përplasen në fytyrë vetëm sa ua forcojnë edhe më tej ndjenjën e përkushtimit ndaj së Vërtetës që ushqejnë; stuhitë e zemërimit e të urrejtjes vetëm sa ua bëjnë t'u gufojnë edhe më gurrat e dashurisë e të dhembshurisë, që u gurgullojnë në shpirt; gufojnë e për hir të gjithë kësaj sa e sa të mira i kapërcejnë e i lënë pas, e sa e sa vështirësive u dalin përballë.

Në ditët e sotme, këta heronj të idealit, zotërues të karakterit më të lartë, i kanë shkelur syrin një të ardhmeje të lume që ka nisur të lulëzojë si një farë e mirë në të katër anët e botës, e të ndrijë kudo rreth e rrotull si një pishtar shprese në të mirë të mbarë njerëzimit. Mirëpo “kjo rrugë është e gjatë, tatëpjeta ka mjaft, rrugëdalje nuk ka, por ujëra të thella.” Po, në këtë rrugë ka sa e sa rrugë të largëta për të përshkuar, sa e sa lumenj për të kaluar, sa e sa maja për të kapërcyer. Në këtë rrugëtim të mundimshëm fizik e shpirtëror, që është më i vështirë se çdo lloj vështirësie, për të mos ngecur në kurrfarë pengese, për të mos rënë në rrjetën e bukurive mashtruese e joshëse të botës, për të mos përjetuar lodhje gjatë udhëtimit e për të mos e ulur ritmin, për të rendur vazhdimisht e pa u ndalur porsia kuajt e garës, dashuria për të jetësuar duhet mbajtur kurdoherë e gjallë në zemra e plot jetë. E pra, sipas këndvështrimit tonë, kjo vepër e vyer me titullin “Ideali për të jetësuar”, që po mbani në duart tuaja, do të jetë një nxitje e burim shumë i rëndësishëm frymëzimi për shpirtrat që rendin në të katër anët e botës në të mirë të njerëzimit, që i janë kushtuar përpjekjes për të vepruar dhe dëshirës për të shërbyer. Për shembull, këto radhë që zënë vend që në artikullin e parë të këtij libri, njeriut tonë që gjendet i rrethuar ngado prej materies, interesit, famës, sipas mendimit tonë, e thërrasin drejt një horizonti të lartë e krejt të veçantë:

“Një njeri që dashurohet pas një ideali të lartë, që mundohet në njëfarë mënyre ta rindërtojë botën e vet të mendimit sipas këtij ideali dhe kësodore, përpiqet pa prâ t'i mundësojë mbarë njerëzimit e më së pari kombit të vet një ringjallje, jo vetëm që nuk bëhet/nuk duhet të bëhet pjesë e kurrfarë pritshmërie tokësore, por shpesh ndoshta nuk duhet të bjerë as në shqetësime për pritshmëri shpirtërore prej mirësive të Zotit të Madhëruar, si hyrja në Xhenet dhe të shmangurit prej Xhehenemit...

Zoti i Madhëruar, njëherë e një kohë më pati mundësuar që të isha në vendin tim bashkë me disa shpirtra tejet të devotshëm. Qeshë dëshmitar i plot sakrificave, të cilat në vende të ndryshme të atdheut mund të shërbejnë si shembull... Për shembull, shokë të moshuar që ndoshta kanë hyrë në të tetëdhjetat kanë ardhur kush e di sa herë këtu e më kanë thënë: “Të lutem, a nuk ka mundësi që, ashtu sikurse i keni drejtuar nga hixhreti këta të rinj, a ka mundësi që t'i udhëzoni edhe biznesmenët drejt largimit në vende të tjera? Kësisoj, siç jemi lartësuar me fisnikërinë e dorëdhënies, i Madhi Zot të na nderonte edhe me hixhret.” Ja pra, këto janë dinamika të tilla të cilat është e pamundur

që t'i vlerësojmë brenda përmasave lëndore, dhe për më tepër që janë kthyer pothuajse në një ftesë për t'i kundruar më nga afër hijeshinë dhe mirësinë e Zotit të Madhëruar.”

Duke ju lënë dorë për dore me këtë libër, për të cilin besojmë të jetë për ju plot mendime të larta e qëllime të mëdha, dëshirojmë që, me këtë rast, të përmendim me nderim të gjithë muhaxhirët e idealit, që i kanë vendosur vetes për qëllim ta kthejnë çdo anë të botës në një kopsht trëndafilash, dhe t'i paraqesim miradijen tonë më të përzemërt Autorit të Nderuar, i cili ka ushqyer në shpirtrat e tyre lënien mënjane të dëshirës për të jetuar, duke frymëzuar pasionin për të jetësuar, që me vepra si kjo, ka ndezur në zemrat e tyre dashurinë për t'u dhënë jetë të tjerëve. Duke shprehur lutjet dhe dëshirën që Autori i Nderuar të gëzojë jetë e shëndet sa më të plotë për të na mundësuar leximin edhe të të tjera veprave të vyera si kjo, ju urojmë lexim të mbarë...

Përkushtimi dhe çlirimi prej çdo pritshmërie



Pyetje: Çfarë ndikimi kanë hyrja në një ideal përmes portës së përkushtimit e të sakrificës, dhe hyrja në atë portë e orientuar prej interesash e pritshmërisht, në jetën e mëpasshme të individit që ia ka dedikuar veten e tij shërbimit ndaj njerëzve? A mund të na e shpjegoni këtë?

Përgjigje: Pa dyshim, që mendimi i përkushtimit dhe shpirti i vetëflijimit janë dy dinamikat më themelore që e mbajnë në këmbë një ideal dhe që sigurojnë vazhdimësinë dhe mosreshtjen e tij. Për këtë arsye, Kurani Fisnik, thajse sa herë që flet për të brezat e shkuar (*“sabikun-u evvelun”*) ndër ensarët e muhaxhirët, tregon si një brez ideal ata njerëz që thoshin kurdoherë “po”, dhuronin dhe jepnin gjithnjë prej ç’u gjendej, në një mënyrë që veprimi i tyre qëndronte përherë në majat më të larta të sakrificës përmes mendimit të përkushtimit. [1] Për shembull, në Kuranin Fisnik, në një rast, përmendet se ata, megjithëse nuk kishin mundësi të dhuronin, u mbusheshin sytë me lot prej hidhërimit, dhe ndër vete thoshin: “Ah, sikur të kishim e të dhuronim edhe ne!” [2] Edhe fjalët e ensarëve të nderuar në Besëlidhjen e Akabesë përbëjnë një shembull të mrekullueshëm për këtë. Siç e dini, në këtë besëlidhje, ata i dhanë fjalën Zotërisë sonë, të Dërguarit të Allahut (sal‘allahu alejhi ve sel‘lem), se do ta mbronin Atë me çdo kusht, madje edhe me jetën e tyre nëse do të ishte nevoja, dhe se për çështjen e Tij, ishin të gatshëm të jepnin edhe shpirtin. [3] E pra ata, teksa jepnin një besë të tillë, as që u shkonte ndër mend pyetja: “Ç’përfitime e ç’fryte do të përfitojmë në përfundim të kësaj pune?” Ndodhi që atë ditë, atyre iu dha sihariqi i vlerësimit të veprave të tyre me Parajsën. Por mund të thuhet se fillimisht njohuritë e tyre të përmbledhura për Xhenetin nuk ishin në gjerësinë e informacioneve që na sigurohen neve sot prej shpjegimeve të Kuranit e të Sunnetit, apo prej njohurive të paraqitura prej të parëve tanë të mirë *“selef-i salihinë”*. Mirëpo pavarësisht gjithë këtyre, në një koncept besnikërie të plotë e vetëflijimi bujar, u shprehën se kjo besëlidhje ishte një marrëdhënie shumë e bukur dhe e pranuar atë pa kurrfarë pritshmërie, duke synuar kësodore vetëm kënaqësinë e Zotit të Madhëruar.

Atëherë, Një njeri që është dashuruar pas një ideali të lartë, që mundohet që ta rindërtojë botën e vet të mendimit medoemos sipas këtij ideali dhe kështu, përpiqet pa ndërprerje t’i jetësojë krejt njerëzimit, e më së pari kombit të vet, një ringjallje, jo vetëm që nuk bëhet/nuk duhet të bëhet pjesë e kurrfarë pritshmërie tokësore, por shumëherë ndoshta nuk duhet të bjerë as në shqetësime për pritshmëri shpirtërore prej mirësive të Zotit të Madhëruar, si hyrja në Xhenet dhe të shpëtuarit prej

Xhehenemit. Në fund të fundit, siç është shprehur qartë edhe në hadithe të shëndoshë, është e pamundur që njeriu të fitojë të drejtën e hyrjes në Xhenet përmes adhurimeve që kryen. Ai mund të hyjë atje vetëm përmes mirësisë dhe mëshirës së Zotit të Madhëruar. [4]

E pra, edhe për nga drejtimi i vështrimit kah bota e ahiretit, një njeri që zotëron një koncept përkushtimi në një përmasë kaq të gjerë, kam përshtypjen se nuk do të ketë as ndonjë pritshmëri rreth çështjes nëse do të shpërblehet apo jo për shërbimet që ka bërë dhe nuk do ta vrasë mendjen për hollësi që nuk i përkasin, si “suksesi” apo “arritjet”. Po, po! Një shpirt i përkushtuar nuk do të interesohet për atë çka premton investimi që ka bërë, nuk do të rrijë të mendojë nëse farëzat që ka shpërndarë nëpër tokë do të nxjerrin apo jo filiza gjatë kohës së tij. Ai do të shohë vetëm punën e vet, do të ketë të bëjë vetëm atë që i përket dhe do të veprojë me vetëdijen se krijimi i përfundimit i përket vetëm Allahut (xh.xh.). Bediuzamani, në lidhje me këtë citon një vërejtje të goditur të Xhelaledin Harzemshahut. Teksa po nisej për udhëtim, këtij personaliteti i parathanë se ç’do të përfitonte prej rrugëtimit, por ai u shpreh se një sendërtimi i përfundimit dhe dhënia e përfitimeve është punë e Allahut, kurse ai ai do të kryente detyrën që i takonte, e kurrsesi nuk mund të përzihej në punët që i përkisnin Zotit. [5]

Lëvdata i nënshtrohet dijes

Nga ky këndvështrim, një individ që i ka hyrë që në fillim një pune me mendimin e përkushtimit, me kalimin e kohës, nuk do të hyjë në ndonjë lloj pritshmërie të lidhur me të përfituarit prej punës në fjalë. Për shembull, pritshmëritë si vëmendja mbi të, përfitimi i lëvdatave, i duartrokitjeve, i përgëzimeve të njerëzve kundrejt shërbimeve të kryera, nuk do të jenë as bujtës në botën e ëndrrave të tij. Mes popullit ekziston një fjalë e përhapur që thotë: “Lëvdata i nënshtrohet dijes.” Ndoshta në rastin e shumë njerëzve mund të bëhet fjalë për një disiplinë të tillë. Domethënë, nëse njerëzia u paraqet atyre lëvdata, disa njerëz shprehin dijenitë e veta, shpërfaqin aftësitë e veta. Për shembull, dikush që bën një pikturë, nëse vëren se ajo përbën interes për njerëzit, nis punime të tjera të ngjashme. Lëvdatat me të cilat përballet ia përndezin vullnetin dhe përpjekjet. E pra, këso lëvdatash, në një kuptim të përgjithshëm mund të shihen si një element nxitës, madje si një nevojë për njerëzit. Mirëpo për një shpirt të përkushtuar, lëvdata i nënshtrohet dijes. Nëse ju bëni atë çka duhet bërë, paraqisni atë çka nevojitet të paraqisni, në përfundim të kësaj, bota po të dojë të thurë lëvdata, po të dojë të mos thurë; ju nuk e vijoni punën lidhur veç pas syve të botës. Madje shumë herë, duke u përballur me lëvdatat e të tjerëve, ndaleni të hetoni egon tuaj dhe thoni: “Nuk jam i denjë për këtë unë ingrati, / gjithë këto hire e mirësi ndaj meje përse?” Sepse duke qenë se e shihni veten si një njeri prej njerëzve, juve ju duket sikur të tilla lëvdata nuk ju shkojnë e nuk ju përshtaten kurrkund.

Ndaj edhe të nisësh punën fillimisht pa kurrfarë pritshmërie, t’ia nisësh një çështjeje duke dhënë nga vetja, të veprosh me ndjenjën e përkushtimit, përbën një burim të tillë fuqie domethënëse, saqë njeriu që i zotëron këto, me lejen dhe ndihmën e Allahut, nuk e kaplon asnjëherë mungesa e shpresës, qëndron kurdoherë i papërkulur kundrejt ngjarjeve dhe i kapërcen ato me një besim të palëkundur e gjithë shpresë. Kjo, në të njëjtën kohë, është rruga e përvuajtërisë dhe e varfërisë. Domethënë, njeriu së pari do të kuptojë përvuajtërinë dhe varfërinë e vet, më pas do të veprojë me mendimin e përkushtimit dhe nuk do të pushtohet prej një mendësie si “nuk u shpërbleva për sa bëra, nuk u lëvdova e nuk tërhoqa vëmendjen, çka do të thotë se nuk pata sukses.”; nuk do të

pushtohet prej këso mendimesh, ndaj edhe nuk do të ankohet, nuk do të hyjë në asfarë ankthi, nuk do të përjetojë panik dhe për më tepër, nuk do të fajësojë fatin. Ai do të veprojë gjithmonë i lidhur pas mendimit:

“Në ardhhtë prej Lartisë Sate zemërim

A prej hijeshisë Sate shpërblim,

Që të dyja janë t’erëndshme,

Hir e hidhërim i ke të këndshme.”

Ta pohojmë edhe këtë, që kur një njeri i lutet Zotit të Madhëruar me fjalët: “O Zoti ynë, na dhuro neve në këtë botë e në tjetrën mirësi e na ruaj nga ndëshkimi i Xhehenemit!”, [6] është tjetër çështje që ai të kërkojë mirësi për jetën e kësaj bote, sikurse është krejt tjetër çështje që të kërkojë në këtë botë shpërblimin e veprave të mira e të hijshme që kryen duke ushqyer pritshmëri për to. Për më tepër, nëse njeriu i lidh veprat e mira me përfitimin, shpërblimin dhe arritjen e suksesit a fitores absolute, por vullneti hyjnor i Zotit të Gjithëfuqishëm nuk shkon në atë drejtim, atëherë ai humbet shpresën dhe bëhet pre e zhgënjimeve të njëpasnjëshme. Veç kësaj, nëse ju veproni në këtë mënyrë mbi baza të një pritshmërie, njerëzit që ju pasojnë mund të bien në dasi e përçarje duke bërë që të lindin krisje në vlerësimin dhe mendimin e mirë që ata kanë për ju. Kjo gjendje, porsì një rreth vicioz, jua rrëmben fuqinë shpirtërore dhe kur nuk jeni të suksesshëm shfaqen ndjenjat e fajit, lëndimi, madje dhe nervozizmi.

Kështu që njeriu, duke ia lënë shpërblimin e veprave parajsore hirit dhe mirësisë së pafundme të Zotit të Vërtetë, nuk duhet t’i burgosë ato në përmasat e përkohshmërisë, krejt kalimtare e të ngushta të kësaj jete. Për shembull, nëse e përfytyroni çlirimin e Stambollit brenda ngushtësisë së kësaj bote, atëherë bëhet fjalë vetëm për të qenë çlirimtar i Stambollit. Vetëm nëse pritshmëritë e shpërblimit për një çlirim të tillë lidhen me vlerësimin prej Zotit të Madhëruar, atëherë përfitimi që lind prej çlirimit e ngadhënjimit në jetën e përjetshme, plaçka e luftës dhe afria e botës së engjëjve më të lartë i dhurohen njeriut jo më brenda ngushtësisë së kësaj bote, por në gjerësinë e paanë të përjetësisë. Kështu që ndërsa kemi mundësi që të themi këtu një *“Subhanallah”* dhe të vihemi në anën tjetër në zotërim të një kopshti parajsor, përse të mos e lidhim çështjen e suksesit në këtë jetë vetëm me përmasat e një shqiptimi të fjalës *“Subhanallah”* !

Nuk e dinë se ku gjen shpërblim sakrifica

Shembujt janë të atillë që mund t’i shtojmë edhe më. Për shembull, nëse ju shpenzoni një energji a përpjekje shumë serioze në mënyrë që fryma muhamedane (sal‘allahu alejhi ve sel‘lem) të shtrijë krahët në të katër anët e botës, por nuk ia dilni dot në krye, ju nuk përjetoni ndonjëfarë pikëllimi, pasi nuk e keni lidhur veprimin dhe aktivitetin tuaj pas rezultatit të arritur. “S’kemi ç’bëjmë, kështu na ndodhi tani”, -thoni, dhe porsì Ademi (a.s.), me mendimin: “O Zoti ynë, ne bëmë padrejtësi ndaj vetvetes. Në mos na falsh e në mos tregofsh mëshirë për ne, pa dyshim që ne do të jemi prej humbësve.” [7] , kërkonte llogari prej vetes, e rishikoni gjendjen ekzistuese, më pas sërish ngriheni, sërish rimëkëmbeni dhe i vihëni edhe një herë punës për të bërë gjithë ç’është për të bërë. Nga ky

këndvështrim, gjendja e mospritmërisë dhe mendësia e sakrificës përbëjnë dinamika mjaft të rëndësishme e jetike, në mënyrë që ta kryejmë punën me pastërti e sinqeritet deri në frymën e fundit. Njerëzit që i janë kushtuar kësaj bote, duke qenë se nuk i njohin këto dinamika, e lidhin çështjen vetëm me lëndën, me paranë dhe përpiqen që vetëm përmes këtyre të mund ta kuptojnë përfundimin e arritur. Ndërsa sakrificat dhe mospritmëria janë vlera të tilla që nuk është e mundur t'u gjendet barasvlera brenda përmasave materiale. Një pjesë e njerëzve të lidhur pas botës, që nuk e kapërdijnë e nuk e durojnë dot *Lëvizjen e Vullnetarëve*, e interpretojnë çështjen me mendësinë: “Pas kësaj pune duhet të fshihet kaq e aq kapital, sepse përndryshe nuk ka mundësi që e gjithë kjo të ecë në mënyrë kaq të përkryer!” Sepse ata nuk e kanë idenë e të dhënit pa marrë asgjë. Ata nuk e kuptojnë se gjithçka e harxhuar për hir të kënaqësisë hyjnore paraqitet si një investim, dhe kështu, Zoti i Madhëruar e kthen të paktën në të shumtë, asisoj që njëshin e bën njëmijë. Po, po! Këto dinamika barazohen me një vlerë parajsash; dhe sipas kësaj, Zoti i Madhëruar, zotërues i fuqisë e i mëshirës së pafundme, dhuron vazhdimisht fryte dhe suksese.

Një tjetër anë e çështjes është edhe kjo: ndër shokët që gjenden brenda këtij rrethi, unë mund të them se nuk njoh as një në njëmijë. Madje tani mund të them se nuk njoh as një në një milion. Deri edhe ata që në të shkuarën i kam njohur, pasi nuk më është dhënë mundësia që t'i takoj rishtazi, me kalimin e kohës ndodh që të mos i mbaj mend mirë. Prandaj, t'ia ngarkosh një individ a një grupi të vetëm shërbimet e kryera prej njerëzish që këta as që i njohin, përbën mungesë respekti e padrejtësi edhe ndaj Allahut, poende ndaj mundimeve e përpjekjeve të atyre njerëzve. Po, po! Sipas botëvështrimit tim besimor, t'ua ngarkosh të gjitha veprat një individ, një gjenialiteti, një urtësie, një mençurie apo një zgjuarsie të vetme, është njëfarë idhujtarie. Në daçin, edhe me dëshirë e mendim të mirë le të thonë të tjerët: “Përpjekja e akëcilit për këtë çështje është e plotë, nëpërmjet tij u arritën këto rezultate.” Duke thënë këtë, ata bëjnë një gabim në gjykimin e tyre individual. Zoti i Ligjësishë Hyjnore premtos se do t'i falë gabimet e bëra në gjykimin individual. Ndërsa ajo që na mbetet neve është që të veprojmë gjithmonë me vetëdijen e përluljes dhe, kurrsesi të mos u dalim për zot të tilla lëvdatave dhe mbivlerësimeve.

Veç kësaj, siç shihet qartë, çështja është hiperbolizuar aq shumë, ka hedhur rrënjë aq thellë dhe ka marrë një pamje aq të gjithësishtme, saqë është e pamundur t'i ngarkohet një apo disa individëve apo një grupi të caktuar të vetëm. Ka mundësi që, pas një moshe të caktuar, që përmes ëndrrave e përfytyrimeve të mia të mos vij në mendimin se “edhe unë diç bëra” e të mos bie kësisoj në idhujtari, i Madhi Zot pati mëshirë për mua dhe në fund të jetës më shpërnguli këtu. Tani ka plot djelmosha që e çojnë përpara atë punë me tërë pastërtinë e nevojshme. Zoti ynë i nderoftë ata me dëlirësi e qëndrueshmëri të plotë!

Por më duhet të pohoj edhe se Zoti i Madhëruar urdhëroi e më mundësoi që për një kohë të caktuar të gjendem në vendin tim së bashku me plot shpirtra të përkushtuara. Me këtë rast, qeshë dëshmitar i plot e plot sakrificave shembullore në krahina të ndryshme të vendit. Për shembull, në anën e sipërme të Bozjakasë iu drejtuam bujarisë së njerëzve fisnikë të Anadollit. Të gjithë dhanë diçka. Më pas, shkova dhe u ula në dhomën time. Një ushtarak i dalë në pension, duke tundur çelësat nëpër duar, më erdhi pranë e më tha kështu: “Këtu gjithsecili dha diçka, por unë nuk dhashë dot. Me të ardhurat e pensionit kam blerë një shtëpi, kështu që kam vendosur ta dhuroj edhe atë. Ju kam sjellë çelësat e shtëpisë.” Natyrisht që në një situatë të tillë, detyra juaj është që të thoni: “Vëlla i dashur, secili ka përgjegjësinë për të dhuruar sipas mundësive që i janë dhënë. Ti mund të japësh gjithë ç'del prej nevojave të domosdoshme. Nuk ke pse të japësh gjithë shtëpinë. Allahu

nuk e do atë prej teje.” Kështu, atij ia ktheni sërish çelësat dhe i thoni: “Shko e rri në shtëpinë tënde. Zoti bën mëshirë për ty, të çel dyer të reja e pastaj edhe vjen dita që edhe ti të mund të vish e të japësh diçka.” Sepse edhe Profeti ynë (alejhis’salatu ues’selam), sahabëve si Kab ibni Maliku [8] apo Sad ibni Ebi Uakasi [9] (radijallahu anhuma), të cilët donin që ta dhuronin krejt pasurinë e tyre, i ka urdhëruar për ta ndryshuar masën.

Tetëdhjetëvjeçarët që kërkojnë hixhretin

Përgjatë gjithë jetës jam njohur edhe me sa e sa njerëz të tjerë të sakrificës. Për shembull, shokë të moshuar që ndoshta kanë hyrë në të tetëdhjetat kanë ardhur kush e di sa herë këtu e më kanë thënë: “Të lutem, a nuk ka mundësi që, ashtu sikurse u keni bërë shenjë këtyre të rinjve kah hixhreti, të na orientoni edhe ne tregtarët drejt Hixhretit, që edhe ne të fisnikërohemi prej mërgimit në vende të tjera? Kështu, siç jemi lartësuar me nderin e të dhuruarit, i Madhi Zot të na nderonte edhe e hixhretin.” Ja pra, këto janë dinamika të tilla që nuk mund t’i vlerësojmë dot brenda përmasave lëndore dhe që janë kthyer pothuajse në një ftesë për hijeshinë dhe mirësinë e Zotit të Madhëruar. Ndoshta brenda sistemeve të ndryshme ekonomike mund të mos kuptohet se si këto dinamika kthehen në nga një vlerë. Por nuk ka dyshim se këto janë më të vlefshme se kapitali dhe se puna. Prandaj gjithkush le të thotë ç’të dojë, por përfundimi që arrihet është se ndërtimi i një mendësie të përbashkët mbi një bazë të përbashkët të përkushtimit dhe të sakrificës së njerëzve që janë bashkuar rreth së njëjtës arsye, të njëjtit mendim e të njëjtit besim është hiri e mirësia që buron prej të Madhit Zot.

Për ta mbyllur, po them edhe se për njerëzit që tregohen aktivë, që i vihen punës që në kohë të mira e të qeta dhe që e çojnë në vend një detyrë që marrin përsipër, duhet ndier respekt. Ajo që na mbetet neve është që për ta të lutemi duke thënë: “I Madhi Zot ua shtoftë dëshirën e pasionin dhe i lartëssoftë përmes vijmësisë!” Po, po! Si atë që nuk ka e përpiqet gjithsesi të dhurojë, si atë që jeton në pasuri e gëzon plot të mira dhe duke dhuruar sakrifikon në një nivel të caktuar, është detyra jonë që t’i kujtojmë gjithmonë për të mirë e t’i përmendim të gjithë në lutjet tona. Ne e duartrokasim sakrificën e çdo individi që punon në të mirë të kombit tonë e të mbarë njerëzimit, ndaj edhe lëvdojmë Zotin e Madhëruar, e falënderojmë Atë dhe kështu, besojmë se në përfundim të këtyre falënderimeve e mirënjohjeve të mirat e Tij do të vijojnë të zbresin pa mbarim mbi ne.

[1] Shih: Enfal, 8/72-75; Teube, 9/19-20, 100; Hashr, 59/8-10.

[2] Tevbe, 9/92.

[3] Shih: Ebu Nuajm, Delailu’n-nubuvve, f. 302-303.

[4] Shih: Buhari, Rikak 18, Merda 19; Muslim, Sifatu’l-munafikin 71-78.

[5] Bediuzaman, Shkrepëtimat, f. 163 (Shkrepëtimat e shtatëmbëdhjetë, Shënimi i trembëdhjetë, Çështja e parë).

[6] Bekare, 2/201.

[7] Araf, 7/23.

[8] Buhari, Vesaja 16, Megazi 79, Ejman 24; Muslim, Teube 53.

[9] Shih: Buhari, Xhenaiz 37; Muslim, Vasijet 5.

Paqja dhe vetëkontrolli që kërkojmë



Pyetje: Si duhet të jetë vetëkontrolli i një besimtari, qoftë në jetën vetjake, qoftë në pozitën shoqërore e në institucionet e përfaqësuara prej tij?

Në ditët tona jemi dëshmitarë të cenimit në shumë e shumë raste të paqes familjare e asaj vetjake. Për shembull, në marrëdhëniet brenda institucionit të familjes përjetohen shqetësime serioze mes bashkëshortëve ose mes fëmijëve dhe prindërve. Këto shqetësime, që burojnë prej individit dhe prej familjes, me kalimin e kohës u përçohen institucioneve shoqërore dhe kjo gjendje shkakton krisje e keqfunksionime edhe më të mëdha në shoqëri. Ndërkohë që një shoqëri e ngritur mbi mirësi e shpërblime hyjnore dhe e formuar prej individësh që jetën e tyre e thurin me punë të mira e të arrira, as që mund të shkojë nëpërmend që të jetë keqfunksionuese. Për këtë arsye, nëse në një shoqëri është shfaqur një defekt, mund të thuhet me lehtësi se ky defekt përbën një gjendje që buron prej molekulave të saj, pra, prej individëve dhe familjeve. Nderi i gjithësisë, Zotëria ynë (sal‘lallahu alejhi ve sel‘lem), me fjalët e Tij, e përmbledh shumë bukur këtë gjendje. Ai urdhëron e thotë: “Siç jeni, ashtu qeveriseni.” [10] Pra, në qofshi qumësht, ajka juaj do të jetë prej qumështi e në qofshi kos, ajka juaj do të jetë e tillë gjithashtu. Por në paçi një gjendje si prej shapi, edhe ajka juaj njëlloj do të jetë. Në këtë këndvështrim, nëse dëshirojmë të arrijmë paqen, para së gjithash në institucionin e familjes dhe më pas në krejt shoqërinë, nëse mendojmë të futemi me atmosferën dhe shijen e paqes, të gjithë ne, siindividë që përbëjmë shoqërinë, para së gjithash duhet të përballlemi njëherë me vetveten; e me këtë përballje, duhet të njohim e të pranojmë gabimet dhe mangësitë tona.

Koncepti i qeverisjes shërbyese

Për shembull, një rrugë e rëndësishme e zgjidhjes së problemeve të caktuara në shoqëri është që përfaqësuesit e një organizmi a institucioni, pra, administruesit që gjenden në krye të punëve, ta pranojnë si filozofi të shërbimit rregullin e parashtruar prej hadithit: “Zotëria i një bashkësie është ai që u shërben atyre.” [11] Po, po! T’u gjendesh pranë e të japësh ndihmesë në shërbime në shoqëri të njerëzve që shërbejnë, është pjesë e moralit më të lartë të Zotërisë së Zotërinjve (alejhis’salatu ues’selam). Kështu, kur Ai Mbret i Profetëve dilte për udhëtim, teksa të gjithë i

viheshin punës, pikërisht Ai njeri i madh që yjet i shtroheshin si gurë kalldrëmi nën këmbë, Ai synim e fryt i ekzistencës, Ai shkak i krenisë së gjithësisë, merrte përsipër të mblidhte dru dhe u bashkohej në punë sahabëve. [12] E në qoftë kjo rruga e Zotërisë sonë, që ishte “*usuetun hasene*” (shembull i shkëlqyer), [13] atëherë duhet ta dimë se duke ushtruar autoritet, duke shfaqur sjellje imponuese, duke u ngarkuar të tjerëve punë me pahir, nuk është e mundur të arrijmë ndonjë rezultat. Për këtë arsye, një administrues duhet që së pari t’i bëjë vetë ato punë që është e nevojshme të bëhen dhe në këtë mënyrë duhet t’i nxisë edhe njerëzit e tjerë që punojnë pranë tij që edhe ata t’i kryejnë ato punë.

Po ja që diçka të këtillë, kaq të rëndësishme, sot, nga pikëpamja e moralit të ngulitur në shoqërinë tonë, nuk do të jetë edhe aq e lehtë për ta zbatuar, sepse në ditët tona, në shumicën dërrmuese të individëve, në mendësinë e në botën e tyre të ndjenjave, mbizotërojnë uni dhe egoizmi. Ndaj edhe njerëzit që, në shkallët e ndryshme të jetës, fitojnë një pozitë të caktuar, e shohin veten më të ndryshëm e më të lartë se të tjerët dhe sjelljen e qëndrimin e tyre ndaj njerëzve të tjerë në mjedisin e tyre e formësojnë po mbi këtë konceptim. Për këtë arsye, që të punosh për t’i ndryshuar këto praktika të përgjithshme, të rrënjosura tashmë në shoqëri, dhe për t’i zëvendësuar ato me mendësi të tjera, është njësoj sikur t’i bësh njerëzit që të përjetojnë papritmas disa mutacione njëherësh, ndërsa në përfundim një qenie që u nënshtrohet kaq shumë mutacioneve nuk është e mundur të jetojë. Po, po! Nëse i ngarkoni në kurriz shoqërisë një barrë që ajo s’mund ta mbajë, do ta shtypni atë shoqëri nën rëndesën e asaj barre. Atëherë ajo që duhet bërë është që ata që besojnë se kjo çështje është e drejtë, edhe në qofshin veç një grusht njerëzish, duhet t’i japin asaj jetë në jetën e tyre, ta vënë në zbatim në jetën e tyre. Domethënë, në vend të sjelljeve prej diktatori e prej sundimtari, duhet ta bëjmë vetë atë që duhet bërë dhe në këtë mënyrë të kthehemi në udhërrëfyes për njerëzit. Nëse do të veprohet kështu, atëherë do të vërehet se ky moral, me kalimin e kohës do të përhapet edhe në shoqëri dhe do të pëlqehet prej saj.

Administruesi si pjesëmarrës në shqetësime

Në të vërtetë, sikurse nëpunësve u takon të tregojnë me respekt ndaj drejtuesve të tyre, edhe të mëdhenjve u takon të sillen ndaj tyre me dashamirësi dhe në atë çka duan që ata të bëjnë t’i udhëzojnë duke i bërë edhe vetë gjërat. Në lidhje me këtë situatë, i Dërguari i Allahut (sal‘lall’lillahu alejhi ve sel‘lem) urdhëron e thotë: "Ai që nuk tregon dhembshuri për të vegjlit dhe respekt për më të mëdhenjtë, nuk është prej nesh." [14] Siç shihet, për ata që nuk tregojnë dhembshuri ndaj të vegjëlve pranë tij, që nuk i afrojnë e nuk i përqafojnë ata, që nuk i mbrojnë, që nuk merren me ta në masën e duhur, si dhe për ata që nuk janë të mbushur me respekt e nderim ndaj të mëdhenjve që ka pranë, Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (sal‘lall’lillahu alejhi ue sel‘lem) ka përdorur një shprehje fort të rëndë duke urdhëruar e thënë: “nuk është prej nesh” dhe në këtë mënyrë, ka tërhequr vëmendjen te rëndësia e kësaj pune.

Këtu ka një çështje për të cilën duhet theksuar: të treguarit i respektueshëm ndaj të madhit, të vënit në vend e asaj që thotë ai, të kryerit e asaj që tregon ai, në thelb, është një detyrë e të voglit, pra e atij që është nën administrim. Krahas kësaj, ajo që i takon të madhit është që të mos presë nderim e respekt prej tij. Atij i takon që t’i trajtojë ata që ka nën urdhra duke u mbështetur me dhembshuri, mirësi e butësi tek ta, t’u qajë atyre hallet dhe madje kur ata të rënkojnë, të rënkojë edhe ai bashkë me ta. Që prej atij që gjendet në pozitën e drejtorit të një shkolle e deri te një drejtues i lartë, te një

kryetar qarku, te një prefekt, madje deri tek ai që drejton e administron një shtet, nëse sheh ndër njerëzit që ka nën përgjegjësi një njeri të kapluar prej ndonjë problemi, duhet t'i gjendet pranë në masën që i mundëson t'i vijë në ndihmë atij apo të gjithë njerëzve për të cilët është përgjegjës.

Siç e dini, një grua e moshuar me shqetësime mendore shkoi një ditë në prani të Atij që iu dhurua Fjala Hyjnore, dhe duke i thënë se kishte një problem, i kërkoi Tablosë së Krenarisë Njerëzore (alejhis'salatu ues'selam) që t'ia zgjidhte këtë problem. Paskëtaj, duke e marrë Kreun e Dy Botëve për dore, pa dëgjuar prej tij asgjë gjysmë fjale kundërshti, e mori Zotërinë tonë, Profetin (sal'lall'llahu alejhi ve sel'lem) dhe duke ecur e ecur me të, e vuri t'ia zgjidhte të gjitha hallet që kishte. [15] Ja pra, çdo administrues e qeverisës duhet të jetë kaq pranë njerëzve, sepse nëse ju nuk hyni në gjirin e tyre, edhe ata nuk do të jenë në gjirin tuaj. Ndërsa mendoni që t'i qeverisni ata, do t'ju qeverisin ata juve. Kjo çështje nuk mund të sjellë përfitim as nëse nuk jemi vërtet të tillë, por bëjmë gjithçka vetëm sa për t'u dukur të mirë e simpatikë. Nëse mendojmë kësodore, vjen dita e gjithçka përmbysset dhe vihet re që llogaritë janë ngatërruar keqas. Atëherë vëreni, pra, se njerëzit që ju janë dukur të mirë nuk janë më të tillë dhe njerëzit që ngjanin simpatikë janë bërë tashmë krejt antipatikë. Për të mos rënë në një pozitë të tillë, duhen gjetur rrugët për të hyrë në zemrat e njerëzve. Edhe në i qortofshi e u tërheqshi vëmendjen atyre për shkak të mangësive e të pasaktësive, duhet të jeni në gjendje që më pas t'i tërhiqni mënjandë e t'u thoni: "O vëllai im! Pak më parë ndoshta të fola ashpër, të hyra në hak. Ma bëj hallall! Jam i gatshëm të bëj ç'të kem në dorë që të më falësh, e të ma bësh hallall të drejtën tënde." Kjo sjellje e treguar, me një dashamirësi që e kapërcen atë të një babai apo të një nëne, i pushton zemrat e tyre në një mënyrë të tillë që ju mundëson të fitoni pranimin dhe bindjen e tyre. Kësisoj, punët nisin t'ju ecin porsì sahat. E pra në kopsht, në rrugë, në shkollë, në kursin e Kuranit, në xhami e kudo, në të gjitha institucionet tona, për të arritur që të ngrihet një moral i tillë, njerëzit duhet të rehabilitohen e të ngrihen drejt këtij niveli.

E pra, kushdo që nuk e kontrollon veten, që nuk e vë në pyetje veten; një njeri që gabimet e dala në fillim apo gjatë procesit të realizimit të punës nuk i lidh me gabimet e bëra prej vetë atij, por kërkon gjithmonë të gjejë mangësitë nga jashtë, as fajtorin nuk e gjen dot, as prej mangësive nuk shpëton dot. Por ai që reflekton dhe pyet veten, "çfarë gabimi bëra unë që, teksa gjithçka po shkonte mirë, hasëm në një problem të tillë?", me ndihmën dhe me lejen e Allahut, i kapërcen pengesat që i dalin përpara dhe në punët që bën, ia del përherë në krye me sukses.

"Gjithçka ndodhi për fajin tim"

Bashkësia më e zgjedhur, që ka zënë vend pas Tablosë së Krenarisë Njerëzore, çliroi Mekën dhe me atë çlirim u lartësuan gjithë zemrat. Më pas i drejtohen Hunejnit, por aty në fillim pësojnë një humbje të përkohshme. [16] Kurani Fisnik e shpreh kështu gjendjen që iu nënshtrua kjo ushtri e suksesshme që kishte çliruar Mekën: *Nuk ka dyshim se Allahu ju ndihmoi në shumë vende, sikurse edhe në ditën e Hunejnit. Atë ditë, numri juaj i madh bëri që t'ju pëlqejë vetja. Por kjo nuk ju sollti juve asnjë dobi. Me gjithë numrin tuaj të madh, toka aq e gjerë u ngushtua për ju. Më pas u kthyet pas dhe rendët në arrati.* [17] Për ne, është mungesë respekti dhe edukate që të vëmë në pyetje e hetim sahabët fisnikë. Mirëpo këtu, me qëllimin për të tërhequr vëmendjen te një e vërtetë, u ndiem të detyruar të shprehemi për këtë çështje. Po, po! Pikërisht ata njerëz të zgjedhur, që në çdo ulje e ngritje, në të ushqyer e në të pirë, shkurt, në gjithçka që bënin, vepronin në përputhje me pëlqimin

e Allahut, kur patën në zemrat e tyre një grimë vetëpëlqimi për ato çka kishin bërë, përjetuan një humbje të përkohshme. Pas kësaj, duke zënë vend pas të Dërguarit të Allahut (alejhis'salatu ues'selam), atë humbje e kthyen sërish në fitore. [18] Sepse Zotëria ynë, ai Udhërrëfyes i Përsosur, ai Udhëheqës i Përkryer (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), nuk ia kishte lejuar kurrë vetes që në zemrën e Tij të shfaqej një ndjenjë e tillë.

Tani, nëse Kurani Fisnik urdhëron e shpreh një paralajmërim të kësaj natyre për zotërinjtë tanë, sahabët e nderuar, atëherë a nuk është e nevojshme që ne, sa herë të gjendemi përballë një falsoje a një fiaskoje, të reflektojmë duke i thënë vetes: “Gjithçka po ndodh për fajin tim.” Për shembull, ka njerëz që nuk na durojnë dot dhe prej vitesh shkruajnë kundër nesh. Përballë kësaj gjendjeje, nuk është e drejtë që ne të mendojmë: “E ç'të bëjmë! Allahu kësisoj i paska krijuar të tillët. Të bëjmë ç'të duam, nuk i kënaqim dot këta njerëz!” Në vend që të themi këtë, besoj se është më mbarë që të mendojmë me mendësin e logjikën që të përfton Kurani: “A kemi mundur ne vallë t'i vlerësojmë të gjitha rrugët alternative për të vënë në lëvizje ndjenjat njerëzore dhe mendimet e këtyre njerëzve, për t'i pajtuar kësisoj ata në një linjë të caktuar? Mos vallë kundrejt këtyre njerëzve kemi pasur ndonjë gabim në mënyrën tonë të të shprehurit? A shkuam të pyesim ndonjë të urtë për t'i marrë mendime e këshilla në lidhje me këtë gjendje?”

Reagimi ndaj paralajmërimit dhe udhëzimit

Veç kësaj, duhet ditur se një njeri që nuk lejon diskutimin e defekteve dhe të mangësive, që nuk e pranon kurrsesi reflektimin, që sipas shprehjes popullore, s'të lë t'i prekësh as edhe një qime floku, në njëfarë mënyre do të thotë se është i sëmurë. Veçanërisht në vendet ku mbizotëron sistemi i kastave, disa njerëz nuk janë aspak të mësuar e të hapur kundrejt kësisoj llogaridhëniesh. Ata nuk durojnë as kritikën më të vogël që mund t'u drejtohet dhe për këtë shkak janë të gatshëm të çelin grindje. Madje edhe kur gabimet dhe mangësitë shprehen në përgjithësi, ata kundërpërgjigjen me reagim të ashpër. Për këtë arsye, njeriu i ngarkuar me paralajmërimin e udhërrëfimin duhet ta marrë parasysh edhe këtë gjendje shpirtërore dhe t'i hedhë hapat sipas saj. E pra, sot janë të paktë ata njerëz që kur t'ua thuash të metën në sy, të ndihen të kënaqur e të flasin sipas qasjes së mësuesit të nderuar, Bediuzamanit: “Bekuar qoftë ai që më lajmëron për akrepin në qafën time!” [19] Sepse, para së gjithash, nuk kemi ndonjë çerdhe që t'i rrisë e t'i ngrejë njerëzit tanë në këtë shkallë e t'i përsosë ata kaq shumë, e as rruga nuk është në gjendje ta përçojë këtë përsosje. Shkolla është e mbushur plot me kurrikula e programe shumë të ndryshme e krejt jashtë këtyre ndjenjave e mendimeve. Faltorja, edhe në qoftë një vend i hijshëm ku falim namaz, ku dëgjojmë ligjëratat e këshilla të vazdhueshme e në këtë mënyrë i afrohem/do t'i afrohem më shumë Allahut, në gjendjen e mposhtjes përballë rutinës e përditshmërisë, edhe mesazhet e saj pasqyrohen te ne si të vjetruara e të shkuara kohe. Po, po! As edhe në faltore nuk po thuhet më diçka e re që të mund të zgjojë emocion ndër zemra. As atje nuk feks vezullimi i ndonjë dashurie të fuqishme profetike apo hyjnore. Tani, nëse në të gjitha këto institucione përjetohet një zbrazëti, kjo pasqyrohet në shoqëri përmes të tjera zbrazëtish shumë të thella e të ndryshme, si padurimi e bezdia prej të tjerëve, mosrënia në sy e mangësive të veta dhe reagimi i menjëhershëm kur dikush na vë në dukje të meta. Prandaj duhet ta pranojmë se shoqëria ka nevojë për një rehabilitim shumë serioz prej kokës tek këmbët, sepse po shihet që, në të vërtetë, të gjithëve, kur na përmenden të metat tona, në një mënyrë apo në një tjetër, shfaqim një reagim të caktuar. Në këtë këndvështrim, në çështjen e paralajmërimit

e të udhërrëfimit, duhet vepruar me ndjeshmëri e kujdes shumë të madh, duke llogaritur edhe gjendjen e përgjithshme të shoqërisë.

Po përpiqem ta sqaroj këtë çështje me një ngjarje të cilat i kam përjetuar vetë. Në vitet e para që shkova në Izmir, kisha një shok të vyer nga Erzurumi, që mendohej ta kalonte jetën fill për fill sipas vlerave të Sunnetit. Po ta shihnit në sy, do të vërenit tek ai atë brendi që të përkujton menjëherë Allahun. Një ditë këtij shoku i bëra një kërkesë të tillë: “Kur të shohësh gabimet e mia, ti më qorto. Po ashtu, kur të kesh ti ndonjë gabim, do të të qortoj unë.” Në këtë mënyrë, do t’i gjendeshim pranë njëri-tjetrit për të ruajtur të dy vlerat tona, për të ndjekur orbitën tonë në vendin ku na ka vendosur Allahu dhe për të mos shkuar në rrugë të gabuar. E pra, pas kësaj marrëveshjeje, kur pa se në sexhdet dhe në rukutë e namazit unë nuk i shprehja tesbihët në nivelin e duhur, një ditë më erdhi pranë e më qortoi kështu: “Ç’rend e ç’ngutësh në namaz ashtu, si akëcil njerëz! Atë gjendje aq pranë Allahut pse s’e pasuron plot e përplot me lutje?” Tani shikoni, megjithëse me të kishim bërë një marrëveshje vëllazërore për këtë çështje, më duhet ta pranoj me keqardhje të plotë se u trondita si një makinë që ka frenuar papritmas. Mirëpo lavdi i qoftë tim Zoti që u mendova e i thashë vetes: “Tash është koha t’i japësh hakun vullnetit. Duke qenë se kjo është detyra e tij, unë nuk duhet t’i kundërvihem. Fundja edhe unë e meritoja këtë. Duhet të tregoj kujdes për këtë hollësi gjatë namazit.” Një ditë tjetër, mbaj mend se edhe unë e qortova atë për një çështje. Besoj se edhe ai u trondit po në të njëjtën mënyrë.

E solla këtë shembull për këtë arsye: nëse ju ua thoni të tjerëve mangësitë e të metat në sy, jo gjithkush mund ta kapërdijë diçka të tillë me qetësi. Nga ky këndvështrim, ato çka do të thuhesh në të tilla situata duhen shprehur në mënyrën e duhur. Sa e hijshme dhe sa e këndshme është për këtë rast mënyra e Zotërisë së Zotërinjve (sal‘allahu alejhi uesel‘lem)! Sikurse edhe e dini, kur dikush shfaqte ndonjë të metë, Ai nuk ia vinte në dukje këtë në sy të bashkësisë dhe nuk luante me nderin e tij. Menjëherë ngjitej në minder dhe duke iu drejtuar njerëzve në përgjithësi, mundësonte që edhe personi që kishte të metën të vetëkorrigjohej, edhe të tjerët të merrnin mësim. [20] Kështu, edhe personi në fjalë nuk fyhej, edhe një gabim nuk lihej të mbetej gabim, por vihej në orvatjen për ta përmirësuar. Prandaj duhet ta lexojmë mirë karakterin e njeriut që kemi përballë, duhet të vlerësojmë se deri në ç’masë mund të reagojë ai dhe sipas kësaj të vijojmë në rrugën e gjetjes së mënyrave alternative të komunikimit. Në të kundërt, duke dashur të përmirësojmë të metat, nëse i fyejmë e i lëndojmë njerëzit përmes ndonjë gabimi që mund të bëjmë në mënyrën e komunikimit, mund të përballemi me rrëzimin dhe rrafshimin e gjithçkaje dhe të vijmë në përfundime që as që i kemi pritur.

[10] El-Bejhaki, Shuabu’l-iman 6/22; El-Kudai, Musnedu’sh-Shihab 1/336.

[11] Hatib el-Bagdadi, Tarîhu Bagdad 10/187; Ed-Dejlemi, El-Musned 2/324.

[12] Et-Taberi, Hulasatu sijeri Sejjidi’l-besher f. 87; Es-Safedi, El-Vafi bi’l-vefejat 1/72.

[13] Shih: Ahzab, 33/21.

[14] Tirmidhi, Birr 15; Ebu Davud, Edeb 58; Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 2/185, 222, 4/358.

^[15] Muslim, Fedail 76; Ebu Davud, Edeb 12; Ibn Maxhe, Zuhd 16.

^[16] Shih: Buhari, Xhihad 52, 61, 97, 167; Megazi 54; Muslim, Xhihad 78-80.


^[17] Teube, 9/25.

^[18] Shih: Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 7/298; Ibn Sa'd, Et-Tabakatu'l-kubra 2/151-149.

^[19] Shih: Bediuzaman, Letrat f. 66-67 në variantin në gjuhën turke (Letra e Gjashtëmbëdhjetë, Pika e tretë).

^[20] Shih: Buhari, Ejman 3, Hijel 15; Muslim, Imaret 26, 27, 28, 29.

Nënshtirimi dhe asketizmi



Pyetje: Si duhet kuptuar asketizmi në drejtim të përmbushjes së adhurimeve me ndezullinë për Xhenetin, me frikën prej Xhehenemit, me ndjenjën e dashurisë dhe me vetëdijen e adhuruesit kundrejt të Adhuruarit? Nga ky këndvështrim, ç'janë kategoritë e sikurtregtarëve, të trupnorëve, të ndijesorëve dhe të të apasionuarve?

Përgjigje: Siç e kemi shprehur edhe më herët në raste të ndryshme, dëshira për Xhenetin, të kërkuarit e Xhenetit, është tjetër çështje, dhe lidhja e adhurimeve me një dëshirë e me një kërkesë të tillë është krejt tjetër çështje. Po, njeriu duhet të ushqejë dëshirë për Xhenetin. Por ibadeti nuk duhet assesi të kryhet me dëshirën për Xhenetin dhe nuk duhet parë si një shkak e shkallë për të hyrë në Xhenet. Ndoshta detyrat dhe përgjegjësitë tona si robër, përujja që ne i paraqesim Fuqisë së Pafundme dhe Mëshirës së Paanë duhen parë sipas shkallës së nënshtirimit. Ndërsa çështja e hyrjes në Parajsë duhet pritur veçmas si një mirësi prej Zotit të Madhëruar. Në një hadith fisnik që e pohon këtë, Zotëria ynë, Profeti (sal' lallahu alejhi ues'sel'lem) urdhëron e thotë: “Kurrkush nuk hyn dot në Xhenet me veprat e veta.” Kur dëgjuan këtë, sahabët e nderuar pyetën: “As Ti, o i Dërguari i Allahut?” Fakti që sahabët e nderuar i drejtuan Profetit me një pyetje të tillë për të përcaktuar gjendjen e vet, tregon shumë për mençurinë e tyre. Pra, nëse çështja testohej te Zotëria ynë (alejhis'salatu ues'selam), do të ishte më e lehtë për ta që të kuptonin gjendjen e tyre. Dhe Profeti ynë u përgjigjet duke thënë: “Po, as unë nuk hyj dot në Xhenet vetëm falë veprave të mia. Veç nëse Zoti i Madhëruar më fal mëshirën e më lartëson me mirësitë e Tij.” [21]

Në pyetje përmendet edhe përmbushja e adhurimeve me dashuri krahas ndezullisë për Xhenetin dhe frikës prej Xhehenemit. Ta pohojmë sakaq se krahas dëshirës për Xhenetin dhe frikës prej Xhehenemit, vënia në vend e adhurimeve duke u strehuar në dashurinë, madhështinë dhe lartësinë e Zotit të Gjithëfuqishëm është një hollësi që duhet pranuar deri në njëfarë mase. Ne i lutemi e i përgjero kemi Zotit tonë dhe na i mbush të Ai zemrat e secilit prej nesh me ato ndjenja të frikës e të respektit që duhen ndier ndaj Lartësisë së Tij të paanë! Përmbledhtazi, mund të themi se përballë madhësisë dhe lartësisë së Allahut, në një drejtim, ndjenja e të qenit i nënshtuar mbart më shumë rëndësi sesa të kërkuarit të Xhenetit dhe të larguarit prej Xhehenemit.

Ai nuk e lë në baltë askënd që i mban sytë nga qielli

Ndërsa hollësia e fundit që është përmendur në pyetje është çështja e përmbushjes së adhurimeve me vetëdijen e adhuruesit kundrejt të Adhuruarit. Në këtë pikë, nëse më lejoni, do të shpreh edhe një herë një çështje ashtu siç shprehet për të Zotëruesi i së Vërtetës: Zoti është i adhuruar për arsyen se është Zot. Pra, duke qenë se Allahu është i Adhuruari Absolut, Pikësynimi i Natyrshëm, i Dashuri i Vërtetë, ne e adhurojmë Atë. Në fakt, për shkak të pamjaftueshmërisë së termave, këtu përdorëm fjalën “është”, që shpreh qenie. Ndoshta kjo e vërtetë do të ishte e drejtë të shprehej në këtë mënyrë: Allahu është Allah dhe për këtë arsye nënshtrimi ynë në robërim ndaj Tij është e drejta e Tij, ndërsa për ne kjo përbën borxh dhe detyrim.

Tani, duke e parë çështjen nga ky këndvështrim, atyre që i lidhin adhurimet e tyre me dëshirën për Xhenetin u themi *tregtarë*, atyre që marrin si thelbësore frikën prej Xhehenemit u themi *trupnorë* ndërsa atyre që janë në gjendjen e nënshtrimit me ndjenja të frikës e të dashurisë u themi *ndijesorë*. Tregtarët gjenden në kuadrin e shkëmbimit e të tregtimit. Mendësia e tyre është: “Unë po kryej adhurim, po fal namaz, po mbaj agjërim, po jap zekat, andaj Ti më jep Xhenetin.” E në fakt, siç shprehet edhe në ajetin e shenjtë, “Vërtet, Allahu u ka dhënë si shkëmbim Xhenetin teksa u ka blerë besimtarëve shpirtrat dhe pasuritë e tyre.” [\[22\]](#), atë që gjithë ç’ka ia jep gjithçka Allahut, edhe Allahu nuk e lë kokulur.

“Të Madhin Zot në e do,

Ai vetë si mos të të dojë?

Kujt rend kah kënaqësi e Tij

I Larti a s’ia jep kënaqësinë?

Në derë të Perëndisë

Shpirt e xhan në flijofsh,

Në bëfsh siç ka urdhëruar,

Allahu a të lë pa shpërblyer?

Si ujë në gurgullofsh,

Si Ejubi në lotofsh,

Kraharorin në e ndezsh,

Hallin a nuk ta qan?”

(Muhamed Lutfi Efendiu i Allvarit)

Po, po! Zoti i Madhëruar nuk lë askënd duarbosh e kokulur. Krahas kësaj, nëse i lidh adhurimin e nënshtrimin tënd me mendimin për Xhenetin, je si një ndër tregtarët që merren me shitblerje në treg. Mirëpo veprat e kryera prej teje nuk e kanë vlerën e mirëfilltë të mirave që ti kërkon.

Kategoria e të apasionuarve

Ndërsa atyre që, duke qëndruar jashtë konceptit sikurtregtar dhe trupnor, nuk e lidhin vetëenështrimin e tyre me asnjë pritshmëri, që nuk vihen në pritje të ndonjë shpërblimi, por i qëndrojnë thjesht mendimit “Dashuria ndaj Zotit është e drejta e Tij dhe detyra jonë”, u themi *të apasionuar*. Mexhnuni nuk rendi pas Lejlës që ajo t’i jepte diçka. Edhe dashuria e Ferhadit ndaj Shirinit, që çau malet për të arritur pranë asaj që dashuronte, nuk mëtonte asfarë shpërblimi material. Po kështu mund të mendoni edhe për sa e sa të tjerë, të dashuruar. Po, po! Me qindra të dashuruar, pa pritur kurrfarë dëshire për përfitim, janë ndezur prej ndjenjave të dashurisë. Madje shumë herë, ata të dashuruar, pasi i kanë arritur ato që kanë dashur plot pasion, janë zhgënjyer. Për shembull, në historinë e Fuzuliu, të shkruar përmes thellësisë së mistikës, mbërritja e njëri-tjetrit prej Mexhnunit dhe Lejlës nuk qe veçse një pengesë mes të dyve, sepse Lejla që ai dashuronte ishte veç Lejla e ëndrrave të tij. Ai, në ndjenjat e veta dhe në gjerësinë e botës së tij të brendshme, ishte Mexhnuni i marrë i Lejlës që i kishte dhënë shpirtin e i kishte rrëmbyer zemrën. Sa bukur shprehet kjo në disa vargje: *“I Lejlës është Mexhnuni, i Shirinit Ferhadi / E unë jam mjerani i dashurisë së marrë.”* Po, po! Duhet të jemi mjeranët e dashurisë së marrë. Veç duhet vajtuar për Të, dhe kjo s’duhet lidhur me interesin që tregojnë të tjerët.

Asketizmi dhe largimi prej vetjes

Për të ardhur tek asketizmi, në Kuranin e Shenjtë, në ajetet e para që kanë mbërritur që me suren “Muzem’mil”, [23] ai është një ndër çështjet e para që i është urdhëruar Zotërisë sonë [24] Profeti ynë (alejhiss’alatu ues’selam), kundrejt vështirësisë së zbulesës, tjetërsimit të botës, ndryshimit të dimensioneve, hapjes së portave të botës shpirtërore, dalëngadalë po rehabilitohej prej Zotit të Madhëruar në marrëdhënie me mesazhin që do t’i jepej. Sepse detyra që do t’i ngarkohej, për shkak të nevojave njerëzore, ishte shumë e rëndë. I Dërguari i Allahut (sal’allahu alejhi ues’sel’lem), pavarësisht të qenit i pajisur me cilësitë më të përkryera, kur i erdhi zbulesa e parë ndjeu emocion e ndoshta, në njëfarë mënyre, edhe drithërima në zemër. Për këtë arsye, u struk nën mbulesë dhe tha: “Më mbuloni, më mbuloni!” [25] E atëherë, Allahu (xhel’le xhelaluhu) zbriti ajetin fisnik: “O i mbuluar, ngrihu, kaloje i zgjuar, në adhurim një pjesë të vogël të natës!” [26] dhe në të njëjtën sure, duke iu drejtuar Atij, urdhëroi e i tha: “Dhe kushtoj Atij me vetëdorëzim!” [27]

Vetëdorëzimi, apo asketizmi, duke qenë se përdoret në një kapitull që shpreh rëndesë, mbart këtë kuptim: “Mos u mjafto duke i prerë lidhjet me lëndoren veç një herë të vetme, por tregohu i qëndrueshëm e këmbëngulës në këtë rrugë dhe shtrëngoje veten. Pavarësisht se mund të kesh dëshira, familje, që gjenden të rrënjosura në natyrën e qenies e të krijimit, ti mos i burgos këto në botën tënde njerëzore të mendimit e të vetëdijes; bëji, por çliroji prej materiales, zhvishi prej ekzistencës fizike, duke u ngjitur në orbitën e zemrës e të shpirtit, me gjithë individualitetin tënd drejtoju Allahut, shih dhe rend kah Ai.” Siç do të kuptohet prej fjalës së fundit të ajetit, përtej tebettulit të qëllimshëm e thelbësor, shfaqja e cilësisë së ndërprerjes së lidhjes me gjithçka është

vetëdorëzimi i plotë. Dorëzimi që vjen në trajtë të përforcuar gjuhësore, është për bollëkun. Mirëpo zbatimi i braktisjes së dëshirave egoiste bëhet vetëm në sajë të asketizmit. Pra, mbërritja në horizontin e ndërprerjes së lidhjes me gjithçka, arritja e asaj maje, realizohet vetëm përmes rrugës së asketizmit. Atë që e arrin këtë majë e quajmë “betul”. Kjo është arsyeja se pse nënën tonë, Merjemin, e kemi quajtur Betul. [28] Ajo, megjithëse përreth kishte gjithçka, nuk pa kurrëgjë tjetër veç Allahut, e vështroi Atë me sytë e besimit, u fokusua, u përqendrua dhe duke prerë të gjitha lidhjet me botën, u mbyll në mihrab dhe në sajë të këtij veçimi nisi të ushqehet me frytet e amshimit. Kurani Fisnik e shpjegon këtë gjendje duke shprehur këto fjalë: “Zekerija, sa herë që hynte në dhomëzën brenda faltores ku ndodhej ajo, gjente aty ushqime të freskëta.” [29] Kur Zekerija fisnik pyeste: “O Merjem! Ku i gjen këto ushqime?” [30], merrte këtë përgjigje: “Këto më dërgohen prej Allahut. Pa dyshim që Allahu, kujt të dëshirojë, i dhuron pa masë” [31] Po, po! Kur shkëputesh e i pret lidhjet prej botës, gjithçka vihet në shërbimin tënd. Në këtë çast, mund t’i kujtojmë edhe një herë fjalët e Imam të Allvarit:

“Si ujë në gurgullofsh,

Si Ejubi në lotofsh,

Kraharorin në e ndezsh,

Hallin a nuk ta qan?

Për dertin Shërim është ky dert Dertliun e do m’i Madhi,

Për hallin shërim i Vetmi,

A s’mbërrin tek ti Mirësi e Tij?”

E pra, Nëna jonë, Merjemi, prej domosdoshmërisë së çuarjes në vend të detyrës e të misionit për të qenë nënë e Mesisë së nderuar dhe për t’u mbarsur me një shtatzëni hyjnore, i ndërpreu lidhjet me gjithçka. [32] Kur ajo i ndërpreu marrëdhëniet me botën, edhe Allahu (xhel’le xhelaluhu) urdhëroi e i dha asaj një fëmijë më të vyer se mijëra, miliona njerëz, siç ishte Mesihu i nderuar.

Të dëlirësohesh e të veçohesh

Nëna jonë Merjemi, në çështjen e ruajtjes së nderit ishte aq e ndjeshme, saqë edhe kundrejt një qenieje shpirtërore u drithërua e tha: “Mbështetem në mbrojtjen e Zotit prej teje. [33] Për shkak të këtyre veçorive, asaj i janë dhënë emrat “Betul” dhe “Azra” (e dëlira). [34] E pra, pavarësisht ekzistencës, duhet prerë lidhja me gjithçka dhe duhet të dëlirësohemi e të veçohemi kësisoj, të orientuar nga njësia hyjnore. Kur Bediuzaman Said Nursiu hapte kuturu “Mektubatin” e Imam Rabbaniut, duke synuar të nxirrte mësim prej tij, Imam Rabbaniu i thoshte: “Drejtohu kah njësia!” [35] duke e orientuar kështu më së miri. [36] Pra, mos u huto duke parë herë në këtë e herë në atë drejtim. Nëse një herë bie pas dëshirash për të ardhmen, një herë pushtohesh prej pasionit për famë, një herë lidhesh pas dëshirës për karrige apo drithërohesh prej frikës e

shqetësimit, atëherë hutohesh dhe humbet. Në të vërtetë, të gjitha forcat dhe energjitë ti duhet t'i përqendrosh në një pikë të vetme, duhet ta shposh atë çka duhet shpuar, ta thyesh atë çka duhet thyer dhe kështu, duke u zhveshur prej zhguallit, të gjesh Atë. E pra, asketizmi është pikërisht titulli i të ecurit në një udhë e në një rrugëtim të tillë.

Zoti i Madhëruar, pasi e lartësoi Tablonë e Krenarisë Njerëzore me misionin e vështirë, thotë: ky mision është një peshë aq e rëndë, saqë nëse nuk bën asketizëm, nuk e ngrë dot. Ti mund të gjendesh brenda botës. Po, ti mund kesh një bashkëshorte të mirë që quhet Hatixhe, mund të kesh bija të bekuara si Zejnebi, Rukija, Umu Gulsumi. Por ato, për sa u përket statusit të tyre, në familjen Tënde të lume janë veç nganjë amanet. Të drejtat e tyre do t'i respektosh vetëm në këtë kuadër. Përtej kësaj, Ti duhet të vështrosh vetëm kah Allahu. Shikimet e tua të thella duhet të kërkojnë kudo Allahun dhe në çdo rrugë duhet të ecësh drejt Tij. Në çdo vend duhet të largohesh prej vetes dhe t'i afrohesh Atij. Kjo mund të realizohet vetëm me asketizëm. O Profet famëlartë i strukur në mbulojën tënde! Çohu dhe mbarte atë barrë të rëndë të njerëzimit, rrëfeju atyre të vërtetat dhe rrugët që çojnë në Parajsë. Hapua sytë dhe mundësou që ta lexojnë mirë ekzistencën.

E pra për këtë, Zoti i Madhëruar urdhëron e thotë: [37] Përmende emrin e Madhërisëm të tët Zoti, kujtoje Atë sa më shpesh dhe më pas, për të arritur dorëzimin e plotë, hyr në rrugën e asketizmit. Përfitoje dorëzimin e plotë tek Allahu në atë rrugëtim. Shih t'i afrohesh horizontit, majës apo lartësisë së ndërprerjes së lidhjeve me botën. Sepse që atje do të këndellesh duke e parë ekzistencën tënde krejt ndryshe, do ta lexosh atë krejt ndryshe dhe do të jesh dëshmitar i plot e plot sendeve larushane.

Asketizmi absolut dhe relativ

Natyrshëm, siç ndodh me mirësitë dhe virtytet e tjera, edhe tebettuli mund të jetë absolut ose relativ. Më së pari Zotëria ynë, Shpirti i Ajkës së Krijesave (sal‘lallahu alejhi ues‘sel‘lem) është nderuar me atë absolut. Sepse Zotëria ynë, si njeriu më i lartë e më i përsosur, krahas respektimit të të drejtave të kësaj bote e të familjes, i respektonte plotësisht edhe detyrimet e adhurimit. Sipas shprehjes së Xhiliut, Ai vërtet që është njeriu i plotë e i përsosur. [38] Po, po! Ai është bërë një pasqyrë e tillë hyjnore, që duke e parë Atë nuk është e mundur të mos e shohësh Allahun. Prandaj edhe përfaqësuesi i asketizmit në kuptimin e plotë të fjalës është pikërisht Ai. Si gra shembullore për dhënien e vetes mund të shikoni Nënë Tonë, Hatixhen fisnike, që edhe në kohën e injorancës e ruajtji nderin e saj, më pas nënat tona Aishen dhe Fatmën e nderuar dhe pas tyre, sipas shkallës së vlerësimit, mund të përfshini në këtë kategori edhe bashkëshortet e tjera të dëlira. Sepse secila prej tyre ka kryer vepra të mëdha për të mbështetur e për t'i dhënë krahë misionit të profetësisë. Nëna jonë, e dlira Merjem, është ndër ato që përfaqësojnë asketizmin relativ që i afrohet më së shumti kuptimit absolut. Por siç u shpreh pak më përpara, edhe asketizmi mund të cilësohet si i përshkallëzuar dhe shkallët e ndryshme të tij, në të cilat mund të qëndrojnë gjithsecili, janë nga më të larmishmet. Nëse këtë gjendje do ta përfytyronim si një spirale që ngjitet drejt lartësisë, gjithsecili ka një shkallë për të qëndruar në këtë spirale.

Kështu, ndër këta ka beqarë që i janë kushtuar çështjes së lartësimit e të përhapjes së fjalës hyjnore. Sikurse në rastin e shumë prej sahabëve dhe tabiinëve, në historinë e Islamit, që prej Imam Neueuiut e deri te Mjeshtri i madh, Bediuzamani, është bërë fjalë për plot beqarë të tillë që i janë

përkushtuar tërësisht çështjes së Allahut. [39] Imam Neueuiu tregon se ushqehet me nga dy-tri kafshata në ditë, sa për të mbajtur trupin gjallë. [40] Kur pyetet për arsyen e kësaj sjelljeje, ai thoshte: “A nuk më thotë më pas Zoti: ‘Mos vallë të krijova që të hash ushqime, t’i tretësh dhe t’i nxjerrësh si jashtëqitje?’” Nga ana tjetër, thoshte edhe se të ushqyerit e shumë do t’i sillte gjumë, ndërsa kishte shumë gjëra për të lexuar e për të shkruar, saora duke parë si përparësi vetëm shërbimin ndaj fesë. [41] Por megjithatë duhet thënë se këto shprehje, edhe në qofshin përsiatje shumë të larta, duke qenë se përbëjnë një gjykim subjektiv, nuk janë mendime që duhen zbatuar medoemos, dhe prej të gjithëve. Sidoqoftë, duke parë qëllimet e dëlira të tij dhe të personaliteteve të tjera të mëdha si ai, në këtë pikë ata duhen mirëkuptuar. Veç kësaj, ata nuk ia kanë këshilluar kurrkujt tjetër pos vetes këto gjendje dhe nuk u kanë thënë të tjerëve: “Edhe ju duhet të jetoni se s’bën kësodore.”

Në shekullin tonë, teksa vërejmë personalitetin që është në të njëjtën linjë me Imam Neueiun, hasim në mendime të njëjta. Kur e pyesin “A ke menduar ndonjëherë për martesën?”, pasi shpreh brengosjen për braktisjen e një suneti të tillë, në një vlerësim të veçantë, thotë se të menduarit për hallet e botës islame e ka penguar prej të menduarit edhe për këtë çështjeje. [42] Duke vlerësuar këto fjalë të Saidi Nursiut fisnik, duhet ta kuptojmë atë brenda karakterit të vet. Sepse ai, brenda kushteve në të cilat ndodhej, ka parë të ngrihet flakë drejt qiellit, gjendje kundruall së cilës është shprehur kështu: “Kam përballë një flakë të tmerrshme. Brenda saj më digjet fëmija, më përflaket e më digjet besimi. Po rend të shuaj atë flakë, që të shpëtoj besimin tim. Rrugës del një gurë e do të më pengojë; po ç’rëndësi ka kjo? Përballë asaj flake të jashtëzakonshme, si mund të ketë vlerë një ngjarje kaq e vogël?” [43] Teksa shohim shprehjet e tij, përballemi me një karakter që vazhdimisht mendon me duart në ize dhe heq e vuan përballë vuajtjeve së njerëzimit. Ndaj edhe njerëzit që nuk e kanë këtë horizont, e kanë shumë të vështirë ta kuptojnë këtë gjendje. Por le ta theksojmë edhe një herë, se këto mendime të tyre nuk janë objektive, por subjektive. Për më tepër, ata vetë këto mendime e pikëpamje nuk i kanë përgjithësuar, nuk ua kanë paraqitur të tjerëve si një rregull objektive, duke mos i kthyer ato në mënyra sjelljeje për të nxitur njerëzit rreth vetes që të bëjnë të njëjtën gjë. Për këtë arsye, edhe nëse nuk themi dot se “detyrimi objektiv është siç kanë bërë ata”, atyre duhet t’ua njohim atë që u takon, sepse në të njëjën kohë këso mendimesh janë gjykime shumë të larta e madhore, janë përfundimi i të mbyllurit brenda ndjesisë së atij që nuk jeton për vete, por që jetëson të tjerët. Prandaj edhe kjo gjendje e tyre nuk duhet menduar në një formë asketizmi të ngjashëm me murgërinë. [44]

Duhet t’ju tërheq vëmendjen dhe te një hollësi tejet e rëndësishme që kam vërejtur në lidhje me temën dhe me këtë do ta përmbyll çështjen: çështja e asaj që mund ta quajmë asketizmin absolut, apo e ndërprerjes së lidhjes me çdo send dhe të refuzuarit e çdo gjëje, edhe nëse jetohet për një kohë të shkurtër në një rrugëtim shpirtëror, nuk duhet të kthehet në një gjendje të përhershme brenda rrjedhës së natyrshme të jetës. Nëse veproni kështu, pa e kuptuar aspak, u hapni portën keqpërdorimeve të ndryshme, sepse në jetën e njeriut, brenda kufijve të së lejueshmes, duhet të ketë gjithmonë një derë gjysmë të hapur. Natyrisht që ëndjet e dëfrimet brenda kufijve të së lejueshmes janë të mjaftueshme për t’u kënaqur. Po nëse e mbyllni atë rrugë, nëse nuk lini asnjë hapësirë për ta hapur atë derë, nëse nuk u mundësoni njerëzve që të përfitojnë prej atyre kënaqësive e këndelljeje që janë brenda kufijve të së lejuarës, atëherë rrisni mundësinë që ata të shkelin në të ndaluarën.

Po, po! Nëse duam që njerëzit, duke jetuar brenda kufijve të së lejuarës, të jetojnë një jetë brenda kornizës së asaj çka ka urdhëruar Allahu (xh.sh.), nuk duhet t'i mbyllim dyert e së lejueshmes në çështje si të ngrënit e të pirit, të jetës familjare, të krijimit të familjes e lindjes së fëmijëve. Sepse një njeri i krijuar brenda natyrës, i përkundur në djepin e nënës natyrë, i mëkuar me gjirin e nënës natyrë, nuk është e mundur të ndjekë një rrugë të kundërt me natyrën. Përndryshe, e prish natyrën e vet dhe pëson shformim në natyrën e tij të brendshme. E në të vërtetë, ndryshimi më i rëndësishëm që e dallon vetëdorëzimit asket prej murgërisë është pikërisht ky. Në rastin e asketizmit bëhet fjalë që nga njëra anë, me dëshirën për të dhënë jetë, të ngresh tendën në kërthizën e jetës dhe nga ana tjetër të hapesh pafundësisht për nga jeta e shpirtit, e ndenjës dhe e ëndjes, duke u gjendur gjithmonë në marrëdhënie të pandërprera me Allahun. Prandaj edhe kjo rrugë është më e paqtë, më e sigurt dhe më e besës.

[21] Buhari, Rikak 18, Merda 19; Muslim, Sifatu'l-munafikin 71-78.

[22] Teube, 9/111.

[23] Shih: Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-eusat 2/319.

[24] Shih: Muzzemmil, 73/8.

[25] Buhari, Bed'u'l-vahj 3, Tefsiru sure (96) 1, Tabir 1; Muslim, Iman 252.

[26] Muzzemmil, 73/1-2.

[27] Muzzemmil, 73/8.

[28] Shih: Ahmed Ibn Hanbel, El-Musned 1/202; Ibn Ebi Shejbe, El-Musanef 7/350; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 2/110.

[29] Ali Imran, 3/37.

[30] Ali Imran, 3/37.

[31] Ali Imran, 3/37.

[32] Shih: Merjem, 19/16-34.

[33] Merjem, 19/18.

[34] Shih: Ahmed Ibn Hanbel, El-Musned 1/202; Ibn Ebi Shejbe, El-Musanef 7/350; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 2/110.

[35] Imam Rabbani, El-Mektubat 1/87 (Letra 75).

[36] Bediüzzaman, Letrat f. 402 (Letra e njëzetetë, Çështja e tretë).

[37] “E përmende emrin e lartësuar të tët Zoti! Dhe ndaj Tij qëndro në rrugë të tebettulit.”
(Müzzemmil, 73/8)

[38] El-Xhili, El-Insanu'l-kamil 2/71-72.

[39] Shih: Abdulfettah Ebu Gudde, El-Ulemau'l-uzzab.

[40] Shih: Es-Subki, Tabakatu'sh-Shafiijeti'l-kubra 2/153; El-Jafii, Mir'atu'l-xhinan 4/183.

[41] Shih: Edh-Dhehebi, Tarihu'l-Islam 50/252; Ibnu'l-Imad, Shezeratu'dh-dheheb 5/356.

[42] Shih: Bediüzzaman, Udhërrëfyeni i grave f. 23-24.

[43] Shih: Bediüzzaman, Jetëshkrimi f. 615 (Analiza; citimet e dhëna prej veprës së Bediuzaman Said Nursiut janë të gjitha sipas variantit të gjuhës turke).

[44] Shih: Hadid, 57/27.

Begatia e plotë dhe kallinjtë që japin njëmijë për një



Pyetje: Respekti dhe dhembshuria për prindërit u përkasin atyre cilësive të mira që, në një kuptim të përgjithshëm, përmenden si një arsye për bekim e begatim. Një individ që dëshiron t'i shërbejë fesë së vet, në mënyrë që t'i shumëfishojë ato të mira që gëzon, cilave prej këtyre arsyeve të begatimit duhet t'u japë përparësi?

Përgjigje: Në mënyrë që një punë të jetë e begatshme, duhet që individi të jetë në vetëdijen e arsyes se “pse, përse” po e kryen atë punë dhe krahas kësaj të dijë shumë mirë se “si” ta bëjë atë punë, t'i përkushtohet asaj pune dhe të veprojë me mendimin sikur po e sheh Zotin dhe sikur edhe Zoti po e sheh atë; pra, lidhet më të kryerit e kësaj pune me ndërgjegjen e mirësisë. [45] Siç shprehet Bediuzaman Said Nursiu, besimtar i duhet të veprojë, të ecë, të ulet, të ngrihet, të hajë, të pijë, të jetojë me mendimin se është gjithmonë në vëzhgim. [46] Siç e dini, Zotëria ynë, Profeti Muhamed (s.a.s.) e përmend këtë çështje me fjalët: “Mirësia është që ta adhurosh Allahun sikur po e sheh Atë; sepse edhe nëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty.” [47] Po, po! Nëse ju do të jetoni në orbitën e vetëdijes së të qenit nën vështirimin e Allahut, atëherë do të jeni dëshmitarë e do të shihni se si prej vendit të mëshirës do të zbresin mbi ju shira e shira të bollshëm të begatisë.

T'ia njohësh të drejtën e vet vetes dhe familjes

Njeriu ka përgjegjësi e detyrime nga më të ndryshmet. Një hadith i shpreh kësime të këto përgjegjësi: “Zoti yt ka të drejta mbi ty, egoja jote ka të drejta mbi ty dhe familja jote ka të drejta mbi ty. Jepi gjithsecilit të drejtën e vet.” [48] Siç shihet, në krye të të gjitha përgjegjësive të njeriut renditen të drejtat e Qenies Hyjnore. Se cilat janë këto të drejta, është shpjeguar në Kuranin Fisnik dhe në Sunetin e Qartë. Këto të drejta, si besimi (*imani*), Islami dhe ihsani, janë detyrimet më parësore të njeriut.

Zotëria ynë, Profeti Muhamed (alejhis'salatu ues'selam), pasi na sjell ndërmend se kemi përgjegjësi kundrejt Allahut, urdhëron e thotë se edhe egoja, nefsi ynë, ka të drejta mbi ne. Nefsi ynë, që është krijuar si “ahsen-i takuim” (në më të bukurën trajtë) [49] dhe që është i vyer e i vlefshëm porsia një xhevahir e margaritar, nuk duhet ta shpërdorojmë kot së koti e në punë të padobishme. Në mënyrë që ta vlerësojmë atë në rrugën e drejtë, duhen bërë përpjekje për të arritur

pozita të larta si Xheneti Firdeus, fqinjësia me Profetin e Dashur dhe mbi të gjitha, për të fituar kënaqësinë dhe dashamirësinë e Zotit të Madhëruar. Nëse egoja nuk do të ishte potencialisht kandidate për këtë horizont, nëse nuk do të ishte krijuar me mundësinë për t'i arritur këto qëllime të larta, Allahu nuk ua caktonte njerëzve këto objektiva madhore. Po duke qenë se këto pikësnyime të madhërisme i janë treguar njeriut, atëherë do të thotë se njeriu është pajisur me atë çka i nevojitet për t'ia mundësuar vetes arritjen e tyre. Atëherë, siç e shtjellon edhe Bediuzaman Said Nursiu në *“Fjalën e Trembëdhjetë”*, një xhevahir i tillë, pa u shpërdoruar në pazar të bakërxhinjve, duhet vlerësuar e menduar për qëllime shumë më të vlefshme dhe duhet punuar që ato qëllime të arrihen. [50] E pra, vlera e vërtetë e njeriut nuk kuptohet brenda përmasave të kësaj bote ikanake. Nëse kërkoni të fitoni imanin, Islamin e ihsanin dhe të gjitha shtresat e jetës së zemrës e të shpirtit që prej tokës e gjer në yjësi, atëherë jeni duke rendur vërtet pas diçkaje të vyer e të çmuar. Ja, këto janë të gjitha të drejta të egos njerëzore. Prandaj edhe është i mangët konceptimi, sipas të cilit, të drejtat e egos janë vetëm që të mos vrasësh veten, të mos presësh dorën, këmbën, gjuhën, gojën, pra të mos e flijosh veten më kot. Për ta përmbledhur, moscenimi i egos do të thotë të mos ia cenosh asaj të gjitha të drejtat lëndore e shpirtërore që ajo ka.

Po kështu, edhe të drejtat e familjes ndaj teje nuk janë vetëm që të ulesh me ta e të kalosh bukur kohën e lirë, të bësh me ta biseda kafeje e t'u fitosh zemrat. Për ta thënë ndryshe, duke treguar kujdes vetëm për vënien në vend të të drejtave të tyre fizike, të drejtat e tyre nuk janë të përmbushura plotësisht. Krahas kësaj, atyre duhet t'u sigurohet një udhërrëfim për një jetë të zemrës e të shpirtit dhe t'u shërbehet porsì një gjilpërë busulle që u tregon gjithmonë drejtimin e kibles. Pra, ndër të drejtat e familjarëve të tu ndaj teje janë edhe që ti, si një individ besimtar, t'i ndriçosh duke u bërë të njohur të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), dhe t'u mësosh të jetojnë në mënyrë të njerëzishme. Krahas kësaj, e drejta e fëmijëve ndaj teje është që t'i ndjekësh gjithnjë si një kujdestar i vëmendshëm dhe të mos i lësh qoftë edhe një çast të vetëm ballë për ballë me të keqen e me të ligjtë. Natyrisht që këto përgjegjësi nuk mund t'i vësh në vend duke u nxehur, duke bërtitur, duke ushtruar trysni, duke ushqyer ndjenja urrejtjeje ndaj atyre që nuk kanë mendimet e tua, por duke vrarë mendjen, duke qenë pjesë e dhimbjeve të tyre, sipas shprehjes së poetit të madh Nexhip Fazëllit, *“duke i nxjerrë mendtë për hundësh”*, sipas rregullave të pedagogjisë e të psikologjisë, veçanërisht sipas metodës së udhërrëfimit që na ka lënë trashëgim Zotëria ynë, Udhërrëfyesi i Përkryer (sal' lallahu alejhi ues'sel'lem). E pra, të gjitha këto janë të drejtat e fëmijëve tanë mbi ne dhe këto të drejta të tyre duhen vënë plotësisht në vend.

Burimi i vërtetë i zbrazëtisë të fëmijët

Në një rrëfenjë tregohet: fëmija i njërit prej njerëzve të lartë të Allahut, duke dashur të bëjë shaka, u shponte mbajtëset e ujit njerëzve që mbartnin ujë prej një burimi shumë të largët. Në fillim, për hatër të atij njeriu të nderuar, askush nuk bëri zë për këtë punë. Mirëpo me kalimin e kohës gjendja nisi të bëhej e padurueshme, kështu që një a dy vetë shkojnë e ia rrëfejnë çështjen atij njeriu të nderuar. I nderuari nisi menjëherë të bënte një llogari me egon e vet, duke e vrarë mendjen se cili do të ketë qenë gabimi që ai vetë kishte bërë e që kishte sjellë në këtë përfundim. “Vallë ç'të kem shpuar e ç'të kem prishur unë, që im bir ta ketë trashëguar prej meje?” – tha me vete dhe nisi të rishikojë të shkuarën e vet. Duke qenë se të dashurit e Allahut i marrin si mëkate edhe të këqijat që u shkojnë në mend nëpër ëndërrime, do të ketë gjetur ndoshta plot të meta të vetja. Mirëpo në fushën e realitetit nuk i kujtohet asnjë mangësi e kësaj natyre. Atëherë shkoi tek e shoqja për t'ia

shpjeguar edhe asaj çështjen duke e këshilluar kështu: “Djali ynë prej shumë kohësh bënë diçka të tillë, po njerëzia, për shkak të mirësjelljes e të edukatës së mirë të tyre, nuk na paskëshin thënë kurrëgjë. Tani, ne duhet t’ia presim rrugën kësaj sjelljeje të papëlqyeshme. Mendohu një herë edhe ti, dhe rishikoj të gjitha ngjarjet e jetës tënde.” Kaq duhej, dhe gruaja nis të mendojë dhe më pas thotë: “Zotëri! Për Zotin, unë nuk ia gjeta vetes një mangësi të tillë, por kur isha shtatzënë, pata shkuar në shtëpinë e dikujt. Po thurja dhe kisha grepin në dorë. Pashë një thellë portokalli. Me majën e grepit e preka pak dhe e futa në gojë.” Kur e dëgjoi këtë, i nderuari i tha të shoqes që të shkojë menjëherë te fqinji, t’i kërkojë falje për të drejtën që i ka shkelur dhe të ulet e të shprehë pendesë te Zoti.

Nuk kalon shumë, dhe fëmija, teksa shponte mbajtëset e ujit, papritmas tha me vete: “Unë jam i biri i filanit, që e njohin dhe e nderojnë të gjithë. A më shkon për shtat mua, si biri i një njeriu të tillë, të bëj lojëra të tilla të pahijshme? Falmë, o Zot!” Dhe rendi për tek i ati duke i thënë: “Baba! Unë deri tani kam bërë një gabim të tillë.” Kush e di, ndoshta në atë çast i ati, do t’i jetë përgjigjur: “O bir! Atë gabim nuk e bëre ti, por e bëmë ne me kohë.”

Kështu pra, prindërit duhet t’i ndjekin nga afër fëmijët e tyre dhe të mos u japin rastin që ata të shkaktojnë prishjen e ndonjë gjëje. Sepse një mangësi e juaja, në mos te ju, del te fëmija, dhe sërish do të jeni ju ata që do ta vuani prej dhembshurisë prindërore për fëmijën. Faqe Allahut, ju do të turpëroheni e do të ulni kokën kundrejt kësaj gjendjeje të fëmijëve tuaj ju do ta përjetoni hidhërimin dhe vuajtjen. Gjithsesi kjo është një rrëfenjë. Mirëpo në lidhje me rrëfenjat unë i varfri kam një mendim. Them se në rastin e rrëfenjave, nuk duhet parë vërtetësia e thelbit të tyre, por përmbajtja që ato bartin.

Rrugët e largimit të të këqijave

Në hadithin e përmendur pak më parë, duke shkuar më tej mbi këto tri shtylla që tregojnë Krenaria e Njerëzimit, Profeti ynë (sal‘allahu alejhi ues‘sel‘lem), [51] mund të themi se kombi ynë dhe mbarë njerëzimi kanë disa të drejta kundrejt nesh. Sepse edhe nëse në hadith këto nuk përmenden në mënyrë të drejtpërdrejtë, vërejmë përmes pikësnyimesh që na tregohen nga hadithe të tjera, se këto të drejta ekzistojnë. [52] Për këtë arsye, të drejtat e kombit tonë dhe të mbarë njerëzimit ndaj nesh, mund t’i vlerësojmë brenda të njëjtës kategori. Po, po! Është detyrimi ynë që ta drejtojmë e ta lartësojmë sërish përmendoren e myslimanëve dhe që nga sot vënia në vend e këtij detyrimi është një e drejtë e myslimanëve ndaj nesh. Qoftë për nga dinamikën e udhëzimit, qoftë për nga rruga dhe metodat, qoftë për nga të tjera mundësi që na janë krijuar, na është lënë amanet që ta lartësojmë emrin e myslimanëve me vlerat, thelbin dhe shpirtin e vet. Nëse disa e kanë kryer në një mënyrë apo një tjetër këtë detyrë e më pas na e kanë lënë amanet neve për ta vijuar më tutje, përbën një detyrim për ne që të respektojmë detyrimet e lindura prej kësaj të drejte. Sepse gjer më sot, dertlinjtë e këtij ideali, duke vuajtur sa e sa dhembje burgjeve e qelive dhe duke shkuar një jetë të tërë në syrgjyn, duke hequr njëmijë e një vuajtje e duke iu nënshtruar çdo lloj dhune, e kanë prurë këtë amanet gjer në ditët e sotme dhe na e kanë lënë më pas neve. Prandaj edhe që t’i dalim për zot atij amaneti është e drejta e tyre, dhe njëherazi detyrimi ynë.

Po kështu, për sa u përket njerëzve që shohin shtrembër, që atyre t’u mësohet sistemi i shikimit dhe t’u korrigjohet këndvështrimi, është detyrimi ynë karshi mbarë njerëzimit. A nuk urdhëron e

thotë i Dërguari i Allahut (alejhis'salatu ues'selam): “Cilido prej jush që sheh një të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e vet. Në mos pastë fuqi për këtë, ta ndryshojë me gjuhë. Në mos pastë fuqi as për këtë, le të mbajë qëndrim me zemër ndaj saj. Por kjo e fundit është më e ulëta shkallë e besimit.” [53] Pra, nëse i ke mundësitë, nuk do të krijosh hapësirë që njeriu që ke përballë të zhytet në të keqen, por në vend të kësaj do të bëhesh shkak që ai të kridhet në të mira. Do ta zësh për dore, do ta marrësh e do t'i tregosh mihrabin dhe kiblen e vet. Nëse këtë ke mundësi ta bësh me dorën tënde, asisoj do ta bësh. Nëse nuk i ke mundësitë që ta realizosh me duar, atëherë do t'i hysh rrugës së udhërrëfimit me një gjuhë të butë. Nëse as këtë s'e bën dot, atëherë do të vlerësosh mundësi të tjera. Sipas rastit, duke ndërprerë marrëdhënien e përzemërt dhe duke mbajtur një qëndrim, do të përpiqesh ta çosh në vend këtë detyrim duke thënë: “Nuk e prisja këtë nga një njeri me mend në kokë si ti!”

Jo me zemërim, duke skërmitur dhëmbët, duke u nderur në fytyrë e duke lëshuar shprehje si “Ore i mallkuar!”, por duke shpërfaqur një sjellje të dhembshur prej besimtari, duke iu drejtuar zemrës, duke rikujtuar një kohë kur ai ka shprehur anët më njerëzore, do të përpiqesh t'i tregosh rrugën e drejtë. Në qoftë e nevojshme, duke u ulur e duke pirë me të një filxhan çaj, do të mundësosh që ai të zbutet e të ndryshojë vetveten. Edhe kur bëhet një injeksion, në mënyrë që maja e mprehtë e ages të depërtojë me lehtësi, të sëmurit i thuhet që të mos shtrëngoje muskujt. Prandaj edhe fjala e butë dhe sjellja e mirë, një buzëqeshje e singertë, mund të bëjnë të mundur që bashkëbiseduesi të çlirohet prej ashpërsisë dhe zemërimit. Pastaj, në një atmosferë të tillë të butë, mund të rrjedhësh te bashkëbiseduesi si një dritë, si një nur, si një rreze ndriçuese; mund të ulesh e të zësh vend në zemrën e tij dhe t'i heqësh udhë atij në bukuri e mirësi. Ja pra, këto u përkasin sjelljeve që duhen bërë me zemër.

Begatia e plotë dhe pjekuria e sahabit

Sot shpirtrat e përkushtuar duket ta kenë marrë parasysh një detyrë të tillë universale me vendosmëri e këmbëngulje. Kjo nuk duhet marrë lehtë. Po, po! Ai fat i madh që patën sahabët, që nga sot u ka ardhur si një amanet zemrave të përkushtuara të ditëve tona. Mirëpo që kjo çështje të mbartë një kuptim për njerëzimin, që të jetë e qëndrueshme dhe të ketë jetëgjatësi, duhet që ata ta jetojnë jetën e tyre me një pjekuri prej sahabi. Po, po! Pjekuria e sahabit, serioziteti dhe sinqeriteti duhen ruajtur përgjatë gjithë jetës. E pra, shpirtrat e përkushtuar, të gjitha detyrave që u dalin, duhet t'u dalin për zot me një vetëdije të tillë, duhet të veprojnë me mendimin e ihsanit në ruajtjen e ndërgjegjes, duhet të ndalen aty ku duhet ndalur dhe njëkohësisht duhet ta rishikojnë shpesh vendin në të cilin janë ndalur; duhet ta rishohin dhe sipas rastit, duhet të thonë: “Unë nuk duhet të jem këtu, por pesë hapa më tutje. Madje jo pesë, por dhjetë hapa më tutje duhej të ndalesha. Po ç't'i bëj që s'po ia jap dot hakun kësaj pune!” E kështu, të rendin gjithnjë pas më të mirës. Nëse mundemi ta bëjmë këtë, atëherë Zoti i Madhëruar na mundëson begatim të plotë, ndërsa këto qëndrime e sjellje tonat, porsi farërat gjejnë tokën pjellore, prekin ajrin e ujët, hyjnë në kontakt me diellin dhe ecin drejt kallirit; ecin e shihni se ato farëra, sipas shprehjes së Kuranit, japin shtatë, shtatëqind e më tepër kallinj. Zoti ynë na dhëntë të gjithëve në fushën e shërbimit ndaj fesë të tillë bereqet e të tilla begati të bollshme!

[45] Shih: Buhari, Iman 37, Tefsiru sure (31) 2; Muslim, *Iman* 1.

[46] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 29 (Fjala e Gjashtë).

[47] Buhari, Iman 37, Tefsiru sure (31) 2; Muslim, Iman 1.

[48] Buhari, Saum 51, Edeb 86; Tirmidhi, Saum 45, Zuhd 64; Ebu Davud, Saum 57.

[49] Shih: Tin, 95/4.

[50] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 331-332 (Fjala e Njëzetetretë, Nënkreu i parë).

[51] Shih: Buhari, Saum 51, Edeb 86; Tirmidhi, Saum 45, Zuhd 64; Ebu Davud, Saum 57.

[52] Shih: Muslim, Fiten 19; Tirmidhi, Fiten 14; Ebu Davud, Fiten 1.

[53] Muslim, Iman 78; Tirmidhi, Fiten 11; Ebu Davud, Salat 239.

Kredia e admirimit



Pyetje: Në intervista dhe shkrime të ndryshme keni pohuar se admirimi i njerëzve ndaj zotërisë suaj është një gabim në gjykim, që gjithsesi, në këndvështrimin tuaj, përbën një shkak sprove për ju, që ju përpiqeni ta shfrytëzoni si një kredi për të orientuar njerëzit drejt së mirës. A mund të na i shpjegoni kuptimet që i ngarkoni “kredisë së admirimit”, por edhe mënyrën si e përdorni atë?

Përgjigje: Njerëzit e dhënë pas kësaj bote e burgosin vetveten veçanërisht në egoizëm e në egocentrizëm duke ngarendur gjithmonë pas përpjekjes për të fituar admirim e duartrokitje. Në këtë kategori mund të përfshini edhe disa zotërues të arteve e të dijeve dhe një pjesë të politikanëve. Pra, ndjenja dhe mendimi mbizotërues për këta njerëz është pritshmëria e admirimit të të tjerëve. Madje në ditët tona, edhe njerëzit që syrgjynosjen e vetvetes e pranojnë si një disiplinë themelore, në sjelljet dhe qëndrimet e tyre nganjëherë tregojnë se janë të ndikuar prej kësaj mendësie. Ndërkohë që nëse hedhim një sy kah historia jonë, vërejmë se besimtarët e vërtetë që thelloheshin në besim, përpiqeshin gjithmonë që të qëndronin larg këtyre qëndrimeve e sjelljeve. Për shembull, ashtu sikurse çliruesit e Stambollit nuk kishin kurrfarë pritshmërie për duartrokitje prej atij sukcesi të madh, edhe ata që u kthyen me fitore nga Beogradi nuk prisnin brohoritje. Javuzi i nderuar (aljehir’rahmetu uel-gufran), kur u kthye në Yskydar pas fushatave të Merxhidabikut e të Ridanijes, për t’iu shmangur brohoritjeve të popullit, qëndroi në Yskydar gjer në mesnatë dhe vetë pasi njerëzia kishin rënë në gjumë, pas mesnate, u nis e shkoi pa u ndier për në Sarajet e Topkapisë. Po kështu, teksa Kanuniu kthehej prej një beteje madhështore, zgjodhi ta kalonte natën duke fjetur në një vend të rëndomtë e me lagështi, ponjësoj Tarik ibni Zijadi, pasi ngadhënjeu në Spanjë, ra të flinte në një korridor të thjeshtë. Të gjitha këto ngjarje të mëdha historike duhen parë me vëmendje e duhen kuptuar po në këtë këndvështrim.

Shqetësimi për admirim e lartësim

Në terma të mistikës, këto qëndrime të shpërfaqura kundrejt egos së vet nga ana e këtyre personaliteteve të mëdha, quhen sundim i egos. Do të thotë që, , në çfarëdolloj pozite që të gjendet një besimtar, çfarëdo sukcesi që të arrijë, nisur nga të drejtat e egos së tij, ai duhet ta mbajë atë nën kontroll dhe të dijë si ta nënshtrojë atë. Kësimënyre, egoja kthehet nga urdhëruese në kritikuese, mandej nga kritikuese në frymëzuese, nga frymëzuese në qetësuese dhe së andejmi në këndellëse e në burim kënaqësie, madje sipas aftësive e zotësive të individit, ajo mund ta lartësojë atë në

shkallët e pastërtisë e të dëlirësisë duke bërë që t'i lërë pas edhe engjëjt. Por e gjithë kjo kalon më së pari nga rruga e të nënshtruarit të plotë të egos. E pra, një prej rrugëve të zotërimit të nefsit është të shmangurit prej admirimit të njerëzve. Edhe në qoftë se gjendemi pa dashje në një gjendje të tillë të admirimit, ajo duhet pritur me shqetësimin e lartësimit. Për këtë arsye, njeriu që ka marrë një edukatë të mirë shpirtërore, nuk e do dhe nuk e pret kurrë admirimin e njerëzve. Ndërsa kur mbetet ballë për ballë me rrethana që mund të përbëjnë një admirim të tillë, duke i hapur duart dhe zemrën Allahut, madje nganjëherë edhe pa rënë në sy me hapjen e duarve, gjatë një sexhdeje a rukuje apo gjatë tesbihëve, lutet me fjalët: “Të lutem, o Zoti im! Qoftë edhe një çast të vetëm mos më lër ballë për ballë me vetveten! Hiqma e largoma këtë ndjesi të pritshmërisë për admirim!”

Të shtypurit nën peshën e duartrokitjes

Kundrejt mundimeve dhe përpjekjeve të përbashkëta njerëzve që besojnë në drejtim të kënaqësisë së Zotit, kundrejt veprimit të tyre si një trup i vetëm, mund të ndodhë që prej Zotit të Madhëruar vijë mirësi, ndihmë e admirim. Për shembull, mund të themi, se si pasojë e kësaj ndihme e admirimi, prej njerëzve të Anadollit janë mundësuar shërbime aq të mëdha në të katër anët e botës. Indjeri Bylent Exhevit (qoftë i Xhenetit!), në lidhje me këto shërbime të kryera, kishte një mendim të tillë: “Shteti Osman, sipas standardeve botërore, ishte një shtet i madh për nga përmasat. Ai ishte në një pozitë që i lejonte t’u imponohej të gjitha shteteve. Por as edhe në atë periudhë nuk ka pasur një hapje kaq të madhe, të këtyre përmasave.” Kështu, përballë një shtrirjeje kaq të madhe, njerëzve mund t’u lindë një admirim i madh kundrejt njerëzve që gjenden pas kësaj hapjeje, kundrejt atyre që janë arkitektët e këtij mendimi, dhe në këtë mënyrë ata mund të nisin e t’i zmadhojnë ata në sytë e tyre. Madje nganjëherë ky admirim mund të shumëfishohet. Pikërisht në këtë rast, nëse një njeri nuk e ka sunduar dot egon e tij, nëse nuk i vendos punët në vendin e vet, nëse nuk arrin ta shohë mirësinë dhe ndihmën e Zotit të Gjithëfuqishëm pas shërbimeve të kryera, si dhe pas dinamikave si bashkërendimi, bashkëveprimi, marrëveshja, arsyetimi, atëherë mund të ndodhë që përballë të tralliset prej vlerësimeve dhe dashamirësisë së treguar prej njerëzve.

Prandaj edhe nga këndvështrimi juaj, “mospranimi i admirimit” duhet të jetë thelbësor për ju. Po, po! Çfarëdo suksesi që të arrihet në këtë rrugë, sikurse çdo mirësi e bukuri, begati e sukses, i duhet atribuuar veç Allahut dhe këtë s’duhet ta heqim asnjëherë nga mendja. Përndryshe, do të thyheni përballë admirimit, duartrokitjeve e brohoritjeve të njerëzve, duke mbetur nën peshën e këso vlerësimeve admiruese e lëvdatave ndjekëse të njëra-tjetrës. Siç mund t’ju kujtohet, kur dikush lëvdoi dikë tjetër për shkak të sukseseve në prani të të Dërguarit të Allahu (s.a.s.), Krenaria e Njerëzimit (alejhis’salatu ues’selam) urdhëroi e i tha: “Ja theve shpinën vëllait tënd!” [54] Sepse ndoshta bashkëbiseduesi nuk është në gjendje ta mbajë atë ngarkesë. Po ja që s’keni ç’bëni dhe njerëzit nuk i pengoni dot prej këtyre lëvdatave dhe duartrokitjeve. Veç të shihni dhe krejt plaçkën e luftës që është fituar prej ushtrive e gaborreve shkojnë e ia vënë përpara një njeriu të vetëm; ia vënë përpara e thonë fjalë si: “filani çliroi, filani krijoi, filani është yll e dritë e botës, është përmendore e paqes dhe e bashkimit.” Dhe ai i mjerë, edhe pse është në gjendje ta kuptojë se nuk i meriton të gjitha këto lavde, i pranon menjëherë të gjitha ç’thuhet. E pra, për këtë arsye themi se, me sa të kemi në dorë, duhet ta thyejmë admirimin e njerëzsisë dhe duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm për pozitën tonë prej robi e shërbëtori.

Për shembull ju, në një kohë kur janë shfaqur kërcënueshëm armët më të frikshme e më shkatërrimtare, po mundoheni e po përpiqeni që të hyni në çdo zemër, për të zbutur çdo shpirt, për të pajtuar njerëzit, duke u kthyer në shkak të paqes mes mbarë njerëzimit. Mund të ndodhë që Zoti i Gjithëfuqishëm t'ju mundësojë suksesin në një punë kaq të bukur. Prej kësaj, njerëzit shprehin admirimin e tyre ndaj jush dhe thonë “ai e bëri”, “ai e realizoi”, apo ca më keq, sipas një shprehjeje të gabuar të ditëve tona, “ai e krijoi”. Përballë gjithë këtyre mendimeve, njeriu duhet ta veçojë e ta përjashtojë veten duke mos i pranuar assesi këto lëvdata. Sepse të gjitha këto arritje janë veçse nganjë mirësi e Allahut, e dhuruar prej Tij për shkak të shprehjes së vullnetit tonë në rrethanat e pozitës sonë të ulët e të pafuqishme. Madje edhe vullneti ynë, i shprehur në nisje të punës, mund të na jetë dërguar prej Tij.

Admirimin ktheje në shërbim!

Por pavarësisht të gjitha këtyre, nganjëherë nuk jeni në gjendje ta shmangni admirimin e të tjerëve. Në kushte të tilla, duke pranuar dëmin më të vogël kundrejt një më të madhi dhe duke u kënaqur me të mirën më të vogël në pamundësi për të arritur të mirën më të madhe, duhet gjetur një mënyrë që edhe kjo të përdoret në të mirë të shërbimit. Domethënë, kur të tjerët shprehin admirim ndaj jush, nëse keni mundësi, ju duhet ta shndërroni atë admirim në kuptimin e tij të vërtetë dhe të mund ta meritoni vërtet atë. Për këtë arsye, në paçi në dorë një penel dhe teksa punoni me të nxirrni në pah një tablo mahnitëse, sërish duhet të jeni në gjendje të thoni me lehtësinë më të madhe: “Për Zotin e Madh! Këto i bën Allahu. Unë nuk kam as aftësinë, as përvojën e as horizontin e duhur për të nxjerrë në dritë një punë të tillë të përsosur.” Për shembull, Bediuzaman Said Nursiu, dashamirësve të vet që donin të vinin pranë tij për ta parë e vizituar, u thoshte fjalë të tilla, si: “Po pse të shpenzoni kot së koti aq parë rrugëve për të mbërritur tek unë! Më mirë uluni e rriini në një vend dhe lexoni veprat.” [55] Në këtë mënyrë, ai mendohej t'i largonte sytë e njerëzve prej atij vetë duke u munduar t'u tërheqë vëmendjen atyre në tjetër anë.

E pra, nëse njerëzit janë mbledhur rreth jush plot me admirim, nëse i dëgjojnë këshillat tuaja dhe ju nuk keni asnjë mundësi që ta shmangni këtë admirim të tyre, atëherë kjo dashamirësi e ky vlerësim, që vijnë si rrjedhim i një gjykimi të gabuar – ndërsa gabimet në gjykime, nëse bëhen prej vullnetit të mirë, mund të bëhen shkak edhe për të fituar shpërblime hyjnore – ju mund t'i vlerësoni duke i drejtuar për te punët që janë të nevojshme për t'u kryer. Natyrisht që njeriu që admirohet në rrethana të tilla është shumë e rëndësishme që të ketë një lidhje shumë të fuqishme me Allahun në mënyrë që të mos rrezikojë të thyhet përballë kësaj gjendjeje.

Në të njëjtën mënyrë, besimi dhe mbështetja e fuqishme të një ideal përmes një lidhjeje të thellë me të, përbën një kredi shumë të rëndësishme. E pra, kjo kredi duhet vlerësuar në të mirë të kombit tonë e të mbarë njerëzimit në mënyrën më fitimprurëse të mundshme. Për shembull, admiruesve tuaj mund t'u thoni kështu: “Institucionet e arsimit dhe mjediset kulturore kanë një rëndësi jetike për kombin tonë dhe për mbarë njerëzimin. Për këtë arsye, hapni shkolla në çdo vend, ngrini mjedise të kulturës. Nëse nuk e bëni dot të vetëm këtë, atëherë bashkujini kontributet tuaja, vlerësojini së bashku mundësitë që keni dhe kështu, nxisni punë e shërbime më të mëdha dhe në vendet e ndryshme të botës hidhni themele e ndërtoni platforma për të zbratur në zemra frymëzimet e shpirtit tuaj!”

Përndryshe, duartrokitjet e njerëzve për ju, fakti se ata ju vlerësojnë e ju ngrenë në qiell, nuk kanë asnjë dobi në llogarinë tuaj për jetën e amshuar. Po, po! Këto për ju nuk përbëjnë kurrfarë përfitimi, por vetëm përmbushin ndjenja të egos suaj. Madje këtë, më tepër sesa një përmbushje, do të ishte mirë ta cilësonim si një stres e shtrëngesë të vazhdueshme që e shtyn njeriun përherë në të tilla pritshmëri. Po! Një pritshmëri e tillë nuk shërben për asgjë tjetër përveçse ta bëjë njeriun edhe më të uritur për admirim dhe duartrokitje. Një njeri që ka mbërritur gjer në majën e administrimit të shtetit, kur sheh një kortezh prej njëqindmijë njerëzish tek shoqërojnë funeralin e një tjetër personaliteti si ai, e pyet veten: “Vallë, kur të vdes unë, a do të ketë kaq shumë njerëz që të më përcjellin?” More, po nëse ti vdes në kuptimin e vërtetë të fjalës, domethënë nëse je në jetë, por vret shpirtin dhe jetën e zemrës, atëherë edhe në ardhshin dhjetëfishi i asaj mase njerëzish në funeralin tënd dhe nëse të gjithë falin xhenazën tënde, ç’dobi do të kesh prej tyre?! Sepse gjithçka, gjer në derë të varrit të shoqëron. Pas asaj pike, ajo që ka vërtet rëndësi është lidhja jote me Allahun. Sa ishte në jetë, e ç’përmasave ishte marrëdhënia jote me Allahun? Me sa dashamirësi hyjnore ushqeheshe? A thoshe, “O Allahu im, të lutem të jesh i kënaqur prej meje!”? A kishe ndonjë lutje si: “O Allahu im! Më çliro mua prej burgut të egos dhe bëj që të mbërrij tek Ti. Më bëj krejt të afërt me Ty! Bëj që të mbërrij miqësinë Tënde!” Nëse nuk je lutur për diçka të tillë, atëherë edhe në të ardhshin në funeral me miliona njerëz, kjo nuk të bën ty kurrfarë dobie!

Për ta përmbledhur, nga njëra anë duhet të punoni për të shmangur admirimet e njerëzve ndaj jush, nga ana tjetër duhet që ato admirime, në një mënyrë apo në një tjetër, të përpiqeni t’i bëni të frytshme. Pra, kundrejt lidhjes së njerëzve pas jush, kundrejt mendimeve të tyre të mira për ju dhe pranimit prej tyre të këshillave tuaja, edhe ju duhet të ecni rrugës së pasurimit e të dhënies vlera për jetën e tyre në botën e përjetshme. Për shembull, nëse unë do të isha inxhinier agrar, atyre që do të më shihnin me besim në dritë të syrit do t’u shpjegoja rrugët e të qenit profesionist në bujqësi. Apo nëse do të isha një kimist i mirë, do t’u shpjegoja rrugët e të përfutuarit të dobisë nga anë e drejtime të ndryshme të kimisë. E pra, edhe nga këndvështrimi i profesionit tonë, orientimi i njerëzve te më e mira është një përpjekje e ngjashme. Kredia e admirimit duhet vlerësuar pikërisht në këtë mënyrë. Nëse kjo arrihet të realizohet, edhe ju shpëtoni prej së keqes, edhe ata nuk vuajnë pasojat e gjykimit të gabuar prej qëllimit të mirë, por marrin shpërblim e mirësi prej kësaj.

Por duhet pohuar edhe, se të presësh një sjellje të tillë nga gjithsecili, sidomos në ditët tona, është tejet e vështirë, sepse fama i ngjan asaj mjaltës së helmuar. Siç mund ta mbani mend, Ustadi i Nderuar, duke dashur të shprehet për këtë çështje, thotë: “Fama është pasqyrë e dyfytirësisë, si një mjaltë i helmatur që e vret zemrën. Ai e bën njeriun rob e skllav të njerëzve... Në rënsh në atë të ligë e fatkeqësi, thuaj: “Ne i përkasim Allahut dhe kur të vijë koha, pa dyshim që tek Ai do të kthehemi.” [56] dhe shpëto prej të keqes...” [57] Me këto fjalë, ai na tregon edhe për të keqen e famës, edhe për rrugën e çlirimit prej saj. Nga ky këndvështrim, nuk është e drejtë të mëtohet që me një lëvizje, me një frymë, njerëzit të ndryshojnë për mirë në brendinë e tyre, ta shkulin me këmbë, ta vënë në zotërim e ta kapërcejnë ndjesinë e famës. Nëse hyni në një pritshmëri të tillë, do të bini në zhgënjim. Përfundimi i duhur në këtë çështje mund të arrihet vetëm dalëngadalë, hap pas hapi dhe duke i përmirësuar njerëzit me durim.

[54] Buhari, Shehadat 16, Edeb 54, 95; Muslim, Zuhd 65.

[55] Shih: Bediuzaman, Shënimet e Kastamonusë, f. 20; Shënimet e Emirdag-ut-2 f. 169, 173, 194.

[56] “Ne i përkasim Allahut dhe kur të vijë koha, pa dyshim që tek Ai do të kthehemi.” (Bekare, 2/156)

[57] Bediuzaman, Mesnevia e dritës f. 73 (Shtojcë e piklës).

Qëndrim i ekuilibruar



Pyetje: Qëndrimi i ekuilibruar pranohet si një pikë kulmore në mistikë. Cilat janë aspektet e tij që prekin jetën tonë shoqërore? A mund të na i sqaroni?

Përgjigje: Fjala “*temkin*”, me një fjalë, qëndrimi i ekuilibruar, përmendet në forma të ndryshme në ajete të ndryshme të Kuranit Fisnik. Për shembull, në suren madhështore “Kehf”, për Dhulkarnejnin, që udhëtoi nga lindja në perëndim dhe mbërriti gjer në Murin Kinez apo në vendin ku ndodhen jexhuxhët dhe mexhuxhët, thuhet kështu: "Ne në botë atij i dhamë sundim (mukne) dhe për gjithçka që kishte nevojë i mundësuam mjete prej mirësisë Sonë." [58] Shprehjen “i dhamë mukne”, sikurse mund ta marrim në kuptimin që Dhulkarnejnit iu fal një sundim, pushtet e fuqi që të mos i shkelë kurrë këmba në dërrasë të kalbur dhe njerëzit t’ia dëgjojnë fjalën, mund ta kuptojmë edhe si dhënie të pozitës së të qenit element i ekuilibrit në ekuilibrin e shteteve. Kështu, kur ai udhëtonte në lindje, njerëzit e lindjes i drejtoheshin atij, kur udhëtonte në perëndim, njerëzit e perëndimit i drejtoheshin atij dhe kur udhëtonte në botën e jexhuxhëve e të mexhuxhëve, njerëzit e shqetësuar prej tyre i drejtoheshin sërish atij për t’i kërkuar zgjidhje. Në një mënyrë të ngjashme, në një periudhë të caktuar, për shkak të të qenit një element ekuilibri, kërkesat për zgjidhje i drejtoheshin gjithmonë Shtetit Osman. Për shembull, një ditë vjen Fransuai dhe duke iu drejtuar Sulltanit me shprehje si “Sundimtari im, Kreu im i Nderuar, Drita Shkëlqyese...”, i paraqet kërkesën për mbrojtje. E pra, ajo mundësi për të qenë element i ekuilibrit në ekuilibrat ndërshtetërorë, i cilësuar me shprehjen “mukne” në ajetin e shenjtë, në një kohë të caktuar i qe dhënë Dhulkarnejnit.

Në mënyrë që çështja të kuptohet më mirë në thelbin e saj, tablotë e larmishme, të shpërfaqura në suren madhështore “Kehf”, duhen parë të lidhura me njëra-tjetrën si një tërësi e plotë. Duke e parë, pra, nga ky këndvështrim, në secilën prej atyre tablove do të shihet se në ecjen materiale drejt pikës së mbërritjes bëhet fjalë për hapa e shkallë të ndryshme. Në këto tablo, para së gjithash, bëhet fjalë për periudhën e shpellë; [59] më pas, përmes shpjegimesh për zotëruesit e kopshteve, tërhiqet vëmendja te vënia në provë përmes të mirave të kësaj bote; [60] më pas shtjellohet një periudhë e re, siç është shoqërimi me Hizrin. [61] Më pas, para se të përfundohet çështja, përmenden shenjat e ajetet që do të mund të përbëjnë pengesë dhe barrierë kundrejt dexhalijetit, kundrejt jexhuxhëve dhe mexhuxhëve. [62] Në të vërtetë, edhe Zotëria ynë, Profeti (alejhis’salatu ues’selam), për t’u mbrojtur nga e keqja e Dexhalit, na ka këshilluar që në ditën e premtë të lexojmë dhjetë ajetet e

para ose të fundit të kësaj sureje. [63] Ndaj edhe çështja e muknes, pasi të shkosh në këtë rrugë e pasi të përjetosh kalimin në këtë shteg, është një mirësi që ta dhuron Zoti i Gjithëfuqishëm. Pra, sikurse një lagështirë mbërrin pikën e vesës dhe aty, duke u ngritur në re pozitive a negative, kthehet sërish në formë shiu për të rrjedhur në zemër të tokës, edhe për mbërritjen e një shoqërie në ngopjen lëndore e shpirtërore është shumë e rëndësishme që, për hir të mukne-s, të gëzojë atë pikë vese. E pra, të gjitha këto janë çështje që hyjnë te temkini.

Ekulibrimi i brendshëm – Ekulibrimi i jashtëm

Një ajet i sures “Haxh” shprehet se zotërinjve tanë, sahabëve fisnikë, në emër të mbrojtjes së pasurive, të erzit e të nderit, u lejohet të hyjnë në përpjekje materiale. Pra, në emër të kundërvënies ndaj dhunës dhe trysnive të armiqve të fesë, të mbyllur në armiçësi e urrejtje, si dhe për të treguar se që sot e tutje një dhunë e trysni e tillë nuk do të mund të ushtrohen më, ajeti urdhëron e thotë kështu: “Besimtarëve që iu është shpallur luftë, iu dha leje që të luftojnë, sepse ata iu nënshtuan mizorisë. Nuk ka dyshim se Allahu ka fuqinë që t’u japë atyre fitore.” [64] Më pas, Zoti i Madhëruar, duke thënë: “Ata besimtarë që, nëse u falim sundim mbi tokë...” [65] shprehet se atyre u ka dhënë “mukne” në faqe të dheut. Pra, Ai shpall se do t’i kthejë ata në një element ekuilibri në ekuilibrin ndërshtetëror dhe do t’u dhurojë mirësinë e temkinit. Zotërinjtë tanë, sahabët, duke kaluar nëpër atë rrugë, duke hequr vuajtjet e Mekës, do të mbërrijnë në Medinë, do të ndërtojnë aty vendqëndrimin e tyre dhe kështu, do të thonë: “Në ekuilibër jemi edhe ne, është edhe fjala jonë!” Zoti i Madhëruar urdhëron e thotë se në këtë rrugë do t’u krijojë atyre mundësi (imkan), do tu dhurojë temkinin prej mirësisë së Vet. Këto hollësi që i përmendëm si shembuj janë të ndryshme nga mënyra se si e kanë kuptuar sufistët teminin dhe sikurse shprehet edhe në pyetjen që është ngritur, janë të lidhura me atë anë të teminit që ka të bëjë me jetën shoqërore dhe fushën e shërbimit ndaj së Vërtetës.

Nuk duhet të mos e vërejmë se temkini i paraqitur prej sufistëve dhe ideja e temkinit që në tasavvuf pranohet si një pikë kulmore nuk përjashtohet krejt prej kuptimit të temkinit që kemi diskutuar më sipër. Por gjithsesi, mes dy koncepteve të temkinit është e qartë se ka një ndryshim. Sepse për sufistët, bota më e madhe është bota e brendshme e njeriut, bota e egos. E pra, sipas tyre, sado e madhe që të duket bota e jashtme, botërat janë të fshehura në botën e njeriut dhe gjithësitë janë të mbledhura në të. [66] Nga ky këndvështrim, temkinet e tjera mbeten të vogla në krahasim me temkinin që njeriu mbërrin në botën e egos së vet. Po, po! Dhulkarnejnizmi, Davudizmi, Sulejmanizmi kundrejt saj janë të vegjël. Edhe Junus Emreja, teksa shkruante “Sulejmani është brenda Sulejmanit”, ndoshta diçka të tillë ka pasur parasysh.

Jo spitullim, por përgjërim

Tani, për arsye të lidhjes mes të dyjave, ju lutem të ndalemi pak në idenë e temkinit nga këndvështrimi i jetës së zemrës dhe të shpirtit. Sufistët, nga këndvështrimi i marrëdhënies me Allahun, kanë zhvilluar një ide të temkinit. Kështu që dikush që shkon në rrugën e tarikatit, duke ecur hap pas hapi, mund t’i plotësojë të gjitha shkallët e ta përmbushë rrugën e vet. Pra, ai, duke u lartësuar tek Allahu për nga horizonti i zemrës dhe i shpirtit, në drejtim të sjelljes duke pranuar të qenët kalimtar përballë Allahut, e gjendjes përjetësi me Allahun dhe të mosekzistuarit pa

Allahun, mund të përdorë disiplina të ndryshme që kanë të bëjnë me moralin e lartë islam. Këto disiplina luajnë secila rolin e një shkalle në ngritjen (miraxh) dhe lartësimin (uruxh) e njeriut. Shprehjen “uruxh” që përmendëm, edhe nëse ajo ka kuptime të ndryshme nëse shqyrtohet në format “kavs-i uruxh”, “kavs-i nuzul”, sufistët e kanë përdorur në kuptimin e lartësimit të njeriut për tek Allahu. Madje për një njeri, që pasi ka përmbushur lartësimin në uruxhin vet, zbret sërish mes njerëzve, janë shprehur me cilësimin “suud” (i lumë, i bekuar). Pra, në hapat që hidhen e në shkallët që kapërcehen në rrugëtimin shpirtëror, mund, mund të konstatojmë njëqind disiplina. Por ndoshta për personalitete zotëruese të dijes e të perceptimit të thellë (jed-i tula) që, njëkohësisht, janë përfaqësues të jetës së zemrës e të shpirtit, si Muhjidin ibni Arabiu apo Ismail Haki Burseviu, këto shkallë janë njëqindpesëdhjetë. Tani ju, duke i kapërcyer të gjitha këto shkallë, me lejen dhe mirësinë e Allahut, mund të mbërrini në një pikë të caktuar. Duke mbërritur në mekamet e pranimit të të qenit kalimtar përballë Allahut, e gjendjes përjetësi me Allahun, ose të mosekzistuarit pa Allahun, mund të viheni në zotërim të një dëshmimi (shuhud) dhe njësimi (vahdet). Brenda jush mund të shfaqen mendimet e mbërritjes në të fshehtë absolute (gajb-i mutlak), në të vërtetën e të vërtetave (hakikatu'l-hakaika). E pra, në këtë pikë, për të mos rënë në antropomorfizëm dhe dimensionin e përcaktuar të hapësirës, themi për nevojë të qëndrimit të ekuilibruar se të gjitha këto gjendje, të përjetuara si kënaqësi e lehtësim, me çeljen e largpamësisë për nga këndvështrimi i ndjenjave dhe i veçantive të njeriut, kanë të bëjnë me mënyrën se si e sheh ai çështjen. Për ta shprehur ndryshe, kjo gjendje që përjeton ai që shkon kësaj rruge është rezultati i një dhembjeje dhe i një pasioni.

E pra, mbërritja në një pikë të tillë mund të sjellë me vete te njeriu mendimet e spitullimit. Domethënë, njeriu që mbërrin në maja të tilla, pa e vënë re fare, porsì struci që hedh hapat kryelartë apo si gjeli i detit që ecën duke u fryrë, mund të nisë të krekoset e t'i rritet mendja. Mirëpo është me rëndësi që ai që rrugëton në shpirtëroren, në botën e vet të mendimit, madje edhe në atë të përfytyrimit e të ëndrrave, të mos hyjë kurrsesi në çështje që mund ta çojnë në spitullim e mendjemadhësi. Po, po! Është me shumë rëndësi që robi, në çfarëdo shkalle që të jetë, të ruajë vetëdijen e robërimit ndaj Allahut, të mbetet gjatë gjithë kohës në mendimin e të qenit i robëruar absolut, i dashuruar absolut dhe zotërues i së drejtës për adhurim dhe kjo gjendje shpreh ekuilibrimin e tij. Pra, njeriu, edhe në qoftë në majë, duhet të gjendet në vetëdijen e të robëruarit, të mos shprehet si disa, në mënyra që nuk i shkojnë për shtat njeriut të përkushtuar ndaj Hyjnores; nuk duhet të flasë kot së koti e pa treguar as përgjegjësinë më të vogël.

Këto çështje që u përmendën janë shumë të rëndësishme, por shumë personalitete me peshë si Imam Suhreverdiu, Muhjidin ibn Arabiu, Molla Xhamiu (rrahmetullahi alejhim), kanë përdorur disa shprehje që, në pamje të jashtme, duken në kundërshtim me disa disiplina themelore të fesë. Edhe interpretimi, duke gjetur një mbështetjeje për këto shprehje përbën një aspekt të rëndësishëm të qëndrimit të ekuilibruar, sepse një qasje e tillë e shpëton njeriun prej rënies në mendim të keq për ta. Ata burra të mëdhenj i kanë përdorur këto shprehje në kushtet e mposhtjes prej gjendjes së ndjesive e të këndelljes hyjnore. Ndërsa ne nuk jemi njerëz të mposhtur as prej ndjenjës, as prej gjendjes, as prej këndelljes. Ne jo vetëm që nuk mposhtemi prej ndjenjës e këndelljes, por nuk ia dalim dot t'i shpëtojmë as egos sonë. Nga kjo pikëpamje, ndaj tyre duhet të sillemi me ekuilibër e vetëpërmbajtje dhe duhet të bëjmë kujdes që të mos biem në keqpandehma për ta.

Atëherë, në çfarëdo shkalle që të mbërrijë, në çfarëdo maje që të ndodhet, njeriu duhet ta mbështesë përherë këmbën në vend të sigurt dhe të ruajë gjithmonë vetëdijen e të robëruarit. Në mbyllje të

namazit, që për ne është adhurimi më i rëndësishëm për ne, pra, në te hijjat, që është miraxhi i ibadetit tonë dhe pika e mbërritjes tek Allahu, Zoti i Gjithëfuqishëm na e paraqet Zotërinë tonë, Nderin e Gjithësisë (sal’lallahu alejhi ues’sel’lem) me këto shprehje: “Dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut.” Nëse do të sjellim ndërmend se, sipas disa dijetarëve, kjo çështje u caktua në Miraxh, mund të themi se Zoti i Madhëruar e ka vlerësuar robërimin pikërisht në një vend të tillë. Pra, Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (alejhi salauatullahi ues’selamuh), në çastin kur ngjitet në majën e majave, i silltet sërish ndërmend të robëruarit. Edhe në nisje urdhërohet e thuhet: “Lëvduar qoftë Ai që e çoi robin e tij nga Mesxhid-i Harami në Mesxhid-i Aksa, rrethinat e së cilës ne i kemi bekuar, për t’i treguar atij shenjat Tona. Vërtet, Ai është Dëgjuesi, Vështruesi.” [67] Kështu, edhe këtu theksohet të qenit i robëruar edhe për Zotërinë tonë, Profetin.

Për rrjedhim, qëndrimi i ekuilibruar do të thotë të kuptosh dhe të jesh përherë në vetëdijen e të robëruarit, të vëthit në vesh, të gjerdanit në qafë, të zinxhirit në këmbë. Një personalitet i lartë siç ishte Mevlana, për Zotërinë tonë (alejhis’salatu ues’selam) thotë kështu: “Rob u bëra, rob u bëra, rob u bëra! Unë në shërbesë ndaj Teje sa një grusht t’u bëra. Robërit kur lirinë fitojnë, gëzojnë; unë se Ty rob t’u bëra ngazëllehem.” [68] Kur këtë çështje, në këndvështrim të marrëdhënies sonë me Allahun, e kthejmë nga Qenia Hyjnore, atëherë mund të themi njëmijë herë: “Rob t’u bëra, rob t’u bëra, rob t’u bëra.” E pra, kjo është një shprehje e temkinit, një frymëmarrje e temkinit, një gjendje që përkon me atë të velinjve. Duke ardhur tek temkini në jetën tonë të udhërrëfimit e të ftesës në besim, ai do të thotë që të përpiqemi t’i shfaqim njerëzimit fytyrën ndriçuese të fesë së qartë të Islamit, që duke ekspozuar një përfaqësim pa mangësi për të, që të thellojmë e të zgjerojmë të thënat e gjuhës përmes përfaqësimit vetjak dhe të paraqesim një stil jetese të atillë që kurrkush nuk do ta kundërshtojë, që kurrkush nuk do të ngurrojë ta pranojë. Natyrisht që për qëndrimin e ekuilibruar është shumë e rëndësishme, që rezultatet dhe frytet e arritura, njeriu të mos ia atribuojë vetvetes si merita dhe të mos hyjë në sjellje prej spitullani apo në ndjesi vetëkënaqësie për shkak të shërbimeve të kryera e të përpjekjeve të realizuara.

Për të mos rënë në shkarje të ekuilibrimin

Po, kundrejt disa arritjeve, njeriu mund të bjerë në vetëkënaqësi. Për shembull, si rrjedhim i mirësisë lavdiplote të Zotit të Madhëruar, në të katër anët e botës mund të jenë kryer shërbime shumë të bukura. Mirëpo, pavarësisht se arsyeja e vërtetë e tyre nuk jeni ju, këto vepra të bukura, në njëfarë mënyre, mund t’ju kthehen juve. Ata që bien në të tilla vlerësime e admirime, nëse në këtë gabim të gjykimit nuk e teprojnë, me leje të Allahut, nuk hyjnë në mëkat. Por nëse personi që i përfiton këto lëvdata dhe – Zoti na ruajtë! – kaplohet nga mendime si “vlerësimi është me vend”, atëherë do të thotë që ai është duke humbur në rrugë të fitores. Po, po! Kundrejt lëvdatave, admirimit dhe vlerësimeve, njeriu mund të shkasë nga trualli i nënshtrimit dhe të bjerë në spitullim. Për pasojë, mund të bjerë në shkarje të qëndrimin të ekuilibruar. Për shembull, nëse mendjen e një njeriu që shërben e përshkrijnë mendime të tilla si: “Shihni ç’po ndodh me ne. Shteti Osman, megjithëse ishte një shtet i stërmadh botëror, nuk mbërriti as në një të dhjetën e asaj ku kemi mbërritur ne!”, atëherë të tilla mendime do të jenë veçse një tregues krejt i qartë i përljerjes së frymës dhe të dhuratës hyjnore, si mendime krejtësisht në kundërshtim me ekuilibrimin. Nëse njeriu i vijnë në mendje të tilla mendime të dëmshme, atëherë ai duhet të jetë menjëherë në gjendje të thotë: “O Allahu im, ‘I denjë nuk jam unë, robi yt, për këto, / Përse vallë më ranë mua këso hir

e mirësi?’ (M. Lutfi) As unë s’po i marr vesh këto mirësi e arritje. Po ndoshta nganjëherë edhe më i vogli mund t’i vërë kësulë në krye më të madhit.”

Pra, ndërkohë që të gjitha bukuritë i duhen njohur Atij të Madhërishmi e të Lartësuari, ata që sillen si njeriu që i ndan vetes diçka prej plaçkës së luftës, që pushtohet prej një mendimi si: “kjo i përket Atij, ndërsa kjo tjetra mua, kjo është e Tij, kjo tjetra imja”, ata që shërbejnë duke thënë: “edhe ne vdiqëm, vdiqëm e u ringjallëm, edhe ne rendëm, rendëm e djersitëm, edhe ne bëmë këtë, edhe ne bëmë atë...”, me të tilla llogari veprojnë në kundërshtim me të qëndruarit me ekuilibër. Natyrisht që ne, duke u përpjekur me mish e me shpirt në rrugën e Allahut, do të punojmë me mish e me shpirt në shërbim, gjer në vetëflijm për idealet dhe, sipas shprehjes së Bediuzamanit, gjer në vetëflijm në vëllazëri. Sipas asaj që thotë njëri prej nxënësve të atij rrethi të ngushtë që merrnin mësim prej tij, kur ai po binte teposhtë një shpelle në qytetin e Vanit, edhe në ato çaste thirri veç: “Vazhdoni!” Më pas, edhe pse gryka e shpellës ishte e futur më përbrenda, ndodhi sikur një dorë e fshehtë e shtyu atë në shpellën më poshtë. Marr me mend se ai, edhe në çastin kur Azraili (alejhis’selam) ka shkuar t’i marrë shpirtin, do të ketë thirrur: “Vazhdoni!”

Zoti i Madhëruar na ruajttë prej asaj sjelljeje të rëndë të të krenuarit me shërbimet që kryejmë! Sepse kjo do të ishte mungesë vetëpërmbytjeje e ekuilibrimi në jetën tonë të shërbimit, me ndikim të keq në lëvizjen tonë. Në këtë çështje, temkin do të thotë që gjithçka t’ia njohim Allahut. Po, po! Njeriu duhet të thotë:

“Gjithçka prej Teje, Ti je i Begatë,

Zoti im, sytë ktheva nga Ti!

Edhe i Parë Ti je, edhe i Fundit!

Zoti im, sytë ktheva nga Ti!”

E kësisoj, duhet të mendojë: “Unë, porsì bulëzat mbi sipërfaqe të ujit që shohin diellin, në e kthefsha fytyrën nga Ti, vezulloj e ndriçohem. Veç atëherë mund t’i fsheh pasqyrimet e diellit në beben e syrit tim. Në të kundërt, nëse unë zhytem në errësirë, as diell s’mbetet e as pasqyrim.” E pra, ky mendim është shprehje e një temkini që i përket shërbimit ndaj fesë.

[58] Kehf, 18/84.

[59] Shih: Kehf, 18/9-26.

[60] Shih: Kehf, 18/32-44.

[61] Shih: Kehf, 18/60-82.

[62] Shih: Kehf, 18/83-98.

[63] Shih: Muslim, Salatu'l-Musafirin 257; Ebu Davud, Melahim 14; Darimi, Fedailu'l-Kur'an 18.

[64] Haxh, 22/39.

[65] “Ata besimtarë që, nëse u falim sundim mbi tokë...” (Haxh, 22/41)

[66] Shih: Sejid Ahmed Er-Rufai, El-Burhanu'l-muejjed f. 55; El-Munavi, Feyzu'l-kadir 5/366.

[67] Isrâ, 17/1.

[68] Mevlâna, Mesnevia 5/227.

Përkorja dhe pritja e kohës së duhur



Pyetje: Nga jeta jonë ekonomike në botën tonë të mendimit, cilat janë kuptimet që përkorja shpreh për ne? A mund ta vlerësoni përkorjen nga këndvështrimi i pritjes së kohës së duhur?

Përgjigje: Përkorje do të thotë të jetosh duke ruajtur masën e duke u sjellë me ekonomi, të blesh në masën e nevojave, e të konsumosh gjithashtu sipas nevojave, duke i qëndruar larg shpërdorimit. Për ta thënë ndryshe, siç shprehet me një stil lakonik në ajetin e shenjtë, përkorja është kjo: “Në gjithçka që Allahu të dhuron, përkujto vendin e jetës së përjetshme; ndërkohë, mos e harro edhe ç’ të takon prej kësaj bote!” [69] Pra, mundësitë e krijuara nga mirësia e Allahut të Gjithëfuqishëm duhen përdorur në rrugën e të fituarit të përjetësisë, por edhe kjo botë nuk duhet harruar dhe prej saj duhet përfituar në kuadrin e së lejueshmes.

Përkorja është arsyeja e begatisë. Ndaj edhe një njeri i vetëpërmbajtur e i kursyer, nga njëra anë shpëton prej shtrirjes së dorës, prej lypjes e prej turpërimit dhe nga ana tjetër përfiton prej begatisë hyjnore. Bediuzaman Said Nursiu, duke shpjeguar këtë çështje, na ka sjellë edhe shembuj nga jeta e vet. Për shembull, tregon se teksa gostiste nxënësit e tij me një okë mjaltë, e hante atë mjalt me ta tre muaj rresht pa e mbaruar dot. [70] Pasi ai vijoi udhën drejt horizontit të shpirtit të vet, mjaltin e mbetur prej Mësuesit e mori njëri prej nxënësve të tij të rëndësishëm, Hulusi Efendiu. Në vitin 1986, kur i shkova për vizitë, ai më gostiti edhe mua të varfrin me një lugë e më tha: “Ky është nga mjalti i mbetur prej Mësuesit tonë. Po, po! Duke qenë se përkorja është shkas për begati e bereqet, edhe nëse ju merrni e konsumoni diçka, mund të ndodhë që ajo të mbetet siç është, e pandryshuar, në një mënyrë që ju nuk mund ta dini.

Por përkorja tek e cila dua të ndalem këtu shkon përtej kësaj. E kam fjalën për atë lloj përkorjeje që na nxit të mos rendim me tepri pas gjërave të kësaj bote, që t’i mendojmë ato punë si të parëndësishme dhe kështu, të mos e përlyejmë mendjen tonë me to. Për ta shprehur ndryshe, në polin tjetër të përkorjes, duke thënë “Mjafton Allahu si dëshirë e përjetshme” apo “Allahu na mjafton.” [71], mund të ushtrojmë përkorje përmes të mjaftuarit me Allahun. Pra, kjo do të thotë, që teksa na mjafton Allahu, në lidhje me çdo gjë tjetër veç Tij të veprojmë sipas mendimit se mund të bëjmë edhe pa to. Të mos krijohen keqkuptime; është tjetër çështje që të marrash parasys shkaqet dhe krejt tjetër çështje që të mos u kushtosh shumë rëndësi asaj çka sjellin shkaqet. Sepse Zoti i Gjithëfuqishëm, ashtu siç e kërkon urtësia e Tij, nganjëherë dhuron, e nganjëherë nuk dhuron. E pra, nëse njeriu mbetet i kënaqur në të dy këto raste, kjo është një shenjë e përkorjes.

Krahas përkorjes dhe të mjaftuarit me Qenien Hyjnore, është shumë e rëndësishme që të tregojmë përkorje edhe duke u mjaftuar me Islamin si fe dhe me profetësinë e Zotërisë së botës, Profetit të dashur (alejhi elfu elfi salatin ues'selam), që e shohim si një mjet në përmasat e qëllimit tonë. Siç e dini, njëra nga lutjet që ne përsërisim mëngjeseve e mbrëmjeve është edhe kjo: “U kënaqëm me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin (alejhis'salatu ues'selam) si profet.” [72]

Pritja e kohës së duhur

Kështu, ka disa argumente të orientuara në mbështetjen e kësaj ndjenje, të këtij mendimi e të këtyre ideve të paraqitura në emër të përkorjes. Ndër këto argumente është edhe ai i pritjes së kohës së duhur, që ju e përmendët. Pritjes së kohës së duhur është një fjalë arabe e prejardhur nga pjesëza (*sevfe*). Përkundrajt germës (sin), që vjen në fillim të foljes në një kohë të caktuar për të shprehur një të ardhme të afërt, pjesëza (seufe) shpreh kohë të ardhme të largët. Pra, kur vihet në fillim të foljes, pjesëza tregon se veprimi i asaj foljeje do të ndodhë në një të ardhme të largët. Kështu që, koncepti i "*tesvij*"-it, pra pritjes së kohës së duhur për diçka që të ndodhë, do të thotë që të mos tregosh padurim e lakmi që diçka të realizohet menjëherë, por të veprosh i qetë e me mendimin: “Në mos sot, do të bëhet nesër, në mos nesër, do të bëhet një ditë tjetër.” Për ta shprehur ndryshe, duke marrë parasysh shkaqet fizike dhe duke e kuptuar secilin prej tyre si një perde, të mos e administrosh çështjen duke e lidhur vetëm me këto shkaqe, sepse nëse e lidhni çështjen me shkaqet fizike dhe nëse jepeni me shpirt e pasion pas saj, atëherë bini në lakmi dhe shfaqni mungesë përkorjeje kundrejt caktimit hyjnor. Në këtë mënyrë, do të ngulni sytë në atë çka prodhonnë shkaqet fizike dhe do të përpëliteni në padurim që atë që ajo çka synonin, të përmbushet e të arrihet medoemos. Më pas, me këtë lakmi e babëzi, siç edhe i vërehen shembujt mjaft shpesh në ditët tona, se si hyhet në spekulime të ndryshme, kërkohen rrugët e përfitimit të paligjshëm, duke u kryer lloj-lloj shkeljesh e punësh të ndaluara.

Ndërsa përkorja e çliron njeriun prej lypjes e turpërimit, e bën atë të ndihet i kënaqur dhe e mbron prej lakmisë dhe të ngulurit të syve në atë çka i përket tjetrit. Në thelb, kjo është ajo që e quajmë pritje të kohës së duhur. Siç tërheq vëmendjen Mësuesi i nderuar në “Farat e së vërtetë”, një njeri, sa herë që shpirti i kërkonte diçka, i thoshte vetes “*sanki yedim*” (zëre se hëngra) dhe paratë që do të shpenzonte në këtë rast i ndante më vete e i mblidhte, gjersa më vonë me to ndërtoi xhaminë e njohur me emrin “*Sanki Yedim*” (“Zëre se e hëngra”). [73] Edhe ju, kur ju vjen diçka në mendje, në vend që të kënaqni shijen a babëzinë, mund të kënaqeni me disa kafshata apo disa pika, sepse pasi t’i keni gëlltitur, nuk mbetet dallim mesa bakllavasë e byrekut, mes qepës e hudhrës. Domethënë që përmes bakllavasë dhe byrekut, forca e shijes që prodhon kënaqësinë që arrijnë goja dhe gjuha jonë, na mashtron disi. Atëherë edhe ne ta mashtrojmë atë në njëfarë mënyre dhe duke përtypur e përtypur një sasi të vogël në gojë, le të themi: “Kjo është pjesa jote.”

“Një vilë për nipërit e mi”

Për nga aspektet e ndryshme të jetës, njeriu mund të ketë disa kërkesa e dëshira në kontekstin e kësaj bote. Veçanërisht dëshirat dhe kërkesat tona të lidhura me zakone dhe varësi të krijuara mund të bëhen të papërballueshme. Këto rriten, shtohen e fryhen në një mënyrë të tillë që, me kalimin e kohës, mund të mbërrijnë në një gjendje që nuk mund të kapërcehet. Për shembull, mes gjelbërimit,

anës ujërave të një lumi që rrjedh plot gurgullimë, shohim vila verore që i përkasin tjetërkujt; i shohim dhe kjo tablo kthehet në një cimbisje brenda nesh duke na ndezur dëshirën që edhe ne të zotërojmë diçka të tillë. Siç është bërë zakon të lakmojë njeriu, prirja jonë e brendshme na shtyn që të nisim e t'i themi vetes: "Sikur të kisha edhe unë një vilë si këto!" Madje duke mos u mjaftuar as me këtë, pushtohemi prej mendimesh të ndryshme, si: "Edhe jeta e fëmijëve të mi, sikurse jeta ime, është shumë e rëndësishme. Sikur t'i bëj edhe ata me shtëpi! Më pas do të vijnë nipërit. Duhet të bëj përgatitje edhe për ta. T'ua ngre edhe atyre një vilë." E pra, nëse mjedisi në të cilin jetojmë, zakonet dhe varësitë që krijohen në të, ndezin te ne të tilla dëshira, nëse e gjithë kjo na bën të jepemi me lakmi pas gjithë kësifarë mendimeve, atëherë duhet t'ia lëmë çështjen veprimit duke pritur kohën e duhur. Pra, duke u kënaqur me atë që kemi, duhet ta lidhim çështjen me të mirat që Zoti i Madhëruar do të na mundësojë në jetën e amshuar. Në përfundim të kësaj përkorjeje e vetëpërmbytjeje, Allahu (xh. xh.) do të na dhurojë prej mirësië së Tij shtëpi nën të cilat rrjedhin lumenj. Përndryshe, nëse priremi e jepemi pas të mirave të kësaj bote dhe mendojmë që ato t'i shfrytëzojmë në tërësi që këtu, atëherë do të përballemi me shuplakën e ajetit: *أَذْهَبْتُمْ طَيِّبَاتِكُمْ فِي حَيَاتِكُمُ الدُّنْيَا وَاسْتَمْتَعْتُمْ بِهَا* Pra, në jetën tjetër do të na thuhet: "Të gjitha ëndjet i shfrytëzuat e i harxhuat në jetën e botës, sa u kënaqët me to. Ato begati të hijshme e të këndshme që ju dhuroi Allahu i shpërdoruat e i mbaruat të gjitha. E pëdorët të drejtën tuaj në botë, ndërsa jetës së përjetshme s'i latë kurrëgjë." [74]

Ebu Dherr el Gifari, duke vepruar me këtë mendim e me këto shqetësime, nëse kishte të ushqejej për të sotmen, nuk mendonte për të nesërmen. [75] Omer ibn Abdulazizi, edhe pasi u bë kalif, nuk e ndryshoi kurrë mënyrën tij të jetesës. Ai e ngjyente bukën në vaj ulliri, hante dy herë në ditë dhe e kaloi jetën po në këtë rrugë. [76] Mund të thuhet se ai njeri i madh, që shpërfaqti një mirësi të tillë që të mund të mbulonte të gjitha të këqijat e emevinjve, qe një ripërtëritës, reformator e figurë-simbol e rëndësishme që ia doli me sukses të ndryshojë kërkesat e pafundme, pakujdesinë e të jetuarit, duke menduar se vdekja nuk do të mbërrijë kurrë, ambiciet e dëshirat që s'kishin të mbaruar, të shfaqura mes njerëzve të asaj periudhe. Ai njeri, që në dy vjet e gjysmë bëri punë që s'bëhen dot as në dyqind e pesëdhjetë vjet, periudhën e kalifatit të tij prej dy vitesh e gjysmë e qëndisi me fije ari në histori.

E pra, Kurani Fisnik dhe Suneti i Pastër na rrëfen udhë pikërisht drejt një horizonti të tillë. Ndaj edhe ajo që na mbetet neve është që, duke mos thënë: "Gjithçka do të bëhet sot se s'bën", të jetojmë një jetë me nën ombrellën e parimit të pritjes së kohës së duhur. Të mos keqkuptohemi; patjetër që duhet të punojmë, të fitojmë, por të gjitha këto, në njëfarë mase, le t'i bëjmë në të mirë të brezave që vijnë, në të mirë të mirëqenies së kombit tonë në të ardhmen. Përbalë këtyre objektivave të mëdha, nëse çështjen e lidhim vetëm me egon tonë, me trupin, me lëndën dhe me instinktët tona, dhe synojmë që të gjitha mirësitë e dhuruara prej Allahut t'i konsumojmë qysh në këtë jetë, atëherë, në njëfarë mase, e dënojmë vetveten me shumë privime në jetën e amshuar.

Vendi ku lakmia është e lejuar

Përkorja, krahas sjelljes me mosinteresim kundrejt kësaj bote nga njëra anë, kërkon që, nga ana tjetër, në çështjen e të fituarit të kënaqësisë e të dashamirësisë së Allahut, të tregojmë ambicie më të mëdha e më serioze. Sepse në pastë një fushë në të cilën ambicia e lakmia janë të lejuara, ajo është të fituarit e kënaqësisë së Allahut dhe ambicia për të shpallur në planin e shkaqeve fizike

emrin e madhërishtëm të Hyjnisë. Po, po! Nëse na bëhet e mundur që gjithkujt në faqe të dheut t'i paraqisim të vërtetat hyjnore – nëse na lejohet të shprehemi kështu – në përshtatje me atë çka urdhëron brendia e unit, nëse i dilet me sukses që gjithkujt t'i bëhet i dashur Zotëria ynë, që gjithkujt t'i bëhen të njohur Kurani dhe hijeshia e identitetit të vërtetë të myslimanit, atëherë sërish, me një dëshirë e lakmi që s'njeh fund për përhapjen e fjalës së Allahut (xh.xh.) dhe të udhëzimit hyjnor, do të duhet të themi: “Vallë, a ka një shkallë për të arritur në qiej?” Po, edhe në një gjendje të tillë, sërish duhet të vijojmë të kërkojmë e të themi: “Vallë, a ka në qiej qenie të tjera të egra, xhindë, djaj, që të mund t'ua përçojmë edhe atyre mesazhin tonë? Në pastë, a ka mundësi që edhe ata ta dëgjojnë zërin tonë?” Sado që të gjitha përpjekjet e bëra në drejtim të arritjes së këtyre qëllimeve të jenë veç një mjet, një shkak, edhe ne duhet të ushqejmë një ambicie të tillë të fuqishme që t'i marrë parasysh shkaqet. Nuk ka dyshim se pranimi prej njerëzve i asaj çka u shpjegohet, i përket Zotit të Madhëruar, por detyra jonë është që vënia në vend e kësaj detyre me një lakmi e ambicie të fuqishme. Ndërsa krijimi i pasojës apo i rezultatit i përket Allahut, siç Ai na e tregon vetë në ajetin që vijon: “Ti nuk mund ta udhëzosh atë që do. Vetëm Allahu i jep udhëzim atij që dëshiron” [77]

Për të ardhur tek kënaqësia e Allahut, ajo është një çështje për të cilën, para së gjithash, duhet treguar ambicie. Në një lutje ne shprehemi kështu: *“O Allahu im! Dëshiroj që të më dhurosh prej Teje faljen, shëndetin, dashamirësinë, admirimin, frymën hyjnore, miqësinë, afrinë! Dashurinë për Ty në formën që i shkon për shtat famës Sate të lartë, adhurimin për Ty, mbrojtjen, dëlirësinë, fitoren me ndihmën Tënde, mbajtjen larg prej së keqes!...”* E pra, siç shprehet në këtë lutje, këto janë ato çka duhen kërkuar me dëshirë të fuqishme prej Zotit të Madhëruar. Ndërsa hollësitë e tjera që mund të kërkojnë janë veç gjëra kalimtare e të përkohshme, sepse këto janë të lidhura me jetën e njeriut. Ndërkohë që zemra duhet të jepet pas një bukurie e hijeshie të tillë që kurrë të mos mbarojë, të mos zbehët, të mos vyshket e të mos thahet. Miqësia, dashuria me ju të vijojë në pafundësi. E pra, nga ky këndvështrim, për kënaqësinë e afrinë hyjnore duhet treguar një lakmi e ambicie, e cila të mos njohë assesi fund.

Bediuzaman Said Nursiu, në një rast, thotë se sikur “Imam Rab’bani Ahmed Faruku i të ishte gjallë në Indi, dhe ta ftonte për vizitë gjer atje, ai, duke iu nënshtruar të gjitha mundimeve e rreziqeve, do të shkonte për ta vizituar.” [78] Po atëherë, kur bëhet fjalë për të parë Profetin Muhamed Mustafa (alejhissalatu ues’selam), që është sa për mijëra si Faruk Serhendiu, përse nuk nxitohemi? Në këtë çështje, ne duhet të ushqejmë një dëshirë e nderzulli shumë të madhe. Ne vetëm sepse Allahu nuk ka thënë “eja”, i nënshtrohemi qëndrimit këtu. Po, po! Për ne, të qëndruarit në këtë botë është një nënshtrim e bindje. Për këtë arsye, mendimi ynë është ky: “Unë po i nënshtrohem kësaj barre mashtruese. Duke qenë se është Ai që mua më ka bërë këtu ushtar për në qëndrën stërvitore, që më ka dërguar në kazermë dhe që do të më japë librezën, atëherë po qe se unë, pa ma dhënë Ai librezën me vullnetin e Vet, pushtohem prej dëshirës për të shtënë në dorë librezën, do të thotë që po veprojmë në kundërshtim me vullnetin e Tij, dhe kjo përbën mungesë respekt ndaj Tij.”

Dëshira e arritjes dhe hollësia e bindjes ndaj urdhrit

Le t'i lëmë mënjandë të gjitha këto. Sikur vetëm për të parë Ebu Bekrin e nderuar (r.a.) apo Omerin e nderuar (r.a.), një njeriu t'i duhet të rendë njëqind vjet pa ndërprerje, prapë ia vlen. Po ja që edhe

sikur brenda nesh të ketë për këtë një dëshirë të çmendur, një lakmi të fuqishme, ka një çështje që na frenon. E ajo ka të bëjë me faktin që ne nuk e kemi dëgjuar thirrjen “Eja!” prej Zotit të Madhëruar. Pra, edhe nëse brenda nesh ndizemi prej dëshirës, është detyrim kundrejt respektit ndaj Allahut që dëshirën tonë për të arritur atje ku synojmë ta lidhim me thirrjen hyjnore “Eja!”. Respekt për Allahun do të thotë respekt për kënaqësinë e Tij. Për sa kohë që Ai dëshiron qëndrimin tonë këtu, ajo që na mbetet neve është që, për ta kënaqur Atë dhe për të fituar dashamirësinë e Tij, ne t’i nënshtrohemi kësaj bote. Nga ky këndvështrim, një besimtar duhet të jetë gjithnjë në ndjekje të një horizonti të tillë. Në këtë pikë, mund të vijë në mendje një pyetje e tillë: Ata që kanë mbetur prapa kundrejt këtij horizonti, a mos vallë janë të shkatërruar e të marrë fund? Natyrisht që jo. Njerëzit që besojnë, që kryejnë vepra të mirësishme, shpëtojnë. Po sidoqoftë, ajo që njeriu ka për detyrë është që të jetë i dashuruar me një ideal të tillë të lartë, që ta mbajë përherë vetëkërkesën lart e më lart, duke rendur vazhdimisht nga përpjekja në përpjekje për t’u bërë njeri i përsosur.

Kundërthënia këtu duhet të kuptohet shumë mirë. Domethënë, nga njëra anë, të ushqyerit e një dëshirë të pafund për të ikur nga kjo botë e për të arritur një tjetër ekzistencë në jetën e amshuar, të ngulurit e syve kah urdhri që duhet të vijë prej së largu e të ngashëruarit duke i thënë vetes: “Pse s’po vjen ende ai urdhër?”; e nga ana tjetër, duke thënë: “Ndjemë, o Zoti im! Nëse ti s’e sjell, si mundem unë të ngutem për ta përshpejtuar!”, shmangia e përjetimit të një kundërthënieje të tillë. E kur dëgjon urdhrin e Zotit të Gjithëfuqishëm, “Eja!”, të mund të thuash: “Më në fund!” Pra, jeta e një besimtari të vërtetë shfaqet vetëm në përfundim të një kundërthënieje e të një mospërkimi të tillë.

Kur Ahmet Fejziu, ndjesë pastë, ndërroi jetë, z. Ali Riza dhe Saxhiti e zbuluan dhe e panë. Pastaj, më thanë: “Për Zotin, po qeshte.” Unë i pata prirë namazin e xhenazes. Ne kishim pasur një miqësi të madhe mes nesh. Po pavarësisht kësaj, ndiej gjithnjë hidhërim për faktin që nuk ia zbulova edhe unë fytyrën e nuk ia pashë atë nur të bukur. Ai vdiq prej pushimit të papritur të zemrës. Siç e dini, kur zemra ndalet ashtu, në fytyrën e njeriut ndodhin tkurrje e shtrembërime. Po pavarësisht kësaj, kush e di se ç’i është shfaqur që ai qeshte. Sepse ai njeri i vyer e kaloi jetën në udhën e përcaktuar prej Kuranit, në rrugën e gjetjes së të drejtës në mendim. Kurrë nuk pati as më të voglin mëtim të llojit: “Të ndalem diku që të më vijnë e të më mblidhen gjindja përreth.” Nuk pati të tilla mendime, dhe poashtu e shkoi jetën, pa pritur asgjë prej kësaj bote.

[69] Kasas, 28/77.

[70] Bediüzzaman, Shkrepëtimat f. 179-180 (Shkrepëtimat e Nëntëmbëdhjetë, Pika e pestë)

[71] “Allahu na mjafton.” (Al-i Imran, 3/173)

[72] Ebu Davud, Edeb 100, 101.

[73] Shih: Bediüzzaman, Letrat f. 536 (Farat e së vërtetës).

[74] Ahkaf, 46/20.

[75] Shih: Ebu Nuajm, Hiljetu'l-evlija 1/162; Ibn Abdilberr, El-Istiab 1/256.

[76] Shih: Abdullah Ibn Abdulhakem, Siretu Omer Ibn Abdulaziz f. 79-80.

[77] Kasas, 28/56.

[78] Shih: Bediuzaman, Mesnevia e Dritës f. 117 (Bërthama).

Mendja kuranore dhe funksionet e saj



Pyetje: Feja e qartë u drejtohet zotëruesve të mendjes dhe vendos si kusht zotërimin e arsyes për të qenë të përgjegjshëm. [79]Nga ana tjetër, vërehet se konceptet dhe shkollat që e shohin mendjen sikur kjo të ishte gjithçka, përgjatë historisë, janë zvarritur në devijime të ndryshme. Në këtë pikë, si duhet të jetë vështrimi i një besimtarit kundrejt mendjes dhe funksioneve të saj?

Përgjigje: Funksionet dhe kufizimet e mendjes janë një çështje që, në botën islame, kanë qenë dhe mbeten objekt mendimesh e diskutimesh të ndryshme që prej së shkuarës e gjer në ditët tona. Për shembull, shkolla mutezile, që e shihte mendjen sikur të ishte gjithçka, i jepte asaj vlerë të tepruar, duke i ngarkuar funksione përtej çdo mase. [80]Po kështu, në ditët tona mund të themi se ka individë dhe shkolla që pranojnë mendime neo-mutezie, që pohojnë se të vërtetat e Islamit mund t'i kuptojnë vetëm ithtarët e mendimit dhe se, po kështu, vetëm këta mund t'i konceptojnë vlerat e vërteta të mendjes. Këta e kanë parë mendjen gjithmonë, krahas shpalljes qiellore, si një burim të dytë që bën pjesë në argumentet hyjnore dhe në këtë mënyrë, i kanë njohur asaj një peshë më të madhe nga ç'i takon.

Nga ana tjetër, Imam Muhasibiu, duke shtuar shprehjen “kuranore”, ka folur për “mendje kuranore” dhe kështu, ka hyrë në rrugën e përcaktimit të disa kufijve për arsyen, çka përbën edhe më thelbësoren për mendjen. Pra, pasi na janë dhënë në dorë disa kriteret, mendjes i duhet dhënë mundësia e vlerësimit dhe e interpretimit të tyre dhe kështu, asaj i duhet ngarkuar barra e të çuarit tek e vërteta. Në rast të kundërt, ata që ia lënë mendjes çështje si zbulimi i të vërtetave, mbërritja e së vërtetës së të vërtetave, duke i ngarkuar, kështu, asaj një barrë që ajo nuk e mban dot, atëherë ata nuk bëjnë tjetër pos tradhti, si ndaj mendjes, ashtu edhe ndaj së vërtetës. Sepse mendja edhe nëse mund të vërë në zbatim nga njëra anë disa funksione në vlerësimin e disa çështjeve të jashtme, në paraqitjen e një numri mendimesh pozitiviste, në shtjellimin e disa çështjeve brenda kornizës së natyralizmit, në kuadrin e botës fizike, nga ana tjetër, nuk është e mundur që ajo të shprehet e vetme për çështje që mbartin rëndësi të madhe për botën metafizike të besimtarit, si e vërteta e emrave hyjnorë, e vërteta e attributeve hyjnore, e vërteta hyjnore. Po kështu, në çështje si tjetërsimi dhe shndërrimi i kësaj bote që, përmes ndryshimit, shfaqet para njerëzve me pamje e forma të ndryshme, mendja mbetet e pamjaftueshme për të kuptuar. Sepse në rendin e urdhrave krijues që zotërojnë në gjithësi, pra në rendin e urdhrave të Allahut, për shkak të vazhdimësisë së veprimit me natyrë hyjnore, mendja mund të zhvendoset prej disa gjërave që i di, në disa gjëra që nuk i di. Sikurse në zbatimin e metodës krahasuese në lëmin e ligjshmërisë hyjnore (fikhut), duke ndërtuar

analogji mbi ligjësitë ekzistuese, mund të arrijë në përfundime të caktuara. Por gjithsesi, ka një pjesë të vërtetash që nuk është e mundur të trajtohen brenda kritereve të kësaj bote, si rruga që çon te Qenia e Patëmetë, Qenia Supreme, Qenia Absolute (Qenia e Ekzistencës së Domosdoshme). Këto të vërteta nuk është e mundur të shpjegohen vetëm përmes mendjes. Në këto çështje, mendja mund të arrijë vetëm kuptimet abstrakte. Për shembull, njerëz si ungji i Omerit të nderuar (r.a.), Zejd ibni Amri, [81] apo të tjerë që jetuan në kohën mes dy zbulësive hyjnore (fetaret), [82] i besuan Qenies që e krijoi këtë gjithësi, por ata nuk ishin në gjendje t'u jepnin përgjigje pyetjeve si: “Kush është Ajo Qenie; cila është fusha e Providencës së Saj; Si ushtrohet adhurimi ndaj Saj?”

Mendja aktive

Pa dyshim që Islami i ka njohur mendjes, sipas nivelit shpirtëror përkatës, një vlerë të madhe. Në shumë raste, Kurani i Shenjtë i referohet drejtpërdrejt mendjes. [83] Për shembull, në një rast, çështja është cekur me shprehjen [84], përmes përdorimit të një mënyre që tregon edhe kohë të tashme, edhe të ardhme. Pra, në kontekstin “Në të sotmen e në të nesërmen, a nuk mendojnë, a nuk e përdorin mendjen?”, i është ngarkuar mendjes në funksion dhe kështu, është tërhequr vëmendja në të mbajturit e mendjes vazhdimisht në gjendje aktive. Dhe kjo është shprehje e e rëndësisë që Zoti i jep përdorimit të mendjes.

Një tjetër pikë që tregon vlerën që i është dhënë mendjes, është edhe llogaritja e saj si baza dhe thelbi i përgjegjshmërisë. Kështu, personi që nuk ka mend, [85] që nuk di ç'bën, që nuk është në gjendje të dallojë e të kuptojë atë çka e rrethon, [86] nuk është konsideruar përgjegjës për respektimin e kushteve të fesë. Të gjendurit në pozitën e njeriut të përgjegjshëm është një çelës si për një pjesë të të fshehtave të kësaj jete, ashtu edhe për të hapur dyert e jetës së amshuar. E pra, të gjitha këto janë funksione dhe detyra shumë të rëndësishme që i janë ngarkuar mendjes.

Vija e drejtë

Por në këtë pikë, me daljen në pah të instinkteve e të zemërimit, duhet treguar udha për te forcat e mendjes e të arsyes dhe të siratal-mustekimit apo të rrugës së drejtë. [87] Për shembull, nëse te njeriu nuk gjendet një ndjenjë e zemërimit, e kundërvënies dhe e kryengritjes, atëherë përballë një shkeljeje të truallit të intimitetit, në rast të shfaqjes ditën për diell të dhunimeve e të përdhunimeve, ai nuk do të shpërfaqë asnjë përpjekje njerëzore, fetare e morale. Po, po! Një njeri që e ka lëshuar veten dhe që ka mbetur i zhveshur prej këtyre ndjesive, edhe nëse do të përballlet me shfaqjet më boheme përballë syve të vet, thjesht do të bëjë sikur s'shikon e do të shpërfillë gjithçka. Prandaj, ndërsa disa nga njëra anë vrapojnë pas epsheve të unit si fluturat që rendin pas zjarrit, nga ana tjetër, të tjerë njerëz, duke ndenjur të heshtur përballë kësaj tabloje, bien në gjendjen e një djalli gojëkyçur. Nga ky këndvështrim, edhe forca e zemërimit ka një vend të caktuar në kuadrin e ligjeve që ka përcaktuar Allahu i madhëruar. Në daçi, këtij mund t'i thoni edhe “zemërim kuranor”. Kështu, Zoti i Gjithëfuqishëm në Kuranin e Shenjtë urdhëron e thotë: “Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar e u ka përgatitur Xhehenemin. Sa vend i keq që është ai!” [88] Me këtë rast, Ai është shprehur duke pohuar të jetë zemëruar (duke bërë atë çka kërkon zemërimi). Nga ky këndvështrim, mund të themi se përballë mizorisë, dhunës e padrejtësive, ndjenja e zemërimit te njeriu është pa dyshim e nevojshme në kuptimin e respektimit të një vullneti.

E pra, një njeri që zotëron atë ndjenjë të zemërimit të fuqishëm brenda kornizës së asaj çka është pranuar prej Kuranit, di të ngrejë krye aty ku duhet ngritur krye; di të mos përkulet aty ku duhet ndenjur kryelartë; shprehet e flet aty ku duhet folur dhe nuk tregon kurrsesi mangësi në respektin ndaj vlerave. Të gjitha këto janë hollësi që duhen mbajtur parasysh në çështjen e zemërimit. Ndërsa një njeri që e lëshon veten dhe nuk tregon kujdes ndaj këtyre përmasave, nuk ka ndryshim prej një të vdekuri. Prandaj edhe Bediuzaman Said Nursiu thoshte: “O ju fatkeqë, varre lëvizëse me dy këmbë, braktisës të Islamit që i jep vlerë shpirtit të të dy jetëve! Mos rrini në derë të brezit që po vjen. Ju pret varri, largohuni. Ashtu që të vijë ai brez i ri që ta shpalosë e ta valëvisë në univers Islamit e vërtetë!” [89] Kështu, njerëzit e përmendur më sipër, ai i sheh si të vdekur. Po, po! Njerëzit që nuk ngrenë krye aty ku duhet ngritur krye, që as edhe në kuadrin e mendimit nuk japin shenja gjallërie, që nuk përgjigjen e nuk reagojnë ndaj kurrëgjëje, nuk ka ndonjë dallim nëse ekzistojnë apo jo. Edhe i ndjeri Mehmet Akifi, gjendjen e këtyre njerëzve që e lëshojnë veten dhe bien në një mediokritet të tillë të frikshëm, e ka përmendur përmes këtyre vargjeve:

“ O xhenaze e gjallë, ‘dy duar për një kokë.’

Tundu... Duar e kokë janë tuat!

Pa ndjenjë, pa jetë e dhimbë... a meit je?

Krejt po më habit... Ti s’ishe kësodore.

Pse s’e ke më vullnet të çlirimit, nuk e di.

A ti vetë, a shpresa jote nuk është burrnore?”

Por ashtu sikurse rënia nën nivelin e nervit e të zemërimit të drejtë ka pasoja, edhe teprimi me zemërimin ka ndërlikimet e koklavitjet e veta. Të pushtuarit e menjëhershëm e i papritur prej zemërimit, të vepruarit përmes ndjesish duke shpërfillur urdhërat e fesë dhe arsyen e shëndoshë, përbën kapërcimin e masës dhe teprimin me zemërimin. Për shembull, në ditët tona, lëshimi i bombave të gjalla mbi njerëzit e pafajshëm është pasojë e teprimit në ndjenjat e zemërimit. Ndërkohë që në fenë tonë, kundërvënia ndaj dhunës dhe padrejtësive, lufta kundër tyre, kanë rregullat dhe ligjësitë e veta të përcaktuara. Mirëpo ja që shihni se një individ i çfarëdoshëm ngrihet dhe me lehtësi të madhe mund të shpallë edhe luftë. Natyrisht që pas tij, shpërthen një egërsi e mizori e tillë, që përballë asaj tabloje zemrat na lotojnë gjak, ndërsa fytyra e ndritur e Islamit nxihet. E pra, këto ndërlikime që i shohim me kaq hidhërim, janë shfaqur si pasojë e teprimit me ndjenjën e zemërimit. Përballë kësaj tabloje të dhimbshme, detyrë jona duhet duhet të jetë që të mundohemi sa më shumë dhe të bëjmë të gjitha përpjekjet, që feja jonë të njihet e të dihet me identitetin e saj të vërtetë. Po, po! Është detyrë e çdo besimtarit që t’u shpjegojë njerëzve të drejtën, që t’u thotë “Islami nuk është ky!”, që në fenë tonë nuk ka vend kurrsesi asnjë koncept si lëshimi i bombave të gjalla për të masakruar njerëzit e pafajshëm.

Nga ana tjetër, edhe forca e epshtit është një tjetër ndjesi e rëndësishme që gjendet te njeriu. Sikurse Allahu (xh.xh.) e pohon në Kuranin Fisnik këtë të vërtetë, [90] ashtu edhe Suneti i Pastër e përforcon atë. Për këtë arsye, shpërfillja e plotë e kësaj ndjesie do të thotë impotencë dhe shterpësi, kështu që një qasje e tillë është në kundërshtim me Kuranin dhe me Sunetin, sepse Zotëria ynë,

Profeti (alejhis'salatu ues'selam) urdhëron e thotë kështu: “Martohuni, shumohuni, sepse unë, në ditën e gjykimit, do të krenohem me numrin tuaj të madh.” [91] Ndaj edhe është shumë e rëndësishme që të mos mbyllet dera që ka hapur Kurani dhe çështja të vlerësohet brenda disiplinave të trashëguara prej Kuranit. Në daçi, kësaj mund t'i thoni edhe “epsh kuranor”. Në të vërtetë, Imam Muhasibiu, që ka përdorur shprehjen “mendje kuranore”, për këto forca nuk ka thënë asgjë. Megjithatë, përdorimi i shprehjeve si “zemërim kuranor”, “epsh kuranor” apo edhe “ambicie kuranore”, “konkurrim kuranor”, nuk duhet të përbëjë kurrfarë shqetësimi. Kështu, Bediuzaman Said Nursiu, në lidhje me secilën prej ndjenjave që gjenden te njeriu, bën fjalë për një “gajetu'l-gajat” (pikësynim të pikësynimeve). [92] E pra, çështja thelbësore është që këto ndjenja, të vendosra në natyrën e njeriut, të mund të orientohen drejt qëllimeve të fundme. Për shembull, te njeriu ka një dëshirë për të jetuar në përjetësi dhe një ndjenjë të dëshirës së pambarim. Ndërsa vendi ku duhen orientuar, në të vërtetë, këto ndjenja është bota e ahiretit. Sepse kjo botë ku jetojmë është e kufizuar. Kush vjen, shkon, kush mbërrin, ikën. Nga ky këndvështrim, që dëshira e përjetësisë të gjejë përmbushje në një botë kalimtare, nuk është e mundur. E pra, edhe mendja duhet trajtuar brenda kësaj kategorie dhe pa rënë as në nënvlerësim e as në mbivlerësim, duhet nxjerrë në pah ana e saj kuranore. Përtej kësaj, mendjes nuk i duhet ngarkuar një barrë e përgjegjësi që i zë frymën e s'e mban dot.

Funksionet e mendjes dhe urtësia

Po ashtu, produktet dhe funksionet e tjera të mendjes, të trajtuara në ajetet e ndryshme të Kuranit të Shenjtë, si përkujtimi (tedhek'kur), [93] mendimi (tefek'kur) [94] dhe thellimi (tedeb'bur), [95] duhen përdorur, gjithashtu, mirë dhe me efikasitet. Për shembull, të ushtrosh thellimin në çështje të ndryshme, do të thotë që të bësh veprimet e ecejakeve mes nisjes dhe fundit apo shkakut dhe pasojës së diçkaje, të prekësh ingranazhin e nisjes dhe kështu, të mbërrish në një rezultat, e kësodore të fitosh një produkt. Pra, të thellohesh do të thotë që të shohësh kreun dhe fundin e diçkaje, më pas të ndërtosh lidhje mes kreut e fundit dhe sipas kësaj, të mund të nxjerrësh një punim dantelle. Në këtë aspekt, kjo përbën një funksion të rëndësishëm të mendjes. E pra, këto aspekte dytësore kanë të tilla thellësi e përmasa të ndryshme, që jo vetëm nuk bien në kundërshtim me konceptin e nënshtrimit ndaj Zotit në fenë tonë, por përbëjnë edhe një urdhëresë të kësaj feje.

Po, po! Kurani i jep vlerë mendjes. Pa të, nuk ka përgjegjshmëri. Pa pasur mendjen, nuk mund të bëhet fjalë për përkujtim, për mendim e për thellim. Hapësirat e lira për gjykim të lirë (ixhtihad) e për deduktim (istinbat) mund të plotësohen vetëm nëpërmjet mendjes. Por nëse i njihni mendjes një vendndodhje mbi të gjitha këto, atëherë nuk bëni tjetër, veçse bini në pozita qesharake. Teksa dyzet herë në ditë, në namazet tona përsërisim fjalët “Na udhëzo ne në rrugën e drejtë, në rrugën që mbërrin tek Ti.” [96], i lutemi Zotit të Madhëruar që të urdhërojë e të na udhëzojë në rrugën e kthjelltësisë e të drejtësisë, duke përfshirë këtu edhe shpëtimin prej rënies në teprim, qoftë në drejtim të mbivlerësimit, qoftë të nënvlerësimit në çështjen e mendjes. Sepse mendja, që ndodhet në pozitën e një mjeti për arritjen e Zotit dhe të së Vërtetës, sikurse mund të përdoret në çështje pozitive si mendimi, përkujtimi e thellimi, mund të shfrytëzohet edhe për demagogji e dialektikë. Nëse dikush thotë diçka, përpjekja për t'i mbyllur sakaq gojën, për t'ia zënë fjalën në grykë, për t'i vënë zinxhir në gojë e për t'i prerë fjalën, është gjithashtu teprim me aftësitë e mendjes. Ndërsa ajo që duhet bërë është që, duke qëndruar të lidhur fuqishëm me frymën kuranore, me respektin e duhur ndaj njeriut, të dimë të ndalemi në vendin ku duhet ndalur. Nëse dikush që ia ngul sytë një

ofiqi a posti, që rend pas përfitimit të një pozite të lartë ose që përpiqet të ruajë atë që ka shtënë në dorë, përdor ndaj kundërshtarit të vet një arsenal dialektik fjalësh që mbartin demagogji, kjo është rrjedhojë e shfrytëzimit të tepruar e të skajshëm të mendjes.

Keqpërdorimi i mendjes, përdorimi i saj në gjëra negative dhe rënia në teprim, nënkupton zhveshje të mendjes nga prodhimtaria. Ndërkohë që një orë mendim e meditim, për besimtarin është në vlerën e një viti adhurim ndaj Allahut. [97] Ndaj edhe mendimi është bërë njëri prej dy objektivave që i paraqiten besimtarit. Pra, nëse në heshtjen e tij ka thellim, përkujtim e meditim, në të folurit e tij ka urtësi. Urtësi do të thotë të vihet në dukje e vërteta për sendet dhe pas sendeve. Në fund të fundit, një njeri që në heshtjen e vet nuk ka thellim, përkujtim e meditim, që nuk i lidh siç duhet sendet dhe ngjarjet, nuk e lexon siç duhet kohën në të cilën jeton, pra, që nuk zotëron një proces sistematik dhe të disiplinuar të menduarit, nuk është e mundur që të shpërfaqë diçka në emër të urtësisë. Nga ky këndvështrim, mendimet, thellimet, përkujtimet, meditimet, janë të pazëvendësueshme në çështjen e gjetjes së të vërtetës, të arritjes së interpretimeve të drejta dhe, në njëfarë mënyre, të të qenit në krye të ideve të kohës. Edhe njerëzit e mëdhenj, gjithmonë e kanë jetën e tyre sipas këtij koncepti, sepse ata, para se të flisnin një herë, mendoheshin dhjetë herë. Dhe kështu, Zoti i Madhëruar i ka lartësuar ata me urtësinë. Po, po! Ai urdhëron e thotë: “Nëse një njeriu i është dhënë urtësia, pra, nëse është në gjendje të lexojë të vërtetat përtej natyrës, nëse mund t’i ndërthurë sendet dhe ngjarjet, nëse mund të gjejë rrugët e të ecë kah e vërteta e së të vërtetave, atëherë kjo do të thotë se atij njeriu i është dhuruar një mirësi shumë e rëndësishme.” [98]

[79] Shih: Buhari, Hudud 22; Ebu Davud, Hudud 17; Ibn Maxhe, Talak 15.

[80] El-Xhujeni, Et-Telhis 1/157-158, 3/471-472; El-Gazzali, El-Mustasfa f. 45.

[81] Buhari, Menakib 24; En-Nesai, Es-Sunenu’l-kubra 5/54; El-Bezzar, El-Musned 4/165.

[82] Për shembull, Uaraka ibni Neufeli është një ndër ta. Shih: Buhari, Bed’u’l-Vahj 3, Tefsiru sure (96) 1, Tabir 1; Muslim, Iman 252.

[83] Shih: Bekare, 2/44, 73, 76, 242; Ali Imran, 3/65, 118; En’am, 6/32, 151...

[84] Ja Sin, 36/68.

[85] Shih: Buhari, Hudud 22; Ebu Davud, Hudud 17; Ibn Maxhe, Talak 15.

[86] Shih: Tirmidhi, Hudud 1; Ebu Davud, Hudud 17; Darimi, Hudud 1.

[87] Shih: Bediüzzaman, Shenjat e mrekullisë f. 21-22.

[88] Fet’h, 48/6.

[89] Bediüzzaman, Jetëshkrimi f. 82 (Fillimet e jetës).

^[90] Shih: Nisa, 4/3, 25.

^[91] Abdurrezzak, El-Musannef 6/173; El-Bejhaki, Ma'rifetu's-suneni ve'l-asar 5/220.

^[92] Shih: Bediüzzaman, Hutbeja e Damaskut f. 181; Letrat f. 253-254 (Letra e Njëzetë, Parathënie).

^[93] Shih: En'am, 6/80; Ra'd, 13/19; Ta Ha, 20/44; Sexhde, 32/4...

^[94] Shih: Bekare, 2/219, 266; En'am, 6/50; Sebe, 34/46; Hashr, 59/21...

^[95] Shih: Nisa, 4/82; Muhammed, 47/24.

^[96] “Na udhëzo ne në rrugën e drejtë, në rrugën që mbërrin tek Ti.” (Fatiha, 1/6)

^[97] Shih: El-Gazzali, Ihyau ulumi'd-din 4/423; El-Kurtubi, El-Xhami' li ahkami'l-Kur'an 4/314.

^[98] Bekare, 2/269.

Një lutje kundër fatkeqësive tokësore e qiellore



Pyetje: Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.) ka urdhëruar e thënë: “Kush e bën këtë lutje tri herë në ditë, atëherë atij asgjë s’i bën dëm.” Çfarë veçantish përmban kjo lutje?

Përgjigje: Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (alejhis’salatu ues’selam), me këtë lutje të bekuar që shpreh nënshtrim ndaj vullnetit hyjnor, pra, Duke nisur me të përmendurit e Emrit të Madhërishtëm e të Lartësuar të Hyjnisë; dhe më pas duke thënë: “në vendin ku përkujtohet Emri i Tij i Madhërishtëm, kurrëgjë, as në tokë e as në qiell, nuk e dëmton njeriun.”, strehohet në mbrojtjen e Allahut (xh. xh.) kundrejt të gjitha rreziqeve, shpirtërore e materiale, të kësaj jete e të jetës tjetër. Ndërsa në fund, duke pohuar, e plotëson duanë duke përmendur dy emra që i përkasin Zotit të Madhëruar. Pra, në përfundim të duasë, thuhet: “Zoti i Madhëruar është Ai që, kundrejt të gjitha rreziqeve që mund të shfaqen prej tokës a të zbresin prej qiellit, e dëgjon më së miri përgjërimit dhe lutjen e brendshme të robit që i kërkon me një qëllim të dëlirë mbrojtje, që e njeh më së miri në gjithëdijën e Vet këtë lutje të njeriut të nënshtruar ndaj vullnetit hyjnor.”

Kjo lutje mund të bëhet duke marrë parasysh qëllime të caktuara për sëmundje e simptoma sëmundjesh; dhe Zoti i Madhëruar, me çfarëdo qëllimi që të lexohet ajo, mund të ketë mirësinë që t’ia përmbushë dëshirën robit të vet. Por mes dijetarëve ka një mendim të përhapur se kjo lutje mund të bëhet kundër paralizës. Këtë hadith e ka transmetuar Eban ibn Osmani, babai i Hazreti Osman ibni Afanit (radiallahu anh). Zotërinjtë tanë, sahabët fisnikë, për të cilët kishte shumë rëndësi që sapo të dëgjonin e të mësonin diçka prej fesë, ta vinin menjëherë në jetë, këtë lutje e shqiptonin mëngjes e mbrëmje dhe e këshillonin për të mos rënë në paralizë. E pra, kur shpallej një ajet prej Kuranit apo kur dëgjonin një hadith prej Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), atëherë ata bisedonin me njëri-tjetrin rreth atij ajeti a hadithi, si dhe përpiqeshin ta kuptonin e ta zbatonin atë në jetën e vet.

Kështu, transmetuesi i këtij hadithi fisnik, Eban ibn Osmani (radiallahu anh) një ditë paralizohet. Dikush që e kishte dëgjuar këtë hadith prej tij, kur pa Eban ibn Osmanin në gjendje paralize, nisi ta shohë me habi. Kur Hazreti Eban ibn Osmani e vuri re, e sqaroi kështu atë njeri: “Hadithi është ashtu siç e kam transmetuar. Po ja që unë, në ditën kur u preka prej kësaj fatkeqësie, nuk e kisha bërë atë lutje. Dhe Allahu (xh.xh.) kështu urdhëroi e caktoi për mua.” [99]

Siç shihet, zotërinjtë tanë, sahabët fisnikë, e kishin pranuar si qëllim të jetës së tyre që çdo urdhër hyjnor që u mbërrinte, ta përvetësonin e ta përthithnin menjëherë. Sa keq që sot, ne gjendemi të privuar prej një vetëdijeje të tillë.

Mbi botën tonë të ndjenjave e të mendimit kaloi një krasitje e tillë dhe mbetëm të ekspozuar ndaj një periudhe të tillë kapërcimi, saqë kjo gjendje rrëmbeu, fshiu, largoi, mori tutje gjithçka. Në këtë mënyrë, ne u larguam prej bukurive të fesë sonë, prej vlerave të trashëguara prej paraardhësve, duke u kthyer sakaq në të huaj ndaj tyre. Veç kësaj, edhe të mosditurit e gjuhës së fesë sonë përbën një dizavantazh serioz për ne. Sepse në fund të fundit, që një njeri të recitojë në mëngjes e në mbrëmje një lutje të tillë, nuk ka pse të jetë ndonjë punë e vështirë.

E pra, prijësit tanë si yje, sahabët, e lexonin paprerë, mëngjes e mbrëmje, këtë lutje dhe besonin me shpirt se njeriu që e bënte atë nuk do të mund të sëmurej nga paraliza. Duke qenë se ai që vëzhgon e mbron është Allahu, në këtë pikë nuk duhet të jepemi pas shkaqeve. Që prej shekujve të fundit, ato që i quajmë shkenca pozitive, krahas sjelljes së plot dobive në të mirë të njerëzimit, fatkeqësisht mbështeten në një koncept që gjithçka e kërkon të lënda dhe e lidh me shkaqet. Kështu, një mendësi si kjo, duke na ulur edhe ne në sjelljen e njerëzve që gjithçka e ngrenë mbi racionalizmin, na ka shtyrë edhe ne në një hon të tillë. Në përfundim, edhe ne kemi ardhur në një pikë që nuk i shohim disa mirësi e urtësi hyjnore, të cilat qëndrojnë mbi shkaqet. Në kuadrin e shkaqeve, një sëmundje si paraliza ju mund ta lidhni me tensionin, me teprimin në përdorimin e kripës, mund ta shihni si gjenetike, të ardhur prej prindërve apo prej yndyrës në enët e gjakut, duke gjetur në këtë mënyrë shkaqe nga më të ndryshmet. Mirëpo nuk duhet zgjatur për të pohuar se Allahu është Shkaktari i çdo shkaku. Ai, gjithçka të planifikuar a të zbatuar përmes shkaqesh, me forcën dhe caktimin e Tij mund ta ndryshojë si të dëshirojë, mund t'i prishë të gjitha sistemet dhe të shpalosë vullnetin e Vet hyjnor. Po, po! Ai, në pastë dëshirë, me ndihmën dhe mbrojtjen e tij sublime, ju sheh, ju vëzhgon dhe nuk lejon që ju të pushtoheni prej një sëmundjeje të tillë. Ndoshta ata që kanë një këndvështrim materialist, pozitivist dhe natyralist, kundrejt gjithë këtyre çështjeve që përmendëm mund të rrudhin buzët e të vështrojnë me qesëndi, por një besimtar besoj në pushtetin e në vullnetin e pafund të Zotit të Gjithëfuqishëm në një formë të prerë që nuk do t'i krijonte asnjë hapësirë një mundësie të kundërt.

Nga ky këndvështrim, këshilla e duhur është që kjo lutje të bëhet mëngjes e mbrëmje, siç thoshin të parët, qoftë kundër të këqijave qiellore, qoftë kundër të ligave tokësore, e veçanërisht kundër paralizës. Nëse e ndiejmë veten keq, për shembull nëse tensioni na rritet, nëse ndiejmë ngrirje a dridhje në fytyrë, atëherë menjëherë të kërkojmë mbrotje me këtë lutje te Zoti ynë. Pasi trupi ynë, në vende të ndryshme të tij, në njëfarë mënyre, mund të na dërgojë sinjale të caktuara duke nxitur disa ndjesi “matëse” të shëndetit e të jetës. E pra, në një gjendje të tillë, ç'të keqe ka të përdoret një recetë kaq e thjeshtë si kjo! Pra, kundrejt shqetësimeve të ndryshme që na vënë në vështirësi, mund të kërkojmë mbrotje në mëshirën e pafundme e në fuqinë e paanë të Zotit të Lartësuar. Siç është përmendur shpesh në sqarimet rreth lutjes, mendimi se gjithçka do të arrihet menjëherë dhe në formën e kërkuar në lutje, nuk është një konceptim i saktë. Sepse Zoti i Madhëruar nganjëherë na dhuron pikërisht atë që i kërkojmë e nganjëherë, mbështetur në urtësi e arsye të ndryshme, na dhuron edhe më mirë se ajo, por duke qenë se njohja jonë është e kufizuar, ne këtë nuk mund ta dimë. [100] Por mbi këtë përfundim, nëse kur mbetemi nën peshën e një vështirësie i drejtohemi menjëherë lutjes, atëherë ne e kemi vlerësuar rastin siç duhet dhe kemi hyrë në qarkun e një adhurimi (ibadet), të një përkujtimi (dhikr) e të një meditimi (fikr).

Të këqijat që mund të vijnë prej Qiellit

Në hapësirën e shprehjes në qiell, mund të bëjnë pjesë të këqijat që mund të na vijnë prej krijesave të tjera shpirtërore dhe prej xhindëve. Sepse ashtu sikurse oksigjeni, dioksidi i karbonit dhe plot e plot gazra të tjera pluskojnë në atmosferë, edhe xhindë e krijesa të mira qarkullojnë vazhdimisht aty. Në thelb, nuk mund ta dimë nëse ato qenie metafizike përbëhen apo jo vetëm prej aso gazesh të larmishme. Sepse në ajetin kuranor ato qenie përshkruhen si të krijuara prej zjarri pa tym. [101] E ne nuk mund ta njohim plotësisht brendinë e zjarrit pa tym.

Një prej interpretimeve rreth shtatë palë qiejve [102] ndalet te shtatë shtresat e atmosferës sonë. Atmosfera, nga nivelet më të ulëta gjer te më të lartat, ndahet në shtresa të ndryshme. Në këto shtresa janë vendosur sipas mundësive e prirjeve të tyre të natyrshme xhindë, si dhe, krahas tyre, engjëj e krijesa shpirtërore. Siç tërhiqet vëmendja në tefsirin e shkruar nga Elmallëllë M. Hamdi Jazëri, disa dukuri atmosferike si rrufeja, bubullima e zhurmat qiellore mund t'i shohim edhe si shprehje e shfaqje në botën fizike të disa dukurive të lidhura me qeniet engjëjlore e shpirtërore. [103]

Kur bëjmë fjalë për qiellin, nëse nisim duke vështruar kah qielli i kësaj bote, çështjen mund ta shtrojmë nga një perspektivë më e gjerë. Rreth kësaj çështjeje, njëri nga interpretimet e Bediuzaman Said Nursiut, sikurse edhe i i nderuaru Elmallëllë M. Hamdi Jazërit, është ky: qielli që ne shohim dhe që është i stolitur me yje, është shtresa e parë qiellore. Për sa i përket të dytës, të tretës, të katërtës, të pestës, të gjashtës e së fundi të shtatës, ato ne nuk mund t'i shohim. [104] Sipas këtij interpretimi, mijëra rrugët e galaktikave që vezullojnë krahas Rrugës së Qumështit janë qielli i parë. Ndoshta mbi të ka një tjetër qiell prej eteri që nuk e shohim; ndoshta ka edhe qiej të tjerë prej lëndësh që mund të përbëjnë lëndën thelbësore edhe për eterin. Ato nuk janë gjëra që ne të mund t'i shohim as me teleskopët, as mikroskopët tanë e as me rrezet iks. Pra, bota e jetës së varrit ka një qiell të saj, bota e shëmbëlltyrave ka një qiell të saj, Xheneti ka një qiell tijn dhe Xhehenemi ka një qiell të tijn gjithashtu.

Kur lexojmë shkrime rreth astronomisë dhe astrofizikës, mësojmë se edhe prej planetesh më të largëta rruzulli tokësor pëson ndikim. Për më tepër që edhe në rastin e këtij ndikimi, nëse e vështrojmë vetëm në kontekstin e ndikimit fizik, sërish e ngushtojmë shumë çështjen. Sepse në të mund të kenë rol edhe krijesat e tjera shpirtërore, xhindët, ifritët, apo të tjera krijesa të paperceptueshme prej nesh. Siç shprehet Bediuzaman Said Nursiu, prej asaj bote në këtë botë zbresin vazhdimisht krijesa shpirtërore dhe shpirtra të ligj. [105] Madje edhe meteorët apo gurët e mëdhenj qiellorë, mund të jenë njëfarë goditjeje e tyre ndaj tokës.. [106]

E pra, duke i marrë parasysh të gjitha këto, në këtë gjerësi duhet ta perceptojmë qiellin. Sikurse ka gjëra që prej qiejve më të largët mund të vijnë në qiellin e botës sonë, edhe prej atmosferës sonë ka gjëra që mund të vijnë në botën tonë. Nga ana tjetër, kundrejt thënies së djallit: “Do t'u dal para e pas, majtas e djathtas, duke nxitur dyshime do të ngre pusi, dhe Ti shumicën e tyre nuk do t'i kesh robër mirënjohës.”, Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në një lutje të tij urdhëron e thotë: “Allahu im, mbromë (prej rreziqeve që mund të më vijnë) nga para e nga pas, nga e djathta, nga e majta e nga lart. Mbështetem në madhësinë Tënde prej rrënimit nën veten time (duke u rrëzuar përdhe).” [107] Në këtë mënyrë, pra, ai i kërkon mbrojtje Zotit prej rreziqeve që mund t'i vijnë nga përpara, nga pas, nga e djathta, nga e majta, nga poshtë e nga lart. Prandaj, siç mund të ketë

rreziqe prej përplasjesh me atë çka mund të na vijë nga qielli, ka rreziqe edhe prej përplasjesh me atë çka na vjen nga toka. Në të njëjtën mënyrë, mund të ndodhin edhe përplasje me shpirtra të ligj e me djallin. Për nga kuptimet simbolike, mund të bëhet fjalë edhe për goditje nën brez. E pra, kjo lutje e shprehur nga Tabloja e Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.) me fjalët e Tij të pakëta e kuptimplota, ka anë të ndryshme për nga ajo çka shpreh, nënkupton, argumenton, kërkon. Për ta prekur çështjen në të gjithë gjerësinë që Ai ka synuar përmes shprehjes, duhen mbajtur parasysht të gjitha këto shtresa të kuptimit. Përndryshe, nëse do ta prekim temën vetëm nga një këndvështrim pozitivist e natyralist, atëherë do ta largojmë çështjen nga thelbi i së vërtetës së saj dhe do ta burgosim atë në ngushtësinë e konceptimit tonë të kufizuar.

Ringjallja e Sunetit

Në disa vende është bërë traditë që kjo dua të lexohet para sures “Hashr”. Për shembull, në Erzurum, para se të kalohej në leximin e sures “Hashr”, thuhej tri herë: $\text{\u0645\u0627\u0634\u0631}$ dhe pastaj, duke shprehur besmelenë, kalohej tek ajetet. Në të vërtetë, në burimet ekzistuese, as në kohën e shpalljes hyjnore dhe as në periudhën e Kalifëve të Drejtë, nuk hasim në ndonjë praktikë të tillë. Mirëpo disa dijetarë, me mendimin e ringjalljes së çështjeve që kanë bazë në Kuran ose në Sunet, nuk kanë parë ndonjë të keqe që ajo çka është e vërtetë, të shndërrohet prej njerëzve dhe të formulohet prej tyre. Në këtë pikë, edhe ata që e kanë parë çështjen në mënyrën më negative, e kanë cilësuar këtë vetëm si një risi të mirë (*bidat hasene*). [108] Për shembull, zotëria ynë, Omeri i nderuar (r.a.), kur pa se namazi i teravive po falej me xhemat, urdhëroi e tha: “Sa bidat i bukur që qenka ky!”, [109] sepse Profeti ynë (s.a.s.) vetëm tri herë e ka falur namazin e teravive me xhemat. [110] Kur pa një vrull të madh nga ana e popullit për të bërë të njëjtën gjë, ai e braktisi faljen e namazit të teravive me xhemat.

Arsyeja ishte sepse sjelljet e Profetit tonë të Nderuar ishin shumë të rëndësishme në lidhje me ligjëvënien. Veprat e të Dërguarit përbënin një burim për caktimin e një ligjësie në fe. Pra, në se Zotëria ynë, Profeti, do të vazhdonte ta falte me xhemat namazin e teravive, atëherë edhe myslimanët do ta pranonin këtë dhe do të mbeteshin përballë detyrimit që të vepronin gjithnjë të njëjtën gjë. Prandaj edhe Tabloja e Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), mbështetur në lehtësimin që është në shpirtin e fesë, [111] për të mos i vënë besimtarët përballë një detyrimi të tillë, pasi e fali për tri ditë namazin e teravive me xhemat, hyri në dhomën e tij të lume, që është më e bekuar se Xheneti i Firdeusit, dhe doli që aty. Më pas, urdhëroi e shpjegoi arsyen e kësaj sjelljeje. [112]

E pra, thelbi i lutjes, gjen vend në hadithe të mirënjohura dhe mbështetet në këshillat e të Dërguarit të Allahut, por pavarësisht kësaj, njerëzit janë treguar të pakujdesshëm dhe e kanë braktisur këtë sunet. Për këtë, në disa vende janë bërë përpjekje që kjo lutje të ringjallet duke u kënduar para sures “Hashr”. Pra, është vepruar me mendimin: “Imami ta lexojë këtë dua, xhemati ta dëgjojë dhe kështu, kjo këshillë e Zotërisë sonë, Profetit Muhamed (s.a.s.) të vihet në vend.” Sidoqoftë, sipas mendimit tim, në këto çështje dhe në të tjera të ngjashme me të, dera duhet çelë me kujdes. Veçanërisht në vendet ku kjo praktikë nuk ndodh, nuk i duhet krijuar hapësirë mendimit “Ç’bëni, po nxirrni diçka të re, të paqenë më parë?”.

[99] Po në to.

[100] Shih: Bediüzzaman, Fjalët f. 337-339 (Fjala e Njëzetetretë, Nënkreu i parë).

[101] Shih: Rrahman, 55/15.

[102] Shih: Bekare, 2/29; Fussilet, 41/12; Talak, 65/12; Mulk, 67/3; Nuh, 71/15.

[103] Shih: Elmalılı Hamdi Yazır, *Fe e së vërtetës gjuhë e Kuranit* 1/249-252.

[104] Shih: Elmalılı Hamdi Yazır, *Fe e së vërtetës gjuhë e Kuranit* 1/294.

[105] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 191 (Fjala e Pesëmbëdhjetë, Shkalla e pestë).

[106] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 194 (Fjala e Pesëmbëdhjetë, Shkalla e shtatë).

[107] Ebu Davud, Edeb 100; Ahmed Ibn Hanbel, El-Musned 2/25; En-Nesai, Es-Sunenu'l-kubra 6/145.

[108] El-Ixhi, Kitabu'l-Mevakif 1/159; El-Gazali, Ihjau ulumi'd-din 1/275, 2/256.

[109] Buhari, Teraviih 1; Muvatta, Ramadan 3.

[110] Shih: Buhari, Xhuma 29, Tehexhjud 5, Teraviih 1; Muslim, Salatu'l-musafirin 177.

[111] Shih: Buhari, Iman 29; Nesai, Iman 28.

[112] Shih: Buhari, Xhuma 29, Tehexhjud 5, Teraviih 1; Muslim, Salatu'l-musafirin 177.

Ndërthurja mendim-veprim



Pyetje: Zhvillimi i lëvizjeve dhe i veprimeve sipas një planifikimi paraprak përmendet si një disiplinë e rëndësishme. Nga ana tjetër, bëhet fjalë edhe për ekzistencën e një mendimi që i jep përparësi veprimit. Kundrejt këtyre hollësive, si duhet kuptuar dhe zbatuar një mendim që i jep përparësi veprimit?

Përgjigje: Çdo individ që do të prodhojë një veprim tokësor a shpirtëror afatgjatë, të sigurt e të qëndrueshëm, që t'u sigurojë njerëzve dobi, duhet ta bëjë këtë duke u mbështetur në një plan e program të caktuar. Për një njeri që beson, kriteret për këtë janë ato që i quajmë argumentet thelbësore, si Libri, Suneti, njëmendja e umetit dhe analogjia e fakihëve (interpretuesve të ligjit). [113] Krahas kësaj, janë edhe ato që mund t'i quajmë argumente dytësore apo të përkohshme, të lidhra me punët, pëlqimet dhe zakonet e përditshme. [114] Në lidhje me këto, ka mendime të lira dhe interpretime. Por nuk duhet harruar se të gjitha këto mendime të lira e interpretime realizohen duke vlerësuar pikat lidhëse në burimet thelbësore. Edhe zotërinjtë tanë, muxhtehidë të nderuar, nuk kanë nxjerrë gjykime të pabazuara e si t'u thotë mendja, “min indi enfusihim”. Nëse do të shpreheshim me një term nga metodologjia e fikhut, ata, duke u mbështetur në një përngjasim, kanë shkuar drejt një analogjie apo kanë shprehur një gjykim të tyrin. Veç kësaj, duhet të pohojmë edhe se këtë punë me peshë e shumë të vështirë, ata njerëz të mëdhenj e kanë kryer me një përkujdesje të jashtëzakonshme gjer në hollësitë më të imëta.

Plani i përgjithshëm

Duke iu kthyer temës kryesore, paraprakisht duhet bërë një plan brenda kriteresh të caktuara. Por unë i varfri gjithmonë e shoh atë plan me një vështrim të përgjithshëm. Ashtu sikurse edhe njeriu, kur pranon të besojë, më së pari hyn në kufijtë e besimit me një dije të përgjithshme. Pra, në fillim, ai e pranon çështjen me anë të një njohurie të përgjithshme, duke thënë: “Allahu ekziston, Ai është Krijues Madhështor, Krijues i botës.” Por me kalimin e kohës, sipas nivelit, moshës dhe aftësive mendore, duke pranuar e përvetësuar edhe interpretimin e ligjësive të natyrës, shkon përmes rrugësh të tjera argumentimi edhe në sqarime të hollësishme, madje përpiqet të thellohet në çështjet përkatëse. Po kështu, njeriu, para se të vërë në jetë një veprim apo veprimtari, paraprakisht duhet të zotërojë një plan e program të përgjithshëm për çështjen dhe që këtë duhet të nisë rrugën e tij.

Por çfarë nënkuptojmë me cilësimin “i përgjithshëm”? Për shembull, një besimtar ka një numër vlerash themelore që i ka besuar e përvetësuar. Ai, duke dëshiruar që këto vlera e bukuri t’i njohë gjithkush, thotë në çdo çast: “Sikur atë që unë dua, ta donte mbarë njerëzia / E të mos bëhej fjalë për tjetër veçse për të..!” Tani, kjo gjendje tregon se ai besimtar, në mënyrë që të gjitha zemrave, të gjithë njerëzimit t’ia paraqesë e t’ia bëjë të ditura këto vlera e këto hijeshi, ka një mendim e një plan paraprak. Mirëpo në çdo gjeografi bëhet fjalë për kushte, mjedis kulturor, tradita e zakone të veçanta dhe të mbash qëndrim duke i llogaritur të gjitha këto, është e lidhur me një mendim të hollësishëm, me një plan e program të hollësishëm. E pra, ajo që e quajmë “mendimi që i jep përparësi veprimit”, në thelb, është ky. Pra, mbartja dhe vënia në jetë e njohurisë, e planit dhe e programit të përgjithshëm duhet kthyer në veprim energjik. Dhe si përfundim, kjo do të thotë se veprimi duhet t’i shërbejë si udhërrëfyes planit dhe mendimit të hollësishëm, duhet të gjendet para tij.

“Këta janë trashëgimtarët e Tij”

Nëse dëshironi, nisur nga shembulli i dhënë, mund të përpiqemi që temën ta zgjerojmë disi edhe më tej. Le të themi se atij sistemi vlerash hyjnore, që i ka ardhur njerëzimit si dhuratë nga përtej qiejve ju i besoni nga thellësia e shpirtit dhe ndieni me të vërtetë se ato kanë zënë vend thellë në kraharorin tuaj. Natyrshëm, rezultati i një imani të tillë është që ju, si të pushtuar prej një dashurie të marrë, keni dëshirë që atë sistem vlerash t’ia bëni të ditur gjithë botës. Duke bërë këtë, nuk është fjala as për ndonjë qëllim si të bërit propagandë, as për veprimtari misionare dhe as për t’u imponuar të tjerëve besimin e për të futur botën në fenë tuaj, sepse nëse fenë që ju i besoni nuk e paraqisni me ngjyrat dhe tablonë e vet, puna që bëni nuk do t’ju sjellë tjetër përfundim përveçse do t’ju bëjë të gënjeni veten! Për këtë arsye juve ju thuhet që t’i lini shpjegimet tuaja dhe të lejoni që sjelljet tuaja të flasin vetë. Përsosmëria në sjelljet tuaja le të ushtrojë ndikim në zemrën e palës përballë jush. Atyre që ju shohin, që dëshmojnë veprimet e sjelljet tuaja, vajtjet e ardhjet tuaja, shikimi e fjalët tuaja, bëjini që ato le t’u sjellin përherë ndërmend Allahun e le t’u thonë gjithmonë “Allah”; t’u thonë e t’i bëjnë që në zemrat e bashkëbiseduesve tuaj të mbruhet mendimi: “Diç duhet të ketë pas këtyre njerëzve, këta nuk i hedhin më kot hapat e tyre.” E pra, gjërat që u lihen amanet të tilla rregullave e të tillë qëndrese, edhe në u përballshin me një tërmet dhjetë ballë të shkallës Rihter, me lejen dhe mirësinë e Allahut, nuk lëkunden. Por një ftesë në besim, që mbështetet edhe në fjalët më të bukura e në shprehjet e retorikës më të lartë, nëse nuk thellohet në përfaqësim të mirë, mund të rrënohet edhe me tri ballë tronditje. Prandaj, mund të thuhet se fjala nuk ka shumë rëndësi. Fjala fiton një vlerë relative vetëm si shprehje e sjelljeve dhe e veprimeve. Vetëm ai përfaqësim që është bërë pjesë e natyrës, që është rrënjësor në thellësinë e saj, zgjon një interes të madh dhe ushtron ndikim tek të tjerët. Për shembull, nëse ju nuk e çoni dorën tek e ndaluara as edhe sa për një kokërr elbi. Madje edhe në paçi një nevojë shumë të madhe, tregoni vullnetin tuaj dhe shpërfaqni të njëjtën sjellje. Nëse kjo ndodh një herë, dy, tri... dhe më në fund, kjo gjendje juaja do të ftojë shikimin e kujdesshëm të të tjerëve. Nëse ju kujtohet, kur Bediuzaman Said Nursiu kalonte bashkë me Sejid Tahanë dhe Haxhi Iljasin në Gjirin e Bosforit, ai ulte kryet dhe i mbante sytë gjithnjë poshtë. Kundrejt kësaj, Sejid Tahai dhe Haxhi Iljasi i shprehën habinë e tyre Mësuesit të nderuar, ai u dha atyre këtë përgjigje: “Përfundimi i kënaqësive të padobishme, kalimtare e mëkatore janë veç dhembje e shqetësime, ndaj s’dua që t’i kem.” [\[115\]](#)

E pra, që gjatë gjithë jetës të tregosh një qëndrim e një sjellje të tillë, është shumë e rëndësishme. Po, po! Pasi për dyzet vite ta ndjekin në heshtje sjelljen tuaj, njerëzit duhet të mund të thonë: “Lavdi Allahut! Këta janë njerëz me sjellje si prej profeti. Gëzojnë cilësi prej profeti si jeta e pamëkatshme, besnikëria, siguria (mbajtja e fjalës dhe amanetit), komunikimi, zgjuarsia dhe mendja e hapur. Duke qenë se pas Vulës së Profetëve, Muhamed Mustafasë (s.a.s.), nuk do të vijë profet tjetër, do të thotë se këta janë trashëgimtarët e Tij.” E pra, duhet të përpiqeni që të arrini atë pjekuri e të prekni atë horizont që t’i bëjë bashkëbiseduesit tuaj të thonë të tilla fjalë.

Aq më tepër sot, që bëhen përpjekje për ta nxirë fytyrën e ndritur të Islamit, në mënyrë që të korrigjoni e të rregulloni një numër gabimesh, në përfaqësimin e drejtë të vlerave që ju përkasin, ju duhet të bëni një mundim e përpjekje përtej të zakonshmes. Për shembull, kundrejt atentateve vetëvrasëse aq të patolerueshme, kundrejt shpalljeve të luftës që disa i lëshojnë me mendje të vet si t’u shkrepet, kundrejt hedhjes së papërgjegjshme të dy-tri raketave sa andej këndeje në kushtet kur për baraspeshë forcash as që mund të bëhet fjalë dhe me ato dy-tri raketa shkaktohen mijëra të vdekur të pafajshëm duke u bërë shkak për lëshimin e qindra raketave të tjera, ju duhet t’i shpjegoni gjithkujt e kudo, se këto sjellje nuk pajtohen asesi me të qenët mysliman. Sepse Islami nuk ka lënë të zbrazur asnjë fushë të jetës. Ai e ka sqaruar në mënyrë krejt të qartë se si duhet të mbrohem brenda kufijve të legjitimites përkundër dhunës e padrejtësive. Për shembull, siç ndodhi në Luftën e Pavarësisë, përfaqësuesit e kombit mblidhen e krijojnë një komision, ku edhe vendosin shpalljen e luftës. Individët, më pas, e pranojnë këtë vendim dhe e zbatojnë atë në të katër anët e vendit duke nisur një betejë brenda kufijve të së lejueshmes.

E pra, për t’i treguar botës fytyrën e ndritur e të dëlirë të Islamit, që disa e kanë përlyer, duhet të kemi një plan të përgjithshëm. Për të ardhur, më pas, te zbatimi i tij hollësisht, duhet të shpërndahemi në të katër anët e botës dhe duke e përfaqësuar Islamit drejt, duhet të mund t’i bëjmë njerëzit të thonë: “Paskësh edhe myslimanë të tillë!” Pa dyshim që nëse do të nxisnim që të thuhet fjalë të tilla për veten tonë, kjo do të ishte përpjekje për t’u dukur e për të rënë në sy (rija), por nëse fjala është për t’i bërë njerëzit që të flasin mirë për Islamit, atëherë kjo është detyrë. Domethënë, e kemi për borxh që atë Islam që na e kanë lënë amanet Tabloja e Krenarisë Njerëzore dhe Kalifët e Drejtë – shpirti ynë u flijoftë për shpirtrat e tyre – t’ia bëjmë të njohur krejt botës në identitetin e tij të vërtetë. Po, po! Njeriu i shekullit tonë duhet ta pastrojë imazhin e avullt, të mjegullt, të oksiduar të Islamit dhe ne, me thellësinë e duhur të të vërtetave të brendshme, të nxjerrim në pah fytyrën e vërtetë e plot dritë të identitetit të vërtetë mysliman.

Për shembull, duke hapur në të katër anët e botës shkolla e qendra kulturore, duke i parë ata nxënës e prindër në ato institucione si një urë e mundësi komunikimi, duke shkuar në shtëpitë e tyre, duke vlerësuar edhe ditë të veçanta, duke gatuar herë hallvë, herë hashure, herë byrek, herë kadaif, dhe duke treguar se “këto janë produkte të rëndësishme të kulturës sonë, me këto gostitim fqinjët”, mund të vendosni ura me njerëz të kulturave nga më të ndryshme, mund të afroheni me ta dhe mund të përpiqeni të mbyllni ato hendeqe që janë krijuar më herët prej mendimesh të gabuara. Kështu, duke ngritur ura mbi rrjedha, duke vendosur shtigje mes malesh, duke mbërritur edhe një herë në zemra për t’i larguar pengesat mes zemrave dhe Allahut, mund të përpiqemi edhe një herë për të siguruar natyrshëm afrimin e njerëzve me Allahun.

Mendime dhe projekte alternative

Po, po. Njerëzit në vendet ku shkoni, pavarësisht nëse ju e vini apo nuk e vini re, ju vëzhgojnë dhe jua masin pulsën pesëdhjetë herë. Për shembull, kur disa njerëz qëllimkëqij ju kanë ndjekur e përgjatur jashtë vendit, përgjigjja që kanë marrë është kjo: “Kemi dhjetë vjet që i dëgjojmë këta njerëz. Asgjë nga këto që thoni ju s’ë kemi vënë re tek ata. Nuk kemi rastisur në kurrfarë aritmie. Pulsu u rreh po njëlloj.” Siç shihet, me këto fjalë, ata u kthyen thuajse në mbrojtësit tuaj. Nëse duke vështruar në disa vende është vërejtur ndonjë bllokim, arsyeja e kësaj është sepse ne nuk kemi qenë në gjendje ta tregojmë vetveten siç duhet dhe kemi pasur ndonjë mangësi në të shprehurit tonë. Në këtë pikë, mund të tërheqim vëmendjen edhe tek kjo hollësi: në mënyrë që negativitetet që shfaqen të mund t’i kthejmë në pozitivitete, që negatives të mund t’i shtojmë pozitiven, gjithmonë duhet të kemi plan dhe programe alternative.

Pra, përkundrejt rrethanave që ndryshojnë, në mënyrë që ta vlerësojmë edhe një herë gjendjen ekzistuese, duhet të ndërtohen plane dhe projekte alternative sipas atyre rrethanave të reja, çka mund ta quajmë plan të hollësishëm. Njëkohësisht, kjo do të thotë edhe mendim që ka si përparësi veprimin. E pra, nga njëra anë duhet të keni një plan të përgjithshëm dhe një numër të dhënash kryesore, në mënyrë që punët e veprimtaritë tuaja t’i ndërtoni mbi to. Por krahas kësaj, duhet të ruani edhe një numër fijesh të lira për t’ia lënë kohës dhe të ndërtoni plane e projekte alternative për t’i vënë në zbatim sipas rrethanave. Duke marrë parasysh kulturat e ndryshme, duke i njohur njerëzit nga këndvështrimi i gjuhëve, i besimeve, i botëkuptimeve, i sendeve e i dukurive të ndryshme, brenda veprimit tuaj, duhet të jeni në gjendje të thoni: “Këtu mund të ndodhë diçka e tillë, aty mund të ndodhë diçka tjetër.” Dhe kështu, sipas kushteve të vendit ku keni shkuar, duhet të prodhoni alternativa të ndryshme dhe me ndihmën dhe mirësinë e Allahut, duhet të jeni në gjendje të zhvilloni disa sisteme të reja të të menduarit.

Shkurt, një njeri që në fillim mendon thjesht dhe drejtpërdrejt, në përfundim do të mendojë më gjerë e më thellë. Nëse do të shpreheshim me fjalët e përdorura prej poetit Zija Gökalp në lidhje me padijen, kush mendon thjesht në nisje, duke shkuar drejt fundit do të fillojë të mendojë në mënyrë të ndërlikuar – për çka ju mund të përdorni edhe shprehjen “të shumëfishuar” – e në shumë shtresa. Pra, duke menduar, do ta marrë në shqyrtim çështjen përmes alternativash, duke thënë: “Mund të ndodhë kjo, mund të ndodhë ajo, por mund të ndodhë edhe diçka tjetër”; dhe kështu, do të vihet në zotërim të një gjerësie horizonti që do ta shtyjë të fusë në llogari të gjitha alternativat. E pra, të gjitha këto, në njëfarë kuptimi, janë hollësitë në të cilat duhet ndaluar në kuadrin e mendimit të hollësishëm, të planit të hollësishëm, të projektit të hollësishëm.

[113] Shih: El-Pezdevi, El-Usul 1/221; Es-Serahsi, El-Usul 1/279.

[114] Shih: Mehmed Sej'jid, Medhal f. 323.

[115] Bediuzaman, Jetëshkrimi f. 504-505 (Periudha e Emirdağ-ut).

Ndjenja – emocioni dhe arsyeja e shëndoshë



Pyetje: Ç'është qëndrueshmëria në fe dhe si duhet manifestuar ajo?

Përgjigje: Fjalën “*salabet*” apo qëndrueshmëri nuk është e drejtë që ta kuptojmë si ngurtësi, rreptësi dhe ashpërsi. Për ngurtësinë, ne përdorim më shumë konceptet e fanatizmit e të zellit të tepruar në kuptimin e këmbënguljes në mendimin vetjak qorrazi, pa argument e pa u mbështetur kurrkund, si dhe në sjelljen jotolerante e refuzuese kundrejt mendimeve të tjera. Nga ky këndvështrim, qëndrueshmëria në fe shpreh vendosmëri, ngulmim dhe përqaftim të fuqishëm. Ky kuptim, në suren “Bekare”, gjen shprehje kështu: “Nuk ka detyrim në fe; e vërteta është dalluar prej së kotës dhe është bërë krejt e dukshme. Tashmë kushdo që i kundërvihet tagutit dhe beson tek Allahu, ai është kapur në mbajtësen më të sigurt.” [116] Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.), duke na lënë amanet fenë e qartë të Islamit, atë dritë të përherëshme, ka urdhëruar e thënë: “Ndiqni rrugën time dhe rrugën e Kalifëve të Drejtë në udhën e drejtë. Kapuni fort me dhëmballë pas kësaj rruge.” [117] Shprehja “kapuni me dhëmballë”, e përdorur në hadith, në gjuhën arabe është një idiomë, një mënyrë të shprehuri. Ndaj edhe përtej kuptimit të fjalëpërfjalshëm, duhet kuptuar ajo çka arabët synojnë të thonë me një shprehje të tillë. E parë nga ky këndvështrim, shprehjen “Kapuni me dhëmballë” mund ta marrim në kuptimin: “Ruajeni fuqishëm fenë e mos e braktisni atë kurrë, duke u mbajtur pas saj thuajse siç kapet dara pas diçkaje.” E pra, siç kuptohet prej teksteve të shenjta të përmendura, qëndrueshmëri në fe do të thotë që të jesh i qëndrueshëm në vlerat e larta si besimi, morali, nderi... të mos tregosh lëkundje dhe të mos e lëshosh veten në marrëdhënie me to. Ndërsa të tregohesh i ashpër e të imponohesh për të shtrënguar njerëzit në pranimin e fesë, siç e thamë që në fillim, nuk është qëndrueshmëri në fe, por një lloj fanatizmi dhe zelli i tepruar.

Të largosh prej fesë duke menduar se po i shërben fesë

Nëse një individ e kupton imponimin, fanatizmin dhe ashpërsinë si qëndrueshmëri në fe dhe nëse mendon se me këtë mendësi po i bën apo do t'i bëjë shërbim fesë, ai është në një vetëmashtrim të madh. Të tilla qëndrime bëhen shkak për reagim dhe në përfundim jo vetëm që nuk mundësojnë që njerëzit të pranojnë fenë, por i hapin rrugën neverisë dhe largimit të tyre prej fesë. Prandaj edhe mund të thuhet me siguri se nëse njerëzve nuk u shpjegoni thelbin e fesë, thellësinë e saj të brendshme, përmbajtjen që do të kishte kuptim për ta dhe mirësitë e bukuritë që do t'u falte atyre

besimi, nëse me sihariqin që feja u paraqet atyre nuk zgjoni në zemra një zell e dëshirë kundrejt fesë, atëherë ndryshe nga ajo çka synoni, do të merrni një shuplakë, do të përballeni me reagime të papritura dhe teksa thoni se po i shërbeni fesë, në të vërtetë, do t'i largoni njerëzit prej saj. Po, po! Një mesazh i paraqitur me mendësi të fanatizmit e të kryeneçësisë, më shumë sesa përfitim, sjell humbje.

Në të vërtetë, të gjithë e dinë se ç'përfundim patën gjatë shekullit XX një numër “-izmash” që ushtruan dhunë, imponim e trysni për t'i detyruar njerëzit që të pranojnë sistemet e tyre. Siç e dini, në emër të kësaj, në një vend u vranë dyzet-pesëdhjetë milionë njerëz dhe sistemi u përpoq të ngrihet pothuajse mbi eshtrat e atyre të vvarëve. Por ajo çka la pas kjo mizori, trysni e dhunë e egër nuk qe asgjë tjetër veç urrejtjes dhe neverisë. Pra, pavarësisht prej gjithë asaj dhune, mizorie e shtypjeje, pasi kaluan pesëdhjetë-gjashtëdhjetë vjet, ai sistem qe i detyruar të shthuret e të shpërbëhet. Ndërsa njerëzit që i qenë nënshtuar shtypjes u rikthyen aty ku kishin qëndruar në të shkuarën dhe nisën t'i drejtohen sërish asaj që kishin besuar dikur.

Përmasa e vërtetë e besnikërisë ndaj fesë

Prandaj, një besimtar që zotëron qëndrueshmëri në fe nuk duhet të lëshohet pas ndjesive dhe nuk duhet të bjerë kurrsesi në gabimin e të shpallurit të çështjeve me thirrma e bërtitje. Një mënyrë e tillë sjelljeje vetëm sa do të vërë në lëvizje ndjenjat e neverisë te bashkëbiseduesit dhe do të shkaktojë që ata të mbyllen më shumë në guaskën e tyre e të ashpërsojnë qëndrimet. Më vonë, një gjendje e tillë shpirtërore mund të kthehet edhe në reagim e madje në agresivitet e armiqësi. Për të mos u hapur rrugë të gjitha këtyre përfundimeve negative e ndërlikimeve, duhet të veprojmë mbi bazë të sjelljes pozitive, të mbahemi fort pas vlerave tona, të përqendrohemi në to, të bëhemi shprehës të tyre dhe njëkohësisht të përpiqemi që me gjuhën e zemrës, me mënyrën e sjelljes, t'i shpërfaqim ato vlera në formën më të hijshme. Për shembull, në ditët tona, kur përparësi kanë dituria dhe të shprehurit, kur epërsia qytetëruese realizohet përmes rrugës së bindjes, ajo që duhet të bëjë një njeri i lidhur me fenë e tij, që zotëron qëndrueshmëri në këtë fe, është, që para së gjithash, t'i mësojë shumë mirë vlerat e veta dhe pasi t'i mësojë, të përpiqet t'i përvetësojë ato në natyrën e vet. Nëse për këtë, për shembull, i duhet të lexojë njëqind libra, një njeri që dëshiron t'i shërbejë fesë së vet duhet t'i sigurojë ato libra dhe në dy-tri vite duhet t'i kushtohet të lexuarit dhe të kuptuarit të tyre. Nëse është nevoja, duhet t'i konspektojë, t'i analizojë e t'i klasifikojë ato çka lexon, madje dhe kuptimet e përmbajtjen që nxjerr e përfiton prej tyre duhet të përpiqet t'i përvetësojë e t'i bëjë pjesë të individualitetit të vet. Krahas gjithë këtyre, nuk duhet ta lërë asnjëherë pas dore edhe dimensionin shpirtëror të çështjes. Në qoftë nevoja, me qëndrueshmëri e vendosmëri, edhe dyzet vite rresht duhet të ngrihet netëve, të falë namaz nate, të vërë ballin përdhe në namaz të haxhetit e të lutet e të përgjërohet me fjalët: “O Allahu im, të lutem veç Ty! Zbuti zemrat e këtyre njerëzve ndaj fesë e besimit!”

Nëse të lexosh e të mësosh vlerat e tua dhe pasi t'i kesh mësuar, t'i përvetësosh e t'i bësh ato pjesë të natyrës tënde, kërkon kaq shumë vullnet, përpjekje e vendosmëri, atëherë në atë masë do të lexosh, në atë masë do t'ia kushtosh veten kësaj pune. Njëkohësisht, duke qenë se kjo çështje nuk është individuale, nuk do të mjaftohesh me lexime individuale, por do të ulesh e do të konsultohesh me shokët e tu, do t'i testosh mendimet në arsyen e përbashkët dhe kështu, duke tërhequr pas vetes forcën shpirtërore të arsyetimit dhe të të menduarit të përbashkët, do të vihesh në udhë. Dhe nuk

do të mjaftohesh me kaq, por në mënyrë që të sigurosh mbështetjen e Zotit të Gjithëfuqishëm, do të bësh përpjekje të vazhdueshme për ta mbajtur të fuqishme marrëdhënien me Zotin tënd dhe gjithmonë do të mundohesh të jesh një shërbëtor i mirë i Tij. Kështu, edhe Allahu (xh.xh.) do t'i mbështesë këto përpjekje të sinqerta dhe fjalëve të tua do t'u mundësojë që të dëgjohen. Ashtu që fjalët që dalin prej gojës sate të frymëzojnë ringjallje në shpirtin dhe të zgjojnë emocion në zemrën e bashkëbiseduesit. Siç shihet, çështja në fillim nuk i duhet lënë ndjesisë, por logjikës e gjykimit dhe më pas, gjithashtu, duhet ecur nën udhërrëfimin e tyre. Në fund të fundit, a nuk është kjo rruga e Zotërisë së Zotërinjve (s.a.s.)? Brenda atyre njëzet e tri viteve, ai gjithmonë ua paraqiti mesazhin bashkëbiseduesve në mënyrën që ata mund ta pranonin, veçoi me mendjen dhe me logjikën e Kuranit dhe pa zgjuar reagim tek askush, ua bëri të ditur zemrave zbulesën hyjnore.

Në të kundërt, veçanërisht në ditët tona, duke qenë se njerëzit ndjekin në një masë të caktuar arsyen, i kushtojnë rëndësi mendimit dhe i trajtojnë çështjet brenda kornizës së të kuptuarit, nëse mbështeteni te forca, duke thirrur e bërtitur dhe duke u treguar i ashpër, nuk mund t'i shpjegoni kurrkujt asgjë dhe nuk mund t'i zgjidhni problemet. Po, po! Nëse do të keni mendimin e të shërbyerit ndaj fesë deri në gatishmëri për vetëflijm, atëherë duhet të zotëroni një nivel të lartë në çështje të fesë, si dhe në pajisjen mendore e shpirtërore, të ruani marrëdhënie të fortë me Allahun dhe vazhdimisht të meditoni e të mendoni thellë. Dhe veçanërisht në botën tonë, që sa vjen e zvogëlohet gjithnjë e më tepër, në të cilën përfaqësimi i Islamit është kthyer në një çështje gjithnjë e më të përgjithshme, në një vend ku është fjala për të drejtat e të gjithëve, askush, asesi nuk duhet të hidhet në qëndrime e sjellje individuale. Sepse të tilla sjellje individuale mund të bëhen shkak për gabime që mund t'i turpërojnë të gjithë besimtarët. Për shembull, nëse në emër të mbrojtjes së Islamit vriten njerëz të pafajshëm përmes bombash të gjalla e sulmesh vetëvrasese, kjo paraqet një tablo sterrë të zezë të Islamit, aq sa të gjithë myslimanët në faqe të dheut e kanë të vështirë ta shpjegojnë atë dhe mbeten në një gjendje shumë të vështirë. Edhe pala e kundërt pohon se “ata që i bëjnë këto janë myslimanë, pasi veshja dhe pamja e tyre e jashtme tregon që ata janë myslimanë”, duke përpjekur në këtë mënyrë që një fe përfaqësuese të së mirës, të së drejtës e të dhembshurisë, ta paraqesë në një pol krejt të kundërt dhe t'i vërë nën dyshim të gjithë njerëzit. E pra, një shkelje kaq e rëndë, që prek të drejtat e të gjithë besimtarëve, buron prej të moskuptuarit të shpirtit të fesë, prej mungesës së vetëdijes për idenë e rrugës së drejtë, prej lënies mënjanë të arsyes e të logjikës së Kuranit.

Dinamika e emocionit që shndërrohet prej mendjes dhe arsyes

Nga këto që thashë, nuk duhet kuptuar që unë duartrokas mungesën e rëndësisë së ndjenjës. Nuk ka dyshim që ndjesia është një faktor shumë i rëndësishëm në të shpjeguarit dhe të mbrojturit e fesë së pastër të Islamit. Njeriu, për t'ua bërë të njohura shpirtit vlerat në të cilat beson, duhet të jetë plot emocion dhe kundrejt çdo të keqeje që mund t'i vijë fesë, duhet të shqetësohet aq shumë sa të jetë thujse në gjendje për të vdekur. Por bashkë me këto, ai gjithmonë duhet, që përmes mendjes dhe arsyes, të mund ta shndërrojë atë dinamikë të emocionit, ta orientojë atë në rrugën e duhur dhe të dijë të përfitojë prej saj në mënyrën më të bukur.

Po përpiqem ta shpjegoj me një shembull atë që dua të them: mendoni, për shembull, për një vendbanim që ndodhet nën male të larta. Në këtë vend, çdo vit, me shkrirjen e borës, pason rreziku i përmbytjes prej një rrjedhe shumë të fuqishme që merr me vete gjithçka porsia ashklat. Tani këtu,

punë e logjikshme dhe me mend është që të ndërtohet një digë, të vihet nën kontroll ai ujë i harbuar, pastaj të hapen kanale dhe të ujitën me të tokat e thata. Në mënyrë të njëllojtë, edhe te një besimtar duhet të ketë emocion. Ashtu që kur të shfaqet një situatë negative për fenë, ai të vuajë e të shqetësohet tej mase, të ndiejë dhimbje, të mos e zërë gjumi netëve dhe të ngrihet e të vijë si i çmendur rrotull nëpër dhomë. Por gjithsesi, ai nuk duhet ta shpërdorjë e ta çojë kot këtë emocion në britma e thirrje që nuk sjellin kurrfarë dobie. Kundruall një situatë të tillë, ai duhet të përpiqet që të bëjë ç'të jetë e logjikshme e me mend dhe në këtë mënyrë, atë emocion të harbuar të mund ta kthejë në lëvizje pozitive, në punë e në veprim të dobishëm. Dhe ndërsa e bën këtë, kurrsesi nuk duhet të hyjë në veprime individuale, emocionale e impulsive. Sepse sado që emocionin të jetë një ndjenjë që meriton të lëvdohet, edhe përpjekja për ta vënë emocionin nën kontroll dhe për ta bërë atë të dobishëm brenda rrjedhave të mendjes e të arsyes është po aq e lavdërueshme. Sot, gjendja e dhembshme në të cilën ndodhet e gjithë bota islame, dhe madje mbarë njerëzimi, duhet të na bëjë të gjithëve të vuajmë e të ndiejmë dhembje të thellë dhe të na mbushë me emocion në gjithë qenien tonë. Por nëse një njeri vepron vetëm sipas këtij emocionin, nëse rrëzon e thyen ç'ka rreth e rrotull, ai zgjon ndjenja urretjeje te njerëzit e tjerë dhe në përfundim, bën që përballë tij të shfaqet një front agresiv dhe shkatërrues. Pra, nëse ndjenja dhe emocionin nuk i nënshtrohen dot provës së mendjes dhe të logjikës, nëse nuk vlerësohen dot brenda kanaleve të përcaktuara prej gjykimit e mendimit dhe nëse nuk i dorëzohen arsyes, atëherë ajo ndjenjë dhe ai emocion kthehen në një përmbytje që i sjell mjaft dëme mjedisit përreth.

Në këtë pikë, a është e mundur të mos sillet ndërmend ai qëndrim i jashtëzakonshëm e i drejtë, të cilin e tregon Bediuzaman Said Nursiu? Siç e dini, ai ishte një njeri i mbushur plot me dashuri e me emocion. Mund të thuhet se në shekullin që jetoi nuk ka pasur tjetër njeri më emotiv se ai. Por në të njëjtën kohë, mund të thuhet edhe se nuk ka pasur njeri që të ketë vepruar më me kujdes e më me maturi se ai. Po, po! Pavarësisht se një jetë të tërë punoi paprerë për përparimin material e shpirtëror të kombit, gjë për të cilën meritonte që të vlerësohej shumë lart, edhe mosha shtatëdhjetepesë apo tetëdhjetëvjeçare e gjeti burgjeve, madje herë herë të hedhur në vende si nevojtoje, pa i parë syri një ditë të bardhë. Por pavarësisht të gjitha këtyre, ai kurrë nuk u hodh në veprime emotive e impulsive. Madje ai personalitetin e jashtëzakonshëm, krahas vetëkontrollit, ia dilte të frenonte edhe njerëzit e tjerë pranë vetes që të mos vepronin me emocionalitet, duke mos treguar asnjë mangësi në këtë drejtim, megjithëse rreth vetes kishte plot njerëz trima, të guximshëm e plot emocion, të cilët përpëliteshin rrotull në vuajtje e dhembje. Mirëpo Mësuesi i nderuar, me botën e tij të dëlirë të ndjenjave, duke e ditur se përmes lëvizjesh e veprimesh reaguese nuk do të mbërrihej kurrkund, atë potencial të emocionit e orientonte në kanale të ndryshme me arsyen dhe logjikën e Kuranit, duke e vlerësuar në një mënyrë të tillë që në ditët e sotme nuk është e mundur më të mos vihet re ai ndikim i fuqishëm i tij në rritjen dhe zhvillimin e mjedisit tonë në drejtim të dijës, të mësimit e të besimit.

Në përfundim, mund të themi se ndjenja dhe emocionin përbëjnë një dinamikë të nevojshme e shumë të rëndësishme për përhapjen e fesë në zemrat e njerëzve dhe për mbrojtjen e saj kundrejt sulmeve që i bëhen. Por kjo dinamikë pa dyshim që duhet të kontrollohet përmes dijës, mendjes së shëndoshë, logjikës, gjykimit, këshillimit, diskutimit dhe gjykimit të përbashkët; dhe duke u vënë nën kontroll, të bëhet e dobishme dhe të sjellë rendiment.

[116] Bekare, 2/256.

[117] Tirmidhi, Ilim 16; Ebu Davud, Sunnet 5; Ibn Maxhe, Mukaddime 6.

Vlerat tona dhe çerdhja jonë



Pyetje: Vërejmë se institucioni ynë i familjes tradicionale, i ngritur mbi vlera kombëtare e shpirtërore të trashëguara prej së shkuarës, ka nisur të tronditet qysh prej periudhës së Reformave të Tanzimatit. Në cilat hollësi duhet bërë sot kujdes për ringjalljen e institucionit të familjes, që mbart një rëndësi jetike për shoqërinë?

Përgjigje: Fermani i Tanzimatit ishte përpjekja e elitës sonë të arsimuar e më së shumti të ushqyer me kulturën franceze, që t'i organizonte sipas asaj kulture jetën, sendet dhe ngjarjet në vendin tonë. Në këtë ferman-reformë, të hartuar nga Mustafa Reshit Pasha, duke marrë si bazë kriteret e Perëndimit, fatkeqësisht, vlerat e ngjizura e të prejardhura prej shpirtit dhe thelbit tonë nuk u morën parasysh. Është e vërtetë se Dokumenti Sulltanor i Gylhanes përmbante, ndoshta, përpjekjen për ta shpëtuar Shtetin e Lartë. Nëse Mustafa Reshit Pasha, që u përzie në këtë punë, ishte i sinqertë apo jo, nuk e di. Atë vetëm Allahu e di. Gjithsesi, mund të themi se brenda kësaj përfshiheshin edhe shumë njerëz të sinqertë. Mirëpo ja që rruga apo metoda që ata ndoqën nuk ishte e drejtë. U synua diçka, dëshirohej të mbërrihej diku; ndoshta ëndërrohej sërish epoka e një Ligjvënësi apo e një Ngadhënjimtari si Mehmeti II, por një mendim i tillë, që meriton të duartrokitet, nuk mund të gjente zbatim duke shkuar rrugëve të gabuara. Sepse me sistemin edukativ, me rregullsitë sociologjike e konceptet pedagogjike të Perëndimit, nuk mund të viheshin në jetë ato mendime e projekte të synuara, që na përkisnin neve. E pra, pikërisht në këtë pikë gaboheshin njerëzit e Tanzimatit. Sepse edhe rrugët e ndjekura duhet të jenë të drejta në masën e qëllimit, të mendimit dhe të drejtësisë së horizontit. Nëse pikësynimi juaj është që të mbërrini të sigurt e të shëndetshëm në Stamboll, atje nuk mund të mbërrini përmes shtigjesh dhish, por vetëm përmes autostradash. Nëse niseni nëpër shtigje, ato rrugë mund t'ju sjellin vërdallë, përpara mund t'ju shfaqen male; dhe kështu, ju mund të mbeten rrugëve, pa mbërritur asnjëherë në destinacion.

Ndërkohë, më duhet të pohoj se në të vërtetë, shpërbërja te ne kishte nisur në një periudhë shumë më të hershme se Tanzimati. Tanzimati është vetëm emri i periudhës, në të cilën kjo punë u bë e dukshme. Është e gabuar që çështjen ta lidhim vetëm me Mustafa Reshit Pashën dhe me vitet e para të shekullit XIX. Ndoshta ajo çështje shkon gjer në kohët kur jeniçerët ngrinin krye, kur sulmoheshin sarajet, kur përmes atyre sulmeve bëheshin përpjekje që të hiqeshin e të viheshin sundimtarë; gjer në kohët e Osmanit të Ri dhe të Muratit IV. Që prej atyre kohëve, trazirat, mosmarrëveshjet dhe ngatërresat na gërryenin e na karbonizonin së brendshmi. Për këtë arsye, mund të thuhet se në vitet që u shpall Fermani i Tanzimatit, filozofia jonë e shtetit dhe e

administrimit, koncepti ynë për të drejtën dhe drejtësinë ishin rrënuar krejt. Këto fjalë të të ndjerit Mehmet Akif Pejani duken sikur përshkruajnë atë periudhë:

“Koka pa mend, zemra pa ndjenjë, shpirtra me ndryshk;

Ditë shkuar punës në robëtim, netëve që s’presin agim,

Qaja së ikuri në largim; qaja së ndenjuri n’vajtimit.

S’dëgjon e s’bëzan kush, i brita mëmëdheut në rrënim.”

Ndërsa në vitet e mëpasme kjo gjendje u thellua edhe më, dhembjet u shtuan akoma më tej. Vlerat tona themelore, në tërësinë e tyre, siç shprehet Mjeshtër Nexhip Fazëlli, u rrëzuan njëra pas tjetrës. Ndërkohë, edhe vatra familjare u shkatërrua; sikurse edhe filozofia jonë e jetës, e ngritur mbi themele të fuqishme në marrëdhënien mes bashkëshortëve, në lidhjen e ngrohtë e të sinqertë mes prindërve dhe fëmijëve.

Por megjithatë, përballë kësaj tabloje të dhimbshme e të zymtë, në vend që të biem në mungesë të shpresës, secili prej nesh duhet të bëjë përpjekjet që kemi në dorë për ta ringjallur sërish institucionin e familjes. Dhe nuk duhet harruar as fakti se familja është e lidhur me një shoqëri të tërë, ndaj edhe përmirësimi dhe ringjallja e saj në kuptimin më të plotë ka lidhje edhe me përmirësimin dhe me ringjalljen e të gjitha institucioneve të shoqërisë. Mirëpo nëse rruga nuk e dhuron atë frymë e atë domethënie, atëherë çështjet që ju u jepni zgjidhje jua rrëmben sërish rruga dhe i bën ato sërish të ngjashme me të. Në të njëjtën mënyrë, nëse faltorja nuk i bëhet mbështetje në këtë kuptim vatrës familjare, nëse shkolla nuk është pranë saj, atëherë ato tipare të bukura që iu sillni familjes bëhen sërish të padobishme e të kota dhe ju ikin nga duart. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet harruar se rilindja e institucionit të familjes është e lidhur me rilindjen e gjithë shoqërisë.

Qëndrimi serioz krahas frymës revolucionare

Për t’u kthyer sërish në thelbin e çështjes sonë, pasi gjithçka u rrënuar e na iku duarsh, besoj se tani ka ardhur koha e kthimit sërish në vlerat tona. Në këtë pikë, çështja që duhet pasur kujdes është që në daljen për zot ndaj vlerave tona duhet të shpërfaqim qëndrimin më serioz të mundshëm. Emri i kësaj nuk është as kthim pas, as prapambetje, as reaksion. Sepse ne, krahas përpjekjes për t’u dalë për zot vlerave tona, besojmë edhe se duhet ta lexojmë botën drejt e sipas kohës në të cilën jetojmë dhe se në këtë çështje duhet të ushqejmë një frymë shndërruese. Në të vërtetë, kjo gjendje për besimtarin përbën një dilemë dhe një kundërthënie prej së cilës është e vështirë të çlirohet; por ai pa tjetër duhet të ketë vullnetin për ta jetësuar gjithë këtë. Domethënë, nga njëra anë duhet t’u dalë për zot vlerave të tij aq sa të mos pranojë të heqë dorë për tyre edhe nëse i premtohet një botë e tërë, duke thënë: “Sikur njëmijë shpirtra të kisha, të gjithë u qofshin falë atyre vlerave!”; dhe nga ana tjetër, nuk do të lërë pas dore tefsirin e kohës si më i madhi komentues, si dhe të bërit kujdes që erën e atij tefsiri ta mbajë kurdoherë pas vetes. Përndryshe, vijnë njerëz që i interpretojnë më mirë kohën dhe ligjësitë e natyrës; dhe të tillët, duke ushtruar trysni mbi ju, nisnin t’ju sundojnë. Pas kësaj, siç ndodh në ditët tona, detyroheni të hyni nën tutelën e tyre dhe jeni të dënuar të shtypeni. E pra, në këtë drejtim, gjithsecili prej nesh duhet të përpiqet të jetë revolucionarizues dhe

i përkushtuar në vazhdimësi ndaj zhvillimit të aftësive. Duke qenë se stanjacioni në mendim, në meditim, në hulumtim, në leximin e kohës në mënyrën e duhur, na ve në gjendje robërie, duhet që sendet dhe ngjarjet t'i shtjellojmë në vazhdimësi siç shpëstillen pambuku a leshi prej furke.

Në një kohë të caktuar, në lidhje me një çështje, ju mund të keni arritur më të mirën e më të përsosurën. Cila është ajo, më e përsosura që keni arritur? Për shembull, zberthimi dhe kuptimi më i qëlluar që mund të arrini në lidhje me një çështje duke lexuar shumë mirë Kuranin dhe Sunetin e Kulluar. Por, në njëfarë mënyre, edhe pas kësaj që keni arritur nuk duhet të qëndroni të lidhur e të mjaftoheni me aq, por sipas kohës dhe rrethanave në të cilat ndodheni, duhet ta rilexoni situatën dhe të rishikoni nëse ajo çka ishte gjykimi më i goditur është vërtet i tillë. Të mos keqkuptohemi, kuptimi i kësaj kurrsesi nuk mund të jetë që të hyhet në reforma e ndryshime sipas kohës në çështje të ritit e të ibadetit. Në fakt, e kemi fjalën për t'i lexuar siç duhet urdhëresat hyjnore, për t'i parë jetën dhe edukimin shoqëror nga këndvështrimi i këtyre urdhëresave dhe krahas asaj që do t'u japim të tjerëve, edhe ne, duke kalibruar gjithçka saktësisht dhe me kushtin që të mos biem në kundërshtim me vlerat tona themelore, të marrim dhe të përfitojmë prej të tjerëve. Të gjitha këto janë pjesë e nevojës së të qenit bij të kohës në të cilën jetojmë.

Për këtë arsye, nga ky këndvështrim, duhet t'u drejtohem edhe një herë vlerave tona dhe pasi t'i rishikojmë, t'ia paraqesim ato mendimit të përgjithshëm të njerëzve. E pra, atëherë, dituria, faktorja, familja do të çlirohen prej tëhuajëzimit; dhe pasi të çlirohen, do ta ngrenë sërish mbi vlerat e veta përmendoren e shpirtit. Natyrisht, këto nuk janë punë që kryhen në një çast, me një lëvizje e me një frymë. Shikoni, Zëtorja ynë, i Dërguari Fisnik (alejhissalatu vesselam), që kishte në biseda dhe në praninë e vet një bashkësi me një dëlirësi të thellë që atë dëlirësi e përfaqësonte në mënyrën më të drejtë në mjedisin shoqëror, është përpjekur në mënyrë të jashtëzakonshme për njëzet e tri vite që gjithçka të zërë vendin e vet dhe morali i Ibrahimit të përhapet sërish.

Ç'dashuri për të Drejtën është kjo, për hir të Zotit!

Dhe tani, nëse dëshironi, le të njihemi me disa fragmente të zgjidhjes së problemeve familjare nga jeta e Atij Shembullori të çdo Kohe, që na tregon rrugën e zgjidhjes së të gjitha problemeve që do të na ndodhin gjer në Ditën e Gjykimit: fakti se Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), i trajtonte pjesëtarët e familjes së vet në paqe të plotë e pa kurrfarë të mete, është shprehje e një urtësie shumë të madhe që ai zotëronte. Edhe sikur i Dërguari i Allahut (alejhis'salatu ues'selam), si argumentim të profetësisë së vet, të mos kishte shfaqur mrekulli si të buruarit e ujit prej gishtërinjve, [118] ndarja e hënës duke i bërë një shenjë të vetme me gisht, [119] të ngopurit e njëmijë njerëzve me mishin e një keci [120] etj., trajtimi i njëkohshëm pa sherre e pa zhurmë i nëntë nënave tona të bekuara do të mjaftonte plotësisht për të mbështetur e argumentuar profetësinë e Tij. Veç kësaj, bashkëshortet e tij të dëlira ishin gra që sapo kishin dalë prej errësirës injorante të kohës. Por ja që ato Nënata tonat të bekuara, që mbartnin ende mbi vete disa tipare karakteristike të asaj periudhe, sapo hynin në vatrën e lume, ndryshonin sa hap e mbyll sytë. Thuajse dilnin prej njerëzores për të arritur engjëlloren. Nisur nga të qenët qenie njerëzore, pa dyshim që edhe ato kishin një numër ndjesish të caktuara; por ato, të gjendura në prani të Joshjes së Bekuar, i kapërcyen ato ndjesi dhe krijuan një atmosferë paqeje. Zotëria i Zotërinjve (alejhis'salatu ues'selam) i trajtoi ato pa i dhënë mundësi lindjes së kurrfarë problemi serioz. Po, po! Ia vlen ta përsërisim se edhe sikur Zotëria ynë, Nderi i Gjithësisë, të mos kishte shpërfaqur asnjë mrekulli,

do të mjaftonte trajtimi i nëntë bashkëshorteve me të cilat lidhi jetën, si një mrekulli e plotë, si një argument i qartë dhe si një provë e padyshimtë e profetësisë së Tij. U bëftë shpirti ynë fli edhe për Të, edhe për bashkëshortet e Tij të dëlira! Secila prej tyre e ka vendin mbi kryet tona.

Tani, se si ia doli me sukses kësaj Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (alejhi elfu elfi salatin ues'selam), se çfarë rruge ndoqi për këtë, është një çështje e rëndësishme, tek e cila duhet të ndalemi. Para së gjithash, duhet thënë se Ai, mes bashkëshorteve të tij të bekuara, ruajti gjithmonë ekuilibrin dhe mishëroi drejtësinë. Kështu, në një hadith që na transmeton Nëna jonë, Aisha (r.a.), mësojmë se shkonte një muaj, më pas një tjetër e më pas një tjetër muaj dhe në vatrën e lumturisë nuk ndizej zjarr në oxhak. [121] Kjo është diçka shumë e rëndë, sepse Ai, prej nevojës së misionit profetik, e jetonte jetën e Tij në varfëri të detyruar dhe nuk krijonte asnjë mundësi që në mendjen e njerëzve ta njollose qoftë edhe dyshimi i vogël për misionin e tij profetik. Po, po! Ai jetonte i lidhur fuqishëm pas së vërtetës: “Sepse unë as që pres shpërblim prej jush! Shpërblimi im është vetëm tek Allahu.” [122] Ai ishte mishëruesi i gjallë i së vërtetës: “Ndiqni ata që nuk kërkojnë shpërblim prej jush për ftesën në besim dhe që janë të udhëzuar!” [123] Kur shpirti i Tij shkoi drejt horizontit të shumëpritur, siç e dini, mburojën e kishte lënë peng te një hebre. [124] Për të siguruar jetesën e familjes, nuk kishte gjetur të holla dhe kishte marrë borxh te një hebre, të cilit i kishte lënë mburojën si peng. Vetë flinte në një dysheme të fortë e të thatë. [125] Madje një sahab që, me rastin e “Ngjarjes së propozimit të divorcit”, quajtur ndryshe *"Ngjarja e ila-së"*, pati shkuar në praninë e Tij, duke rrëfyer për pamjen që pa, na bën të ditur se Ai qëndronte i shtrirë në një dalëz mbi një hasër dhe hasra ishte aq e ashpër, sa që i kishte lënë gjurmë mbi trup. [126] Dhe teksa shihnin se Ai, bashkë me bashkëshortet e tij të bekuara, jetonte në një thjeshtësi të tillë, askush nuk kishte mundësi të thoshte asnjë gjysmë fjale për Të. Pra, brenda asaj familjeje kishte një ekuilibër e drejtësi të tillë që askujt nuk i lindte e drejta të protestonte për asgjë ndaj Tij.

Nga ana tjetër, edhe në njohjen dhe në respektimin e të drejtave të familjes, ai tregonte një ndjeshmëri shumë të lartë. Po ashtu, e dimë mirë se çfarë përmallimi e ndezullie shfaqte Tabloja e Krenarisë Njerëzore në marrëdhënie me adhurimin dhe me nënshtrimin ndaj Zotit. Për shembull, në një hadith, Ai urdhëron e thotë: “Mua më janë bërë të dashura (tri gjëra): Gratë, aroma e këndshme; ndërsa namazin e kam dritën e vërtetë të syve.” [127] Ndërsa tjetërkund thotë kështu: “Epshi im është që të fal namaz netëve.” [128] Kuptimi i kësaj është kështu: kënaqësinë që ju përpiqeni ta shijoni prej të ngrënit, të pirit e prej plot dëshirash të tjera trupore, unë e marr prej kryerjes së adhurimeve ndaj Zotit. Mirëpo pavarësisht gjithë kësaj, vërejmë se Profeti ynë (s.a.s.), para se të ngrihej nga shtarti për të kryer ibadet gjatë natës, i kërkonte leje Aishes fisnike (r.a.). Po, po! Ai, edhe kur ngrihej nga shtrati për të kryer ibadetin e natës, thoshte: “O Aishe! A më jep leje që këtë natë t’i bëj ibadet Zotit tim?” Kundrejt kësaj, Nëna jonë, Aishja e nderuar (r.a.), i jepte këtë përgjigje: “Më pëlqen të jem me Ty, por më pëlqen edhe gjithçka që do të të pëlqente Ty.” [129] O Zot! Ç’përkushtim ndaj të Drejtës! Sepse në atë kohë është fjala për të drejtën e nuses së tij të bekuar; në atë kohë duhet të jetë bashkë me të. Por nga ana tjetër, ka një ndezulli e dëshirë të thellë për t’i kryer adhurime Zotit të vet. Siç shihet, Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.) e kapërcen këtë kundërthënie duke kërkuar leje prej bashkëshortes.

Delikatesa, brishtësia dhe besnikëria

E pra, në marrëdhëniet mes bashkëshortëve, një delikatesë, brishtësi e mirësjellje e tillë është e një rëndësie të veçantë. Të tregosh një lidhje e afri të këtyre përmasave ndaj zonjës së nderuar... Në të vërtetë, shoqëria jonë e tillë ka qenë. Nëse më lejoni, dëshiroj t'ju tregoj disa gjëra që i kam parë në rreth të ngushtë, brenda familjes sime. Ata, megjithëse ishin mbetje e një shoqërie që në një masë të madhe u prish e u degjenerua, mbeteshin sërish një familje që ende jetonin shumëçka prej asaj çka kishte mbetur prej shoqërisë osmane. I ndjeri gjyshi im ishte një burrë aq i ashpër, sa që kur dilte nga shtëpia për të shkuar në xhami, nuk mbetej njeri pa u ngritur, që të qëndronte drejt në shenjë mirësjelljeje. Kur thuhej se po vjen Shamil agai, i zinte frika. Ndërsa gjyshja ime, Muniseja, ishte një njeri me një natyrë krejt tjetër. Ajo ishte një grua me zemër të butë, që nëse përmendnit një herë Allahun në prani të saj, qante njëzet e katër orë. Kur unë arrita moshën njëmbëdhjetë apo dymbëdhjetë vjeç, ata të dy ishin ende gjallë. E pra, atë burrë të sertë e të rëndë nuk e pashë qoftë edhe një herë të vetme që t'i ngryste vetullat së shoqes.

Ajo grua zemërmirë e sypërlotur, në fund të jetës së vet, u paralizua e zuri shtratin. Ime më, çdo ditë te koka e krevatit, e ndihmonte që të merrte tejemum dhe të falte namazin. Nëna thoshte: “Në natën e së premtes para ndarjes nga jeta, më kërkoi që t'i mundësoja të merrte abdest. E ndihmova. Pas kësaj ia dha një të qeshure dhe tha kështu: ‘Kurr gjë s’paskemi fituar prej kësaj bote. Xhenazja e ne të dyve do të falet këtë natë në shtëpi.’ Në fakt, gjysh Shamili nuk kishte asnjë shqetësim. E megjithatë, në çastin që gjyshja ndërroi jetë dhe ra mbi jastëk porsi një pupël, teksa unë i mbyllja sytë, në dhomën tjetër u dëgjua grahma e gjyshit që gjithashtu ndërroi jetë.” E pra, një lidhje e tillë ekzistonte mes atyre të dyve.

I ndjeri im atë ndërroi jetë në vitin 1974. Në atë kohë unë isha tridhjetë e pesë, tridhjetë e gjashtë vjeç. I ndjeri baba, gjatë gjithë jetës, veç një herë mbaj mend t'i ketë ngrysur kërcënueshëm vetullat sime mëje. Në atë çastë, gjyshja ime ndërhyri menjëherë e i tha: “Ramiz! Nëse i bën gjë asaj, t'i bëj haram qumështin dhe mundimet që kam hequr për të të rritur.” E pra, struktura e familjes sonë, të mbetur prej shoqërisë tashmë të prishur osmane, ishte ende në këto nivele.

Një tjetër shembull dëshiroj ta jap prej xhaxhait të tim eti. Se ç'jetë kishte me të shoqen, nuk e di fort mirë. Por pasi i ndërroi jetë e shoqja, ai çdo javë i hipte karrocës në Erzurum, shkonte të vizitonte varrin e saj në fshat dhe qante gjysmë ore në krye të varrit. Pastaj, i hipte sërish karrocës dhe kthehej në Erzurum. Madje një herë, më erdhi motra e m'u lut: “Sikur t'i jepje ndonjë këshillë xhaxhait! A është mirë që të qajë kaq fort pas një të vdekuri?” Të gjitha familjet që kam njohur në një rreth të ngushtë ishin kështu. Po, po! Edhe struktura e familjes sonë, që ishte cenuar e kishte pësuar shformime aty këtu, ishte e tillë.

Nuk e kam hallin këtu që të rrëfej as për Shamil aganë, as për zonjën Munise, as për tjetërkënd. Me këto shembuj, dua të tërheq vëmendjen në një çështje: besnikërisë i duhet përgjigjur me besnikëri. Nëse ju nuk tregoheni të besës në ato përmasa, as të tjerët nuk do të sillen me besë ndaj jush. E pra, nëse pas aq shumë goditjeve që kanë ndodhur në shoqërinë tonë, mes bashkëshortëve ka ende kaq shumë besnikëri, për mua kjo më duket shumë e rëndësishme.

Shkurt, ju duhet t'i frymëzoni siguri e garanci palës tjetër dhe duhet ta bëni të besojë që edhe ajo të mund t'ju besojë. Duhet të jeni të besës që tjetri të sillet me besë ndaj jush. Duhet që tjetrin ta

ndiqni e ta shikoni që edhe ai t’ju shohë e t’ju ndjekë. Kjo gjendje, në atë që mund t’i themi strukturë molekulare siç është jeta familjare, duhet të jetë brenda kësaj kornize edhe në përmasat e fshatit, të qytetit, të shtetit. Besës i përgjigjemi me besë, buzëqeshjes me buzëqeshje, vështrimit me vështrim, ndershmërisë me ndershmëri. Në të vërtetë, ajo që bënte Profeti ynë (s.a.s.) ishte pikërisht kjo. Ai, në Hutben e Lamtumurës, ka urdhëruar e thënë: “Ato janë amanet për ju dhe ju jeni amanet për to.” [130] Nëse e shihni çështjen nga këndvështrimi i këshillave të Tij, do të vëreni se ata që mbrojnë sot të drejtat e grave kanë mbetur pas edhe në krahasim me të prapambeturit. Mijëra përshëndetje e selame të Allahut qofshin mbi Të! Dhe Allahu qoftë i kënaqur në përjetësi prej kujtdo që i beson Atij me drejtësi, që e pranon Atë me drejtësi dhe që e ndjek Atë në drejtësi!

[118] Shih: Buhari, Menakib 25, Megazi 35, Eshribe 31; Muslim, Fedail 6, 45.

[119] Shih: Kamer, 54/1; Tirmidhi, Tefsiru sure (54) 1, 2, 5; Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 3/165, 4/81.

[120] Buhari, Megazi 29; Muslim, Eshribe 141.

[121] Buhari, Hibe 1, Rikak 17; Muslim, Zuhd 26, 28.

[122] Junus, 10/72.

[123] Ja Sin, 36/21.

[124] Buhari, Xhihad 89; Tirmidhi, Buju’ 7; Ibn Maxhe, Ruhun 1.

[125] Buhari, Rikak 17; Muslim, Libas 37.

[126] Buhari, Mezalim 25 Tefsiru sure (66) 2, Nikah 83, Libas 31; Muslim, Talak 30, 31.


[127] Nesai, Ishretu’n-nisa 1; Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 3/128, 199, 285.

[128] Et-Taberani, El-Mu’xhemu’l-kebir 12/84.

[129] Ibn Hibban, Es-Sahih 2/386; Ibn Kethir, Tefsiru’l-Kur’an 1/441.

[130] Ebu Davud, Menasik 56; Ibn Maxhe, Menasik 84.

Përrulësia, frika dhe butësia e zemrës



Pyetje: “A nuk erdhi ende koha që ata që i besojnë Allahut (xhel’le xhelaluhu) ta kujtojnë Atë dhe t’u zbuten zemrat në respekt për të vërtetën që zbriti prej Tij?” [\[131\]](#) Nga këndvështrimi i kuptimit të këtij ajeti të shenjtë, a mund të flitet për një pikë të shkrirjes që ekziston në çdo zemër? Cilat janë mjetet që nxisin ndjenjën e përrulësisë në zemër?

Përgjigje: Sipas transmetimit të Ibn Mesudit të nderuar (r.a.), ky ajet është zbritur në Mekë. [\[132\]](#) Siç e dini, ky sahab i madh ka qenë ndër besimtarët e parë dhe që prej viteve të para të Islamit është gjendur pranë Krenarisë së Tablosë Njerëzore. Nga kjo pikëpamje, edhe ai, si Enes ibn Maliku (r.a.), i njihte shumë mirë hollësitë mbi Zotërinë tonë, Profetin. Njëkohësisht, ai ishte një sahab që sillej me kujdes shumë të madh në transmetimin e haditheve. Për shembull, kur pyetej për një hadith, ai, me një kujdes e përgjegjshmëri shumë të madhe, i mbështetej Allahut duke thënë: “La haulu ue la kuuete il'la bil'lah.” Dhe pas kësaj, me një ndjeshmëri e përkujdesje të plotë, e transmetonte hadithin e kërkuar. Ashtu që prej Zotërisë sonë, Profetit (s.a.s.), të mos transmetonte asnjë fjalë të paqenë. Sepse sipas mendimit të Ibn Mesudit (r.a.), në përmendjen e një hadithi të Zotërisë sonë, ndryshimi i të shprehurit të qoftë edhe një fjale të vetme mund ta rrënojë jetën e përtejme të njeriut. Për shkak të kësaj ndjeshmërie, në shkencën e hadithit, Ibn Mesudi (r.a.) ka një vend krejt të veçantë, gëzon një vlerësim e respekt krejt të veçantë.

E pra, Ibn Mesudi (r.a.) na bën të ditur se ky ajet u zbrit në Mekën e Përrnderuar, kur kishte kaluar veçse fare pak kohë prej fillimit të zbulesës hyjnore dhe jam i mendimit se për të kuptuarit e kësaj teme në përmasat dhe në thellësinë e vet të vërtetë, kjo hollësi mbart rëndësi të veçantë. Pra, kur kishte kaluar veç pak kohë prej fillimit të zbulesës, vërejmë se Kurani i Shenjtë i paralajmëron dëgjuesit e tij me fjalët: “A nuk ka ardhur koha që kur të përmendet Allahu, zemrat e besimtarëve të drithërohen në frikë, të përkulen në respekt; që përkundraill ajeteve të lexuara kraharorët të pushtohen prej drithërimës e ndjeshmërisë?” [\[133\]](#) Ndërkohë që qiellorja e çështjes ende ndihej në zemra. Zëri i përtej qiejve kishte zbritur mbi gjethe pors i një bulë e pikël vese. Por ja që madje edhe në një kohë të tillë, Allahu (xh.sh.) i thërriste sahabët që të thelloheshin më shumë në një horizont të ndjenjës, të emocionit e të ndjeshmërisë. Sepse kur çështjet i shihni me një vështrim të mpirë, nëse i trajtoni ato brenda rutinës dhe të zakonshmes, ahëre ato çështje nuk arrijnë ta nxjerrin në pah atë emocion që duhet të mbartin shpirtrat tuaj. Pra, këtu ka një paralajmërim kundrejt lënies pas dore. Madje duke qenë se fjala i përket Hyjnisë, mund të thuhet se këtu përfshihet, madje, edhe një qortim. Natyrisht që ne nuk mund të hyjmë në të tilla mendime për zotërinjtë tanë, sahabët e

nderuar, por Allahu (xh.xh.) mund t'ua thotë këtë edhe robërve të tij të lartë, edhe sahabëve fisnikë, edhe zotërinjve tanë, profetëve të mëdhenj, sepse Ai është Krijuesi i gjithçkaje. Nga ky këndvështrim, nuk duhet të përbëjë ndonjë shqetësim nëse pohojmë që në këtë ajet gjenden një qortim e një kritikë.

Zoti i Madhëruar, në vazhdimin e ajetit të shenjtë, urdhëron e thotë kështu: “Të mos bëhen si ata që iu dha Libri më herët. Mbi ta kaloi një kohë e gjatë, por zemrat e tyre veç u ngurtësuan.” [134] Pra, ata që iu dha libri para jush u mposhtën prej rutinës e prej të zakonshmes dhe megjithëse mirësia qiellore iu zbraz mbi krye, ata ranë në një gjendje që nuk ndienin më kurrfarë emocioni; dhe ndodhi që: “Shumica e tyre doli udhe e u bënë të ligj.” [135]

Risia në nisje dhe përpjekja për ripërtëritje në rrugë e sipër

Tani, po deshët, le të ndalemi pak në disa prej arsyeve të hidhërisë së zemrës, të rënies në të zakonshmen e në rutinën e përditshme që shfaqet. Thuajse gjithçka e re zgjon në një mënyrë apo një tjetër emocion te njeriu. Madje edhe te njerëz si ne, me zemër të ngurtë, te njerëzit e mbyllur kundrejt Zotit të Vërtetë, fillimisht kraharorët mund t'i mbështjellë një valë dashurie dhe emocioni që prodhon e reja. Ju pata folur më herët për një ndjesi timen. Kur pashë për herë të parë një personalitet që vinte prej pranisë së Bediuzaman Said Nursiut, tek unë ndikuan shumë pastërtia, kthjelltësia dhe përzemërsia e tij. Im atë, kur unë isha i vogël, fliste gjithmonë për sahabët. Kur unë e pashë atë njeri, thashë me vete: “Edhe në këtë shekull qenka e mundur që të ketë personalitete si sahabët!” E pra, një tablo e bukur që e shihni për herë të parë, ju shkakton një drithërimë të tillë. Kraharori çelet thuajse me krejt brendinë e vet dhe përpiket ta vlerësojë atë. Por nuk duhet harruar se nëse një mirësi që i është dhuruar njeriut, ai nuk e pasuron me thellësi të reja, nuk e zgjeron, nuk shton ndonjë shënim anës saj, nuk e prek aty këtu formatin e saj, ose së paku nuk përpiket të bëjë ndryshime në sqarimin e asaj çështjeje, atëherë pa e vënë re fare mund të bjerë në grackën e rutinës e të së përditshmes. Ashtu që, nëse u prin njerëzve në namaz e u lexon Kuran diku, prej namazit që fal dhe prej Kuranit që lexon nuk ndien asnjë emocion e drithërimë. Zemra e tij kthehet në një shkëmb të zhveshur, mbi të cilin nuk mund të dallosh asnjë shenjë jete. [136]

Po, është e vërtetë se fillimisht, në një mënyrë a një tjetër, lind një drithërimë, nderim e respekt që sjellin e reja dhe origjinaliteti. Por me kalimin e kohës, njeriu që nuk gjendet vazhdimisht në një përpjekje ripërtëritëse, që nuk jeton vazhdimisht në një stil të risimit përmes lutjeve e përkujtimit të Zotit, përmes adhurimit hyjnor të ushtruar në thellësitë e netëve, përmes vetëkorrigjimit, vetëkontrollit e meditimit; dhe duke qenë se nuk i përjeton këto, nuk kufizohet në ndjenjat e egos së vet, atëherë ai njeri herët a vonë e humbet fillin e vijimësisë. Ndaj edhe një individ i tillë nuk ka mundësi që ta ruajë pikën e vet të vesës. Dhe rruga për të mos rënë pre e një ngurtësimi të tillë të zemrës, kalon nga rivlerësimi i vazhdueshëm i çështjeve në këndvështrime të reja dhe nga thellimi në to. Pa shihni! Që nga shekujt e parë të zbritjes së Kuranit Fisnik e gjer në kohën tonë, sa shumë komente janë shkruar dhe sa shumë orvatje e përpjekje mendore janë bërë vetëm për trajtimin e kësaj çështjeje! Për shembull, pavarësisht se zotërinjtë tanë sahabë kanë përgatitur sa e sa tefsire mbi kuptimet e Kuranit, zotërinjtë tanë tabiinë nuk janë mjaftuar me to dhe kanë shkruar tefsire të reja.

Megjithëse personalitete si Ibn Xheriri, Zemahsheri, Fahrud'din Razi, Ebu Hajjani, Bejzaviu, të ardhur në periudhat e mëpasme, shkruan në kohën e tyre aq e aq tefsire, gjithsecili prej tyre nuk i gjykonte si të mjaftueshme ato që ishin shkruar para tyre, por çdonjëri shtonte shënime të reja, çdonjëri gjendej në përpjekje për të sqaruar diçka edhe më tej. Deri në ditët tona, sa e sa personalitete të mëdhenj e monumentalë ndër shekuj, duke sjellë me vete disi edhe interpretimin e kohës së tyre, nisur nga horizontet e veta, janë përpjekur të rigjejnë, ta kuptojnë e ta shpjegojnë Kuranin sërish e sërish. Për shembull, Bejzaviu, për të paraqitur interpretimet e veta, shkroi një vepër tefsiri me dy vëllime. Mirëpo historianët e dijes – qofshin në stil të shtjellimit (sherh), të shënimeve sqaruese (pashije) apo të komentit (talik) – janë shprehur se punimet e bëra mbi këtë tefsir janë më shumë se 250.

E pra, secili ka mundësi që në çdo kohë të thotë diçka të re për Kuranin. Madje edhe fjalët e një njeriu si Said Nursiu, fjala e të cilit zë vend në çast e milimetër për milimetër, duhen shprehur e sqaruar duke marrë nga pas atmosferën dhe interpretimin e kohës. Në të kundërt, nëse i merrni veprat e tij, bëni çdo mëngjes mësim siç pranohet për zakon, ose nëse shkoni mbrëmjeve diku dhe atje lexoni sipërfaqësisht ndonjë pjesë prej atyre veprave dhe nëse mendoni se kësisoj e keni kryer detyrën tuaj, atëherë nuk do ta kuptoni dot atë në thellësinë dhe në pasurinë e tij të vërtetë. Atëherë ajo që duhet bërë është që të biem në një mendë që, përmes përqasjesh e analizash krejt të reja, duke mbërritur në interpretime të ndryshme prej tekstit të lexuar, duke u ndalur në konstatime të reja, të bëjmë të rrjedhin gurra të reja të dijes prej zemrës e ndërgjegjes sonë. Sikurse mësuesi i nderuar tërheq vëmendjen në “Ajetu’l-Kubra”, për nga bota e zemrës sonë, duhet të jemi kurdoherë njerëz të parimit dhe gjithmonë duhet të mund të themi: “A nuk ka edhe më?” [\[137\]](#) Ashtu që një njeri, edhe në u përballtë një ditë ballas me Qenien Hyjnore, sërish duhet të mbartë mendësinë, pra, të mund të thotë: “O Allahu im, a s’ka edhe më tej? Gjendja që po përjetoj tani është siç i shkon për shtat zemrës sime. Të lutem e të përgjerohem, o Allahu im, hapma atë horizont të dijes që të mësoj siç e meriton Ti, Qenia Jote Hyjnore!”

Amaneti u dorëzohet zemrave të fisme e të gjalla

Meqë erdhëm në këtë pikë, dëshiroj të kujtoj një çështje: mund të hapni shkolla në dyqind e më tepër vende të botës. Në ato dyqind e më tepër vende, institucionet që do të hapni mund të arrijnë gjendjen që të bien në sy të gjithkujt e të tregohen me gisht për mirë prej çdokujt. Në vendet ku gjendeni, njerëzit mund të tregohen dashamirës dhe mund të dëshirojnë të ngjyrosen me ngjyrat dhe dizajnin e ndjenjave dhe mendimeve tuaja. Kudo, njerëzit mund t’ju shohin me dashuri e vlerësim. Por nëse nuk i drejtoheni Allahut me imanin e një Ebu Bekri (r.a.), të një Ibn Mesudi (r.a.), të gjitha këto punë që keni kryer nuk do të kenë kurrfarë vlere e kurrfarë domethënieje tek Allahu.

Allahu na ka dhuruar sa e sa mirësi. E rëndësishmja është që në përshtatje me të tilla mirësi, të forcohet marrëdhënia jonë me Allahun. Nëse ju nuk i drejtoheni me shumë seriozitet Allahut me mirënjohje e përgjërime si: “O Allahu im, m’i dhurove mua këto mirësi, ndërkohë që gjendja ime mëkatore dhe e errët i shkonte më fort për shtat kufrit. Po Ti nuk bëre kështu. Nuk më le në mohim. Nuk ma ngurtësove zemrën. Nuk më hodhe në rrugë pa krye. Nuk më bëre prej atyre që fituan zemëratën Tënde. Urdhërove për mua udhëzimin e më caktove këtu. O Allahu im, përkundrejt të gjitha të mirave që i njoh e s’i njoh, që i kam vënë re e s’i kam vënë re, që Ty të qofshin lëvdime

e falënderime pa fund e pa anë!"; nëse nuk e përforconi në vazhdimësi marrëdhënien tuaj me Allahun, nëse nuk mbeteni të lidhur pas mendimit që Imami i Allvarit e shpreh me fjalët: "Me meritë nuk i kam këto unë i varfëri, / Ky hir e kjo mirësi vallë pse më erdhi?", atëherë duhet që të gjitha punët që bëni, t'i rishikoni edhe një herë për të marrë vesh nëse i kryeni apo jo me pikësynim të vetëm të arritjes së kënaqësisë së Allahut.

Allahu (xh.xh.) i jep vlerë të resë dhe të mirës. Ashtu siç i zbret nga qielli çështjet e lidhura me Fenë e Tij, po ashtu mundëson që ato të dëgjohen, të ndihen e të vlerësohen gjithmonë të reja e plot freski. Për këtë arsye, mund të themi, se nëse Zoti i Madhëruar dëshiron, edhe në qofshi të dobët, Ai mund t'ua heqë të tjerëve mundësinë e të qenit element i balancës në ekuilibrin mes shteteve dhe t'jua dhurojë atë juve. Asisoj, që porsi një zë i fuqishëm, i dalë prej një koraleje, të mund t'ia bëni të ditura të gjitha ndjenjat dhe mendimet tuaja botës mbarë. Por në mos e përfaqësofshit dot plotësisht këtë mision, ahëre Vullneti Hyjnor, i pastër e i lirë prej kryerjes së punëve të pavlera, pse t'jua ngarkojë më kot juve një mision të tillë! Sepse, për arsye të mospërfaqësimit në thelbin e saj të vërtetë, ai mision do të merret sërish prej jush e do t'i ngarkohet tjetërkujt.

Nga ky këndvështrim, kundrejt ngurtësimit të zemrave, duhet të jemi gjithmonë në një tendosje të vazhdueshme. Por në përballje me gjendjen tonë plot shqetësim e trazim të brendshëm, nuk rri dot pa i bërë vetes këto pyetje: "Përse ne, sikur të ishim ftuar në një sofër në të cilën gjenden plot e plot të mira nga më të larmishmet, me një dashuri e dëshirë, me një përflakje të brendshme, nuk ngrihemi të falim namaz nate? Përse nuk e ndiejmë të njëjtën kënaqësi teksa marrim abdes? Përse kur vëmë ballin në tokë, nuk jemi në një marrëdhënie të tillë me Allahun, aq sa të themi: "O Allahu im, sikur kjo sexhde të mos mbaronte kurrë!"?

Nëse në marrëdhënie me Të nuk ushqejmë një dëshirë e ndezulli si ajo e një Shah Gejlani, e një Ebu Hasan Shazeli, e një Ahmed Bedeui apo e një Ahmed Rufaiu, nëse nuk e çojmë çështjen përpara duke thënë: "A nuk ka edhe më, o Allahu im?", ahëre punët dhe veprat që kryejmë, edhe në paçin ndonjë vlerë gjer në njëfarë pike, mund të thuhet pa ndonjë dyshim se ato nuk shprehin një vlerë e domethënie në lartësinë e duhur. Prandaj edhe nuk duhet harruar kursesi, që Zoti i Madhëruar amanetin e vet ua lë njerëve të rinj e të mirë, që janë të sigurt në çuarjen e amanetit në vend.

Shkurt, nëse dëshirojmë që në zemrat tona të ndezim ndjenjën e respektit e të frikës, ahëre duhet të mësojmë vazhdimisht rreth çështjeve në biseda të hijshme, të përpiqemi t'i kuptojmë çështjet nga ky këndvështrim në mënyrë më të gjerë dhe në këtë mënyrë të forcojmë besimin tonë. Madje edhe kur ulemi të pimë një çaj, duhet ta lidhim e ta sjellim çështjen tek Allahu dhe në çdo rast, në një horizont të ri të dijes, gjithçka duhet ta lidhim e ta përfundojmë me Të. Në të kundërt, fare pa e kuptuar, emocionin bie në lodhje prej rrugës, e humbasim gjallërinë tonë dhe brendia jonë fillon të vdesë e të kalbet. Zoti na ruajtë të gjithëve prej një fundi të tillë!

[131] Hadid, 57/16.

[132] Muslim, Tefsir 24; En-Nesai, Es-Sunenu'l-kubra 6/481; Ebu Ja'la, El-Musned 9/167.

[133] Hadid, 57/16.

[134] Hadid, 57/16.

[135] Hadid, 57/16.

[136] Shih: Buhari, Ilm 20; Muslim, fedail 15.

[137] Shih: Bedizaman, Rrezatimet f. 101 (Rrezatimi i Shtatë, Rrezja e parë).

Të përgatitemi për lexim



Pyetje: Në të katër anët e botës po vërehet se dashamirësia dhe vlerësimi për “Lëvizjen e Zemrave” po shumëfishohet ditë pas dite. Në këtë pikë, për të shmangur çuarjen dëm të mundësive që ekzistojnë, si dhe për lumturinë në këtë jetë e në jetën e përjetshme të bashkëbiseduesve, cilave çështje u duhet dhënë përparësi?

Përgjigje: Është e vërtetë se në ditët tona bëhet fjalë për një zgjerim në progresion gjeometrik. Në gjeografinë e botës, njerëzit tanë kanë mbërritur në 150-160 vende të ndryshme. Në krejt faqen e dheut thuajse nuk ka mbetur asnjë vend që të mos e keni bërë të ndiejë zërin dhe frymën tuaj. Lavdi Zotit të Gjithëfuqishëm, mund të thuhet se na është dhuruar një mirësi që i ngjan mirësisë së dhuruar ndaj sahabëve prej vetë Allahut. Pa dyshim që kjo tablo është krejtësisht dhuratë e mirësi hyjnore prej Zotit të Madhëruar. Se përse na është dhënë ne kjo mirësi e ky bekim, nuk e dimë. Dashtë Zoti që kjo të mos përbëjë një dëshirë për t’u largësuar; mos qoftë e tillë dhe në përfundim mos ndodhtë që të na hedhë në krenari e të na marrë mendjen.

Fryma e një ripërgatitjeje të re

Tani, kundrejt këtij zgjerimi në progresion gjeometrik, nëse sasia dhe rrethanat e njerëzve që do të sigurojnë udhërrëfimin janë ende në gjendje algjebrike, atëherë gjendja ekzistuese duhet rishikuar, dhe kësaj, në një ripërgatitje të re, në zemra duhet ndezur sërish po ajo dashuri e dëshirë e zjarrtë si në rastin e atyre shokëve tanë që në fillim të viteve '90, me synimin e shpërblimit të Hixhretit, u organizuan për emigrim jashtë vendit. Kurani Fisnik na e tregon këtë pikësynim duke urdhëruar e thënë: “Ata që emigruan e përpiquen që për hir të Allahut.” [138] Pra, nëpërmjet emigrimit, njerëzit fitojnë një vlerë të Zotit. Ndërsa më pas, duke pohuar të drejtën e hixhretit, në vendet ku kanë emigruar bëjnë përpjekje në drejtim të kalimit të pengesave mes njerëzve e Allahut, për të bërë të mundur një ritakim të sërishëm me Allahun. Prandaj, lidhur me zgjerimin në përmasa gjeometrike, është shumë e rëndësishme që, siç ndodhte në Shekullin e Lumturisë, me një edukim intensiv, të zhvishen njerëzit prej lëndores, të çlirohen prej kafshërores dhe të drejtohen nga Allahu (xh.xh.) në orbitën e zemrës e të shpirtit. Në fund të periudhës së sahabëve dhe në fillim të asaj të tabiinëve, disa njerëz të rinj, për shkak se nuk e konceptuan dot shpirtin e fesë, u bënë shkak për

rryma si ato harixhije, rafidije dhe batinije. I Dërguari fisnik (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), në shprehjen e lume të kësaj gjendjeje, urdhëron e thotë: “Nga mesi juaj do të dalin të tillë njerëz, që juve do t’ju duken shumë të vegjël, namazi juaj kundrejt namazit të tyre, agjërimi juaj kundrejt agjërimin të tyre, veprat tuaja kundrejt veprave të tyre. Ata lexojnë Kuran, por Kurani atyre nuk ua kalon gurmazin. Njëlloj si heshta që hyn e del duke e përshkuar gjahun, edhe të tillët hyjnë e pastaj dalin sërish nga feja njëlloj siç hynë.” [139]

Kuptimin e shprehur prej këtij hadithi fisnik mund ta mendoni edhe për epokën tonë. Disa njerëzve mund t’u krijohet edhe kallo në ballë e në gjunjë prej faljes së namazit, por duke qenë se nuk arrijnë të depërtojnë në thelbin e dijes, nuk çlirohen dot prej rënies në teprim të skajshëm (ifrat) apo në lëshim të skajshëm (tefrit). Pavarësisht se duken sikur janë vërtet pranë Allahut, ata janë në gjendje që, me lehtësinë më të madhe, të cilësojnë si jobesimtarë edhe njerëz të përgëzuar me Xhenet nga i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ues'sel'lem), si Ebu Bekri (r.a.), Omeri (r.a.), Osmani (r.a.), Aliu (r.a.). [140] Shihni, pra, në ç’kundërthënie ndodhen. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) përgëzon dhjetë vetë me Parajsën, [141] por ja që disa ngrihen e shprehin për ta shpifje që të rrëqethin. E pra, kjo është një gjendje injorance që buron prej mungesës së plotë të njohjes së shpirtit e të thelbit të fesë.

Prandaj, duke ndezur sërish në zemra shpirtin e një mobilizimi të dytë, për të mos mbetur të ekspozuar ndaj shformimeve e tjetërsimeve brenda kulturave e konceptimeve të ndryshme, duket të kërkojmë rrugët e përgatitjes së njeriut të përsosur. Për këtë arsye, në radhë të parë ata individë që mund t’i quajmë mësues e udhërrëfyes, duhet të kenë njohuri mbi burimet themelore të Fesë, siç janë Libri dhe Suneti. Njëkohësisht, ata duhet t’i njohin njerëzit në vendet ku shkojnë në të gjitha tiparet karakteristike e në vija të përgjithshme. Krahas këtyre, duhet të zotërojnë dije edhe prej disiplinave pozitive, të mësojnë diçka prej shkencave si fizika, kimia, matematika, antropologjia. Po. Njeriu që do të shërbejë si udhërrëfyes, në vendin pritës duhet të shkojë si një individ i përgatitur në mënyrë të përsosur. Ata që shkuan të parët, shkuan vetëm me besimin e tyre të thjeshtë, naiv e të dëlirë dhe me lejen e Allahut u bënë shkak për shumë e shumë mirësi. Por tashmë, qysh sot e mbrapa, në hapjen e mëtejshme në të katër anët e botës, ka nevojë për një thellësi të veçantë, për një gjerësi të veçantë, për një pajisje të veçantë.

Çfarë premtion të lexuarit me diskutim

Teksa njihemi me burimet tona për këtë thellim, zgjerim e pajim të veçantë, duhet që librat e zgjedhur të mos i shfletojmë thjesht përse i përket anës së tyre sasiore, por t’i lexojmë me një vështrim krahasues e analitik, me vullnetin dhe përpjekjen për të arritur në sinteza e analiza të reja. Shihni, për shembull, historinë e tefsirit; që prej ditës kur u zbrit Kurani Fisnik e gjer më sot janë shkruar sa e sa interpretime, janë mbajtur sa e sa shënime. Po, tefsiret e shkruara në lidhje me Kuranin, sot kanë mbërritur në mijëra. Në njëfarë mënyre, çdo komentues është një “bir i kohës së vet” dhe duke u mbështetur në interpretime të frymëzuara prej rrethanave të epokës së vet, ka thënë se “prej këtij apo atij ajeti duhet kuptuar edhe kjo, duhet mbërritur në këtë përfundim”. Kështu, në drejtim të të kuptuarit të Kuranit, ai ka hyrë në analiza të reja. Nëse shfletojmë tefsiret e ndryshme, mund ta vëmë re lehtësisht këtë larmi. Për shembull, Raziu, në lidhje me një ajet, ka sjellë një interpretim të caktuar, ndërsa Zemahsheri ka nxjerrë prej tij një tjetër kuptim. Bejzaviu e ka shtjelluar atë me një analizë më të ndryshme. Kurse Ebu Suud Efendiu, edhe nëse është mbështetur

përgjithësisht te Bejzaviu, ka shprehur edhe interpretime të veçanta. Pra, tefsiri i Kuranit, gjer tek Alame Hamdi Jazëri në kohën tonë, ka vijuar pa ndërprerje, është zhvilluar vazhdimisht, dhe natyrisht që do të vazhdojë edhe më tutje. Kështu edhe ne duhet të ecim me këtë mendim dhe duhet të përgatisim njerëz që i lexojnë shumë mirë arritjet e kohës, që lexojnë e mbërrijnë në analiza e konstatime të ndryshme, që i shohin sendet dhe ngjarjet në mënyrë më të gjerë, më gjithëpërfshirëse dhe më të shtresëzuar. Sepse këta udhërrëfyes du të përballen me bij të mjedisëve shumë të larmishme kulturore. Për pasojë, nëse njeriu nuk është i përgatitur e i pajisur me njohuri rreth atyre mendësive e kulturave, rreth problemeve të shumëllojshme me të cilat do të përballlet prej tyre, atëherë ai bie i humbur.

Për këtë arsye, mund të themi se në vendet e ndryshme ku shkoni, Zoti i Madhëruar mund të bëjë shkak rrethana nga më të ndryshmet në mënyrë që ju të mund t'i jepni zë frymëzimeve të shpirtit tuaj. Por ju, duke vlerësuar këto rrethana, nuk duhet t'u jepni zë atyre sipas mjedisit tuaj kulturor apo sipas mjedisit kulturor të Turqisë, por sipas mjedisit kulturor në të cilin ndodheni. Kjo nxjerr në pah nevojën për të pasur udhërrëfyes që mund t'i shohin sendet dhe ngjarjet në mënyrë më gjithëpërfshirëse, që mund t'i përqafojnë më gjerësisht bashkëbiseduesit e vet, që kanë zemërgjerësi më të madhe. Pikërisht për të përballuar këtë nevojë, duhet nisur sërish një mobilizim i ri për të lexuar e menduar.

Zotëria ynë, i Dërguari i Nderuar (s.a.s.) i qaset çështjes me fjalën diskutim. [142] Kuptimi i kësaj fjale do të thotë që së paku dy apo më shumë njerëz të këshillohen e të diskutojnë disa çështje. Në këtë mënyrë, për njerëzit që mblidhen në rreth dhe diskutojnë e këshillohen mes vedi, sërish Zotëria i Zotërinjve urdhëron e thotë se ata do të rrethohen e përqafohen prej hirit e mëshirës hyjnore, e do të merren nën mbrojtje prej saj. Veç kësaj, për një tubim të tillë, ai jep edhe këtë sihariq: “Edhe dikush, që ulet e rri me ta, nuk mbetet pa përfituar.” [143] Pra, në çdo rast, gjithkush që ndodhet në një tubim të tillë, përfiton diçka prej mjedisit shoqëror, i hyn diçka në mendje apo në zemër. Ndoshta ai individ mund të ketë hyrë në atë mjedis edhe për ndonjë interes tokësor, në përpjekje për të nxjerrë ndonjë përfitim material. Por duke qëndruar e jetuar pranë njerëzve në fjalë, edhe atij diçka i mbetet. Më saktë, ai individ e jeton ngjyrën e tubimit. Qenia Hyjnore e prek edhe atë me penelin e Vet dhe kështu, edhe ai ngjyroset me një ngjyrë shpirtërore. Nga ky këndvështrim, me lejen dhe mirësinë e Allahut, udhërrëfyesit duhet të arrijnë në një nivel që, përmes diskutimit e këshillimit, të fusin në rrugën e zgjidhjes thujse çdo shqetësim, të prodhojnë zgjidhje për çdo problem, të gjejnë përgjigje për çdo pyetje.

Sa keq që sot, si shoqëri, ne jemi të privuar prej një forme të tillë të të lexuarit. Deri edhe fjala e Zotit tonë, Kurani Fisnik, është bërë pre e rutinës, e traditës, e përpjekjes për t'u dukur. Ndoshta sot ai qëndron varur tek kryet e shtretërve tanë, i futur në këllëf kadifeje. Kombi ynë tregon ndaj tij një nderim e respekt kaq të veçantë. Dhe unë e vlerësoj shumë një respekt të tillë. Mirëpo sot njerëzit tanë nuk janë të njohur me kuptimin e Kuranit. Ai është një mesazh që na vjen prej Allahut, por sa keq që ne nuk përpiqemi ta kuptojmë e të themi: “Vallë ç’do të na thotë Allahu nëpërmjet këtij mesazhi?” Ja pra, sa të huaj jemi bërë me Librin tonë. Po, po! Rutina dhe zakoni na i kanë verbuar sytë dhe ne nuk e njohim kuptimin e Librit tonë madhështor, ndërsa mjaftohemi vetëm me një respekt të thatë ndaj tij. E përsëris se unë edhe një respekt të tillë e vlerësoj, por respekti i vërtetë ndaj Kuranit Fisnik është ai që i drejtohet shpirtit, kuptimit dhe thelbit të tij.

Mund të themi se edhe ndaj veprave të personalitetit që na pasqyrojnë në kohën tonë të vërtetat e Kuranit dhe të Sunetit Sahih, jemi duke përjetuar të njëjtën verbëri. Të marrësh në mëngjes një prej atyre veprave në duar dhe të bësh mësimin e zakonshëm, nuk është e mjaftueshme për ta kuptuar atë. Thelbësorja është që të shohësh hollësitë dhe nënkuptimet e mendimit e të meditimit të shprehur në veprat e atij personaliteti dhe të përpiqesh t'i kuptosh ato duke bërë krahasime e pranëvënie me të tjera tekste. Për shembull, duhet të mund të bëjmë lexime krahasuese në përmasa të tilla, sa të mund të themi: “Imam Gazaliu për këtë temë ka thënë kështu, mirëpo Bediuzaman Said Nursiu kësaj çështjeje i është qasur disi më ndryshe.” Duhet të zhvillojmë një sistem të ri të të lexuarit. Mendoni pak, ky i zgjedhur i shekullit, çfarë emocioni ka bërë të lindë brenda jush kur e keni ndier për herë të parë, çfarë shpirti prej sahabi ju ka frymëzuar, si ju ka nxitur dhe ju ka vënë në lëvizje? Po çfarë ndodhi që ato vepra ranë, më pas, pre e leximeve rutinore? Ndërkohë që ato vepra, për të cilat ndihet nevojë si për bukën e për ujin, duhet të merren në shqyrtim më thellësisht nga këndvështrime të ndryshme, madje pa u mjaftuar vetëm me atë çka ka shprehur ai personalitet, por duke u përpjekur që të arrihen horizontet e treguara prej tij; duke u përpjekur që të realizohet një lexim analitik e sintetizues.

Thellësia në përpjesëtim të drejtë me gjerësinë

E pra, përballë kësaj rritjeje në përmasa gjeometrike, kemi nevojë për udhërrëfyes e mësues të tillë, që të mund t'i lexojnë veprat në këtë mënyrë e në këtë gjerësi dhe të na e ndriçojnë kësaj rrugën tonë. Përndryshe, nëse mjaftoheni thjesht me gjendjen algjebrike, në mungesë të një ushqimi serioz, mund të fillojnë e të shfaqen shumë të meta e mangësi. Në fund të fundit, defektet që shfaqen herë pas here, në thelb, burojnë prej mungesës së një përpjekjeje serioze për lexim në drejtim të zbulimit të vlerave tona burimore. Këmbëngulja në dyshim dhe në mungesën e sinqeritetit, ecejaket veç në sipërfaqe, janë shkaqet që qëndrojnë në bazë të këtyre problemeve. Bediuzaman Said Nursiu, “Traktatin e Sinqeritetit” (İhlâs Risalesi), të cilin e ka shkruar po vetë, e ka lexuar plot 115 herë. Tani, dikush që është profesor, i habitur me këtë, pati thënë: “A ndodh që njeriu ta lexojë kaq shumë një vepër që e ka shkruar vetë?” Sipas meje, nëse ajo vepër ia vlen të lexohet aq, duhet lexuar. Sepse Mjeshtri, në çdo lexim, me atë çka arrinte e përfitonte në zemrën e tij, hapej në horizonte shumë të ndryshme dhe u çelte vela thellësive shumë të larmishme. Por sa keq që, pavarësisht mundësive të gjera që kemi ne sot, nuk besoj se jemi në gjendje që, me një këndvështrim të shtresëzuar, të mund të lexojmë në një gjerësi të tillë, sa të themi: “Kjo temë, në aksh vend tregohet kështu. Në tjetër vend, e njëjta temë, si në një indeks, përmendet kësajsoj. Mes kësaj dhe asaj ka një lidhje të këtillë apo të atillë.”

E pra, sot, ne, si shoqëri, kemi nevojë për udhërrëfyes e mësues, të cilët, qoftë Kuranin, me retorikën e tij të mrekullueshme, qoftë Sunetin Sahih, qoftë veprat në të cilat janë paraqitur komente dhe shpjegime të tyre sipas tipareve të veçanta të kohës sonë, t'i rishikojnë dhe duke i asimiluar e përvetësuar më së miri, t'i kthejnë ato në një pjesë të natyrës e të karakterit të vet. Përndryshe, teksa nga nëra anë hapja vijon të realizohet me shpejtësinë më të madhe, nga ana tjetër, në një mënyrë krejt të papritur, në pesëdhjetë vende të ndryshme do të përballlemi me pesëdhjetë probleme të ndryshme. Kësaj here, mendoni se si do t'i zgjidhni ato probleme, harxhoni energji me to dhe ndoshta shumë prej tyre nuk jeni në gjendje t'i zgjidhni.

Po, po. E përsëris edhe një herë se, në rrjedhën e historisë, njerëzit e papërgatitur gjithnjë kanë shkaktuar probleme. Mijëra harixhi u mblodhën e mëtuan diçka me njëri-tjetrin. Ibni Abasi, i lartësuar me gradën e dijetarit të madh të umetit, [144] shkoi pranë tyre dhe u tha: “Ju keni një mëtim të tillë, por kjo çështje është në këtë mënyrë.” Kur e dëgjuan këtë, qindra syresh u shprehën me habi: “Allah, Allah! Neve s’na kishte shkuar mendja fare që kjo punë mund të ishte kësisoj!” [145] Ndoshta mes tyre ka pasur njerëz që kanë falur njëqind rekate namaz në ditë, që kanë lexuar krejt Kuranin në çdo tri ditë. Por ishin po këta njerëz, që ishin në gjendje që të ngrinin edhe deri fajësime për femohim për zotërinjtë tanë, sahabë të nderuar si Hazreti Aliu, Hazreti Muavija, Hazreti Amr ibn el As...

Sepse kur individët nuk i njohin drejt dhe gjerësisht çështjet që duhen njohur, dhe nuk veprojnë sipas njohurive të drejta, atëherë mund të shkaktojnë gjithmonë nganjë problem. Në një gjendje të tillë, sasia nis të zhvillohet pavarësisht cilësisë dhe pastaj, Zoti na ruajtë, çështja mbërrin në një pikë të tillë që detyroheni të thoni: “Ah, sikur të mos kishim pasur një zhvillim kaq të madh sasior!” Kështu, për të mos i bërë njerëzit që të përjetojnë zbrazëti, duhet t’i dini çështjet që janë të nevojshme të dihen dhe duhet t’i bëni pjesë të jetës suaj gjërat që duhen jetuar. Kur falni namazin, duhet ta bëni këtë me vetëkontrollin dhe vetëdijen e të gjendurit në praninë hyjnore; kur të përkuleni në sexhde, kraharori duhet t’ju ziejë porsi ena në zjarr. Njerëzit duhet t’ju shohin juve si të tillë; dhe duke ju parë, ndaj namazit tuaj duhet të thonë plot admirim: “Këta janë vërtet njerëz që i kanë besuar Allahut me zemër.” Pa dyshim që ne nuk i bëjmë asnjërin prej këtyre me qëllimin që njerëzit “të thonë” këtë apo atë, por përpiqemi që t’i shndërrojmë këto në një pjesë të natyrës sonë. Ndaj edhe njerëzit, kur të mësojnë për këtë thellësi e cilësi të bërë pjesë të natyrës sonë, të pushtuar prej një joshjeje të shenjtë, do të thonë: “Ja, kjo ishte ajo që kërkoja. Gjeta pikërisht atë që doja!”

Për ta përmbledhur, krahas ndriçimit e shkëlqimit të mendimeve dhe krahas paraqitjes drejt të çështjeve, joshja prej përfaqësimit të tyre në jetë ka një ndikim e një thellësi të veçantë. Nga ky këndvështrim, ne, duke nisur një mobilizim të ri në të mirë të njerëzimit, duke thënë vazhdimisht “me emrin e Allahut” nga brendia dhe bota jonë e shpirtit, duhet t’i përvishemi punës me një emocion të tillë sikur po e nisim udhëtimin nga fillimi. Nëse ky ideal përfaqësohet në masën e përfaqësuar nga Hulusi Efendiu, nga Hafiz Aliu e nga Hysrev Efendiu, atëherë njerëzit që e shohin këtë do të rendin për të ardhur te ne dhe kushdo që vjen nuk do të kthehet pas për të ikur. Nuk duhet harruar se njerëzit që largohen, ikin sepse nuk gjejnë atë që prisnin. Pra, ikin e largohen me mendimin: “Pse të humbas kohën kot?” Ndaj edhe në këtë çështje, ajo që ne kemi për detyrë është që pavarësisht dëshirave e ambicieve tona, të shfaqim një përpjekje e mundim të skajshëm gjatë gjithë jetës në mënyrë që duke gjalluar të jetësojmë, duke vdekur të gjallojmë.

[138] Bekare, 2/218.

[139] Buhari, Menakib 25, Edeb 95, Istitabe 6; Muslim, Zekat 143.

[140] Shih: Tirmidhi, Menakib 25; Ebu Davud, Sunnet 8; Ibn Maxhe, Mukaddime 11.

[141] Shih: Tirmidhi, Menakib 25; Ebu Davud, Sunnet 8; Ibn Maxhe, Mukaddime 11.

[142] Darimi, Mukaddime 32.

[143] Buhari, Daauat 66; Muslim, Dhikr 25.

[144] Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 10/237; El-Hakim, El-Mustedrek 3/616.

[145] Shih: El-Gazali, Ihjau ulumi'd-din 1/96; Ibn Asakir, Tarihu Dimashk 42/463-464.

Thagma – qerasja hyjnore dhe shqetësimi i madhështimit



Pyetje: Cilat janë dallimet mes thagmës dhe qerasjes hyjnore? A vlejnë edhe për ikramin mendimet në lidhje me të moskërkuarit e thagmës?

Përgjigje: Gjendjet e mrekullishme që Allahu i krijon dhe i shfaq për të bërë të dukshme provat për vërtetësinë e profetëve (ala nebij'jina ve alejhimus'salatu uesselam) i quajmë *muxhize*. Fjala “*muxhize*”, për nga kuptimi, shpreh të lënit e të tjerëve në gjendje pazotësie (axhz). Ajo është një rend hyjnor që Allahu na e sjell prej së jashtëzakonshmes. Nga njëra anë, ka një rend hyjnor të vazhdueshëm e të mrekullueshëm që e dëshmojmë dhe e lexojmë në urdhëresat krijuese, në ndërtimin tonë fizik dhe në nevojat e tij. Krahas kësaj, ka edhe një rend hyjnor në të cilin Zoti i Madhëruar i tërheq këto urdhëresa. Muxhizet apo mrekullitë e paraqitura nga Zoti i Madhëruar për të provuar profetësinë janë të kësaj kategorie. Po kështu, me krijimin e Allahut (xh. xh.) ka edhe disa ndodhi të pazakonta që shfaqen ndër evliatë e Allahut, të cilat, gjithashtu, i përkasin në tërësi rendit të mrekullueshëm hyjnor.

Thagma fshihet

Natyrisht, kur flas për “evliatë e Allahut”, këtu e kam fjalën për lartësimin në kuptimin terminologjik. Përndryshe, në kuptim të përgjithshëm, gjithsecili që beson fuqishëm e që kryen vepra të mirësishme, është rob i zgjedhur i Allahut, është mik i Allahut. Në vargjet e ndryshme të Kuranit Fisnik vërehet se të gjithë myslimanët, në njëfarë kuptimi, janë secili nganjë rob i lartësuar i Zotit të Madhëruar dhe Allahu është Mbrojtësi i të zgjedhurve. Për shembull ajetet që vijojnë, mund të përmenden si shembuj për këtë çështje: “Mbrojtësi im është Allahu që ka zbritur Librin; e Ai është Mbrojtësi i të gjithë robërve të mirë.” [146] Apo ajeti tjetër: “Kjo, pasi Allahu është Mevlaja dhe Ndihmuesi i njerëzisë. Ndërsa për jobesimtarët, nuk ka kurrfarë miku e mbrojtësi.” [147]

E pra, nëse do ta shtjellojmë lartësimin në të zgjedhur të Zotit brenda kornizës terminologjike dhe jo në kuptim të përgjithshëm, vërejmë se për të mbërritur në një makam të tillë ka rrugë dhe metoda

të caktuara. Për shembull, ndër personalitetet e mëdha si Ebu Hasan Shadiliu, Muhammed Bahauddin Nakshibendi, Abdulkadër Gejlani, Ahmed Rufaiu, Imam Rabaniu, secili prej tyre ka ndjekur një rrugë të ndryshme që e ka çuar në horizontin e lartësimit. Në këtë rrugëtim shpirtëror, edhe në rastin e Bediuzamanit, krahas pranimit të dobësisë e të pafuqisë, të adhurimit e të mirënjohjes së pakufishme kundrejt Hyjnisë, [148] është fjala për një rrugë e mënyrë të ndryshme në orbitën e meditimit, me përmasa të dhembshurisë e të mëshirës. [149] Natyrisht që edhe udhëtarët e kësaj rruge, të cilën Bediuzamani e ndërtoi duke e lidhur me gjashtë disiplina, ka shumë rëndësi që t'i pranojnë e t'i përvetësojnë këto disiplina dhe të rregullojnë vetveten në bazë të tyre. Pra, nuk mjafton vetëm që të themi: “Puna jonë është punë e dobësisë dhe e pafuqisë, e adhurimit dhe e mirënjohjes.” E rëndësishmja është që këto disiplina t'i përvetësojmë dhe t'i asimilojmë. Kjo do të thotë, që krahas lidhjes pas mendësisë se “po nuk më mbajti për dore fuqia hyjnore, unë s'bëj dot asgjë”, krahas pranimit të vetvetes si të dobët e të pafuqishëm, duke ia njohur krejt fuqinë Allahut, kundruall begative hyjnore që zbresin si shira të mëshirës qiellore, njeriu të gjendet vazhdimisht në një gjendje ndezullie e dëshire të zjarrtë. Siç shihet, për ta ngjitur njeriun në majën e lartësimit, ekzistojnë rrugë të ndryshme në bazë të tipareve, të karaktereve e të kohëve të ndryshme. E pra, një miku të të Vërtetit, që ka arritur një pastrim të tillë të egos e një dëlirësim të tillë të zemrës, Zoti i Madhëruar mund t'i dhurojë një pjesë më tepër prej mirësisë a qerasjes hyjnore Po kjo nuk do të thotë që ai mik i të Vërtetit e kërkon një mrekulli a thagmë të tillë. Sepse është tjetër gjë që Zoti i Madhëruar të dhurojë prej bujarisë së Vet një mirësi në formë të thagmës, sikurse është një çështje krejt tjetër që robi të zgjedhur e të lartë në fjalë të kërkojë vetë një thagmë të tillë. Për shembull, ta zëmë se një njeri fluturon në ajër apo ecën mbi det pa u zhytur në ujë. Sipas këndvështrimit të miqve të të Vërtetit si Hazreti Ahmed Rufaiu, një ngjarje e tillë duhet fshehur siç fshihet gjendja e gruas në ditët e saj menstruale. Në të vërtetë, ne nuk kemi kurrfarë të drejte që të kërkojmë diçka të tillë të mrekullueshme prej Allahut. Çdo ibadet që ne do të kryejmë ndaj Tij, është vetëm e drejta e Tij dhe detyra jonë. Sepse ai është i Adhuruari Absolut; dhe ne jemi robërit absolutë. E pra, ithtarët e Allahut, dukuritë e mrekullishme që u janë dhuruar në nivelin e thagmës i kanë parë gjithmonë në këtë mënyrë. Mirëpo pavarësisht se ata nuk kanë kërkuar asgjë dhe nuk kanë pasur ndonjë pritshmëri për mrekulli, nganjëherë prej duarve të tyre janë shfaqur disa thagma. Kundrejt kësaj gjendjeje, ata që gjithçka e interpretojnë nën dritën e profetësisë, janë sjellë me ndjeshmëri shumë të lartë dhe janë drithëruar tej mase me shqetësimin e vetëmadhështimit .

Madhështimi, për nga mënyra se si ndodh e si del në pah, është një gjendje e mrekullueshme sikurse thagma. Por ai nuk është përbën një dhuratë e mirësi, por një të keqe të madhe dhe fatkeqësi. Po, po. Madhështim do të thotë, që njeriu, pa kurrfarë merite të veçantë, të bjerë pre e të mirave dhe dalëngadalë të vijë në përballje me ndëshkimin e merituar. Në Kuranin Fisnik, kjo gjendje përmendet me këto shprehje: “Dhe ata që i mohojnë shenjat tona, dalëngadalë dhe pa e kuptuar i afrojmë drejt rrënimit.” [150] Edhe në ditët tona mund të shihni shembuj të gjendjeve të tilla. Nga ky këndvështrim, të flasësh për grada shumë të larta, t'i lidhësh punët me të pazakontën, është gjithmonë shumë e rrezikshme.

“Egoja nën gjithçka, detyra mbi të gjitha.”

Për të ardhur te dallimi mes thagmës dhe qerasjes hyjnore: në një kohë kur me egoizmin ishte tepruar shumë, me sa duket për arsye se fjala “thagmë” sillte ndër mend edhe lartësimin pranë

Allahut në kuptimin terminologjik, Bediuzamani e ka shtjelluar çështjen në këtë pikë në mënyrë më të kthjellët dhe mirësitë e bekimet e pazakonta, të dhuruara prej Zotit, i ka trajtuar në kuadrin e qerasjes hyjnore. [151] Duke e parë nga ky këndvështrim, ikrami duhet të ndezë te njeriu ndjenjën e mirënjohjes ndaj mirësisë hyjnore dhe duhet të entuziazmojë ndjenjat e lëvdimit e të falënderimit ndaj Zotit. Sipas shprehjes së Imamit të Allvarit, njeriu gjithmonë duhet të jetojë me mendimin: “Me meritë nuk i kam këto unë i varfëri, / Ky hir e kjo mirësi vallë pse më erdhi?” Ndërsa Said Nursiu e shpreh këtë mendim me një gjuhë disi më të ndryshme: “Egoja nën gjithçka, detyra mbi të gjitha.” [152] Po, po. Sipas tij, mund të na caktohet një detyrë e rëndësishme, por ai që e vë në zbatim atë detyrë është veçse një ushtar. Prandaj edhe ajo që ai thotë, në thelb, ka këtë kuptim: “Ai Zot i Madhërishtëm nganjëherë edhe një ushtari mund t’i caktojë si detyrë që t’u vendosë një medalje të tjerëve. Edhe detyra ime është vetëm kaq.” [153] Duke thënë këtë, ai ka zgjedhur rrugën e përluljes, të thjeshtësisë, të ndrojtjes e të shumëzimit të vetvetes me zero, çka përbën thelbin e këtij mësimi. Sipas kësaj pikëpamjeje, njeriu nuk duhet t’i shohë qerasjet hyjnore si shfaqje të një pajisjeje me cilësi të jashtëzakonshme e të veçanta, por si një dhuratë hyjnore më tepër, e dhënë falas prej Hyjnisë.

Në ditët tona, egoizmi ka shkuar aq larg, saqë mund të gjejë vend madje edhe brenda rrethit të ithtarëve të besimit. Për shembull, nëse dhjetë-pesëmbëdhjetë vetë mblidhen rreth një njeriu, ai menjëherë pushtohet nga dëshira e madhe për të rënë në sy e për ta shprehur vetveten brenda këtij rrethi njerëzish. Në të shkuarën, kanë dalë aty-këtu njerëz që e kanë shpallur veten Mehdi. Por duhet thënë, se kurrë më parë, në asnjë periudhë të së kaluarës, nuk është përjetuar një inflacion i tillë Mehdiinjsh. Po, kanë dalë në të shkuarën mes karmative, batinive, fatimive mëtues të tillë; por në këtë shekull këta janë bërë aq të shumtë, saqë njeriu habitet e shushatet krejt përballë një tabloje të tillë.

Mjeshtri i nderuar, në një rast, pohon se shfaqja e qerasjes hyjnore është shprehje e mirënjohjes për Zotin, se në këtë çështje nuk ka të bëjë merita vetjake, ndaj edhe egoja nuk duhet t’ia njohë mrekullinë vetvetes si arritje. [154] E pra, në këtë këndvështrim, bëhet dallimi mes thagmës dhe qerasjes hyjnore. Domethënë, individi që ka përfituar një mrekulli si ikram hyjnor, sipas asaj çka është thelbësore në rrugën shpirtërore që ka zgjedhur të ndjekë, duhet të mendojë se një bekim i tillë i është dhuruar për të shprehur mirënjohje e falënderim ndaj Zotit dhe se, në të vërtetë, ai nuk ka kurrfarë merite vetjake për atë çka i është dhuruar. Mendimi i Bediuzamanit në lidhje me këtë çështje është ky: “Mos u kreno se po i shërben fesë. Ti nuk je i çliruar prej të fshehtës së shprehur në fjalët: ‘Allahu këtë fe, nganjëherë, e vërteton edhe me dorën e një njeriu të dalë udhe.’ [155] Ku i dihet, ndoshta je pikërisht ti ai njeri i dalë udhe.” [156] Siç shihet, Mjeshtri i nderuar nuk e përjashton as veten nga kategoria e njerëzve që mund të jenë të dalë udhe e që gjenden gjithsesi në shërbim të fesë.

E pra, një njeri që e sheh veten kësisoj, një njeri që e ka përcaktuar shumë mirë vendin, pozitën dhe marrëdhënien e vet kundrejt Allahut, një njeri që e ka nënshtruar e shumëzuar me zero veten krejt para Hyjnisë, e kupton se mrekullitë e ardhura si një qerasje prej Zotit të Madhërishtëm nuk vijnë për meritë personale. Kundrejt bekimeve e mirësive të mbërritura, ndjenjat dhe mendimet e tij janë kësisoj: “Unë jam një krijesë, që më dërgohet një rrobë prej atllazi. Mirëpo një rrobë e tillë nuk është për mua të varfrin as për nga cilësia, as për nga modeli e as për nga vlera. Ahere kjo për mua është veçse një ikram, një dhuratë.” Të njëjtat mendime shprehen prej Bediuzamanit edhe në veprën “Letrat” me këtë shëmbëlltyrë: “Nëse dikush vjen e të vesh një rrobë të përsosur, të

shtrënjtë e të stolisur më së miri, pastaj njerëzia vijnë e të thonë: “Mashallah! Je shumë i bukur! U hijeshove shumë!” Nëse ti, me modesti, thua: “Kursesi!... Ç’jam unë! Hiçgjë! Ç’bukuri është kjo! Ku është hijeshia!”, atëherë kjo shpreh përçmim të mirësisë dhe përbën mungesë respekti kundrejt artistit të aftë që ta përgatisë e ta veshë atë rrobë. Nëse plot kreni thua: “Po, shumë i bukur jam! E ku ka më të hijshëm se unë! Tregomëni, a keni parë ndonjë kaq të bukur sa unë!”, atëherë kjo është një vetëlëvdatë mendjemadhe. E pra, për të shpëtuar edhe prej mendjemadhësisë, edhe prej mosmirënjohjes, duhet thënë: “Po, unë u zbukurova, por bukuria i përket rrobës, ndërsa rroba është e atij që ma veshi mua dhe nuk është imja.”” [157]

E pra, ky është mendimi i mirënjohjes ndaj bekimit të dhuruar. Nëse çështjes i qaseni në këtë mënyrë, besoj se as nuk bini në kryelartësi, as nuk shkisni në mohim e mosmirënjohje ndaj mirësisë hyjnore.

Qerasja hyjnore të mos kthehet në madhështim

Mirëpo, për shkak të teprimit të skajshëm me egoizmin në ditët tona, unë kam disa shqetësime të veçanta në çështjen e shfaqjes së qerasjes hyjnore apo të dhuratës hyjnore. Për shembull, ta zëmë se morët një vendim apo një nismë për një punë të caktuar. Ta zëmë se, sipas shprehjes popullore, vendimi që morët zuri vend. Në një gjendje të tillë, mund të pushtoheni nga mendimi: “Edhe kjo është një dhuratë hyjnore. Por gjithsesi, Zoti i Madhëruar urdhëroi dhe e çoi në vend këtë dhuratë nëpërmjet dorës sime.” Mirëpo ky mendim mund të kthehet në madhështim. Nga ky këndvështrim, kundrejt një gjendjeje të tillë, duhet thënë: “O Allahu im! Këtë qerasje e dhuratë që ma dërgove e vë mbi krye dhe e pranoj me mirënjohje të heshtur si një mirësi prej Teje. O Zoti im! Mos qoftë kjo madhështim për mua! Unë e kam një shqetësim të tillë në këtë çështje. O Allahu im, në qoftë kjo një madhështim e mashtrim prej thagmave, ahëre kërkoj mbrojtjen Tënde.” Sepse Allahu (xh. xh.), me të tilla ngjarje, mund t’i vërë njerëzit në provë. Po, është e vërtetë se Zoti i Madhëruar i njeh karakterin, natyrën dhe shpirtrat e njerëzve; por duke jua treguar juve veten tuaj, neve veten tonë, për të mbyllur derën e kundërshtimeve dhe të preteksteve, na vë në provë dhe na thotë: “Ja pra, shihe karakterin tënd. Sapo të bie diçka në dorë, menjëherë diç nis ta kujtosh veten. Sapo t’u dhurua një madhështi e hijeshi, menjëherë nise të përpiqesh të biesh në sy. Kur u begatove me mirësinë e një horizonti, të një vetëdijeje e të një konceptimi të lartë, sapo nisën t’i falen fryte punës dhe përprjekjes sate, ti nise menjëherë t’ia njohësh vetes meritat e të tilla mirësive. Ndaj edhe ti je një njeri kaq i kotë e i pavlerë.” Nga kjo pikëpamje, sipas këndvështrimit tim të përlurur, njeriu duhet ta ruajë gjithmonë veten prej një shqetësimi të tillë. Kundrejt qerasjeve hyjnore që i vijnë, duhet të shprehë mirënjohje e pranim duke thënë: “Këto më erdhën prej Zotit tim. Mijëra lëvdata e falënderime i qofshin Atij!” Por nga ana tjetër, duhet ta shohë veten edhe me këtë mendim: “Duke qenë se në këtë punë madhështore që bëri Zoti i Madhëruar, këtë qerasje hyjnore e dhuratë hyjnore mendja nuk ma rrok dot, nuk di në më duhet të qaj a të qesh. Nganjëherë, Ai edhe gomarit i vesh samar prej atllasi.”

Po, është e vërtetë se në ditët e sotme individualizmi dhe egoizmi janë kthyer në një sëmundje ngjithëse, aq sa – Allahu na ruajtë! – edhe ithtarët e namazit e të kiblës, kundruall qoftë edhe pak lëvdatash, nisin menjëherë të mendojnë se meritojnë vende e nivele të caktuara. Ndërkohë që, kur Allahu (xh. xh.) e lartëson njeriun, ky i fundit duhet të përgjunjet e të përulet krejt kundrejt një mirësie të tillë. Masa që Bediuzamani ka përcaktuar mes thjeshtësisë dhe vetëvlerësimit është

shumë e rëndësishme. Ai thotë: “Për çdo njeri, ka një dritare që shërben si përshkallëzim për të parë e për t’u parë në rrethin shoqëror. Në qoftë ajo dritare më e lartë se shkalla e vlerës shpirtërore, atëherë ajo do të arrihet përmes kryelartësisë. Në qoftë më e ulët, atëherë egoja do të ulet e do të përkulet përmes thjeshtësisë, gjersa të arrihet niveli në të cilin sheh dhe shihesh. Etaloni i madhështisë tek një njeri është vogëlsia, domethënë, thjeshtësia. Ndërsa njësia e vogëlsisë është madhështia, domethënë kryelartësia.” [158] Kjo qasje paraqet edhe një harmoni të plotë me kuptimin e hadithit, pasi Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.) urdhëron e thotë: “Këdo që gjendet vazhdimisht në modesti, përlësi e ndrojtje dhe sillet kokulur për hir të Allahut, Allahu e lartëson. Ndërsa atë që krenohet, që mban hundën përpjetë e përpiqet të duket, Allahu (xh. xh.) e poshtëron.” [159]

Në këtë çështje, ajo çka duhet bërë kujdes është që në një rreth a grupim shoqëror, ne nuk duhet t’i shohim me syrin e dëshirës për madhështi rezultatet e nxjerra prej punëve, qëndrimeve dhe sjelljeve të njerëzve që gjenden në të, sepse një këndvështrim i tillë do të thotë që të vësh nën paragjykim gjithë grupin. Nëse me mijëra e miliona njerëz i dalin për zot një ideali, realizojnë një mision të rëndësishëm dhe i vihen punës me mundim e përpjekje serioze në atë drejtim, të mendosh se ata e bëjnë këtë prej dëshirës për madhështi, do të thotë të paragjykos një bashkësi të tërë, çka përbën mëkat të madh. Por brenda atij grupimi, çdo individ për veten e tij, me mirënjohje të thellë ndaj Zotit të Madhëruar, duhet të mendojë e të thotë me vete: “Kundrejt një mirësie e bekimi të tillë unë nuk kam kurrfarë merite. Nuk i meritoj gjithë këto unë i varfri. Por pavarësisht gjithçkaje, unë do ta njoh atë si mirësi dhe do të lëvdoj e falënderoj Zotin.” Me të tilla mendime e mirënjohje duhet të jetë i mbushur çdo individ i tillë dhe në çfarëdo posti e pozite që të arrijë, gjithmonë duhet të ruajë ndjenjën e thjeshtësisë e të përlëjes, si dhe shqetësimin e rënies në kryelartësi.

[146] Araf, 7/196.

[147] Muhammed, 47/11.

[148] Shih: Bediuzaman, Letrat f. 17 (Letra e Katërt).

[149] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 518 (Fjala e Njëzetegjashtë, Shtojcë).

[150] Araf, 7/182.

[151] Shih: Bediüzzaman, Letrat f. 30 (Letra e Nëntë).

[152] Bediüzzaman, Rrezatimet f. 424 (Rrezatimi i Katërmbëdhjetë).

[153] Shih: Bediüzzaman, Letrat f. 400-401 (Letra e Njëzetetë, Çështja e tretë).

[154] Shih: Bediüzzaman, Letrat f. 30 (Letra e Nëntë).

[155] Buhari, xhihâd 182; Muslim, îmân 178.

[156] Bediüzzaman, Fjalët f. 515 (Fjala e Njëzetegjashtë, Përfundim).

[157] Bediüzzaman, Letrat f. 416-417 (Letra e Njëzetetë, Çështja e shtatë).

[158] Bediüzzaman, Letrat f. 536 (Farat e së vërtetës); Fjalët f. 791 (Lulet prej farave); Diskutimet f. 64.

[159] Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-evsat 5/140. Për hadithe me kuptim të përafërt, shih: Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 3/76; Ebj Ja'la, El-Musned 2/358.

E drejta e nderit dhe e vullnetit



Pyetje: “Ju silluni me nder e si ju ka hije ndaj grave të të tjerëve, që edhe gratë tuaja të jenë të ndershme e të sillen si u ka hije.” [160] Si duhet ta kuptojmë këtë hadith? A mund të na e sqaroni?

Përgjigje: Hadithi transmetohet në këtë formë: “*Ju silluni me nder e si ju ka hije ndaj grave të të tjerëve, që edhe gratë tuaja të jenë të ndershme e të sillen si u ka hije.*” [161] Për nga kriteret e hadithit, mund të ndaleshim paksa në diskutimin e vërtetësisë së tekstit. Por për sa i përket kuptimit të shprehur dhe përmbajtjes, është e dukshme se kemi të bëjmë me një fjalë ndriçuese, të bekuar e domethënëse, shembuj të së cilës kemi parë e dëshmuar shpesh mes perlave të retorikës së hijshme të Zotërisë sonë, Profetit (s.a.s.).

Arsyeja e shëndoshë dhe nderi

Në radhë të parë, në konceptimin e hadithit, sikurse kemi parë në tekstet e tjera, dua të tërheq vëmendjen te një disiplinë themelore: Njerëzit, përgjigjen ndaj veprave të tyre, në përgjithësi, e gjejnë në llojin e vet. Domethënë, nëse ju mendoni mirë për të tjerët, edhe ata mendojnë mirë për ju. Nëse ju i përqaftoni njerëzit me dashuri e mirësi, edhe ata jua hapin zemrat me dashuri e mirësi. Nëse ju i vlerësoni e i trajtoni njerëzit me të mirë, edhe ata ju përgjigjen me të mirë. Sepse mirësia juaj bëhet shkak për të ndezur ndjenjën e mirësisë edhe tek ata. Këtë të vërtetë është e mundur ta nxjerrim prej pohimit lavdiplotë të Kuranit Fisnik: “Për njeriun është vetëm fryti i asaj çka ai vepron. Fryti i përpykjes së tij pa dyshim që do të duket. Paskëtaj, atij do t’i jepet shpërblimi pa kurrfarë mangësie.” [162] Po, është e vërtetë se njeriu, shpagimin e një pjese të veprave të veta të këqija do ta shohë që këtu. Ndërsa shpagimin e të këqijave që nuk janë falur në këtë botë e të lëna për Gjyqin e Madh, do ta gjejë medoemos në jetën tjetër. Meqë ra fjala, po them se teksta mendojmë për gjerësinë dhe pafundësinë e mëshirës hyjnore, shpresojmë që Allahu (xh. xh.), të gjitha të këqijat e bëra, me mëshirën e Tij, në jetën tjetër, t’i ngushtojë e t’i mbledhë dhe të na i kthejë duke na thënë: “Haku është kaq!” Ndërsa duke ardhur tek të mirat, edhe ato, Zoti i Madhëruar, me mirësinë dhe mëshirën e Tij të pafundme, sikurse një farë e hedhur në tokë dhuron njëmijë kallinj, do t’i shumëfishojë ato e do t’ia dhurojë njeriut në jetën e amshuar. Kjo është një e vërtetë që shpreh drejtësinë absolute të treguar në ajetin e gjendur në Kuranin Fisnik: “Kush ka bërë një të mirë sa një grimcë, do ta shohë atë; dhe kush ka bërë një të keqe sa një grimcë, do ta shohë

atë.” [163] Por kur e shtjellojmë çështjen me mendimin e mëshirës hyjnore dhe me emrat e Allahut që lidhen me ahiretin, mund të thuhet se nuk është e drejtë të mendohet që mëkatet e kryera në masën e një grimce do të ndëshkohen patjetër.

Pasi tërhoqëm vëmendjen te kjo disiplinë themelore, nëse dëshironi, le t’i kthehemi tekstit të hadithit. Shprehja *Ju silluni me nder e si ju ka hije ndaj grave të të tjerëve*, në këtë hadith, duket sikur u drejtohet së pari personalisht burrave. Pra, përmes saj, i Dërguari i Nderuar bën këtë paralajmërim: “O burra! Së pari ruajeni ju nderin dhe moralin kundrejt bashkëshorteve të të tjerëve, në mënyrë që edhe bashkëshortet tuaja të ruajnë nderin e tyre kundrejt burrave të tjerë.” Se nëse një njeri bën diçka negative dhe pavarësisht të gjitha paralajmërimeve dhe këshillave këmbëngul të mos heqë dorë, atëherë Allahu (xh. xh.), herët a vonë, e bën atë individ të përballet me pasojat e së njëjtës të keqe. Kjo gjendje i shfaqet herë te vetja, herë te bashkëshortja, herë te një tjetër i afërm, sepse ndëshkimi pësohet sipas llojit të fajit të kryer. Mes fajit dhe ndëshkimit në kuptimin, *se dënimi i çdo vepre bëhet sipas llojit të saj*, ka një lloj përkimi, përputhjeje e pajtimi. Kështu, Allahu na ruajtë, njeriu mund ta pësojë zhdëmtimin e mëkatit të kryer me një turpërim e koritje të ngjashme. Për birin e njeriut, që është i krijuar në gjendje të fisme, i bekuar me të fshehtën që mbartet në *“ahsen-i takvim”* apo në formën më të bukur, kjo është diçka shumë e rëndë. Zoti ynë mos e turpëroftë askënd me një cenim të tillë të dëlirësisë a të nderit!

Po, njeriu është krijesa më e nderuar. Ndaj edhe është shumë e rëndësishme që ai të përdorë mendjen, arsyen dhe logjikën në çështjen e të qenit i ndershëm e i moralshëm. Sepse kur i drejtohet një mendjeje të shëndoshë, njeriu e trajton çështjen nga fillimi gjer në përfundim, e peshon atë bashkë me shkaqet dhe përfundimet, i sheh që më parë përfundimet e pritshme prej veprave që do të kryejë dhe kështu, duke i dhënë hakun vullnetit të vet, u qëndron larg sjelljeve dhe veprimeve që do ta turpëronin e do ta vinin në pozitë të vështirë.

Nga ky këndvështrim, njerëzit që nuk duan t’u njolloset nderi i vet, duhet të tregohen të kujdesshëm kundrejt nderit të të tjerëve. Në fund të fundit, duke e parë nga një pikëpamje e përgjithshme, vetëkuptohet se një besimtar, që është përfaqësues i sigurisë e i paqes, kujdesin dhe ndjeshmërinë që tregon për të ruajtur nderin dhe moralin e vet duhet ta tregojë edhe në ruajtjen e nderit dhe të moralit të të tjerëve. Sipas kësaj qasjeje, një besimtar nuk duhet të thotë vetëm “nderi im”, “cipa ime”, “moralimi im” apo “shoqja ime e jetës”. Sepse nëse njëra është shoqja ime e jetës, tjetra është motra ime, është vajza ime, është teza apo halla ime. E pra, një njeri që vepron duke iu nënshtruar të tilla ndjenjave e mendimeve – Allahu na ruajtë! – nuk bie në gabime që do t’i ktheheshin kundër vetes, nuk luan me nderin dhe moralin e të tjerëve, e nuk sheh askënd me sy të keq.

As edhe njerëzit e moshuar...

Atëherë, cilat janë disiplinat e imponuara prej Islamit mbi këtë çështje? Për shembull, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një rast, urdhëron e thotë: “Assesi një burrë të mos qëndrojë i vetmuar me një grua nëse ajo nuk ka pranë një të afërmin e saj.” [164] Po ashtu, Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në një tjetër hadith urdhëron e thotë: “Një grua, pa pasur pranë një të afërm, të mos dalë në udhëtim.” [165] Aq sa, sipas fakihëve të shkollës hanefite, qoftë edhe për kryerjen e një ibadeti të detyruar siç është haxhi, për gruan vihet si kusht prania e bashkëshortit ose e një të afërmi. [166] E pra, këto disiplina janë secila në vlerën e një barriere, të një kufizimi e të një

parandalimi. Besimtari duhet të përpiqet në vazhdimësi që të ndalet para këtyre parandalimeve dhe të mos i kapërcejë këta kufij. Kjo gjendje, në një tjetër hadith, gjen shprehje në këtë formë: “Gjërat e lejuara (në një mënyrë të tillë që të mos i lënë vend dyshimit) janë të qarta dhe gjërat e ndaluara janë të qarta. Mes këtyre të dyjave, ka disa gjëra të dyshimta, që shumica e njerëzve nuk i di. Ai që e ruan veten prej gjërave të ndaluara, ka ruajtur fenë dhe nderin e vet.” [167] Të hysh në fusha të dyshimta është si të endesh në një tokë të minuar. Një njeri që bredh aty, nga çasti në çast mund të bjerë pre e një shpërthimi. Në të vërtetë, në perlat e të folurit përmes heshtjes prej Mbretit të Fjalës, pasi tërhiqet vëmendja tek ajo lloj e ndaluare që e sheh syri, tek e cila shkon këmba, të cilën e zë dora, dhe tek e cila, pas një pike të caktuar, nuk ka më kthim, këshillohet që, për këtë shkak, njeriu të largohet menjëherë prej kredhjes në një lloj përfytyrimesh të tilla të fëlliqura. Sepse njeriu, nëse vazhdon të ecë në botën e këtyre ëndërrimeve të pisëta, rrezikon të mposhtet prej natyrës e prej lëndores dhe mund të përballet me rreziqe vdekjeprurëse që mund t’ia paralizojnë botën e zemrës e të shpirtit. Madje edhe ata që janë të moshuar, tek të pesëdhjetat apo të gjashtëdhjetat, nëse nuk i ndjekin me kujdes disiplinat e caktuara prej Islamit në lidhje me këtë çështje dhe nuk tregohen parimorë në këtë temë, do të thotë që gjenden përballë po këtyre rreziqeve. Zoti ynë as të riun, as të vjetrin mos i rrëzof të në batakun e pandershmërisë dhe mos turpëroftë askënd kësisoj! Në paçin rënë, u dhuroftë prej mirësisë së Tij rrugët e shpëtimit prej një koritjeje të tillë! Sepse siç u përmend më parë, për qenien njerëzore, që është krijesa më e nderuar, e bekuar me misterin “*ahsen-i takvim-it*”, një turpërim i tillë është shumë i rëndë.

Meqë erdhi fjala këtu, me lejen tuaj, dua të përsëris edhe një herë fjalët e shokut tim orëndreqës e poet, që e kam përmendur edhe më herët në raste të ndryshme: “*Ia çela velat detit të rebelimit. Tani s’më lë të dal në breg.*” Po. Njeriun e merr me vete një rrjedhë e tillë, që edhe nëse pendohet për ç’ka bërë dhe do të shpëtojë prej gjendjes në të cilën ndodhet, mund të mos kthehet dot më prapa. Më e mira është që njeriu të mos i ketë besë as fuqisë, as forcës, as vullnetit të vet. Ai duhet të bëjë kujdes që në krye të punës që të mos bjerë pre e një rrjedhe të tillë. Allahu na ruajtë, nëse ka ndodhur që, prej disa shkaqesh, arsyesh e faktorësh është kapur prej një rryme të tillë, atëherë, në atë gjendje, duhet të thotë: “Unë nuk jam një kafshë që vepron me instinkte.” Në këtë mënyrë, duhet t’i japë hakun vullnetit të vet dhe menjëherë duhet të dijë të kthehet prapa.

Po ja që në ditët tona është fort e vështirë që të mund të thuhet se ekziston një ndjeshmëri e tillë. Gjendja ekzistuese, më së shumti, i kujton njeriut fjalët e të ndjerit Mehmet Akif:

“Turpi shpërvjelë e rënë: Pacipësi kudo...

Ç’faqe të zezë mbuluakësh perde e hollë!

Premtim e besë s’mbet, fjalë boshe amaneti;

Drejtësi s’gjen kush, tradhti e rrenë ngado.

...

Gërditen trutë, Zot, ç’rrezim e tmerr ka ngjarë:

S’mbet besë e fe, rrënuar dini, pluhur bërë imani!

Krenitë avullofshin, zemrat mbetshin pa fjalë...

Ky zvetënim pa pushuar, egoizmi s'ka të ndalë!"

Po, po. Në ditët tona, për këtë çështje, ka shpërbërje, shpërndarje, thyerje e shformime që pasojnë njëri-tjetrit. Prandaj, në një kohë të tillë, ka nevojë për sjellje të mrekullishme, për heronj të vullnetit, që duke shpërfaqur të tilla sjellje, të mund ta kthejnë mbrapsht këtë rrjedhë. Ka nevojë për vullnete të tilla të larta të njerëzve, që nuk mendojnë vetëm për nderin e vet, por që drithërohen në emocion edhe për nderin e kombit, që synojnë t'u japin sërish jetë në jetën e tyre atyre ndjenjave e mendimeve të mirësishme e të përsosura dhe kështu, të mund ta kthejnë rrjedhën mbrapsht... I ndrituri Hazreti Piri Mugan thoshte: "Feja është jeta e jetës, edhe drita, edhe thelbi i saj. Rilindja e këtij kombi sendërtohet me rilindjen e Fesë." [168] Besoj se me këto fjalë, ai ka prekur përgjegjësinë më jetësore.

Lartësimi vertikal

Në një hollësi të fundit, dua të pohoj se sa më e fortë që të jetë ndjenja, dëshira dhe prirja negative të një njeri, përkundrajt kësaj gjendjeje, nëse ai mbështetet te Zoti i vet dhe i jep hakun vullnetit siç i takon, atëherë Allahu (xh.xh.) e përsos atë njeri duke ia shtuar mirësitë në drejtim të kapërcimit të këtyre handicapëve që ai ka. Thuajse të gjithkush, në një shkallë a në një tjetër, ekzistojnë ndjesitë e të kryerit të disa të këqijave. Për shembull, babëzia, vënia e syrit në pasurinë e tjetërkujt, dëshira për t'u dukur, ndjenja e egoizmit, përkushtimi pas famës e pozitës, qoftë edhe në masë të vogël, në një formë a në një tjetër, janë ndjesi që mund të gjenden te çdo njeri. Por disa prej këtyre ndjenjave te disa njerëz janë më të forta. Për shembull, ka njerëz të tillë që edhe nëse i merrni t'i hidhni mes arit, ai as që prek as edhe një flori të vetëm. Në qoftë se i ka mbetur me vete gabimisht një monedhë ari dhe ka shkuar me të në një vend të largët, ai njeri, edhe në pastë bërë ditë të tëra rrugë, nuk ngurron të kthehet e ta vërë floririn në vendin e vet. Sepse ai njeri, në këtë çështje, nuk ka kurrfarë dobësie. Por nuk mund të jeni të sigurt që i njëjti njeri, në çështjen e dëshirës për kolltuk e për pozitë do të tregojë të njëjtin qëndrim, sepse në këtë rast mund të ketë një dobësi e një zbrazëti. Madje te disa mund të gjenden të gjitha njëherësh ato viruse që ka përmendur Mjeshtri në "Hücumat-ı Sitte". [169] Tani, një njeri që do të vërë në zbatim hukmin e këtyre viruseve, duke i dhënë hakun vullnetit të tij, mund të thotë: "Unë nuk jam një krijesë e dobët, pre e kafshërores dhe e materiales. Krahas trupit, unë kam edhe një zemër e një shpirt. Më duhet të udhëtoj në atë orbitë." Dhe kështu, duke i dhënë hakun vullnetit të vet, nëse bën një përpjekje heroike kundrejt atyre ndjesive dhe nëse u kundërvihet atyre porsin një gladiator, atëherë shpërblimi hyjnor që do t'i kthehet atij është shumë i ndryshëm. Pra, niveli i një njeriu të tillë, krahasuar me një njeri të zakonshëm që nuk i ka në të njëjtën masë këto dëshira e prirje, është shumë më i lartë dhe kjo shkallë i mundëson që të ngrihet lart në mënyrë vertikale, porsin një raketë për të mbërritur me shpejtësi horizontin e lartësimit.

[160] El-Hakim, El-Mustedrek 4/170.

[161] El-Hakim, El-Mustedrek 4/170.

[162] Nexhm, 53/39-41.

[163] Zilzal, 99/7-8.

[164] Buhari, Nikah 111; Muslim, Haxh 424.

[165] Buhari, Xhezau's-sajd 26, Xhihad 140; Muslim, Haxh 424.

[166] Es-Serahsi, El-Mebthut 4/111; Ibnu'l-Humam, Fet'hu'l-kadir 2/421; Ibn Abidin, Hashije 2/465.

[167] Buhari, Iman 39, Buju' 2; Muslim, Musakat 107.

[168] Bediuzaman, Fjalët f. 781 (Dritat e shkrepëtimave).

[169] Shih: Bediüzzaman, Letrat f. 465-481 (Letra e njëzetënëntë, Risaleja e gjashtë), në shqip teksti titullohet "Gjashtë sulmet e djallit".

T'u japësh zë mirësive sipas vlerës së tyre



Pyetje: Ç'do të thotë falënderim i mirësisë? A mund të na e shpjegoni se si bëhet ky falënderim për mirësitë me gjuhën e shpirtit?

Përgjigje: Falënderimi i mirësive do të thotë që njeriu, me mendimin e mirënjohjes, t'i përmendë e t'i shprehë të mirat, bekimet e begatitë e dhuruara nga ana e Zotit të Madhëruar. Për ta shprehur më ndryshe, domethënë që begatitë hyjnore të mos përdoren si mjet krenarie; por edhe të mos bihet në gabimin e mosmirënjohjes dhe të shpërfilljes së tyre. Kjo bëhet duke mos i mohuar ato mirësi e dhurata hyjnore dhe duke ia njohur ato mirësi Zotit të Vërtetë. Pra, do të thotë, që njeriu të veprojë me mendimin: "Të gjitha këto begati që më janë dhuruar, i përkasin asaj Qenieje që më dhuron mua përmes forcës dhe fuqisë së Vet, që më jep mua aftësinë për të punuar e vepruar, që ma përforcon fuqinë time shpirtërore me shpresë, dashuri e përmallim, që më drejton në rrugët e duhura, që urdhëron për mua udhëzimin në të drejtën e në sinqeritetin." Ndërsa burimi i këtij mendimi është ajeti i sures "Duha", që duke iu drejtuar Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (s.a.s.), urdhëron e thotë: "Tani eja, mirësitë e Zotit tënd rrëfeji e tregoji!" [170]

Mirësitë dhe bekimet e veçanta të përmendura në suren "Duha"

Zoti i Madhëruar, që në krye të sures "Duha", ka urdhëruar e renditur mirësitë e bekimet e veçanta që i janë dhuruar Shpirtit Fisnik të Zotërisë së Mirësive (alejhi efdalutahij'jat ue ekmelu teslimat), ndërsa në ajetin e përmendur, në fund të sures, ka kërkuar prej Tij që t'i kujtojë e t'i shprehë këto bekime. Surja nis me betimin në kohën e mëngjesit, në të cilën dielli është ngjitur e ka mbërritur gjendjen e tij të shkëlqimit të plotë, [171] ndërsa më pas është shprehur betimi në natën, në të cilën ka rënë muzgu e është errësuar krejt. [172] Të betuarit në çastin më të errët pasi është zënë be në kohën e shkëlqimit të diellit të mëngjesit, është një hollësi në të cilën duhet të ndalemi. Sepse në pikun kur errësira është në kulmin e vet, është horizontit i çeljes së dritës. Po, po. Ky çast është porsì platforma, limani apo sheshi i ndriçimit. Ajo errësirë e thellë që mbështjell mjedisin, do të thyhet me agimin. Sado që çasti më i errët pasohet fillimisht nga një agim i rremë, sipas qasjes së Mësuesit të Nderuar, agimi i rremë është shenjë e agimit të vërtetë. Sepse pas saj, nata e vazhdueshme do të marrë fund. [173]

Zoti i Gjithëfuqishëm, pasi përmend pikërisht këto dy hollësi, urdhëron e thotë: “Allahu ty as s’të ka përbuzur e as s’të ka braktisur.” [174] Shprehja *"s'të ka braktisur"* që është përmendur këtu, është përdorur me domethënie të përforcuar. Siç dihet, rendi i shenjimit të përforcuar shpreh përforcim në domethënie. Sipas kësaj, kuptimin e lartë të këtij ajeti të shenjtë mund ta shprehim në formën: “Allahu ty kurrsesi, assesi nuk të ka braktisur.” Nëse e shtjellojmë në koncept antonimik, atëherë nga ky ajet mund të arrijmë në përfundimin: “Allahu të ka konfirmuar kurdoherë me praninë e Vet.”

Ndërsa një ajet më pas, shprehet një tjetër sihariq plot mirësi e bekim me fjalët: “Pa dyshim që për ty, gjithmonë, fundi i çështjes është më i mirë sesa kreu, se gjendja e fundit është më e mirë se gjendja më e hershme.” [175] Kur mendojmë në kuptim të përgjithshëm, mund të themi se, së pari, e personalisht atij të Dërguari Fisnik e të Pashoq dhe së dyti, e në tërësi bashkësisë së Tij u është dhënë sihariqi i së nesërme në krahasim me të sotmen, i gjendjes aktuale në krahasim me gjendjen e mëpasme, i çeljes së kufizuar në qendër krahasuar me shtrirjen e gjerë të rrethit, dhe në përfundim, krahasuar me këtë botë, sihariqi i Parajsës dhe kulmimi i saj me të Shikuarit e Allahut. Në rendin e mirësive e të bekimeve të veçanta që i janë falur Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik, ky sihariq zë një vend të posaçëm. Sepse sipas rregullit “Kush bëhet shkak për diçka, është si të ishte vetë realizuesi i saj”, [176] duke qenë se vargu i vlerave që gëzon sot njerëzia rrjedh në zemrat e tyre prej duarve dhe kraharorit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), mirësia e veprave të kryera prej tyre, në njëfarë mase, shkruhen edhe në librin e veprave të tij. Ndaj edhe të gjitha këto bëhen shkak për ngritjen e tij të vazhdueshme, duke u shndërruar në nganjë shkallë nën këmbët e Tij, që vazhdimisht e çojnë Atë më lart e më lart. Përfytyroni pak, që duke nisur nga ditët tona, në faqe të dheut ka një miliard e gjysmë myslimanë. Nëse prej këtyre, një miliard, pak a shumë, falin namaz, atëherë një miliard njerëz i dërgojnë përshëndetje e selame Zotërisë sonë, Nderit të Gjithësisë, pesë herë në ditë. Veç kësaj, edhe jashtë namazit, me raste e shkaqe të ndryshme, besimtarët lutën çdo ditë për Të dhe i dërgojnë përshëndetje e selame.

Në të vërtetë, të gjithë profetët (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Zotërinë tonë dhe mbi ta!), duke qenë udhërrëfyes të mirë, gjithmonë kanë përfaqësuar të drejtën dhe u kanë hequr kurdoherë udhë njerëzve me sinqeritet në të Vërtetën. Mirëpo ka pasur profetë të tillë, bashkësia e të cilëve ka mbetur e kufizuar në dy-tri njerëz. Në një hadith që gjendet te Buhariu dhe te Muslimi, urdhërohet e thuhet kështu: “M’u paraqitën umetet e shkuara. Pashë profetë që kishin pranë një grup të vogël prej tre a pesë vetësh. Pashë profetë, pranë të cilëve gjendeshin dy a tri vetë. Dhe pashë, po ashtu, profetë që s’kishin kurrkënd pranë. Ndërkohë, një grumbull i madh njerëzish doli para meje. Mendova se ishte ymeti im, por më thanë: “Ky grumbull janë Musa dhe bashkësia e tij.” Pashë sërish; një grup i madh njerëzish. “Ja, këta të gjithë janë ymeti yt. Mes tyre ka shtatëdhjetëmijë vetë që do të hyjnë në Parajsë pa llogari e pa vuajtje”, më thanë.” [177]

Ky hadith tregon se umeti i të Dërguarit të Allahut (a.s.u) është më i shumtë se bashkësitë e të gjithë profetëve. Ka edhe njerëz që, ndoshta në pamje të jashtme duket sikur janë pjesë e bashkësisë, por që në të vërtetë nuk e kanë ruajtur dot këtë pjesëmarrje. Por gjithsesi, numri i njerëzve që do të trajtohen me cilësimin e umetit dhe që mund t’i quajmë bashkësi e Muhamed Mustafasë (alejhissalatu ues'selam) do të jenë aq të shumtë sa s’do të kenë të krahasuar me asnjë umet tjetër.

E pra, duke nënkuptuar të gjitha këto mirësi që përbëjnë nganjë bekim të madh për Atë prej Zotit të Madhëruar, në fund të sures “Duha”, Allahu (xh.xh.) urdhëron e thotë: përmendi mirësitë e bekimet që të ka zbritur Allahu, i Cili të ka zgjedhur.

Të gjithë përbëhen prej një pike

Natyrshëm, shpirttrave të përkushtuara që ndjekin rrugën e Tij, që rendin e punojnë me dëlirësi e sinqeritet në shërbim të besimit e të Kuranit, që ia kanë blatur veten kësaj rruge, mund të ndodhë që, në udhë e sipër, Zoti i Madhëruar t’u dhurojë mirësi e bekime të veçanta. Udhëtari i shërbesës, kur t’ua shohë këto mirëdashje e vlerësime të veçanta, duhet të mbushet me ndjesi të mirënjohjes e të përulet në mënyrën më të thellë. Njerëzit që nuk kanë pjesë në këto shërbime, që nuk kanë ndonjë pikësnyim e pritshmëri përsa i përket këtij drejtimi, mund t’u japin zë këtyre mirësive, madje mund ta tregojnë me ngazëllim një të vërtetë të tillë porsì një thirrje minareje e ta shpallin atë me zë të lartë. Por në këtë pikë, është një çështje me shumë rëndësi që këto mirësi e bekime të mos përdoren si lëndë fame e krenimi. Sepse njeriu, nganjëherë, duke u dhënë zë mirësive e bekimeve që i janë falur, duke qenë se gjendet vetë i përfshirë në këtë mes, mund të pushtohet prej dëshirës për të shprehur vetveten, me pak fjalë për t’i dhënë zë vetvetes. Në lidhje me këtë çështje ju pata rrëfyer një ngjarje që nuk do kam për ta harruar asnjëherë. Kështu, një person që po mbante një fjalë në përrurimin e një institucioni, duke treguar veprimtaritë e bëra, tha diçka, që barte një domethënie të këtillë: “Duke punuar e duke u përpjekur gjër sot, ne, shërbëtori juaj, e bëmë këtë shkollë.” Unë, këtë shprehje të çuditshme, të pazakontë e të gabuar, s’munda ta harroj asnjëherë. Sikur të mund ta harroja! Sepse sa herë e kujtoj atë fjalë, më vjen në mend folësi. Zoti m’i faltë mangësitë!

Ndërkohë që në mendimin e një njeriu besimtar nuk mund të ketë as “unë”, as “ju”, as “ne”. Ne s’jemi veçse një pikë në det, jemi veç nganjë rob e shërbëtor. Ndaj edhe një besimtar, duke folur, nuk duhet të hyjë në asnjë mënyrë në ndonjë ligjëratë që përçon ndjesinë me kuptimin: “Shihni, në këtë punë jemi të përfshirë edhe ne!” Madje edhe përtej të folurit, brenda njeriut, në thellësi të zemrës, nuk duhet të ekzistojë shqetësimi për t’u shprehur e për të treguar për vetveten. Përndryshe, edhe në qoftë fjala e bukur, nganjëherë dëshira dhe prirja e brendshme gjejnë pasqyrim në mimikë. Dhe njohësit e aftë që mund ta lexojnë mirë fytyrën, që mund të nxjerrin kuptim prej fizionomisë, e zbulojnë të fshehtën e thellë. Po, ata që kanë aftësi njohëse, prej mimikës së fytyrës, prej lëvizjeve të gojës, prej irisit të syrit, prej ngritjes së zërit valë-valë, mund ta lexojnë botën e brendshme të njeriut që ka hall të tregojë veten. Edhe engjëjt e kuptojnë këtë gjendje të tijën që pasqyrohet së jashtmi. Po në fund të fundit, Allahu, me dijen e pafundme, pa dyshim që di gjithçka. Prandaj edhe një qëndrim e mendim i tillë përbën një turp së pari përkundrejt Allahut, pastaj përkundrejt engjëjve, pastaj përkundrejt të mëdhenjve që mund të shohin disa të fshehta. Ndërkohë që ne e dimë se sukseset dhe arritjet i mundëson me mirësinë e Tij vetëm Allahu. Edhe engjëjt, si mjet i mirësisë e i bekimit të Tij, na kanë mbështetur e forcuar shumë herë me fuqi shpirtërore. Ata e kanë rrethuar krejt hapësirën qark nesh dhe kanë derdhur mbi ne qetësi e siguri. Besimtarët e përqaftuar me krahët e mëshirës hyjnore, me lejen, mirësinë dhe mbrojtjen e Allahut, kanë qëndruar pa u tutur dhe nuk janë tronditur asfare.

E pra, të qenët apo jo i rrezikshëm i falënderimit të mirësive hyjnore ndryshon sipas këtyre tri mendimeve e qëllimeve. Për shembull, një njeri si Mjeshtri Bediuzaman, mund të shprehet qartë

dhe hapur kundër dashamirësisë dhe lajkatimeve duke thënë: “Mua nuk më pëlqen vetja. Madje nuk më pëlqejnë as ata që më pëlqejnë mua.” [178] Por ajo çka është e rëndësishme këtu, është që njeriu çdo fjalë që nxjerr nga goja ta kontrollojë sipas kriterëve të mirënjohjes dhe t’i kërkojë vetes llogari për gjithçka që thotë. Ty a të pëlqen vërtet apo jo vetja; këtë duhet ta testosh. Për shembull, nëse dikush të prek dhe ti nuk shfaq ndonjë reagim, do të thotë se ke vërtetësi në atë që thua. Ta zëmë se dikush të poshtëron duke të fyer me fjalët: “Ik, ore krimb!” Nëse kundrejt kësaj gjendjeje, ti arrin ta kapërdish egon tënde aq sa të mund të thuash: “Vërtet, më ke gjetur një fjalë që më shumë se çdokujt, më shkon mua për shtat!”, atëherë mund të thuash me plot gojën se nuk të pëlqen vetja. Ose në u ngritë dikush të të thotë: “Ç’ të mirë mund të ketë prej teje?” dhe ti nuk tregon reagim negativ, por ndihesh aq i qetë sa të mund të thuash: “Gjer më sot pse nuk u gjet dikush që të ma thoshte një fjalë kaq të drejtë?”, atëherë mund të mbërrish në përfundimin se nuk të pëlqen vetja.

Veç kësaj, për nevojë të fjalës së thënë më sipër, nuk do t’i pëlqesh as ata që të pëlqejnë. Për shembull, ta zëmë se dikush, për shkak të shërbimeve të mira që ke kryer, të vlerëson me shprehje lëvduese. Përballë një gjendjeje të tillë, nëse nuk përulesh e nuk skuqesh nga ndjesitë e turpit, nëse nuk ndien shqetësim prej atyre fjalëve, atëherë mund të gjykosh se gjendesh në një pohim kundërthënës. Madje nëse në këtë pikë, njeriu nuk e kontrollon dot botën e tij të brendshme, gjendet përballë rrezikut vrasës të një dëshire të fshehtë për t’u dukur e për të rënë në sy. Për shembull, një njeri shprehet në dukje se nuk i pëlqen vetja, ose me sjelljet e veta përpiqet të krijojë mendimin se kinse nuk i pëlqen vetja. Mirëpo këtu është fjala, thellë-thellë, për një mendim të fshehur: nën ambalazhin e përljes e të thjeshtësisë, të investosh për të rënë në sy. Madje të sigurosh që kjo gjendje, duke u përhapur, të mbërrijë edhe tek të tjerët dhe ata të mund të thonë: “Pa shiko! Këtij njeriu nuk i pëlqyekësh vetja. As ata që e lëvdojnë nuk i pëlqyekëshin!” E pra, njeriu duhet t’i mbajë gjithmonë parasysh këto hile e kurthe të nefsit e të shejtanit; dhe qoftë edhe në qëndrimet, sjelljet e bisedat më të pafajshme duhet të kontrollojë veten me shqetësimin se mund të mposhtet qoftë edhe prej një grime. Dhe nëse në mendimet e në qëllimet e tij të brendshme ndien ndonjë mungesë kthjelltësie, atëherë mirësitë e dhuruara nuk duhet t’i shprehë përmes fjalës, por t’u japë zë përmes gjuhës së shpirtit, duke dhënë prova për to. Kjo është një rrugë më e sigurt dhe më e shëndetshme.

As engjëjt të mos e marrin vesh

Në mënyrë që ky mendim të na rrënjoset në mendje e në zemër, duhet të besojmë me shpirt se të gjitha këto mirësi e bukuri i perkasin Zotit të Madhëruar dhe të mos i krijojmë asnjë mundësi kurrfarë besimi të kundërt më këtë. Në fund të fundit, edhe Kurani, në ligjërimin e Tij të mrekullueshëm, e ka shprehur këtë me një stil shumë të qartë e të drejtpërdrejtë. Ai urdhëron e thotë: “Çdo mirësi që të vjen, është prej Allahut; ndërsa çdo e keqe që të bie mbi krye është prej vetes sate.” [179] Sipas kësaj, nëse ju ngulet një gjemb në këmbë, nëse përballenit me një fiasko në punët tuaja dhe nuk arrini të keni sukses... etj., të gjitha i keni prej vetes tuaj. Ndërsa për sa u përket mirësive, bekimeve, sukseseve e arritjeve që zbresin si shi i begatë mbi ju, të gjitha janë prej Allahut. E pra, kësaj të vërtete i duhet besuar me zemër dhe ky kriter, që ka vendosur Kurani, është i atillë që duhet përqaftuar fuqishëm.

Në përfundim, njeriu duhet t'i kërkojë vetes llogari dhe ta qortojë veten ashpërsisht; porsì një enë e shpuar, e cila, vajin që i hidhet brenda, do ta shpërndajë gjer në çastin që ai të zbrazet krejt. Nga ana tjetër, në një kërkesë të thellë llogarie ndaj vetes, pa iu hapur të tjerëve, pra, duke folur me fjalën e shpirtit, do të shpërfaqë në falënderim mirësitë hyjnore duke thënë: “O Zoti im, lavdi e mirënjohje të qoftë Ty për të gjitha bukuritë e mirësitë që ne kemi arritur!” Pa folur gjuha, zëri i zemrës do t'i drejtohet Allahut, i mbushur plot e përplot me ndjenja të brendshme të mirënjohjes e të falënderimit, dhe kështu, do t'u jepet zë mirësive e bekimeve të dhuruara prej Zotit të Gjithëmëshirshëm përmes mendimesh të brendshme. Madje duke shprehur së brendshmi gjithë këtë, duhen bërë përpjekje që të mos lihen hapësira, në mënyrë që as engjëjt të mos e marrin vesh. Njeriu duhet të thotë: “O Zoti im! Nuk dua, që as engjëjt të mësojnë për këtë. Kam dëshirë që ta dish vetëm Ti. Mijëra lëvdata të qofshin Ty, që të Dashurit Tënd i the: “E tani eja e rrëfeje mirësinë e Zotit tënd!” [180] dhe bashkë me të, na dhe një shenjë edhe ne për këtë çështje. Edhe unë, duke iu përshtatur asaj shenje, bëj falënderimin e të mirave që të janë dhënë duke pohuar mirësinë e dhuruar prej Teje. Por këtë nuk dua që ta mësojnë as engjëjt mbrojtës e as ata shkruer. Sido që të jetë, kjo çështje është mes meje dhe Teje. Mua më mjafton që ta dish veç Ti.”

[170] Duha, 93/11.

[171] Shih: Duha, 93/1.

[172] Shih: Duha, 93/2.

[173] Shih: Bediüzzaman, Jetëshkrimi f. 87 (Fillimet).

[174] Duha, 93/3.

[175] Duha, 93/4.

[176] Shih: Muslim, Imaret 133; Tirmidhi, Ilm 14; Ebu Davud, Edeb 115.

[177] Buhari, Tib 17, 41, Rikak 50; Muslim, Iman 374.

[178] Bediuzaman, Letrat, fq. 388 (Letra e njëzetegjashtë, Shkalla e katërt)

[179] Nisa, 4/79.

[180] “E tani eja e rrëfeje mirësinë e Zotit tënd!” (Duha, 93/11)

Miopia



Pyetje: Kundrejt disa bukurive që mund t’u shfaqen në mjedisin e afërt, disa njerëz mund të shfaqin sjelljen e një njeriu që ndodhet krejt larg tyre. Cilat janë shkaqet e kësaj gjendjeje shpirtërore, si dhe çfarë mund të bëhet për t’u çliruar prej saj?

Përgjigje: Sikurse largësia përbën apo mund të përbëjë pengesë që cilësitë e së vërtetës të mund të njihen ashtu siç janë, nganjëherë edhe afria mund të kthehet në një perde që pengon shikimin. Ka pasur njerëz që, megjithëse jetonin në të njëjtën epokë dhe i gjendeshin fare pranë Tablosë së Krenarisë së Njerëzimit, atij vërshimi drite që kroddhi një botë të tërë në nur, nuk e panë dot as Atë dhe as zotërinjtë tanë, sahabët e tij, që ishin në pozitën e yjeve ndriçuese në qiell. Po nga ana tjetër, pati njerëz që qenë të vetëdijshëm për afrinë me një bekim të tillë, që jo vetëm dinin të shihnin, por, krahas kësaj, pasi e vlerësonin çështjen përmes vështimit, e thellonin shikimin e tyre dhe kështu, e panë atë Diell të së Vërtetës që u lindi mbi kryet e tyre, u ndriçuan me Të, u ushqyen prej Tij me gllënjka dëlirësie dhe me Të mbërritën si lumturinë tokësore, ashtu edhe atë qiellore.

Miopia, shurdhëria, sikurse janë përjetuar thuajse në çdo shekull, mund të vërehen edhe në ditët tona. Për shembull, të gjendurit pranë atyre shpirtave të përkushtuar të epokës sonë, që, me një shpirt sakrificë prej sahabësh, rendin pas së drejtës e së vërtetës duke mos u ndalur së vrapuari në rrugën e njerëzimit, mund të ketë përparësi shumë të rëndësishme, sikurse mund të mbartë edhe dëme. Në Erzurum, për të shpjeguar një gjendje të tillë, përdorin shprehjen. “Viçi i shtëpisë nuk bëhet ka!” E pra, sipas këtij këndvështrimi, bukuritë që fillimisht lindin si një lastar, më pas në gjendje të rritur lëkundën e kthehen në një dru të lartë panje, mbeten gjithmonë të ndryra në atë shikim të parë si lastar; mbeten ashtu dhe duke thënë “Edhe ai është një prej nesh”, gjithmonë shihet me syrin e lastarit.

Ndjenja e konkurrencës dhe perdja që bie mbi sy

Kam mendimin se ata që, edhe pse kanë pasur mundësinë dhe rastin e njohjes nga afër, e shohin dhe e vlerësojnë çështjen me një sjellje të distancuar që nuk u ka hije aspak, e pra, ata që vlerësimet e tyre i bëjnë gjithmonë sipas kësaj, në njëfarë mënyre, janë veçse të verbër që nuk e shohin atë ç’kanë pranë. Sa mirë do të ishte sikur të ishte e mundur që këta njerëz të vinin një palë syze për të

parë nga afër dhe kështu, krahas shqisës së të parit, të mund të fitonin edhe shikimin. Mirëpo, fatkeqësisht, syze të tilla nuk ka. Prandaj edhe për ta ngritur këtë perde që zbret mbi sy, për t'i fshirë mendimet e gabuara që i bëhen pengesë shikimit dhe për t'i parë këto bukuri që janë shtrirë në të katër anët e botës, varet vetëm prej përdorimit të vullnetit nga ana e vetë njeriut dhe prej ndryshimit të këndvështrimit nga ana e tij.

Krahas miopisë, ka edhe të këqija të tjera, pre e të cilave mund të bien miqtë, si verbëria e të shkuarit keq me dikë, verbëria e smirës, verbëria e konkurrencës. Madje edhe ajo ambicie që, nëse interpretohet si pjesë e konkurrencës, bën pjesë në zonën e lejuar të fesë, mund të bëhet shkak për verbëri. Nëse ambicien do ta shohim me syrin e të gjendurit të individit në një atmosferë garimi bashkë me shokët e rrugës në të cilën ecën, me mendimin për të mos mbetur pas në çështjen e mirësive të dhuruara prej Zotit të Madhëruar, edhe ky mendim që, në zanafillë, duket si i patëkeq, nëse nuk bëhet kujdes për të mos i kapërcyer kufijtë, mund të kthehet në një gjendje problematike. Për këtë arsye, nxënësit e vërtetë të Kuranit, duke i lidhur mendimet e tyre me një mendim më të gjerë, duhet të thonë kështu: “Vëllezërit e mi, në këtë rrugë të bukur që kanë nisur, rendin drejt Xhenetit, drejt këndelljes dhe meditimit. Nga ana tjetër, për të mos u ndarë prej këtyre njerëzve kaq të mirë, edhe unë duhet të marr pjesë në veprimtaritë e tyre.” Përndryshe, mendime si “Të jem unë ai që do ta fitojë unë garën!”, “Ta këpus unë shiritin e finishit!”, në një shërbim të mirë e të kryer për hir të Zotit, janë mendime të planifikuara sipas cytjeve të shejtanit dhe në këtë aspekt, janë të mallkuara.

Në të njëjtën formë, nëse nuk bëhet kujdes, edhe ambicia, që gjendet në një kufi me smirën, mund të bjerë në një gjendje të mallkuar. Po, po. Nëse nuk ruhen masa dhe kufijtë në këtë çështje, atëherë njeriu, pa e vënë re aspak, në çast, nga ambicia mund të bjerë në smirë.

Edhe në ju ardh të gjer në fund të gjuhëve

Të gjithë këta faktorë i shkaktojnë njeriut verbëri të caktuara, të cilat bëjnë që sa e sa të vërteta të avullojnë e të shkojnë fare pa u vënë re. Nga ky këndvështrim, njeriu duhet ta shohë mjedisin e vet gjithmonë sipas standardeve vlerësuese të zemrës; ta shohë, dhe kudo që të ketë një pikë të vërtetë, ta pranojë atë me respekt. Ashtu që, edhe nëse një njeri që ia njihni të vërtetat, që ia dini fëmijërinë, madje që ju vjen gjer në fund të gjuhëve, zgjat dorën dhe ju arrin, kjo nuk duhet t'ju bëjë të verbër. Edhe në këtë gjendje, duhet të dini të shihni drejt dhe ato çka shihni të mund t'i vëreni në përputhje me cilësinë e së vërtetës.

Nëse kjo nuk arrihet të bëhet, atëherë duke nisur që nga profetët, që janë në pozitën e hënave e të diejve të qiellit të njerëzimit, që nga miqtë e të Vërtetit, si Abdulkadir Gejlani apo Imam Rabaniu, e deri te prijësi i bekuar e i nderuar, te farërat e mbjella prej tij dhe prej njerëzve të dëlirë e të sinqertë të Anadollit në të katër anët e botës, te lastarët e lëshuar prej tyre që kanë lulëzuar në këndet më të largëta, pemët e rritura prej tyre, për shkak të shkallëve të ndryshme të shumë të këqijave që na rrethojnë, mund të mos shihen dot. Zoti i Madhëruar, në një ajet të Kuranit Fisnik urdhëron e thotë: “Kushdo që është i verbër për të parë të vërtetat në këtë botë, edhe në jetën e përjetshme është i verbër.” [181] Në këtë mënyrë, Ai ka pohuar se ata që nuk i shohin të vërtetat e qarta në këtë botë, edhe në jetën tjetër do të trajtohen si të verbër. Ajo çka nënkuptohet këtu nuk është mbajtja e syve fizikë mbyllur. Ajeti në fjalë mbart një kuptim metaforik. Pra, sipas ajetit të

madhërishëm, njerëzit e sipërpërmendur, megjithëse i kanë sytë në ballë, nuk shohin. Madje edhe ata që nuk e pranojnë që në Kuranin e Shenjtë të gjenden kuptime të figurshme, në këtë ajet kanë qenë të detyruar ta pranojnë kuptimin metaforik.

Ndërsa në një tjetër ajet fisnik, tërhiqet vëmendja te verbëria shpirtërore në këtë mënyrë: “Ata kanë zemra, por me këto zemra nuk perceptojnë, kanë sy, por me to nuk shohin, kanë veshë, por me to nuk dëgjojnë.” [182] Siç shihet në këtë ajet të shenjtë thuhet se këta njerëz, edhe pse kanë zemër, janë të privuar prej perceptimit. Pra, këta nuk e kanë aftësinë që, me grepin në duar, mes shkaqeve dhe pasojave, të thurin e të nxjerrin në pah një dantellë. Po, po. Këta fatkeqë e kalojnë jetën e mendimit me krahë e fletë të thyera, duke jetuar brenda një pamundësie për të ndërtuar një rrjet të mendimit, me pak fjalë një analizë a sintezë.

Në një tjetër ajet të shenjtë, verbëria lidhet me zemrën dhe urdhërohet e thuhet kështu: “Po ja që tek ata nuk janë të verbër sytë, por zemrat që kanë në kraharorë.” [183] Do të thotë që ajo çka është vërtet e rëndësishme, është hapja e syrit të brendshëm. Po, po. Problemi i vërtetë nuk është shikimi, por mbajtja hapur e syrit të zemrës, sepse në qoftë i mbyllur ai sy, ahëre pak rëndësi ka që syri fizik shikon. Një njeri i tillë prapëseprapë nuk do të shohë dot saktë, nuk do të analizojë dot saktë, dhe nuk do të ndërtojë dot një sintezë të saktë. Po përse është i verbër syri i brendshëm? Kjo është një çështje që ka të bëjë me hollësitë e përmendura më sipër. Smira, urrejtja, mospërmbajtja, moskalibrimi i këndit të vështrimit, etj., janë faktorë që e çojnë njeriun në verbërinë e zemrës.

Ndjenja vlerësimi të kthyer në thëngjij

Në këtë pikë, dua të ndalem dhe të ndaj me ju disa ndjesi. Sado që nuk jam në gjendje t’i vlerësoj në nivelin e duhur dëlirësinë, sinjeritetin, besnikërinë dhe qëndrueshmërinë e shokëve, mund të them se përpiqem t’i shoh përpjekjet dhe mundimet që ata bëjnë. Nga njëra anë, ndihem i turpëruar që nuk mund të jem pranë dhe pas tyre në nivelin e lartësisë së tyre. Nga ana tjetër, mbushem me ndjenja të vlerësimit përkundrejt shërbimeve të bukura, për të cilat ata bëhen shkak, si dhe përpiqem që ato ndjenja t’i kthej në një pishtar a thëngjill e t’i mbaj të gjallë si një burim ngrohtësie. Sepse jam i mendimit që ndër këto bukuri, qoftë edhe më e vogla prej tyre duhet vlerësuar. Po, po. Nëse fuqia dhe vlera e mirësisë njihen, vlerësohen dhe respektohen, Zoti i Madhëruar e shton atë mirësi. Shikoni, për një çështje që Allahu (xh.xh.) ka urdhëruar e thënë “kjo është kështu”, nuk kërkohet betim. Por megjithatë, Allahu (xh.xh.) e ka shprehur këtë të vërtetë duke u betuar: “Nëse tregoheni mirënjohjes ndaj mirësive që ju mbërrijnë, qofshin këto fjalë, gjendje, vepra, mendime e përkujtime, ahëre betohem se Unë mirësinë time e shtoj edhe më.” [184] Ndërsa në vazhdim të ajetit të shenjtë, gjendet një paralajmërim që duhet ta drithërojë e ta bëjë të rrahë fuqishëm kraharorin e njeriut: “Por në u tregofshi mosmirënjohës, në i shpërfillshi mirësitë dhe në e lëshofshi veten në verbëri, atëherë ta dini se ndaj të verbërve ndëshkimi im është i ashpër.” [185]

Atëherë, si njerëz me zemra që besojnë, për të mos i përjetuar kurrë këto të liga, duhet të bëjmë gjithmonë kujdes, të qëndrojmë zgjuar dhe të ruajmë masën. Nëse sytë tanë hapen në sajë të dikujt përkundruall disa të vërtetave, atëherë është e nevojshme që t’i mbajmë gjithmonë sytë hapur kundrejt të vërtetave; dhe në dorën e kujtdo që të jetë vënë e vërteta, ndaj tij duhet të sillemi gjithmonë me vlerësim. Për shembull, nëse dikush ka ndikuar te pesë njerëz, një tjetër te pesëqind

njerëz, një tjetër te njëmijë e pesëqind njerëz, atëherë të gjithë këta duhet t'i vlerësojmë lart e t'i duartrokasim.

Së fundi, duhet të shtoj edhe këtë, se nëse sukseset dhe arritjet që juve ju ka dhuruar Zoti i Madhëruar prej mirësisë së Vet, disa njerëz nuk i kapërdijnë dot dhe e shfaqin pakënaqësinë e tyre me smirë, urrejtje, zili e madje në mënyrë shkatërruese, ju duhet të shtrëngoni dhëmbët e të duroni dhe të mos bini në gabimin e kundërpërgjigjes me të njëjtën monedhë.

Kundrejt një gjendjeje të tillë, për disa njerëz me karakter të dobët mund të vlejë ajeti i shenjtë që thotë: “Nëse do të ndëshkoni, atëherë ndëshkoni në atë masë me të cilën ju kanë trajtuar.” [186] Por vazhdimi i ajetit, duke nënkuptuar trajtimin në një nivel më të lartë, shpreh këtë horizont: “Nëse do të bëni durim, kjo, për durimtarët është më e mira punë.” [187] Sipas kësaj, në vend që të ecim në rrugën e trajtimit sipas të njëjtës masë e të njëjtit kuptim, është më mirë që të bëjmë durim e të themi: “Në ardhje prej Madhësisë së Tij ndëshkim a prej Mirësisë së tij shpërblim, që të dyja janë këndellje në shpirt.” Natyrisht që për sa u përmond, në mënyrë që të gjitha këto të zbatohen në çdo ngjarje e provim të jetës, duhet që shpirti të ushtrohet e të sprovohet dhe ato të kthehen në një thellësi të natyrës sonë.

[181] Isra, 17/72.

[182] Araf, 7/179.

[183] Haxh, 22/46.

[184] Ibrahim, 14/7.

[185] Ibrahim, 14/7.

[186] Nahl, 16/126.

[187] Nahl, 16/126.

Intelektuali dhe ringjallja



Pyetje: Cila është rëndësia e njerëzve intelektualë në ekzistencën dhe në ringjalljen e një shoqërie? Çfarë duhet bërë për përgatitjen e njerëzve në një nivel të tillë?

Përgjigje: Intelektual quajmë atë rrugëtar të së vërtetës, i cili, një çështje që merr në duar e hulumton në thellësi e me dashuri për dijen dhe për të vërtetën, që zotëron dije të gjera dhe që dijet e fituara është në gjendje t'i shprehë e t'i paraqesë me guxim qytetar. E pra, në këtë kuptim, zhvillimi i një klase intelektuale mbart një rëndësi jetike për ringjalljen e një kombi, ndaj edhe sado gjatë që të diskutohet për këtë, ia vlen. Por nuk duhet harruar asnjëherë se një çështje kaq e rëndësishme nuk është një punë aq e thjeshtë. Për shembull, në shoqërinë tonë, e cila ka përjetuar dëmtime shumë të rënda njëri pas tjetrit, madje në një shkallë shumë serioze, prej disa shekujsh, jo vetëm përgatitja e një kuadri intelektual të këtij niveli, por edhe reforma shoqërore për përgatitjen e njerëzve të zakonshëm që të jenë të çliruar në botën e tyre të ndjenjave e të mendimit nga devijimet dhe shformimet, është shumë i vështirë dhe ka nevojë për një kohë vërtet të gjatë. Nëse nuk fryn një erë e kundërt, nëse nuk përballemi me një kundërshtim shumë serioz, nëse dikush nuk ngrihet të trazojë të korrat, të shkelë bereqetin e ta shpërdorjë atë, qoftë edhe në këto kushte, realizimi i një reforme të tillë ndoshta mund të kërkojë të paktën pesëdhjetë vjet. Ndaj edhe kjo çështje, më së pari, duhet trajtuar dhe vlerësuar në mënyrë racionale. Natyrisht që me mirësi e bekime edhe më të mëdha prej Zotit të Madhëruar, gjithmonë është e mundshme që kombi ynë të përfitojë një institucion të tillë të inteligjencies edhe përtej asaj çka mund të pritët. Por ne, që jemi të ngarkuar me përgjegjësinë e ndjekjes së shkaqeve e të pasojave, duke e trajtuar çështjen në fjalë, para së gjithash, duhet ta vlerësojmë atë nga ky këndvështrim.

Pas një ndarjeje të gjatë

Disa e shohin prapambetjen tonë të nisë me periudhën e Tanzimatit. Mirëpo Tanzimati është vetëm emri i asaj periudhe, në të cilën edhe ne vetë e ndiem se ramë si në një gjendje nokauti. Në të vërtetë, stanjacioni dhe ngecja mendore mund të shkojë shumë më prapa në kohë. Për shembull, nëse do ta shohim në qasjen e Mësuesit të Nderuar, qysh në çlirimin e Stambollit, ndërsa nga njëra anë na hapeshin dyert e ngadhënjimit, nga ana tjetër duket sikur në jetën tonë, dyert e hapura ndaj mendimit dhe dijes mbylleshin. [188] Madje, ai, duke e çuar çështjen edhe më tutje në kohë, e lidh

historinë e nisjes së mbylljes së dyerve të dijës e të mendimit në jetën tonë qysh me shekullin e pestë të hixhrit. [189] Po, po. Nëse e shohim çështjen në një këndvështrim të përgjithshëm, duket sikur deri në shekullin e pestë, ne kemi vënë krejt pasurinë tonë si në fushën e shkencave pozitive si fizika, kimia, biologjia, mjekësia, si në dijet teologjike si interpretimi, hadithi, fikhu, metodologjia e fikhut etj.. Nëse na lejohet të shprehemi kështu, duket sikur sa vezë kishim mundësi e fuqi të bënim, i kemi lëshuar e zbrazur të gjitha në qymez. Ndërsa pas asaj kohe, jemi mjaftuar duke vlerësuar veprat e zgjedhura, të shkruara prej të vjetërve, veç duke u shtuar atyre shënime e komente. Dhe natyrisht që duke u marrë vetëm me këtë, i premë rrugën mendimit e gjykimit të thellë. Gjer më tash, nuk kemi pasur qendra kërkimore e laboratore tonat, të ngritura në vendin tonë, ndaj edhe analiza dhe hulumtime serioze për të kapërcyer këtë ngecje nuk ka qenë e mundur të bëheshin.

Ndërkohë që, qysh në kohën e abasidëve janë bërë punime për të vërtetuar rrumbullakësinë e rruzullit tokësor dhe në lidhje me këtë temë, dijet e ditëve tona kanë mbërritur në përfundime të përafërta me ta. Po kështu, në një kohë të hershme, në shekullin e katërt të hixhrit, shkencëtarët myslimanë janë shprehur se eklipset e diellit e të hënës janë periodike dhe në lidhje me këtë kanë paraqitur konstatimet më të drejta. [190] Mund t'i shtojmë edhe më shembujt. Sepse po t'i shohim këta shekuj për nga historia e shkencës, shihet se jo vetëm në fushën e astronomisë, por edhe në degë të dijës si matematika, mjekësia, kimia etj., janë arritur zhvillime të mëdha shkencore që do të shërbenin për të ndriçuar shekujt që do të pasonin.

E pra, pas kësaj periudhe të artë, ndodhën ato që ndodhën dhe duket sikur që nga shekulli i pestë e këtej, në këto veprimtari shkencore nisi një periudhë stanjacioni serioz. Medreseja, nga njëra anë nisi t'u mbyllte dyert shkencave pozitive dhe nga ana tjetër filloi të mbante qëndrim kundër horizontit të zemrës e të shpirtit. Në përfundim, teqeja dhe medreseja u shkëputën prej njëra-tjetrës, shkencat pozitive, dijet fetare dhe jeta e zemrës dhe e shpirtit u larguan nga njëra-tjetra dhe secila prej tyre u mënjanua. Ndërkohë që këto janë si tri anët e një njësie të vetme. Nëse i qasni të tria së bashku, dhjetë bukuri dalin në pah dhe nëse ato i zhvillonin në harmoni të plotë me njëra-tjetrën, mbërrini në njëqind bukuri.

Në pesë shekujt e parë të hixhrit, njerëzit e asaj kohe, të mbushur plot e për plot me dashuri për hulumtimin dhe për të vërtetën, me të vërtetë që e shtjelluan çështjen shtresë pas shtrese, duke e shpërfaqur atë në thellësitë e saj të ndryshme. Por më pas, dyert dalëngadalë u mbyllën dhe perdet u ulën. Paskëtaj, krahas botës metafizike e psikike dhe kundrejt ligjësisë natyrore, ndodhi një divorc përmes ndarjes së tri shkencave. Kuptimi i saj është që ato nuk do të ishin më kurrë bashkë. Por, nëse do ta shprehim çështjen përmes një shakaje, pas divorcit me mendimin sistematik, me dashurinë për të vërtetën dhe me pasionin për kërkim shkencor, për t'i arritur këto edhe njëherë do të duhej një tjetër martesë. Pasi i ndamë këto, duke qenë se u gjendëm në gjerdek me mendimet e huaja, edhe ky kusht u vu në vend. Prandaj, duke i qëndruar shakasë, mund të themi se tashmë, ka ardhur sërish stina e një gjerdeku të ri për mendjen dhe për zemrën.

Trualli për zhvillim intelektual

Ndërkohë, duhet pohuar edhe se, krahas këtyre konstatimeve, nuk duhet çuar nëpër mend që po i marrim lehtë edhe sa e sa përpjekje të mëdha që janë bërë në të shkuarën. Sepse ne dimë dhe

besojmë se etërit tanë, ndër shekuj, kanë qenë flamurtarë të Islamit dhe njëkohësisht kanë mbrojtur krenarinë, nderin dhe dinjitetin e tij. Me leje të Allahut, me këto gradë të arritura, kanë mundësinë të jenë së bashku nën flamurin e Zotërisë sonë, Profetit (s.a.s.). Por krahas vlerësimit që na takon të bëjmë për këto cilësi të bukura që ata kanë pasur, çështja duhet parë në një vështrim më të plotë dhe më tërësor. Pa dyshim që ne, duke qenë se nuk jemi kronikanë që i lexojmë ndodhitë duke u gjendur në brendi të ngjarjeve e duke i jetuar vetë ato dhe duke qenë se nuk i njohim plotësisht kushtet dhe rrethanat e kohës në të cilën ata njerëz kanë jetuar, ndoshta mund të arrijmë në disa gjykime të gabuara. Por krahas kësaj, nuk mund të rrimë, në fakt, pa ngritur disa pikëpyetje mbi disa çështje. Për shembull, nuk mund të mos ia bëjmë vetes këto pyetje: Përse vallë gjer në kohën e Abdylhamidit II nuk u ngritën institucione të tilla si një *“Mühendishane-i Hümayûn”* (Shkolla e Lartë e Inxhinierisë) apo një *“Tibbiye-i Şahane”* (Shkolla e Lartë e Mjekësisë)? Përse pati kaq vonesë për hapjen e këtyre institucioneve, që mbartin një rëndësi jetike në shoqëri? Krahas sukseseve tona në fusha të tjera, përse nuk funksionuan në të njëjtën masë laboratorët dhe qendrat tona kërkimore? Disa çështje që kanë të bëjnë me shkencat pozitive, pse nuk u trajtuan më herët? Pyetjet mund t’i shtoni edhe më. Por më këto pyetje, çështja thelbësore, tek e cila duam të tërheqim vëmendjen, është kjo: Pas një ngecjeje të gjatë që pësuam, rruga për të përgatitur një klasë elitare dhe intelektuale është shumë e ashpër dhe e vështirë. Por pavarësisht të gjitha këtyre rrethanave të vështira e negative, për rilindjen e kombit tonë, për ringritjen e përmendores së shpirtit tonë, kemi nevojë për njerëz që i dinë saktë ato çka janë të nevojshme të dihen, që ato çka i dinë saktë janë në gjendje t’i përçojnë me zë buçitës në mjediset e dhura, pra, që kur është e nevojshme oshëtijnë si retë dhe që kur oshëtijnë, zbrazin plot bereqet shirat e bekuara. Për shembull, një njeri që është i angazhuar në fushën e shkencave të fesë, duhet t’i njohë drejtimet themelore të shkencave islame si interpretimi, hadithi, jurisprudenca, retorika, metodologjia juridike... dhe atë që di, duhet të jetë në gjendje t’ua përcjellë me shumë lehtësi bashkëbiseduesve të vet. Së paku, duhet të zotërojë një informacion në nivel enciklopedik. Pra, një çështje me të cilën përballet, duhet të dijë se ku mund ta gjejë, duhet të mund të thotë: “Kjo çështje shprehej në këtë kontekst në akcil burim. Mbështetja, qëndrimi ishte ky.” Nëse do të duhej të paraqisnim një standard, për shembull, një njeri që merret me hadithin, së paku, në lidhje me një hadith që has, duhet të mund të thotë: “Mua ky hadith nuk më kujtohet ta kem parë në *Kutub-u Sitte*. Por mund ta kem parë në *Zeuid*”; dhe për këtë hadith që po trajton, duhet të jetë në gjendje të thotë nëse gjendet në *Mustedrekun* e Hakimit apo në *Sunenin* e Darakutniut apo në veprat e hartuara më vonë. Ja pra, për të përgatitur një klasë të tillë intelektualësh, edhe nëse mobilizohen mijëra njerëz, them se ia vlen.

Ndoshta kur unë ju shpjegoj këto gjëra, mendja mund t’ju shkojë të thoni: “Në ditët e sotme, duke qenë se teksti i haditheve instalohet në kompjuter, mjafton që të shtypësh një tastë dhe hadithi i kërkuar na shfaqet menjëherë para syve.” Por le ta pohojmë sakaq se kjo nuk është shkencë. Po, po. Të klikosh diku e të marrësh një çështje, ta printosh atë, pastaj çështjet e printuara t’i hedhësh në libra, pastaj ato libra t’ua paraqesësh jurive, në kuptimin e vërtetë, kjo nuk është shkencë. Puna është që të jesh në gjendje që temat e trajtuara të mund t’i zotërosh në thelbin e në frymën e tyre, në një nivel të tillë që të mund t’i shtjellosh sipas vlerësimit të të parëve tanë të mirë.

Nga ky këndvështrim, ata njerëz të rrallë, që u rritën në shekullin e tretë të hixhrit, unë gjithmonë i kam parë si njerëz të mrekullueshëm, që Zoti i Madhëruar i pati krijuar veçanërisht për Islam. Po, po. Njerëz si Imam Buhariu, Imam Muslimi, Ebu Davud Sixhistani, Imam Tirmidhiu, Imam Nesaiu, Ibni Maxhe, për mendimin tim, janë njerëz që Allahu i krijoi me një karakter të veçantë. Edhe nëse disa përpiqen ta lënë si pa u vënë re, në të vërtetë, edhe i nderuari Imam Tahavi nuk

mbetet pas këtyre. Madje përkufizimet dhe kriteret që ai paraqiti në çështjen e tekstit të hadithit janë një hap përpara edhe në krahasim me Imam Buhariun. Shkurt, duke parë veprat dhe punimet e kryera prej atyre personaliteteve të jashtëzakonshme, do të shihet se ata thuajse janë krijuar qëllimisht me cilësi të veçanta.

E pra, në një periudhë kur jetuan personalitete madhështore si Buhariu apo Ebu Hanifja, ndërsa njerëzit që ndiqnin mektebin e tyre ishin me mijëra, ndër ata mijëra përgatiteshin vetëm njëzet a tridhjetë, të cilët mund t'i quajmë intelektualë. Nga ky këndvështrim, nëse i viheni udhës për të arritur një synim kaq të lartë e madhështor, me sa më shumë njerëz që të niseni, aq më shumë përparësi do të keni në kthim dhe do të mund të lini pas një truall, prej të cilit kombi do të përfitojë po në ato masa.

Në çështjen e përgatitjes së një klase intelektuale dhe të një elite që do të mund të bëhet shkak për ringjalljen dhe zhvillimin e kombit tonë, një tjetër hollësi e rëndësishme që kam vënë re është edhe rishikimi po sipas këtij pikëvështrimi i programeve mësimore që nga shkollat fillore e të mesme dhe deri tek karriera akademike në universitete. Sepse me programin aktual mësimor, duke përjashtuar sukseset e arritura prej punimeve në nivel privat, duket shumë e vështirë që të përgatisim një klasë intelektuale. Po, po. Sado e hidhur që të jetë, duhet ta pohojmë se tani për tani, as gjimnazet tona nuk janë në gjendje të përgatisin njerëz që do të ishin kandidatë për të qenë pjesë e një elite intelektuale dhe as universitetet nuk kanë mundësi të përgatisin njerëz cilësorë e të kualifikuar në këtë drejtim. Me këto fjalë, nuk duam të themi se “me konceptin arsimor që kemi tani nuk mund të arrihet asnjë përfundim pozitiv dhe asnjë fryt.” Por duhet vënë re, se sukseset dhe arrijet e mundësuar, janë të lidhura më tepër me përpjekje të veçanta. Në këtë mënyrë, disa suksese e arritje të veçuara nuk ndihmojnë për të dhënë një mendim për arsimin dhe nivelin e tij në përgjithësi. Ju, në një shkollë, mund të zgjidhni disa nxënës të aftë, të punonin natë e ditë me ta dhe ata, në përfundim të kësaj pune, mund të arrijnë sa të marrin pjesë në olimpiadat e organizuara në vende të ndryshme të botës, të arrijnë suksese, duke fituar edhe medalje. Por kjo gjendje nuk tregon se në kuptim të përgjithshëm, niveli mësimor e kulturor në vendin tonë është i lartë. Nëse suksesi shtrihet e përhapet, atëherë mund të thoni se në vendin tuaj cilësia e arsimit është e lartë dhe me nivel. Pra, pa dashur ta zhvlerësojmë të tashmen, ka një të vërtetë të padiskutueshme se sot, në punën me arsimin, kemi nevojë për një reformë serioze në gjimnaze, në universitete dhe në qendrat kërkimore.

Në lidhe me këtë çështje, një tjetër hollësi tek e cila duhet ndalur është edhe që në punët kërkimore të kryera, të merren si bazë vlerat themelore të kombit tonë. Nëse ne do të vlerësojmë përfundimet e arritura prej të tjerëve përmes mendimesh natyraliste, pozitiviste dhe, në njëfarë mënyre, materialiste dhe pastaj do të mundohemi të arrijmë një përfundim sipas vlerave tona, duhet ta dimë se në këtë rrugë nuk është e mundur t'ia arrijmë qëllimit. Nga kjo pikëpamje, të gjitha rrugët, metodat dhe metodologjitë që bien në kundërshtim me vlerat tona themelore duhet t'i përballim me kritikën dhe t'i filtrojmë. Ndaj edhe, si shoqëri, sikurse ngritët vetë laboratorin, edhe hulumtimin nga fillimi gjer në fund do ta bëni vetë; duhet ta bëni vetë dhe ta shihni me sytë tuaj nga fillimi gjer në fund, ta testoni gjithçka me duart tuaja dhe në atë mënyrë duhet t'ia arrini qëllimit.

Mundi e përpjekjet nuk duhen lënë pa shpërblyer

Në lidhje me këtë temë, një tjetër hollësi është edhe kjo: kur mendoni të zhvilloni elita apo intelektualë, duhet të merrni parasysh e të respektoni edhe realitetin e shprehjes që përdoret shpesh në ditët tona: “Talenti kërkon vlerësim.” Është e vërtetë se shpirtat e përkushtuara e të kyçura në dëlirësi nuk veprojnë/nuk duhet të veprojnë për hir të vlerësimit. Ndoshta për ta, shprehja e sipërpërmendur duhet ndryshuar e duhet thënë: “Vlerësimi kërkon talent.” Pra, nëse ju tregoni talent e zotësi, bota mbarë në dashtë le t’ju vlerësojë e në dashtë le të mos ju vlerësojë, ju kurrsesi nuk bini në pritshmëri të tilla. Por duhet ditur se ajo që na përket neve, është që të sillemi me objektivitet dhe të mos e shpërfillim këtë realitet njerëzor.

Kur shihni punimet e bëra në Perëndim, vëreni se ata, me punë e përpjekje të mëdha, e kanë zbërthyer gjer në hollësi Librin e Universit. Për shembull, njëri thotë: “Unë kam plot njëzet vjet që jetoj në këtë pyll enkas për të bërë një kërkim shkencor mbi kobrat.” Më pas, në dokumentarin e transmetuar, shihin se meshkujt e kobrave e dinë se janë helmues dhe për të mos u kafshuar me njëri-tjetrin, thuajse bien në një marrëveshje. Nëse njëri i shtyp kryet tjetrit, atëherë ai vjen e bëhet sundimtari i zonës, ndërsa i munduri e braktis atë vend dhe shkon tjetërkund.

Një tjetër bën një hulumtim për akrepat. Kërkuesi kap sinjalet që ata përdorin për të komunikuar me njëri-tjetrin. Kur unë e pashë këtë për herë të parë, u çudita jashtëzakonisht shumë. Kërkuesi kishte zbuluar sinjalin e akrepave. Më pas, me një pajisje, kishte nisur ta transmetonte këtë sinjal dhe akrepat, të gjendur nën gurë të ndryshëm, drejtonin bishtat e reagonin duke kërcyer. Tani, pavarësisht masës në të cilën ky hulumtim ka gjetur pranim si e vërtetë shkencore, nuk është e mundur që të mos e vlerësosh këtë vepër për nga mundi dhe përpjekja e bërë.

E pra, këta njerëz kanë rendur nga njëzet vjet kush pas akrepit, kush pas kobrave, kush pas antilopave. Në Perëndim, një njeri që bën një kërkim të tillë, mendon kështu: “Nëse unë robtohem këtu njëzet vjet me këtë punë, ky shërbim nuk do të mbetet pa u vlerësuar. Do të shihet e do të njihet, do të vlerësohet me çmim dhe prej punimeve të mia do të jem edhe unë që do të kem përfitimin tim.” Dhe vërtet, ashtu ndodh. Shkencëtarët dhe kërkuesit shkencorë vlerësohen me një shpërblim që u mundëson që të jetojnë e ta mbyllin jetën më së miri. Ka edhe njerëz si Ajnshatjni apo Edisoni, të dhënë aq shumë pas kërkimit, që kanë vepruar me pasion e dëshirë në hulumtime e në shkencë. Këta janë njerëz që janë ndarë nga kjo botë pa e marrë vlerësimin dhe shpërblimin që meritonin për përpjekjet dhe punët e tyre. Madje edhe për njeriun që shpiku kinemanë, thuhet se në mbrëmjen gala të organizuar për të, vdiq prej urisë. Por në përgjithësi, mund të thuhet se punimet e kryera janë shpërblyer dhe nuk kanë mbetur pa u vlerësuar. Tani, përballë kësaj gjendjeje, se si duhet të rendim e ç’sakrifica duhet të bëjmë ne për hir të dashurisë për të vërtetën që na ka urdhëruar feja jonë, po ua lë mendimit dhe ndërgjegjes tuaj që ta gjykojnë vetë dhe po vijoj më tej.

Për këtë arsye, sipas mendimit tim, çdo mund, punë e përpjekje e treguar në garimin në fushën e shkencës duhet çmuar e vlerësuar dhe askush nuk duhet kthyer mbrapsht me duart bosh. Për shembull, në një olimpiadë të shkencës apo të gjuhës organizohet një konkurs. Atij që fiton çmimin e parë i jepni medalje ari, të dytit argjendi, të tretit bronzi, ndërsa të katërtit një vlerësim nderi për pjesëmarrjen e tij. Sipas meje, në vlerësim, duhen gjetur cilësime të tjera dhe gjithsecili duhet të vlerësohet për mundin dhe përpjekjen e tij. Unë vetë, kur më vijnë këta shokë që kanë marrë pjesë

me sukses në të tilla konkurse, mund të them se përpiqem e synoj t'i vlerësoj pa tjetër, me çfarë të kem në dorë. Po, po. Për arsye të sukseseve të arritura, pse të mos i përqafoj e kështu, t'i lumturoni këta njerëz sipas mundësive! Për shembull, përse të mos i stimulosh duke u thënë: "Shko në këtë universitet me emër në botë, regjistrohu. Po të duash bëj një studim pasuniversitar, po të duash një doktoraturë. Unë do të të siguroj bursën." Me vlerësime të tilla apo të ngjashme, ata duhet t'i vlerësoni vazhdimisht dhe kështu, duhet t'u përgatisnin terrenin që ata t'i shpërfaqin talentet e zotësitë e tyre. Kam bindjen se në përgatitjen e një klase elitare e intelektuale në nivelin e duhur, një ndër hollësitë që çalon në çerdhet e vatrat e arsimit e të edukimit është kjo. Për këtë arsye, duhen përpunuar dinamikat e vlerësimit, të shpërblimit e të nxitjes dhe kështu, kjo çështje, që është lënë pas dore prej kaq e kaq vitësh, duhet vënë në vend.

[188] Shih: Bediuzaman, Gjykimet f. 66 (Thelbi i së vërtetës, Hyrja e tetë).

[189] Shih: Bediuzaman, Gjykimet f. 66 (Thelbi i së vërtetës, Hyrja e tetë).

[190] Shih: Fuat Sezgin, Shkenca dhe teknika në Islam 1/15.

Moral profetik: Mospritmëria



Pyetje: Në ditët e sotme, kur sëmundje ngjitëse si të menduarit vetëm për këtë botë e për përfitime materiale janë kthyer në epidemi nëpër të gjitha shtresat e shoqërisë, si mund ta zbatojmë në jetën tonë disiplinën e mospritmërisë, që përbën edhe një moral profetik? Cilat janë hollësitë që duhen pasur parasysh në këtë kuadër?

Përgjigje: *Istigna*, (gj.shq., mospritmëria) do të thotë që, veç Allahut, njeriu të mos ia çelë duart në lutje kurrkujt, të mos i nxijë faqen vetes duke iu përgjyruar njerëzve; do të thotë që edhe në mbettë pa bukë e pa ujë, të mos u lutet krijesave për nevojat e tij dhe ta kalojë gjithmonë jetën në pasuri të shpirtit, me zemrën të ngopur e brenda kufijve të dëlirësisë. Mospritmëria është një rregull shumë i rëndësishëm i vokacionit profetik dhe një shprehje e përvetësimit të moralit hyjnor. Sepse Allahu (xh.xh.) është i Përrjetshëm e Absolut (*Samed*); gjithçka ka nevojë për Të, ndërsa Ai nuk ka nevojë për kurrgjë. Po, ai është Zotëruesi Absolut i çdo Pasurie (*Gajj-i ale'l-Ëtlak*), në liri absolute prej çdo nevoje (*Mosnevojitari Absolut*). [191]

Ndërsa kur vijmë te njeriu, shohim se ai, në të vërtetë, ka nevojë për disa gjëra. Për këtë arsye, besoj se në rastin e tij është më e drejtë që të përdoret shprehja “mospritmëri e kushtëzuar” apo “relative”. Kështu, zotërinjtë tanë, profetët e mëdhenj, që janë shkaku i krenarisë së botës njerëzore, duke këmbëngulur të jetojnë në liri relative prej nevojave, e shkuan kurdoherë jetën e tyre me frymën e mospritmërisë; gjithë ç’u duhej e kërkonin vetëm prej Allahut, ia qanin hallet vetëm Atij. Kundrejt zbatimit të detyrës së përcimit të mesazhit hyjnor, kundrejt shërbimeve e sakrificave të kryera, ata kurrsesi nuk binin në pritmëri e nuk kërkonin asnjëherë shpërblim.

Kurani Fisnik, në shumë raste, tërheq vëmendje tek kjo hollësi dhe me gojën e këtyre profetëve të mëdhenj, e shpall kështu këtë të vërtetë: “Unë, kundrejt detyrës së përcjelljes së lajmit, nuk kërkoj prej jush asgjë, vlerësimi e shpërblimi im i përkasin vetëm e vetëm Allahut, Zotit të botëve.” [192] Për shembull, në suren “Shuara”, ku përshkruhen në rend jeta e pazakontë, ndodhitë, misioni dhe posta e Nuhut, [193] e Hudit, [194] e Salihut, [195] e Lutit [196] dhe e Hazreti Shuajbit [197] (ala nebij'jina ue alejhimus'salatu ues'selam), çështja në fjalë shpjegohet në mënyrë të përsëritur me gjuhën e bekuar të këtyre profetëve të mëdhenj.

Nga ky këndvështrim, edhe trashëgimtarët e vërtetë të vokacionit profetik, pasuesit e çështjes së profetësisë, gjer në dhënien e frymës së fundit, duhet të veprojnë e të jetojnë gjithmonë me shpirt të mospritmërisë dhe kurrë nuk duhet të përkulen përballë tjetërkujt veç Allahut; nuk duhet të zgjasin dorën e të hyjnë në detyrime kundruall njerëzve. Sepse – mos e thënë Zoti! – nëse njeriu i shërbimit hyn në detyrime, mund të shtrëngohet që ta paguajë shumë shtrenjtë nderin që i është bërë. Për këtë arsye, ata që gjenden në shërbim të besimit e të Kuranit, duhet të përqafojnë një jetë të tërë rregullat e sjelljes me ekonomi dhe sipas bindjes së tyre të brendshme, nëse është e nevojshme të durojnë edhe urinë, qoftë edhe duke u mjaftuar me një vakt ushqim në ditë, por kurrsesi nuk duhet të hyjnë në borxh e në detyrim ndaj të tjerëve. Po, po. Ata duhet t’u qëndrojnë larg shtrirjes së dorës dhe lypjes prej gjithkujt, qoftë prej individëve, prej familjes apo prej të afërmeve. Sepse çdo shtrirje dore e lypje do të thotë një hap largim prej mirësisë e mëshirës së Allahut, do të thotë një humbje e bjerrje më tepër në brezninë e fitores.

Një shpirt i përkushtuar duhet të jetë gjithmonë i lirë e i pavarur

Këtu dua të ndalem pak dhe ta shtjelloj çështjen disi më gjerë: për shembull, njerëzit që mendojnë se ju mund të jeni të dobishëm për shoqërinë me diturinë, kulturën dhe pasionin tuaj, mund t’ju ftojnë në programe të ndryshme, mund të kenë dëshirë që t’ju shoqërojnë me makinat e tyre nga një vend në tjetrin ose mund t’ju ofrojnë diçka duke ju thënë: “Bli një biletë avioni me këtë, mund të përballosh shpenzimet e udhëtimit,” apo të tjera si këto. Mirëpo, nëse jeni në gjendje dhe i keni mundësitë, duhet të përpiqeni që transportin tuaj nga një vend në tjetër, për të marrë pjesë në programin ku po shkoni me dëshirën tuaj, t’i përballoni me mundësitë tuaja dhe duhet të përpiqeni që të mos i bëheni barrë askujt.

Në të kundërt, nëse kundrejt shërbimeve dhe veprimtarive të kryera hyhet në pritmëri materiale, atëherë kjo përbën cenim edhe të vokacionit profetik, edhe të frymës së përkushtimit. Një sjellje e tillë, gjithashtu, do të thotë që një shpirt i përkushtuar ta thyejë me duart e veta ndikimin e vet në shoqëri. Po, po. Nëse nuk vepron mbi bazë të disiplinës së mospritmërisë, ndoshta edhe në u gjendte në një pozitë nga e cila mund të përfitohet seriozisht, ai njeri, pa e vënë re fare, bie në varësi të tjetërkujt dhe me duart e veta ia lidh vetes duar e këmbë me zinxhirë.

Një njeri që rend me përkushtim në rrugën e shërbimit ndaj fesë, ndoshta mund të fitojë diçka me punën e me djersën e vet, herë duke shkruar, herë duke pikturuar, herë duke dhënë mësim, në mënyrë që të përmbushë nevojat e tij të domosdoshme. Por ai që thotë “po shërbej”, apo “unë jam një njeri që rend në rrugën e shërbimit fetar”, nëse me këtë mendon që të arrijë përfitime të caktuara, nëse përpiket të bëhet i pasur dhe aq më tepër nëse ka për qëllim të shfrytëzojë pozitën e vet për t’u siguruar privilegje njerëzve të vet dhe rrethit të të njohurve, kurrsesi nuk duhet të harrojë se këto përbëjnë sjellje që bien në kundërshtim të plotë me atë frymë të përkushtimit që mbështetet në dëlirësi, respekt e dinjitet. Nga ky këndvështrim, udhëtarët e së drejtës e të drejtësisë, asnjëherë nuk duhet të bien në nevojën e shlyerjes së detyrimeve të ardhura prej përluljes, zgjatjes së dorës dhe lypjes. Po, po. Ata që i shërbejnë fesë, duhet të jetojnë gjithmonë të përkushtuar ndaj vlerave universale dhe nuk duhet ta humbasin pavarësinë e tyre, por të jenë gjithmonë të lirë e të pavarur. Po ja që për një periudhë të caktuar, edhe unë, teksa mbaja vaazë e predikoja, teksa bëja detyrën për “emri bi’l-maruf ve nehji ani’l-munker” (“Urdhëroni për të mirë e ndalni prej së keqes), fatkeqësisht, merrja rrogë. Zoti ma faltë pakujdesinë! Është e vërtetë se fakihët (*gj. shq.* juristët)

kanë pranuar që nëse nuk mbetet kurrkush për të bërë detyrën e imamit, në mënyrë që kjo punë të mos braktiset, imamët të marrin pagë. [198] Por thelbësorja është që imami të prijë në lutje pa rrogë, që muezini të këndojë pa rrogë, që vaizi të ligjërojë pa rrogë. Po ç't'i bësh që isha fëmijë i një familjeje të varfër. Pa marrë rrogë, nuk dukej asnjë mundësi tjetër me të cilën do të mund të siguroja jetesën. Po ndoshta në ndonjë vend, duke thyer gurë në ndonjë gurore apo duke u marrë me hamallëk, mund të fitoja me djersë e më pas të predikoj nëpër ligjërata. Ndërsa rrogën që më jepnin mund t'ua ndaja të varfërve e nevojtarëve. Sa keq që nuk ndodhi kështu dhe më duhet ta pranoj se ky ka qenë gabimi im.

Rruga e ndikimit të përhershëm në zemra

Në krye të fjalës, përmendëm shprehjet e mospritmërisë absolute dhe asaj të kushtëzuar. Nëse mospritmërinë e profetëve të mëdhenj e quajmë mospritmëri e kushtëzuar, ata shpirtra të përkushtuara që i kanë lidhur zemrat e tyre me dashurinë për Kuranin, për nevojë të ndjekjes së atyre profetëve të mëdhenj, duhet të përpiqen me ç'të kenë në dorë që të gjenden në një formë të mospritmërisë së kushtëzuar. Siç u shpreh më parë, nëse u mjafton një vakt ushqim, duhet të mjaftohen me një vakt; nëse nuk kanë mundësi të pinë tri gota çaj në ditë, duhet të mjaftohen me një; duhet të jetojnë me dinjitet dhe kurrsesi nuk duhet ta cenojnë besueshmërinë e tyre shoqërore.

Të gjitha këto, pa dyshim që nuk bëhen për të rënë në sy të të tjerëve. Mirëpo pranimi i të vërtetave prej njerëzve lidhet edhe me besimin dhe mendimin e mirë që ata kanë për ju. Ashtu që njerëz me të cilët keni qenë pranë e pranë për dyzet vite duhet të mund të thonë: “Ne kemi tridhjet a dyzet vjet që i ndjekim këta. E kemi parë se asnjë prej këtyre s'ka marrë e s'ka mbledhur asgjë, as në bursë e as tjetërkund nuk ka aksione. Në këtë botë, nuk kanë kurrgjë. As nuk na ka ndodhur të shohim që këta të kenë privilegjuar e mbajtur me hatër ndonjë të afërmin e tyre. Është e qartë se këta njerëz janë kapur pas pasionit për kënaqësinë e Zotit dhe nuk kanë tjetër mendim e pritshmëri veç saj. Thuajse gjithçka që kanë, madje edhe vetveten, ia kanë dhënë Zotit të Madhëruar dhe me këtë kërkojnë të fitojnë Xhenetin.” [199] Edhe një herë po e theksoj, se një njeri që ia ka blatur shpirtin të Vërtetit natyrisht që nuk jeton dhe nuk duhet të jetojë një jetë të lidhur me të tilla thënie. Por një linjë jete e lidhur me të tillë disiplinë, pa dyshim që lë një ndikim shumë të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm në zemrat e njerëzve.

Një prej hollësive të rëndësishme që duhet ndjekur në çështjen e mospritmërisë është edhe mendësia, sipas së cilës, “meqë të tjerët nuk sillen me ndjeshmëri, atëherë edhe unë mund të sillem në mënyrë më elastike.” Ky koncept nuk do të thotë kurrgjë tjetër veçse të gënjesht veten. Sepse një mendësi e tillë nuk ka asnjë tjetër kuptim përveçse të bashkohesh në të keqe me të tjerët. Po kështu, në jetën e amshuar, kjo nuk i sjell njeriut asgjë të dobishme. [200] Ndaj edhe nuk mund të mendojmë: “Të tjerët nuk tregojnë kujdes në këtë çështje. Tani kjo punë është kthyer në një të keqe të përgjithshme, ndaj edhe ne, në njëfarë mase, le të përfitojmë e të gëzojmë mundësi më të mëdha.” Një këndvështrim i tillë i gabuar e tërheq njeriun zvarrë drejt shkatërrimit. Përkundrazi, çdo individ, duke parë mjedisin rreth vetes, duhet të mendojë: “Për të ruajtur qëndrueshmërinë e shokëve, për të ruajtur ndjeshmërinë e ndërjegjes dhe tendosjen e tyre metafizike në çështje të mospritmërisë, duhet të bëj çdo përpjekje që të kem në dorë dhe në këtë mënyrë, duhet të mundohem që t'i pengoj ata nga rënia pre e hijeshive të kësaj bote dhe nga shkatërrimi në përjetësi.” Veçanërisht ata që gjenden në pozitë e drejtimit e të administrimit, nga njëra anë duhet

të tregojnë një ndjeshmëri e përkujdesje shumë serioze duke u bërë shembull për ruajtjen e këtyre linjave, ndërsa nga ana tjetër duhet që këtë frymë ta përhapin te njerëzit e mjedisit të tyre, të përpiqen në vazhdimësi që t'i përmirësojnë ata dhe të mos krijojnë asnjë mundësi që në këtë çështje të krijohet ndonjë zbrazëti a dobësi.

Mospritmëria në çështje të pozitës e të ofiqeve

Nga ana tjetër, mospritmëria nuk është një çështje që ka lidhje vetëm me të ardhurat materiale. Edhe mendja, zgjuarsia, arsyeja dhe gjykimi i shëndoshë, sikurse arritjet e larta në drejtim e në administrim, përbëjnë cilësi të dhuruara si sprovë për njeriun. Pikërisht në çështje të pozitive dhe të ofiqeve materiale e shpirtërore që mund të fitohen në përunfdim të të tilla arritjeve, të emrit të madh dhe të gradave, të famës dhe të vlerësimeve, të lëvdatave dhe të komplimenteve, njeriu nuk duhet të bjerë në pritshmëri dhe duhet të sillt gjithmonë sipas frymës së mospritmërisë. Mësuesi i nderuar, në një rast, na sjell ndërmend se kundrejt pavarësisë që mbart rrezik pasi mund të na ngarkojë me përgjegjësi, duhet zgjedhur pasimi i një udhërrëfyesi. [201] Pra, le të ndodhë, le të na kalojnë të tjerët, le të jenë të tjerët imamë. Për shembull, ta zëmë se shkuam në mihrab dhe njerëzit nisën të rreshtohen nga pas për namaz. Pikërisht në atë çast, na zë syri dikë që do të kryejë detyrën e imanit. Atëherë duhet të dimë të tërhiqemi sakaq prapa dhe të mundësojmë që ai të dalë për të prirë si imam. Dhe sërish, ta zëmë se njëzet a tridhjet vite u shërbyem të vërtetës dhe drejtësisë në vende të ndryshme të botës. Pas kësaj, në rrjedhën e natyrshme të punës, na ngarkuan si amanet një detyrë, në të cilën njerëzit do të na kenë zili dhe do të na lëvdojnë. Pikërisht në këtë rast, duhet ta ndiejmë veten si mbi gjemba dhe duhet të mbartim shqetësimin: “Vallë, kur do të më thërrasin sërish që të kthehem! Të më thërrasin e të më shpëtojnë prej kësaj barre!” Po, po. Me qetësinë më të madhe, duhet të jemi në gjendje që njerëzve që u kemi hequr udhë për një kohë, t'u shkojmë pas e t'i ndjekim.

Nëse njeriu nuk mbart qëllime të tilla të pastra dhe nuk jeton në të tilla mendime, atëherë kjo do të thotë që në punën që ai kryen, trazohen dëshirat egoiste dhe si pasojë, ai nuk sillt me dëlirësi. Po, po. Nëse një njeri i shërbimit ndaj fesë mundohet e përpiqet që ta ruajë sikur të ishte e drejta e vet e përjetshme një pozitë që ia ka dhënë Zoti i Madhëruar, atëherë kjo flet për mungesë të sinqeritetit nga ana e tij. Dhe mes njerëzve të tillë, që u mungojnë pastërtia e sinqeriteti, mund të lindin gjithmonë sherre e zënka, ndërkohë që marrëdhënia mes nxënësve të Kuranit duhet të jetë ajo e dashurisë vëllazërore. [202] Moshë, kryet, njohuria, pozita nuk janë masë dhe standard thelbësor. Në synimet e në objektivat e kësaj bote, mund të gjenden shumë pozita e ofiqe. Por kur bëhet fjalë për vëllazërinë, atëherë të gjithë janë në të njëjtën vijë, si individë të rreshtuar pranë e pranë njëri-tjetrit. Ndaj edhe një individ që ia ka kushtuar veten shërbimit ndaj besimit dhe ndaj Kuranit, në cilëndo fushë qoftë, në cilëndo pozitë qoftë, gjithmonë duhet të jetë i gatshëm që të tërhiqet dy hapa pas. Në të kundërt, edhe mes njerëzve që kanë dalë e janë nisur për një rrugë të mirësishme, zënkat, përballjet e përplasjet që lindin si pasojë e ambicies dhe e egoizmit bëhen të pashmangshme. Në përfundim të kësaj, lindin mosmarrëveshjet e ndarjet, çka çon në ndërprerjen e ndihmës hyjnore. Zoti ynë na ruajtë të gjithëve prej të bërit shkaktarë të një fundi të tillë kaq të rëndë! Zoti e bëftë secilin prej nesh ndër robërit e vendosur e këmbëngulës në pastërti e dëlirësi të besimit!

- [191] Shih: Ihlas, 112/2.
- [192] Shuara, 26/109, 127, 145, 164, 180.
- [193] Shih: Shuara, 26/105-122.
- [194] Shih: Shuara, 26/123-140.
- [195] Shih: Shuara, 26/141-159.
- [196] Shih: Shuara, 26/160-175.
- [197] Shih: Shuara, 26/176-189.
- [198] Ibn Abidin, Hashije 1/562.
- [199] Shih: Teube, 9/111.
- [200] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 181 (Fjala e Katërmbëdhjetë, Përfundim).
- [201] Shih: Bediuzaman, Shkrepëtimat f. 192 (Shkrepëtima e njëzetë, Pika e parë).
- [202] Shih: Bediuzaman, Shkrepëtimat f. 208 (Shkrepëtima e njëzetënjëtë, Parimi i katërt).

Krenaria e dijes dhe egoizmi



Pyetje: Ç’do të thotë krenari e dijes? Si realizohet ruajtja e krenarisë së dijes?

Përgjigje: Për një besimtar, ruajtja e krenarisë së dijes është, pa dyshim, shumë e rëndësishme; por për një zemër që beson, ajo çka duhet të ruhet me përparësi është krenaria e fesë që mbart e përfshin edhe krenarinë e dijes. Se meqë, sipas shprehjes së Omerit të nderuar (r.a.), Allahu na ka nderuar ne nëpërmjet fesë, [203] edhe një njeri që beson duhet të sillet si besimtar, e për të qenë garantues i kësaj çështjeje gjatë një jete të tërë duhet të tregojë për të qenë garantues i kësaj çështjeje dhe kështu, një jetë të tërë, duhet të përpiqet gjithmonë që të ruajë nderin, vlerën, madhështinë dhe dinjitetin e fesë. Po, po. Një njeri që beson, në çdo gjendje që të jetë, ndenjtur a ngritur qoftë, i heshtur a në ligjërim qoftë, gjithmonë duhet të tregojë sjellje prej besimtari dhe të gjithë duhet ta shohin atë si një njeri të besës, tek i cili mund të kenë besim. Në të jetuarit e madhështisë së qenies njerëzore, Islamit, assesi nuk duhen bërë lëshime; përmes moralit dhe cilësive të mira, besimtari duhet të vendosë gjithmonë një nivel të lartë të përfaqësimit dhe kurrsesi nuk duhet t’i lërë hapësirë perceptimit dhe leximit të gabimeve të veta sikur këto të ishin të sakta. Siç shprehen interpretuesit e historisë profetike, edhe në kohën kur nuk i besonin Krenarisë së Njerëzimit (alejhis'salatu ues'selam), njeriu i parë tek i cili bashkëkohësit drejtoheshin kur u duhej të linin një amanet ishte prapëseprapë përfaqësuesi më i mirë në faqe të dheut i sigurisë dhe i besimit, Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.). [204]

Nga ky këndvështrim, një besimtar duhet të sillet gjithmonë si garantues i amanetit dhe kështu, nuk duhet t’u japë asnjë mundësi njerëzve që ta lëndojnë e ta cenojnë besimin që shohin të përfaqësuar tek ai. Ai duhet ta jetojë Islamit në përsosmërinë e ndjeshmërinë më të lartë dhe duhet të përpiqet me gjithë ç’të ketë në dorë që të mos lejojë rënien apo përdhosjen e tij. Njeriu, për nevojë të natyrës së vet, sapo të përjetojë një shkarje e rrëzim, menjëherë duhet të shkojë në rrugën e përmirësimit të tij përmes pendesës, largimit nga mëkatit dhe kthimit tek e mira; duhet të shkojë asaj rruge dhe të lutet porsia Zotëria ynë, Ademi (a.s.), dhe Nëna jonë, Havaja e nderuar, që thanë: “O Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetes sonë. Nëse nuk na mëshiron e nuk na i fal mangësitë, ahare do të jemi prej atyre që bien në humbje të qartë!” [205] Ose si zotëria ynë, Musai i nderuar, që iu drejtua Zotit të vet me fjalët: “O Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes, falmë mua!” [206] Ose si Zotëria ynë, Junus ibni Meta, që ia qau hallin e vet Zotit të Madhëruar me fjalët: “Nuk ka tjetër

hyjni veç Teje. Ti je i pastër prej çdo të mete. Vërtet, unë qeshë prej atyre që i bënë padrejtësi vetes së vet.” [207] Nëse vërehet me kujdes, në të gjitha këto lutje, lutësit, që kanë qenë ata profetë të mëdhenj, kanë përdorur fjalën “padrejtësi” dhe kanë kërkuar mbrojtje tek Allahu. Ndërsa padrejtësia (*dhulm*) është ndërrimi pa të drejtë i vendit të diçkaje dhe vënia e padrejtësisë në vend të saj. E pra, edhe profetët, pa dyshim, nga horizonti, ndjeshmëria dhe thellësia e tyre, gjithmonë kanë kërkuar mbrojtjen e Allahut me frikën e rënies në një gjendje të tillë. Për rrjedhojë, edhe ne, si njerëz që besojmë, duhet të përpiqemi të parët për të qenë përfaqësues të një ndjeshmërie të tillë. Dhe veçanërisht ata njerëz që bien në sy të parët, që populli i sheh në dritë të syrit, duhet të jenë edhe më të ndjeshëm për sa i përket kësaj çështjeje. Sepse siç thuhet në një fjalë të urtë turke, edhe në mos rëntë në sy tjetërkund, miza në çallmën e bardhë të imamit dallohet menjëherë. Nga ky këndvështrim, njerëzit që shërbejnë si udhërrëfyes e drejtues, qofshin prej të ditshmëve, qofshin prej popullit, së pari për mbrojtjen e madhështisë së fesë, së dyti për shkak të domethënies përfaqësuese që mbartin si shërbëtorë të fesë, duhet të tregojnë shumë më tepër kujdes në krahasim me të tjerët për të jetuar në një linjë me ndjeshmëri shumë të lartë.

Egoizmi nën maskën e “krenarisë së dijes”

Por në këtë pikë, duhet treguar kujdes në këtë hollësi: Nganjëherë, madhështia e fesë mund të shndërrohet edhe në egoizëm. Po, po. Nganjëherë, për shkak të dijes dhe të asaj çka ka fituar, njeriu fillon ta ndiejë e ta shohë veten me një sy tjetër dhe, me mendimin e mbrojtjes së krenarisë së fesë, mund të nisë t’i shohë të tjerët me nënçmim, duke u kthyer në një egoist që nuk ka vlerësim për askënd përveçse për veten e tij. Prandaj edhe këto dy çështje, që janë të ndryshme nga njëra-tjetra, nuk duhet t’i ngatërrojme. Për ta diskutuar pak më tej; një njeri, në mënyrë që në personin e tij të mos cenohen nderi e dinjiteti i dijes, bën përpjekje të jashtëzakonshme për të mos rënë në të keqe e në mëkat, tregon kujdes e ndjeshmëri shumë të lartë, nuk ia shtrin dorën kurrkujt, nuk i bëhet borxhli askujt. Mirëpo ndërkohë, pasi mëson shumë e përfiton dituri, i forcohet ndjenja e unit, atëherë kjo nuk është më krenari e dijes; më e shumta që mund të jetë, sipas gradës përkatëse, është egoizëm ose egocentrizëm. Një njeri i tillë, pa dyshim, ka nevojë për edukimin dhe për pastrimin e egos së vet. Dhe kjo, në njëfarë mënyre, është një çështje e lidhur me çlirimin e njeriut prej instinkteve shtazore, me braktisjen e materializmit dhe, nëpërmjet një mësuesi a udhërrëfyesi, me udhëtimin e tij në orbitën e zemrës e të shpirtit.

Ç’ishim e ç’u bëmë!

Duke hedhur një vështrim në kohën e tabiinëve dhe të tebei tabiinëve, edhe pse në atë kohë nuk haset ende ndonjë formë sistematike e sufizmit, e tasavufit apo e tarikatit, vërejmë se është bërë një jetë plot thellësi e zemrës dhe e shpirtit. Ndërsa në periudhat e mëpasme, njerëzit kanë përdorur sisteme të caktuara në rrugëtimin e tyre shpirtëror për afrimin tek Allahu. Në larminë e madhe të këtyre sistemeve kanë qenë përcaktues koniuktura dhe niveli i dijes në kohën përkatëse. Njerëz të mëdhenj si Imam Rabaniu, Izz ibni Abduselami, Fahrudin Raziu, Abdulkadër Gejlani, Ebu Hasan Shadiliu etj., duke marrë parasysh interpretimin e kohës dhe çështjet me të cilat përballëshin në epokën që jetonin, duke i qëndruar besnikë të përgjithshmes, për të mbushur fushat e mbetura të hapura, ngritën metoda e sisteme të ndryshme të interpretimit, të analizës e të gjykimit.

Por duke nisur që prej periudhave të mëvonshme, ngjau e ndodhi që medreseja, nga njëra anë mbajti qëndrim kundër frymës së teqesë që synonte edukimin e pastrimin e egos dhe rrugëtimin në jetën shpirtërore, ndërsa nga ana tjetër ua mbylli dyert edhe shkencave pozitive, në të cilat shqyrtohen e shtjellohen ligjësitë natyrore. Ndërkohë, Bediuzamani, në një rast që bën përshkrimin e Kuranit Fisnik, tërheq vëmendjen se Kurani është një përkthim i përjetësishëm i librit të kësaj gjithësie, një përkthyes i përjetshëm i gjuhëve të larmishme që mundëson leximin e veprave fizike si mrekulli të krijimit hyjnor. [208] Po, po. Zoti i Madhëruar, me vullnetin e Vet, ka shprehur në librin e gjithësisë synimet e tij hyjnore. Ndërsa Kurani i Shenjtë, përmes shprehjes të ardhura prej atributit të kelamit, i interpreton këto ligjësi fizike dhe shpjegon se ç'kuptim kanë ato. Në të vërtetë, nëse i shohim me një sy të kujdesshëm veprat e Mjeshtrit të Nderuar, vërejmë se këto të vërteta janë përmendur prej fillimit gjer në fund. Por sa keq që ne, siç shkulëm prej kraharorit të medresesë gjithçka që kishte të bënte me jetën shpirtërore të Islamit, edhe shkencat e lidhura me ligjësitë fizike i zbuam prej dere po në të njëjtën mënyrë. Në fakt, me këto qëndrime, në njëfarë mënyre, ne vulosëm ndëshkimin tonë. Për pasojë, kur ne këputëm prej njëra-tjetrës jetën shpirtërore, dijet fetare dhe shkencat pozitive, që në fakt përbëjnë tri anë të së njëjtës së vërtetë, atëherë të gjitha këto ngelën jetime. Në ato ditë, krahas kësaj gjendjeje të medresesë, fatkeqësisht, edhe teqetë nuk ishin të ndryshme prej kësaj. Edhe ato jetonin një kurbet të tyrin. Edhe xhamia ishte e dënuar, gjithashtu, me një kurbet të ndryshëm, sipas llojit të vet. Në përfundim të kësaj ndarjeje që zgjati me shekuj, këto kurbe të u kthyen në kurbetin e një kombi. Po, po. Një komb i tërë, i gjithi së bashku, jetonte në brendësi të një kurbeti. Që sot e tutje, të gjithë këto kurbe të kemi jetuar si një realitet, nuk mund të bëjmë sikur nuk i shohim.

Ithtarët e dijes që ecin me këmbët e zemrës

Po hyj sërish në këtë temë, në të cilën jemi ndalur edhe më herët me raste të ndryshme, pasi dëshiroj të tërheq vëmendjen te kjo hollësi: nëse njerëzit që merren me dijen nuk kalojnë nëpër një operacion të edukimit të egos, të pastrimit të shpirtit, të dëlirësimit të zemrës, atëherë qëllimi, thelbi dhe fryma e dijes nuk mund të konceptohet prej tyre dhe ata nuk mund të arrijnë në rezultatin e pritur. Përkundrazi, ata, me shtimin e informacioneve, teksa përpiqen të shprehën e të shpjegojnë, në zërin e tyre, në fjalët e tyre, në theksimet e madje në thirrjet e në britmat e tyre, mendojnë vetëm që të vënë në dukje veten, në këto e sipër pushtohen prej egos e ambicies dhe nguten në llogari me synimin e mendimin për të tregtuar vetveten.

Sikurse në shoqërinë tonë ekzistojnë probleme të tilla, edhe në botën islame, në përgjithësi, janë përjetuar të njëjtat shqetësime. Mendoni që një dijetar me shumë vlera, që ka dalë në periudhat e fundit, si Said Havva, pasi shkroi shumë vepra të vyera, shkroi edhe një vepër në lidhje me jetën shpirtërore të Islamit. Në thelb, në këtë vepër, ai shpjegoi misticizmin islam dhe sufizmin. Mirëpo për shkak të shqetësimeve të ndryshme, nuk përmendi emrin *tasavvuf* apo diçka të ngjashme në veprën e tij. Sepse ka mundësi të ketë menduar që nëse përdorte këtë emër, mund të përballej me zemërimin e disave. Nisur nga ky shembull dhe nga të tjerë të ngjashëm, mund të themi me siguri se në të gjithë botën islame ekzistojnë të njëjtat shqetësime dhe të njëjtat probleme. Dhe kjo sjell si pasojë që çështjet në fjalë të shihen, në njëfarë kuptimi, me syrin e dhahirive dhe të harixhive. Në këto rrethana, lind një zbrazëti për shkak se çështjet nuk mund të shihen me një vështrim konik dhe nuk mund të analizohen e shqyrtohen me një shikim tërësor. Gjithsecili, duke e parë fushën e vet si të mjaftueshme për gjithçka, i lë pasdore aspektet dhe këndvështrimet e ndryshme të

çështjeve. Për këtë shkak, Islami, si një fe që na është lënë amanet e plotë dhe e përsosur, zhvishet njëfarësoj nga plotësia e nga përsosuria. Ndërkohë që Zoti i Madhëruar, në ajetin e shenjtë, urdhëron e i thotë Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (s.a.s.): “E pra, sot përsosa fenë tuaj dhe plotësova mirësinë Time ndaj jush. Pëlqimin Tim ndaj jush e lidha me Islamin.” [209] Në këtë mënyrë, Zoti i Gjithëfuqishëm shprehet se kënaqësinë e Vet e ka lidhur me plotësinë e me përsosjen.

Ndërsa ne, prej shekujsh, nga njëra anë u kemi kthyer shpinën dijeve empirike, ndërsa nga ana tjetër kemi mbajtur qëndrim kundër jetës së shpirtit e të zemrës. Nëse e pranojmë këtë realitet dhe nuk gjendemi në përpjekje kundër tij, atëherë kurrë nuk i zgjidhim dot problemet tona. Veç kësaj, duhet t’i drejtohem Zotit të Madhëruar dhe t’i lutemi e t’i përgjerohem me një përqendrim shumë serioz, që në këtë detyrë të lënë pasdore prej shekujsh, qoftë edhe për një çast të vetëm, të mos na lërë ballë për ballë me egon tonë, por ta mbështesë e ta përforcojë vullnetin tonë me hirin e mirësinë e Tij. Sepse kjo përgjegjësi është vërtetë një barrë shumë e rëndë. Duke marrë si bazë grupin apo bashkësinë brenda së cilës ndodhemi, do të ishte mungesë respekti që të ngrinim ndonjë pretendim në lidhje me këtë çështje. Përkundrazi, nisur nga rrethanat ekzistuese, të gjitha shërbimet e bëra në këtë drejtim duhet t’i duartrokasim e t’i vlerësojmë, duhet ta nxisim edhe më entuziazmin e njerëzve, në emër të zgjidhjes së kësaj çështjeje të madhe e të lënë të vdekur prej kaq shumë kohësh, të përmendim emrin e Zotit duke thënë bismil’lah e të përpiqemi të gjithë bashkë, sup më sup, për ta vënë në vend kazanë e kësaj pune të lënë pa kryer prej shekujsh. E ndërsa e bëjmë këtë, nuk duhet të lëmë pas dore asnjë fushë, duhet të mbajmë vazhdimisht në punë mekanizmat e pastrimit të egos, të edukimit të shpirtit, të dëlirësimit të zemrës dhe kështu, duhet t’i marrim në mbrojtje të gjithë ata kërkues të dijes që, teksa flasin për madhësinë e dijes, rrezikojnë të bien në egoizëm e mendjemadhësi.

[203] Ibn Ebi Shejbe, El-Musannef 7/10, 93; El-Hakim, El-Mustedrek 1/130.

[204] Buhari, Megazi 61; Muslim, Zekat 143.

[205] Araf, 7/23.

[206] Kasas, 28/16.

[207] Enbija, 21/87.

[208] Bediuzaman, Fjalër f. 392 (Fjala e Njëzetepestë, Hyrje); Shenjat e mrekullisë f. 7; Mesneva e Dritës f. 213 (Vala e Katërbëdhjetë, Pikla e dytë).

[209] Maide, 5/3.

Jeta fetare në kurthin e formalizmit, ose myslimanizmi kulturor



Pyetje: Është shprehur pohimi se një ndër rreziqet më të mëdha me të cilat mund të përballet njeriu në botën e besimit e të dijës është kufizimi në informacionet teorike dhe trajtimi i veprave dhe i adhurimeve në formën e një kulture. Cilat janë hollësitë që duhen pasur kujdes për t'u mbrojtur prej një rreziku e fatkeqësie të tillë?

Përgjigje: Një njeri, qoftë në hollësitë e nevojshme për t'u besuar, qoftë në përkushtimin që ka të bëjë me vënien në jetë të atyre hollësive, fillimisht mund ta ketë të nevojshme që të ketë njohuri teorike. Në fund të fundit, informacioni i një fillestari, në përgjithësi, nuk i kapërcen njohuritë teorike. Dhe kjo nuk është një çështje për t'u marrë lehtë. Por nëse ai informacioni teorik nuk mbështetet e nuk vendoset fuqishëm mbi argumente e themele të forta të mendimit, të logjikës, të arsyes e të përpjekjeve, nëse ato hollësi tek të cilat besohet nuk përvetësohen gjer në njësim me ndërgjegjen, atëherë njeriu mbetet gjithmonë brenda gjerdheve të njohurisë teorike, e kalon gjithë jetën në imitim dhe për këtë arsye, nuk e ndien kurrë plotësisht, në gjithë gjerësinë e thellësinë e vet, të qenët mysliman, nuk e përkap dhe nuk e jeton dot atë.

Shumë prej këtyre njerëzve që nuk janë çliruar prej imitimit dhe nuk e kanë mbërritur pjekurinë e besimit kritik, për arsye të rritjes brenda kufijve të një xhamie apo të një bashkësie njerëzish besimtarë, kanë mundur të hyjnë nën hijen e një arritjeje siç është të qenët mysliman. Nga ky këndvështrim, nëse do të mund të bënim një hamendje gjer në të pamundurën, këta njerëz, nëse do të rriteshin në mjedisin e një kishe apo të një sinagoge, ka mundësi që të bëheshin të krishterë ose judenj. Ose, sipas vendit ku do të rriteshin, ka të ngjarë ta shkonin jetën si brahmanistë, shintoistë, budistë apo sionistë.

Arsyeja më e rëndësishme e një tabloje të tillë pikëlluese është lënia pasdore e anës praktike të Islamit. Nëse lihen pas dore veprat dhe praktika, atëherë besimi tek Allahu, e vërteta e Qenies Hyjnore, që janë baza kryesore e parimeve themelore të besimit, – nëse mund të shprehemi kështu – nuk janë njohur në përshtatje me karakterin e së Vërtetës. (Kur përdor këtë shprehje, nuk lë pasdore që të them “nëse mund të shprehemi kështu”, sepse Qenia Hyjnore është e lirë dhe e dliurë prej tipareve sasiore e cilësore në mënyrën që ne i dimë e i kuptojmë. Po ja që, për arsye se nuk

dimë tjetër fjalë për të përdorur dhe për shkak të kufizimit të shprehjeve, detyrohemi të përdorim shprehje të tilla të mangëta.)

Sikurse kemi mangësi e kufizime në konceptimin e Qenies Hyjnore, edhe në të kuptuarit e profetëve, të engjëjve, të Ditës së Fundit e të Gjyqit të Fundit, kemi mangësi e kufizime serioze. Kështu, në ditët e sotme jemi dëshmitarë të disa vlerësimeve që nuk mund të shpjegohen assesi me besimin e me Islamin, si për shembull mospranimi i kaderit. Madje disa, në fushën teologjike, nxjerrin disa risi, që kur një njeri has në to e i dëgjon, habitet e shastiset aq sa të thotë: “Edhe kaq jo!”

Feja i duhet ngarkuar natyrës së njeriut me përkushtim

Për këtë arsye, le ta shprehim edhe një herë se duke depërtuar në thellësi të çështjeve të lidhura me besimin, mbështetja e tyre mbi një themel të sigurt dhe më pas vijueshmëria dhe këmbëngulja në to janë të lidhura me përkushtimin. Po, po. Shndërrimi i teorikes në njëfarë mënyre në realitet, siç është shprehur Kanti në “Kritikën e arsyes së kulluar” – është i mundur përmes veprës. Për ta shprehur ndryshe, mbërritja në të vërtetën e çështjeve të besuara dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre është i realizueshëm nëpërmjet veprës. Nuk duhet harruar, se nëse njeriu i derdh në vepra çështjet në të cilat beson teorikisht dhe bën përpjekje për t’u thelluar në ato çështje, atëherë edhe Allahu (xh.xh.) i krijon atij njeriu mundësinë që të ecë në shtigje të sigurta dhe e bekon duke i hapur rrugët e depërtimit drejt thellësisë. Përndryshe, nëse njeriu mbetet i kufizuar vetëm në planin teorik dhe nëse nuk e bën përpjekje për të dalë në planin praktik, që është ftuesi më i madh për në mirësinë hyjnore, pra, nëse nuk e kurorëzon fenë e tij me kurorën e përkushtimit, atëherë ai është i dënues të mbetet gjithmonë i cekët. Kjo do të thotë, gjithashtu, që një njeri i tillë në çështjen e njohjes së Allahut, gjendet në një pikë në të cilën mund të gënjejhet e të mashtrohet.

Sikur të kishte qenë e mundur që në shtëpitë tona, siç u përshtatim foshnjave tona ushqimin sipas muajve, javëve, madje edhe sipas ditëve, të kishim mundësitë e aftësitë që t’u përgatisnim atyre edhe dozën e njohurive që u duhen dhënë brezave në drejtim të dijeve e të njohjes! Sepse për prindërit është një detyrë e përgjegjësi absolute që t’u japin fëmijëve njohuri të mjaftueshme në lidhje me besimin sipas moshës përkatëse. Por duhet të pranojmë realitetin se, fatkeqësisht, në një shumicë të madhe, në shtëpitë tona mungon një mendësi e tillë. Përrjashtimet nuk e prishin rregullën. Po, po. Në shoqërinë tonë, në shumicën e rasteve, prindërit nuk janë të pajisur me pjekurinë dhe aftësinë që t’i drejtohen mendjes së çdo niveli.

Për më tepër, edhe nëse prindërit do të angazhoheshin në shtëpi e në vatrën familjare me edukimin e fëmijëve në nivelin e duhur, vetëm kjo nuk është e mjaftueshme për një dije e besim të plotë. Sepse nëse oksigjenin që fëmija merr në shtëpi dikush ia kthen rrugëve në dioksid karboni, edukimi që ju përpiqeni t’i jepni në familje do të ketë një ndikim në një masë të caktuar dhe ndoshta me kalimin e kohës ai ndikim do të fshihet e do të zhduket. Nga ky këndvështrim, është e nevojshme që edhe rruga të arrijë një atmosferë besimi e sigurie. Krahas rrugës, edhe shkolla duhet të jetë një institucion mbrojtës i njohurive teorike dhe njëkohësisht, sipas moshës dhe rrethanave, të mund t’i shtojë ato njohuri duke i ndarë e zhveshur sendet e ngjarjet. Nëse shkolla nuk ka një qëllim e pikësynim të tillë, nëse nuk ka një program sipas atij qëllimi e pikësynimi, atëherë ato çka fëmija fiton në shtëpi, edhe në mos paçin shkrirë në rrugë, shkrijnë e zhduken në shkollë.

Ndër këto institucione që i përkasin shoqërisë, ajo që mbetet është faltorja. Nëse çështjet e fesë atje gjejnë zbatim brenda një formati, formaliteti folklorik, pra, nëse nuk ka një pasion e emocion, nëse, për shembull, teksa imami ligjëron e këshillon në ligjëratë, nuk përjetohen drithërima, nuk ka rrëqethje, nëse fjalët nuk i shoqërojnë lot që dalin prej zemre e që, pavarësisht përpjekjeve, nuk vihen dot nën kontroll, atëherë kjo do të thotë se ato që vihen në zbatim aty mund të kthehen në një veprimtari veçse formale. Në këtë pikë, më lejoni të sqaroj diçka: prej këtyre që po them, nuk duhet çuar nëpër mend se këto vepra të zhveshura prej ndjenjës e prej emocionit, prej dashurisë e pasionit, nuk shprehin asgjë dhe se ata që i kryejnë këto vepra janë krejt në humbje. Në këtu po ndalemi në atë se si kjo njohuri teorike mund të thellohet në njohuri praktike, se si mund të arrijë një pjekuri me rritjen e me moshën, se si mund ta mbartë njeriun njohja në horizontin e dijes dhe kështu, si mund të kthehet e gjithë kjo në një kulturë të zemrës. Dhe kultura e zemrës është diçka e ndryshme nga doket, zakonet e kultura e trashëguar prej të parëve tanë, siç e përjetojmë nëpër dasma e nëpër organizime të tjera.

Po. Kur njohuria kalon nëpër shkallët njohje nëpërmjet dëgjimit, njohje empirike dhe njohje e provuar dhe teksa kalon nëpër këto shkallë, në cilëndo pikë që të ndalet, nëse aty ndihet zëri “ *La ilahe il'lall'illah*”, këtë nivel ne e quajmë njohje apo mjeshtëri. Një dashuri e tillë për dijen jep rezultate. Edhe Bediuzamani, duke bërë shenjë tek kjo çështje, tërheq vëmendjen tek kjo renditje: “Ta dish se, pa dyshim, pikësynimi më i madh i krijesave dhe përfundimi më i lartë i natyrshmërisë është besimi në Allahun. E shkalla më e lartë e humanizmit dhe pozita më madhështore e personalitetit është njohja e Allahut, e gjendur brenda besimit në Allahun. Lumturia më e shkëlqyer dhe bekimi më i ëmbël për xhindin dhe për njeriun është dashuria për Allahun, e cila fshihet brenda njohjes së Tij.” [\[220\]](#)

Kështu, kjo çështje, që të parët tanë të mirë, e shihnin si kulturë të njohjes e të ndërgjegjjes, fatkeqësisht, në ditë tona u është lënë si amanet disa formateve të caktuara. Për shembull, nëse në një natë të mirë të lindjes së Krenarisë së Njerëzimit, njerëzit këndojnë mevlud në tonalitete të ndryshme, kjo përbën një praktikë të bukur. Por në një natë të tillë, thelbësore është që marrëdhënia me Shpirtin e Kreut të Krijimit, Ahmedit të Lëvduar, të Zgjedhurit Muhamed (s.a.s.), të shpërfaqet në një gjallëri të caktuar, që të gjithëve t’u lotojnë sytë e t’u rrahin zemrat, sa në kraharorët e gjithsecilit të ndizet e të mbretërojë një zjarr dashurie të dëlirë. Ashtu që në një program të tillë, tek të gjithë të zgjohet ndjenja për të shpëtuar një orë e më parë nga kjo botë e vjetër, për t’u ulur pranë e pranë në sofrën qiellore me Zotërinë e Zotërinjve, për të qenë ballë për ballë me Të. Nëse në mevludin e kënduar nuk zgjohet një ndjenjë e tillë, nëse nuk gjendet brenda tij një frymë e një shpirt i tillë, atëherë – sipas shprehjes së të ndjerit Nurettin Topçu – vetëm sa i bëhet temena gurmazit, që do të thotë se çështja trajtohet thjesht si një veçanti kulturore. Prej këtyre fjalëve që po them, të mos mendohet se jam kundër mevludit apo natës së mirë të mevludit. Unë dua vetëm të shprehem kundër mungesës së dashurisë, të emocionit, të ndjenjës, të pasionit.

Në fillim u mashtruar...

Së paku të mos mashtrohem në fund!

Po, po. Fjala është për një rrezik të tillë, që ajo njohuri teorike në fillim të punës, në vend që të na shërbejë si shkallë për të arritur te një bekim e mirësi, të na kthehet në një të keqe e të na lidhet si zinxhir, të na kapë e të na shtjerë në dorë dhe ne të ngushëllohem me këto formate të zbrazura e

të thata. Duke parë tablonë aktuale, mund të thuhet se krahas me njerëzit që e jetojnë Islamin me pastërti, që thellohen në dëgjimin e gjërave që duhen dëgjuar, që gjithmonë gufojnë e gurgullojnë porsì gurra pasioni e dashurie, shumë prej nesh jemi porsì robër e pengje të asaj njohjeje teorike të fillimit. Fakti që, pavarësisht moshës sonë të thyer dhe përvetësimit të aq shumë njohurive teorike, ne ngushëllohem ende me forma e formate të ndryshme, a nuk është një tregues i qartë i kësaj? Shikoni, copëza kohe të bekuara si netët e Regaibit, të Beraetit, të Kadrit, të Mevludit, që, në thelb, janë afruese kah Allahu dhe përbëjnë nganjë rast të artë për ta ndier veten sikur të kemi ardhur rishtazi në botë. Por ne, në më të shumtën e rasteve, duke biseduar për cilësinë e të recituarit e të kënduarit në mekamat përkatëse, mjaftohemi vetëm me ngushëllimin e të kaluarit të një nate të këndshme. Ndërkohë që në këto copëza të bekuara kohe, nëse në marrëdhënien me Allahun dhe në nënshtrimin ndaj Tij nuk arrin në një horizont njerëzor më të thellë se çdo thellësi, atëherë njeriu vetëm sa vetëmashtrohet.

Të mashtrohesh në fillim është një gjë, e të mashtrohesh në fund është tjetër gjë. Thelbi i çështjes është që, siç shprehet i Përndëruari Imam Rabani, duke shkruar përtej e përtej e përtej, të vijojmë paprerë përpara me mendimin e pamjaftueshmërisë, dhe duke thënë, "*A s'ka edhe më, a s'ka edhe më, a s'ka edhe më?*..."", të ndizemi e të trazohemi prej një pasioni e dashurie të zjarrtë. E pra, nëse nuk kapet një nivel i këtij lloji, atëherë është tejet e vështirë të flitet për vazhdimësi e këmbëngulje. Natyrisht, nuk kemi të drejtë që, duke thënë se "gjithçka rrjedh në zbrazëti" e shkon kot, të thyejmë forcën shpirtërore të kurrkujt. Sepse mëshira e Allahut është shumë e gjerë. Ai ka premtuar se madje edhe ata që vetëm sa kanë thënë "*La ilahe il'lallah Muhamedun Resulullah*" do t'i çojë në Parajsë. [221] Por kjo është një tjetër çështje; ajo çka është e nevojshme të bëhet, është e drejtë e Tij, ndërsa detyra jonë, që të mos harrojmë dhe kështu, të mos biem në mungesë respekti ndaj Tij, është një tjetër çështje.

Kjo panoramë që na paraqitet, tregon se të gjithë ne, në një masë të caktuar, kemi nevojë për riaftësim. Tabloja e Krenarisë Njerëzore, në një hadith, urdhëron e thotë: "Ripërtërijeni besimin tuaj!" Sahabët e nderuar e pyetën: "Si ta ripërtërijmë besimin tonë?" Ai urdhëroi e tha: "Thuajeni shpesh fjalën La ilahe il'lallah!" [222]

Po ashtu, besimin tonë mund ta ripërtërijmë me përsëritjen e këtyre të vërtetave që janë shprehje e të njëjtit kuptim:

Nuk ka tjetër të Synueshëm (Maksud) e tjetër të kërkuar (matlub)."

Nuk ka tjetër të Dashur (mahbub) veç Allahut" "Nuk ka tjetër të Dashur (mahbub) veç Allahut."

Nga ana tjetër, Kurani Fisnik urdhëron e thotë "O ju që besuat, ripërtërijeni besimin tuaj": [223] Këtu, Zoti i Madhëruar, thotë duke iu drejtuar besimtarëve: "O ju që besuat!" Siç shihet, shprehja është përdorur në kohën e shkruar. Dhe te foljet, ripërtëritja është thelbësore. Nga ky këndvështrim, këtë thirrje drejtuar besimtarëve duhet ta kuptojmë kështu: "O ju njerëz që besoni duke përtërirë besimin tuaj!" Por krahas kësaj, Zoti i Madhëruar vijon sërish me dhe urdhëron e thotë: "Sërish, besoni!". Domethënë, duhet që njeriu ta kontrollojë vazhdimisht besimin e vet, të kërkojë në vazhdimësi nga vetja në lidhje me dijen dhe me dashurinë.

Tani, për mendimin tim, besimtarit nuk i shkon e nuk i ka hije që, edhe pse itinerari i rrugës kërkon diçka, ai të gjejë ngushëllim në të tjera gjëra dhe kështu, të bjerë kësodore në apati e në inerci. Ndërkohë, Allahu (xh.xh.) na ka krijuar të gjallë dhe na ka pajisur me aftësi e mundësi për të ruajtur gjithmonë gjallërinë tonë. Ndaj edhe ne, në mirënjohje ndaj të gjitha këtyre mirësive, duhet të mbetemi gjithnjë të gjallë, të bëjmë përpjekje serioze për të ruajtur gjallërinë dhe t'i robërohem Zotit tonë përherë me një shpirt të dëlirë e fisnik.

^[220] Bediuzaman, Letrat f. 253-254. (Letra e Njëzetë, Hyrje).

^[221] Shih: Buhari, Xhenaiz 1, Bed'u'l-halk 6, Libas 24; Muslim, Iman 153.

^[222] Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 2/359; Abd ibn Humejd, El-Musned f. 417.

^[223] Nisa, 4/136.

Sjellje të ndryshme kundrejt mundësive tokësore



Pyetje: Mes njerëzve me mundësi të njëjta, që punojnë në një institucion apo në një firmë, ka nga ata që përpiqen t'i shërbejnë besimit me pasurinë e me shpirtin e tyre dhe në këtë kuadër, mundohen të vënë pasuri, të fitojnë të ardhura, truall, shtëpi. Këto investime vetjake mund të vënë në mendime njerëzit që nuk kanë pasur apo nuk kanë mundur të kenë fitime të ngjashme. Cilat janë hollësitë në të cilat duhet bërë kujdes për të mos lejuar cenimin e vëllazërisë prej paragjykimesh e mendimesh të këqija?

Përgjigje: Para së gjithash, duhet pranuar se natyra dhe karakteri i ndryshëm i gjithsecilit është një realitet. Po. Gjatë historisë së njerëzimit, ajo larmi e shumëllojshmëri që shpreh pyetja e ngritur, përbën një dukuri që lexohet në natyrën e në tiparet e njerëzve, si dhe në jetën e tyre. Madje edhe mes njerëzve që kanë qenë më afër profetëve, në çështjen e pronës, të mallit e të pasurisë ka pasur njerëz në gjendje të ndryshme. Dikush e kalon gjithë jetën në asketizëm dhe nuk bën gjë prej gjëje për të vënë pasuri në këtë botë; dikush tjetër, mundësitë e krijuara prej Allahut (xh.xh.) i shfrytëzon në rrugë të Tij dhe kështu, ka siguruar Xhenetin; ndërsa një pjesë fatkeqësi, duke u dhënë e spitulluar pas mallit e pasurisë, janë bërë mendjemëdhenj e kanë përfunduar në humbje e rrënim. Për shembull, sikurse pranë Zotërisë sonë, Musait (a.s.), gjendej një hero i ri si Jusha ibn Nuni, shembullor në bujari, ka edhe njerëz si Karuni që, siç kuptohet nga shprehja: “Karuni, ishte prej fisit të Musait”, [224] gëzonte fatin e të gjendurit pranë Musait (a.s.), por që gjithsesi nuk ia dha dot hakun kësaj pozite, dhe përfunimi i të tillëve janë rrëzimi e rrënimi.

Karuni dhe samirinjtë, që nga rrethi i afërt u flakën larg

Musai (a.s.) është një ndër profetët e mëdhenj e të lartësuar. [225] Ai është nderuar me cilësimin “*Kelimumallah*” (njeriu, me të cilin ka folur Allahu). [226] Zoti i Madhëruar, kur dërgoi Musain (a.s.) për te Faraoni, e shoqëroi atë edhe me një gojëtar si Haruni (a.s.), që ishte në gjendje t'i magjepste njerëzit me fjalën e vet, dhe kështu, duke ia shndërruar ndjesitë thujse në një gjendje korale, i krijoi mundësinë që t'u japë zë më së miri ndjenjave. [227] Mirëpo ja që edhe prej fisit të një profeti të madh si Musai (a.s.) dolën Karunë [228] dhe samirinj. [229] Kush e di, në fisin e tij, veç këtyre, mund të ketë pasur sa e sa njerëz që, edhe pse kanë jetuar në brezin e të fituarve, kanë dalë të humbur. Sepse brenda asaj shoqërie, ka njerëz të tillë që, pasi kaluan detin bashkë me të

nderuarin Musa, ishin në gjendje të thoshin: “Na bëni edhe neve një hyjni që ta adhurojmë.” [230] Pra, edhe menjëherë pas mrekullive të jashtëzakonshme si çarja e detit në mes dhe mbytja në të e ushtrisë së Faraonit, mrekulli që trokas në portën e mendjes dhe i mundësojnë njeriut të takohet me besimin, kishte në atë mes njerëz që, sapo hasën në dikë që i falej një idhulli, kërkuan edhe ata një idhull që ta adhuronin. [231]

Edhe kur shqyrtojmë kohën e Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (s.a.s.), vërejmë natyra e karaktere të ndryshme. Për shembull, pranë Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), kishte personalitete si Ebu Bekri (r.a.) që e ngriti e çoi përpara flamurin e çështjes së Islamit; si Omeri (r.a.), që qëndronte një hap pas Ebu Bekrit të nderuar, por që mund të thuhet se nuk mbetej pas tij dhe që, për nga veprat e kryera, kalëronte kokë më kokë me të. Kështu, Kreu i Dashur i Krijimit (alejhi elfu elfi salatin ue selam), në një hadith, duke tërhequr vëmendjen te vlerat e mëdha të këtyre sahabëve, urdhëron e thotë kështu: “Në të vërtetë, prej tokësorëve unë kam dy mëkëmbës dhe prej qiellorëve kam, gjithashtu, dy mëkëmbës. Dy mëkëmbësit e mi prej tokësorëve janë Ebu Bekri (radijallahu anh) dhe Omeri (radijallahu anh), ndërsa dy mëkëmbësit e mi prej qiellorëve janë Xhibrili (alejhis'selam) dhe Mikaili (alejhis'selam).” [232] Mirëpo pranë këtyre njerëzve, që rendin kokë më kokë me Xhibrilin dhe Mikailin, shihni edhe njerëz që janë trazuar në ngjarjet e braktisjes së fesë. Për shembull, një ditë, një sahab që erdhi pranë Omerit të nderuar (r.a.), e gjeti atë duke qarë. Kur pyeti për arsyen, mësoi se ai kishte humbur në luftë të vëllanë, Zehdin, i cili kishte rënë dëshmor. Atëherë ai i tha Omerit të nderuar: “O i Besuari i besimtarëve! Yt vëlla ra dëshmor në rrugë të Allahut. Kurse im vëlla ishte në ushtrinë e Musejlemes. Ti hesht e të qaj unë!” [233] Prandaj, duke qenë se edhe në atë periudhë janë përjetuar zikzake të tilla, para së gjithash, kjo gjendje duhet pranuar si një realitet. Po, po. Siç ndodhte në ato ditë, edhe sot, mes një bashkësie që i shërben fesë mund të dalin njerëz që sillen gabim. Për shembull, dikush hiqet sikur po rend në shërbim të kombit, por në të vërtetë bën një numër llogarish të brendshme dhe ushqehen shpresa të tjera. Ai individ, duke u gjendur brenda një lëvizjeje të tillë, mund të shkojë pas disa qëllimesh të kësaj bote. Por nëse nuk ka ndonjë anë negative që ta shfaqë për së jashtmi, duke qenë se ne nuk jemi në gjendje ta njohim botën e tij të brendshme, nuk mund të mendojmë keq për të e ta paragjykojmë. Nëse kemi gjë në dorë, mund të përpiqemi që atë njeri që ka devijuar e ka rënë në të shtrembrën, duke marrë parasysht edhe ndjenjat e tij të brendshme, ta shpëtojmë nga batakua në të cilin është zhytur.

Përfitimet tokësore brenda kornizës së të lejuarës

Një tjetër anë e çështjes është edhe kjo: disa jepen vërtet me mish e me shpirt pas shërbimit ndaj fesë. Por njëkohësisht, i kuptojnë shumë mirë edhe punët e kësaj bote. Po. Disa njerëz, pa e lënë pas dore shërbimin dhe krahas rendjes plot zell në rrugë të Allahut, mund të jenë të pajisur edhe me aftësi për t'u marrë siç duhet me punët e kësaj bote. Për shembull, në kohën e Shekullit të Lumturisë, Zoti i Madhëruar i zbriti porsì shi i begatë mundësitë e të mirat tokësore mbi personalitete madhështore si zotërinjtë tanë sahabë Abdurrahman ibni Afi dhe Osmani (radijallahu anhuma). Në përfundim, edhe ata u bënë njerëz të kamur e plot pasuri.

E njëjta gjendje është jetuar e do të jetohet edhe në periudhat e mëpasme. Në këtë pikë, çështja që nuk duhet harruar është që këta njerëz, në zotërim të mundësive e të pasurive të shumta, me sukseset e tyre, me mendimet e qëllimet e tyre të brendshme, do të dalin para Allahut. Nga ky

këndvështrim, kundrejt këtyre gjendjeve, mendimi i besimtarit duhet të jetë ky: “Me sa kemi parë e me sa dimë, këta vëllezër, kur i kanë hyrë kësaj rruge, nuk kanë pasur ndonjë mendim a pritshmëri egoiste. Përkundrazi, kanë qenë njerëz të mençur e të aftë. Duket se ata i hynë një sipërmarrjeje dhe Allahu (xh.xh.) ua mundësoi atyre këto mirësi.”

Duke lexuar në tekstet e historisë islame, vërejmë se Osmani i nderuar (r.a.) ka dhuruar 500 deve bashkë me ngarkesën. [234] Secila prej këtyre deveve mjafton për të vënë në dukje shkallën e lartë të përsosmërisë njerëzore të një njeriu si Osmani (r.a.). Por në të njëjtën kohë, mësojmë edhe se si ai flinte mbi truall ranor në Xhaminë e Profetit, se si i Dërguari i Allahut (alejshis'salatu ues'selam) shtrihej të pushonte e të flinte mbi hasër. [235] E pra, kur e vështrojmë në tërësi jetën e zotërisë sonë, Osmanit (r.a.), shihet qartë se pavarësisht gjithë atyre mundësive e pasurive të mëdha, ai zgjidhte të bënte një jetë të thjeshtë e pa kurrfarë luks, ndërsa ato mundësi që kishte, i përdorte në rrugë të Allahut, pa rënë kurrsesi në shpërdorim.

Por për nevoja të jetës njerëzore, edhe mes njerëzve që i janë kushtuar shërbimit ndaj së vërtetës, mund të dalin disa që kanë dëshirë të përfitojnë prej disa mundësive tokësore. Sikurse në rastin e asaj shmangieje të pjesshme që u vërejt gjatë luftës së Uhudit, kjo është si të thuash: “Meqë të tjerët po përfitojnë plaçkë lufte, të shkojmë të marrim edhe ne!” [236] Por nga ana tjetër, pati disa njerëz si Amr ibnu'l-Asi, që kur do t'u jepej plaçkë lufte, do të thoshin: “O i Dërguar i Allahut! Unë nuk u bëra mysliman për plaçkë!” [237] Në të njëjtën mënyrë, kur Krenaria e Njerëzimit (alejshis'salatu ues'selam) deshi t'i japë një sahabi që nuk ia dimë emrin pjesën e vet prej plaçkës së luftës, ai burrë i tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë këtë nuk mund ta pranoj. Unë u bëra mysliman që të më godasë një heshtë këtu (dhe tregoi grykën) e të bie dëshmor.” E në fund, siç dëshiroi, ra dëshmor, duke rendur drejt përjetësisë. [238] E pra, ka sa e sa heronj të tillë.

Edhe rreth aureolës së Krenarisë së Njerëzimit, i cili përfaqësonte Islamin në thelbin e vet dhe me ngjyrimin e tij shpirtëror rrëzëllente mbi këdo e i linte pas madje edhe engjëjt, kishte njerëz që nga pikëpamja materiale ishin në gjendje të ndryshme krahasuar me njëri-tjetrin dhe është normale që të tilla ngjarje të përjetohen edhe sot. Për shembull, dalin disa njerëz që ia kushtojnë krejt qenien e tyre shërbimit ndaj fesë, dhe një jetë të tërë as që u shkon mendja të vënë pasuri. Mirësitë që i vijjnë në njërën dorë, ata i dhurojnë me dorën tjetër dhe e kalojnë jetën gjithnjë me të njëjtin asketizëm. Pra, krahas kësaj, ka edhe disa që, përveç kryerjes së detyrës që u bie mbi shpatulla, nuk ngurrojnë edhe të fitojnë brenda kornizës së të lejuarës. E pra, këtu është e rëndësishme që të mjaftohen me të lejueshmen, të mos dalin prej kufirit të saj as edhe me një gjysmë hapi, të mos bien në spekulime dhe njëkohësisht, ato që fitojnë t'i përdorin në rrugë të së Vërtetës, si dhe të mundësojnë që edhe të tjerët të kenë dobi e të përfitojnë prej tyre.

Rreziku i vërtetë është njollosja e nijetit

Këtu dua të tërheq vëmendjen edhe te një çështje e veçantë: Vendi i njerëzve besimtarë, që atë çka besojnë duan t'ua përçojnë edhe zemrave të të tjerëve, duhet të jetë në një nivel ekonomik për t'u pasur zili, madje duhet të kthehet në një vend, në të cilin, në njëfarë mënyre, të gjithë të vrapojnë për të investuar. Sepse këto përbëjnë një argument shumë të rëndësishëm në shpjegimin e Islamit. Nëse të tjerët ju shohin të dobët e të vegjël në fushat e shkencës e të ekonomisë, nëse ju vlerësojnë si njerëz që i shtrini dorën botës e që qaheni në derë të FMN-së e të Bankës Botërore, mos harroni

se ata edhe fenë tuaj do ta shohin me po këtë sy. Nga ky këndvështrim, për mendimin tim, pjesëtarët e një feje të lartë duhet të jenë të lartë e në epërsi në çdo fushë. Nëse edhe çështjen e të fituarit të pasurisë e shohim me këtë sy, atëherë besoj se bëhet e qartë që ajo nuk është diçka për t'u hedhur poshtë.

Po. Në të fituarit e pasurisë, ajo çka është e rrezikshme është njollosja e nijetit dhe përzierja në të e disa llogarive të brendshme. Nëse dikush vepron me mendimin, “Vallë ç'mund të kap prej kësaj lëvizjeje, nëse bëhem pjesë e saj?” dhe nëse do të gjendet prapa në shërbim dhe përpara në shpërblim, atëherë ekziston shqetësimi që ai të gjendet në një dyfytërsi e hipokrizi. Ndërkohë, në lidhje me këtë çështje, duhet marrë për bazë standardi i vendosur prej Bediuzaman Said Nursiut, sipas të cilit duhet të gjendemi përpara në shërbim dhe prapa në shpërblim. [239] Po, po. Një njeri që ka besuar, edhe duke marrë parasysh çmimin e humbjes së jetës e të pasurisë, duhet të rendë përpara në shërbime, ndërsa kur të vijë puna te pagesa e shpërblimi, duhet të tërhiqet prapa, sa më prapa, duke mos hyrë në kurrfarë pritshmërie për mundimin dhe përpjekjen e vet. Zoti i Madhëruar, kundrejt një qëndrimi të tillë, e shpreh kënaqësinë dhe dashamirësinë e Vet duke mundësuar prej mirësisë së Tij hyjnore një bekim e bereqet të tillë, që si shpërblim në jetën e përjetshme, individit në fjalë të mund të gjendet, ndoshta, gju më gju e në një sofër me Zotërinë tonë, Nderin e Gjithësisë (alejhi salauatullahi ue selamuh), apo me Kalifët e Drejtë. Për mendimin tim, sikur gjithçka të bëhet për të përfituar prej një fati të tillë të bardhë, ia vlen.

Për një fat të tillë të bukur, jam i mendimit se duhet të përballemi shpesh me nijetet tona e me botën tonë të brendshme, t'i shqyrtojmë të gjitha këto e të kontrollojmë vetveten. Po, po. Që prej të kënduarit të ezanit e deri tek recitimi i ikametit, që prej të drejtuarit e namazit e deri te thirrja për të vërtetën, në çdo çështje, nuk duhet të heqim kursesi nga mendja hetimin e vetvetes me pyetjen e brendshme: “Vallë, a mos egoja ime po përfiton diçka këtu? A mos po i ndaj vetes diç prej plaçkës?” Sepse ne, në punët e mira, sa më shumë që ta mbajmë jashtë vetveten, aq më shumë bëhemi pjesë e atyre punëve. Por sa më shumë që të marrim e të përfitojmë në brendi të atyre punëve, edhe e vërteta e sinqeriteti mbeten aq më shumë jashtë tyre.

Në këtë çështje, ruajtja e drejtpeshimit është që njeriu të rehabilitojë vazhdimisht vetveten, të këshillohet paprerë për çështjet fetare, të përpiqet që të mbajë mbi shpatulla përgjegjësinë ndaj një shoqërie a një bashkësie dhe ta vërë në jetë me frymë të përkushtimit e të këmbënguljes detyrimin ndaj asaj përgjegjësie. Zoti ynë na bëftë prej atyre që e kalojnë jetën në këtë linjë!

[224] Kasas, 28/76.

[225] Shih: Ahzab, 33/7; Shuura, 42/13; Ahkaf, 46/35.

[226] Shih: Buhari, Teuhid 36; Muslim. Iman 322.

[227] Taha, 20/42-43; Shuara, 26/15-16.

[228] Shih: Kasas, 28/76.

[229] Shih: Taha, 20/95-97.

[230] Shih: Isra, 17/138.

[231] Shih: Bekare, 2/50; Araf, 7/137; Junus, 10/90.

[232] Tirmidhi, Menakib 16; el-Hâkim, El-Mustedrek 2/290.

[233] Ibn Sa'd, Et-Tabakatu'l-kubra 3/377-378.

[234] Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 18/231; İbn Asâkir, Tarihu Dimashk 39/63.

[235] Shih: Buhari, Tefsiru sure (66) 2; Muslim, Talak 31.

[236] Shih: Buhari, Xihad 164; Ebu Davud, Xihad 116; Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 4/293.

[237] Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 4/197, 202; Ibn ebi Shejbe, El-Musanef 4/467; Ebu Ja'la, El-Musned 13/321.

[238] Nesai, Xhenaiz 61; Abdur'rezzak, El-Musanef 7/271; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 2/271.

[239] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 519 (Fjala e Njëzetegjashtë, Shtojcë).

Udhërrëfimi dhe hipokrizia



Pyetje: “Zotësia e vërtetë është, që kur e sheh vëllanë tënd në gjendje të keqe, të mos e braktisësh atë, por t’i forcosh edhe më shumë lidhjet vëllazërore dhe të përpiqesh për ta ndihmuar atë.” A qëndron ky mendim edhe për rastin e mëkateve si hipokrizia, që mund t’i shkaktojnë dëm një shoqërie të tërë? Cilat janë hollësitë që duhen pasur parasysh në çështje të tilla, që kanë të bëjnë me të drejtat e përbashkëta të shoqërisë?

Përgjigje: Një besimtar duhet të bëjë çdo mundim e përpjekje për të shpëtuar e nxjerrë një vëllanë e tij nga gropa e zezë e të ligave ku ai mund të ketë rënë. Ashtu sikurse në vende të ndryshme, kundrejt rrezikut të një mbytjeje fizike, brenda Lëvizjes së Zembrave, ka pasur njerëz që janë lëshuar në ujë për të shpëtuar shokun dhe kanë rënë dëshmorë. Ndoshta ata, në gjendjen shpirtërore dhe tronditjen që kanë përjetuar përballë ngjarjes, nuk kanë menduar apo as që kanë pasur mundësi të mendojnë nëse do ta shpëtojnë dot njeriun që po mbytej, apo nëse do të notojnë dot në ato kushte dhe në përfundim, për të shpëtuar një njeri, kanë vënë veten në rrezik, gjersa kanë rënë dëshmorë.

Po kështu, edhe të këqijat e mëkatet janë nganjë batak i papastërtisë. Ndërsa vëllazëria dhe besa kërkojnë që një njeriu që ka rënë në batakun e papastërtisë t’i zgjatet dora, të bëhet gjithë ç’është e nevojshme për ta shpëtuar. Sepse edhe në u ndodhte në një mjedis të pastër e të dëlirë – Allahu na ruajtë! – njeriu mund të çelë velat në rrjedhën e mëkatit, mundet që dora e këmba, gjuha e buza t’i bien në gjynah. Për shembull, nëse dikush nuk i ndal sytë prej haramit dhe sheh me lehtësi në panoramat që Allahu i ka ndaluar të shihen. Ai nuk e merr fare parasysh fjalën e shenjtë të Zotit të Madhëruar: “Thuaju besimtarëve që t’i ndalin sytë prej të ndaluarës e të ruajnë nderin e tyre.” [240] Madje individ mund ta çojë çështjen në bohemizma edhe përtej shikimit, dëgjimit apo të folurit të haramit. Një tjetër mund të jetë mësuar të mëkatojë me gjuhën e tij duke turpëruar, nënvlerësuar e përgojuar njerëzit. Kjo do të thotë se një njeri i tillë ka rënë në batakun e papastërtisë. Po ashtu, mund të dalin edhe njerëz që nuk e lënë punën me kaq, që planifikojnë t’u bëjnë keq besimtarëve, që duan që atyre t’u shkasë këmba, që ushqejnë smirë e shpifin për ta. E pra, në të gjitha këto situata, pikësëpari, siç është e udhës, një individ i tillë duhet të mbahet për dore dhe të kërkohen rrugët e këshillimit të tij.

Një përmendore e dëlirësisë: Xhulejbibi (r.a.)

Lidhur me këtë, shumica prej nesh janë në dijeni të ngjarjes së përjetuar mes Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (alejhis'salatu ues'selam) dhe Xhulejbibit (radijallahu anh). Hazreti Xhulejbibi në atë kohë ishte në moshën 16-17 vjeçare, kur ndjesitë njerëzore njohin vlimin e tyre. Specialistët e edukimit ankohen se përgjithësisht, nxënësit e kësaj moshe nuk mund të kontrollohen, tregohen të çrregullt e të padisiplinuar. Edhe nëse disa natyra të urta i dëgjojnë prindërit dhe ecin në rrugën e duhur, kur gjenden në një mjedis të zvetënuar, mund të bien në sjellje e qëndrime që bien në kundërshtim me vlerat morale. Me turp e them se në këtë periudhë të rrezikshme, ata që kapen nga vese të këqija si duhani, alkooli, droga, mund të shkasin edhe në mëkate më të ndryshme se këto. Në këtë situatë, para së gjithash, duke i kapur për dore, ata duhen bindur me mendje, me zemër e me ndjenja, për hir të së ardhmes së tyre. E kështu, i Nderuari Shpirt i Kreut të Krijimit (alejhis'salatu ues'selam) e mori Xhulejbibin pranë vetes dhe duke u ulur në gjunjët e tij të bekuar ballë për ballë me të, i tha kështu: “Xhulejbib! Dëgjova se ke sjellje të pahijshme me gratë. Tani më thuaj, a do që të njëjtën gjë ta bëjë dikush tjetër me nënën tënde?” Xhulejbibi u përgjigj: “Jo, o i Dërguari i Allahut, nuk dua!” Atëherë Tabloja e Krenarisë Njerëzore urdhëroi e tha: “Mos harro, edhe ndonjëra nga ato që ti u shkon pas, është nëna e dikujt!” Më pas, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) përsëriti të njëjtën pyetje për motrën, hallën e tezen dhe mori të njëjtën përgjigje. Në përfundim, Zotëria ynë, Profeti (alejhi ekmelut'tehaja), duke iu drejtuar mendjes dhe arsyes së Xhulejbibit, e bindi atë. Po të mendojmë edhe se këto ishin fjalët e një Profeti, besoj se kuptohet më mirë se sa ndikuese kanë qenë ato për Xhulejbibin. Më në fund, Xhulejbibi nuk ka asnjë ngurrim. Pas kësaj, Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.) i vuri dorën e bekuar në kraharor dhe u lut për të. Sahabët e nderuar thonë: “Xhulejbibi, që prej atij çasti, u bë nga të rinjtë më të dëlirë të Medinës.” [\[241\]](#)

Kohë më vonë, Xhulejbibi (r.a.) ra dëshmor në një betejë në të cilën mori pjesë. Secili kërkon dëshmorin e vet. I Dërguari i Allahu (s.a.s.) i pyet ata që kishte pranë: “A keni humbje?” Kur i thanë: “Jo”, Ai urdhëroi e tha: “Kurse unë humba Xhulejbibin!” Sahabët e nderuar e gjetën atë të rënë pranë shtatë vetësh që kishte vlarë në betejë. Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik, iu afrua e iu ndal tek koka, e mori në krahë dhe tha: “Ky është prej Meje dhe Unë jam prej tij.” [\[242\]](#)

Kjo tablo, që e njohim prej historisë së Islamit, është shembull prekës i asaj se si duhet të silltet një udhërrëfyes në situata të tilla. Siç shihet, ai personalitet, ndërsa ishte në udhë e sipër për të hedhur një hap të gabuar, vetëm nëpërmjet këshillës dhe thirrjes drejtuar mendjes e arsyes, hoqi dorë sakaq, u kthye mbrapsht dhe iu dorëzua të Vërtetit. Më pas, Zoti i Madhëruar e lartësoi atë në çast në majën e përsosurisë njerëzore dhe në atë gjendje, e mori pranë Vetes. Prandaj edhe për një njeri që ndodhet në pengim, në rënie a në shkarje e sipër, duhet bërë pikërisht kjo.

Por nëse një njeri e merr lehtë një çështje që feja e ka cilësuar qartë si të ndaluar, e sheh atë si diçka pa rëndësi dhe, pavarësisht paralajmërimeve, vijon të bëjë të njëjtat gjëra, atëherë situata paraqitet e ndryshme. Për të ruajtur seriozitetin e çështjes, ndaj këtyre njerëzve mund të jetë e nevojshme që të mbahet edhe njëfarë largësie. Edhe kjo është një nga hollësitë që bëjnë pjesë në pengimin prej të këqijave.

Në lidhe me këtë temë, Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.) në një hadith urdhëron e thotë kështu: “Cilido prej jush që sheh një të keqe, le ta ndalë atë me dorë. Nëse për këtë nuk i mjafton fuqia, le ta ndalë

duke këshilluar e paralajmëruar. Nëse nuk i mjafton fuqia as për këtë, atëherë le të mbajë qëndrim me zemër kundër saj. Por kjo e fundit është shkalla më e ulët e besimit.” [243] Qëndrimi i parë që duhet mbajtur ndaj një të keqeje është që ajo të pengohet me dorë. Një njeri, për të ruajtur fëmijët apo të afërmit e vet prej të këqijave, mund të zbatojë disa sanksione në përmasat që ia lejojnë ligji dhe e drejta. Por nëse nuk e ka një mundësi të tillë, nëse nuk është në gjendje ta përmirësojë me veprim konkret të keqen që sheh, atëherë duhet të këshillojë e të paralajmërojë duke ushtruar “të urdhëruarit në të mirën” (emr-i bi’l-ma’ruf) dhe “të ndalurit prej së keqes” (nehji ani’l-munker). Nëse nuk ka mundësi e nëse koniunktura nuk ia lejon as këtë, atëherë ajo që i mbetet është që të mbajë në zemër qëndrim mospranues ndaj atyre të këqijave. Në një kuptim, me njeriun që tregohet kryeneç dhe vazhdon rrugën e nisur, mund të vendosë një distancë dhe të mbajë qëndrim ndaj tij. Në thelb, ky qëndrim që mbahet ndaj një individi që këmbëngul në mëkat, sërish është dhe duhet të jetë i prirur për ta shpëtuar e për ta ndihmuar atë.

E pra, në këtë pikë, mprehtësia dhe mençuria e individit që gjendet në pozitën e udhërrëfyesit mbart shumë rëndësi. Kemi një individ që, i zhytur në keqardhje të thellë, pendesë pas pendese, kërkon rrugët për daljen nga gabimi. Sikurse kemi edhe njerëz që, duke gjetur pretekste djallëzore për sjelljet e tyre të gabuara, këmbëngulin në mëkat e në kryelartësi. Pikërisht këta janë njerëzit ndaj të cilëve duhet mbajtur qëndrim. Duke qenë se kjo është një çështje që kërkon ndjeshmëri të lartë, nëse problemi nuk i lihet amanet arsyes, nëse puna nuk shihet brenda standardeve vlerësuese të ndërgjegjes, mund të ndodhë që ta trajtoni edhe rastin e parë si rastin e dytë. Duke qenë se me një sjellje të tillë e drejta nuk vihet në vend, bëheni përgjegjës para Zotit të Madhëruar. Për këtë arsye, sipas gjendjes konkrete të bashkëbiseduesit, gjithçka duhet bërë siç duhet dhe duhet llogaritur mirë që në fillim se çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj sjelljesh të caktuara.

Mëkate të barasvlershme me femohimin

Veç kësaj, siç shpreheni edhe në pyetjen tuaj, ka edhe sjellje e qëndrime si të bërët pjesë në objektiva të errëta, pjesëmarrja në shpifje e gënjeshtër nën maskën e marrjes së informacionit, që e dëmtojnë një lëvizje të përbashkët dhe që janë të barasvlershme me mohimin e fesë. Që të falen mëkate të tilla, nuk mjafton që individët të na falin e të na e bëjnë hallall. Sepse duke qenë se këto llogariten prej të drejtës së përgjithshme, kanë lidhje me të drejtën e Allahut.

Ta zëmë se dikush, duke e vlerësuar për llogari të vet një detyrë që i përket kombit dhe shtetit tonë, kundrejt një pagese, dërgon informacione jashtë vendit dhe bën spiunazh. E pra, kjo është një e keqe e zvetënim i tillë që – Allahu na ruajtë! – i kapërcen kufijtë e hipokrizisë. Zoti ynë mos lëntë kurrkënd që të bjerë në një gjendje të tillë!

Po ja që siç ka ndodhur në të shkuarën, edhe sot mund të ndodhë që të përjetojmë ngjarje të tilla. Mendoni pak se edhe në epokën e artë të njerëzimit, në Kohën e Zbulesës Hyjnore, kishte hipokritë. Për rrjedhim, edhe mes myslimanëve të ditëve tona mund të ketë hipokritë. Siç e shihni në provokacione, ka njerëz që vijnë sa prej Iranit e prej Turanit për të shkaktuar trazira e për të prodhuar ngjarje të ndryshme shoqërore. Këta, duke shfrytëzuar raste nga më të ndryshmet, hyjnë mes turmës dhe shkaktojnë enkas rrëmujë. Madje edhe pse nuk shkelin kurrë në xhami, janë në gjendje që mu përpara xhamisë të shkaktojnë provokacione që nxisin e ndezin njerëzit. Po. Të tilla

ngjarje mund të ndodhin gjithmonë. E pra, për t'i parë të gjitha këto, janë të nevojshme ai vështrim i mprehtë e ajo mençuri që janë ndriçuar në vuajtjen e në dhembjen e mendimit.

Me këtë rast, po e pohoj edhe një herë, se si pjesëtarë të një feje që ka në thelbin e vet dashurinë për njeriun, ne duhet të përmendim në çdo platformë se nuk përbëjmë kurrfarë shqetësimi për të tjerët. Po, po. Ne jemi në krah të konceptit të dialogut e të mirëkuptimit mes njerëzve dhe e konsiderojmë si ibadet e adhurim ndaj Zotit që gjithsecili të përpiqet të dojë tjetrin, t'i shtrijë gjithkujt dorën e pajtimit e të mundohet të ecë në këtë rrugë. Ne jemi pjesë e përpjekjes për të penguar përdorimin e armëve atomike e të bombave me hidrogjen a ç'mos tjetër prej aso armësh të mallkuara që njerëzit kanë shpikur për të vrarë njëri-tjetrin. Ne kemi dëshirë që mbi kryet e njerëzve të mos bien të tilla bomba, të tilla të liga e fatkeqësi, por dëshirojmë që, në një atmosferë dashurie, nën shkëlqime si fishkzjarre që ngjyrosin qiellin, mbi njerëzimin të bien shira të bekimit e të dritës. E gjithë çështja jonë është veç kjo.

Por ata që nuk njohin tjetër vlerë veç fuqisë e forcës, që botën e shohin vetëm si veten, mund t'ju mendojnë edhe ju si ata vetë dhe mund t'ju fajësojnë për çka as s'ju shkon ndonjëherë në mendje e as që e keni ndonjëherë as në ëndërr. Kundrejt gjithë këtyre, ajo çka mbetet për të bërë, është që të shpjegoheni vazhdimisht dhe të mundësoni që të tjerët të mund t'ju lexojnë drejt. Në fund të fundit ju nuk keni pasur tjetër qëllim përveçse, nëpërmjet kënaqësisë së adhurimit, ta ktheni botën në një korridor parajse. Po, po. Me vetëdijen e përgjegjësisë që buron prej fesë suaj, ju keni ndjekur vetëm një qëllim: që njerëzit të mos goditen, të mos përplasen, që bombat vdekjeprurëse të mos shpërthejnë, që të mos ketë vraseje e masakra; që të mos përjetohen më Hiroshima dhe të mos ndodhin sërish tmerre e fatkeqësi si luftërat botërore. Dhe për këtë, që prej fillimit ju u bëzatë zemërave të njerëzve, me durim e porsi milingona u munduat të formësonit kudo ishuj të vegjël paqeje. Ndërkohë, po pohoj edhe se në vendin tonë dhe në të katër anët e botës pati sa e sa natyra të pastra e të dëlira, që iu përgjigjën kësaj thirrjeje, që treguan dashamirësi, që e duartrokitën, e mbështetën dhe i dolën për zot këtij koncepti. Ahere, ajo çfarë na mbetet neve është që, pavarësisht çfarë mund të thotë shumëkush, të mos ngecim në negativitete, por të vazhdojmë përpjekjen rendjen porsi dorinjtë dihatës në këtë rrugë që shpresojmë se do të na çojë drejt kënaqësisë së Zotit tonë.

[240] Nur, 24/30.

[241] Ahmed İbn Hanbel, El-Musned 5/256; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 8/162, 183.

[242] Muslim, Fedailu's-sahabe 131; Ahmed İbn Hanbel, El-Musned 4/420, 421, 425.

[243] Muslim, Iman 78; Tirmidhi, Fiten 11; Ebu Davud, Salat 239.

Kurani dhe ne



Pyetje: Kur vështrojmë jetën e sahabëve të nderuar, vërejmë se ata gëzonin në çdo ngjarje udhërrëfimim e Kuranit të Shenjtë dhe e jetonin jetën e tyre tërësisht sipas inkurajimeve dhe paralajmërimeve të Kuranit. Cilat janë hollësitë në të cilat besimtarët e ditëve tona duhet të bëjnë kujdes për ta jetuar jetën e tyre në të njëjtën linjë?

Përgjigje: Në një hadith, gjendja e Kuranit në ditët e fundit të kësaj bote shprehet kështu: “Ndër njerëzit do të mbërrijë një kohë e tillë, që Kurani do të jetë në një luginë dhe ata në një tjetër luginë.” [244] Siç shprehet në këtë hadith, ka shekuj në të cilët Kurani gjendet në një luginë, ndërsa ne gjendemi në një tjetër luginë. Po, Ne, në një kohë të caktuar, e lamë pas dore Kurantin, veçanërisht për sa i përket urdhëresave të tij fizike; ua mbyllëm e ua zumë atyre dyert. Madje duke ulur edhe grilat, ua premë rrugën për në botën tonë rrezeve të ngrohta të klimës së tij ndriçuese. Ndërkohë që ai libër i madhërishtë ishte sqaruesi i urdhëresave fizike, provuesi e argumentuesi i tyre. Sikurse gjithësia është një libër i mbështetur në një program të dijes që buron prej fuqisë e vullnetit të Allahut, edhe Kurani, me programin e tij të dijes, është një libër i veçantë që vjen prej atributit të të folurit të Allahut. Por ne, në mendësinë e në botën tonë të mendimit, i ndamë këto dy të vërteta prej njëra-tjetrës. Nëse mund të shprehemi kështu, jo me ndarjen e të triave, apo ndarja e tri fushave të dijes, por duke kapërcyer prej treshit të nënta, me ndarja e të nëntave, ne ndamë zemrën prej mendjes, ndamë urdhëresat natyrore prej urdhëresave ligjore (teshrije). Krahas kësaj, në jetën islame të zemrës e të shpirtit, ne rrëshqitëm në një gjendje prej të huaji. Ndaj edhe mund të themi se për një periudhë që mund ta cilësojmë si tranzicion relativ, bashkësia e Kuranit jetoi pa e pasur idenë e Tij.

Historia ka qenë dëshmitare e çuarjes edhe më larg të kësaj ndarjeje. Ka pasur një ditë, në të cilën edhe shqiptimi i fjalës “Kuran” u ndalua. Kurani mund të lexohej e të mësohej vetëm në disa mjedise të ngushta. Edhe në periudhën kur unë i varfri mësova Kurantin, ekzistonin ndalime të tilla. Në atë kohë, kur tre-katër njerëz mblidheshin fshatrave me dëshirën për të mësuar fjalën e Allahut, përballëshin me ndërhyrjen e dhunshme të xhandarmërisë, që nxirrte jashtë fëmijët nën kërcënimin e grykave të armëve. Po, po. As kaq nuk e toleronin të mësuarit e Kuranit.

Përzemërsia ndaj Kuranit

Pasi u larguam kaq shumë prej Kuranit dhe pasi u bëmë kaq të huaj me të, tani thellimi i sërishëm në të, zbatimi i mesazheve të tij të ndritura në jetën tonë vetjake, familjare, shoqërore, ekonomike, psikologjike, pedagogjike e kulturore nuk është një punë që bëhet në çast. E veçanërisht nëse disa njerëz depërtojnë në institucionet tona të bukura e të spikatura dhe vazhdojnë shkatërrimin e tyre, pra, nëse Kurani ende vihet nën hetim në mënyra të ndryshme, nëse shqiptohen tallje kundrejt haditheve të fisme të atij Mbartësi të Kuranit, të Dërguarit të Përnderuar (alejhissalatu ues'selam), nëse ende sulmohen ashpër mrekullitë e tij dhe ende çështjet që i përkasin Kuranit trajtohen me gjykimin e historicitetit, vështirësia e çështjes kuptohet edhe më mirë. Veç kësaj, as edhe tani nuk mund të thuhet se ne i jemi drejtuar siç duhet e me zemër Kuranit. Qoftë për nga gjuha, qoftë për nga terminologjia dhe qoftë për nga jeta e zemrës, jemi tjetërsuar e jemi bërë aq të huaj me Kuranin, saqë kapërcimi i gjithë këtij tjetërsimi dhe hyrja sërish në kontakt me Kuranin është e lidhur ngushtë me një përpjekje shumë serioze. Duhet që njerëzit të besojnë edhe një herë nga zemra në drejtësinë e fesë dhe në vërtetësinë e profetësisë së të Dërguarit të Nderuar, Mbartësit të Kuranit. Ashtu që të mund të themi: “O Allahu im, nëse mesazhin e sjellë prej Atij nuk do ta jetësoj dot në jetën time, atëherë të jetuarit nuk ka kuptim. Nëse nuk do ta ngre dot në këmbë përmendoren e shpirtit tonë, nëse nuk do t’i bëj dot sërish shpirtat që ta ndiejnë shpirtin e fesë, atëherë ia vlen të ma marrësh shpirtin në çast me një thirrje të vetme.”

Po, po. Çështja e vërtetë është që ta ndiejmë Allahun në zemër dhe që njohjen e Tij ta pranojmë si qëllimin thelbësor të ekzistencës sonë. Sepse sipas Kuranit të Shenjtë, qëllimi për të cilin ne jemi krijuar është besimi tek Allahu, njohja e Allahut, dashuria për Allahun, është ajo këndellje shpirtërore që Zoti i Madhëruar ka pasur mirësinë t’ia falë e shpërfaqë njeriut në nivele të ndryshme. [245] Nëse Allahu e ka shprehur këtë si qëllimin e krijimit dhe nëse ne e kemi ndryshuar këtë, atëherë më së pari duhet të bëjmë llogaritë me vetveten dhe t’i rivlerësojmë edhe një herë ato çka kemi shpërfillur. Atë rrënim që është bërë në shekuj duhet ta mbajmë parasysh dhe të përpiqemi të riparojmë gjithçka që është e nevojshme të riparohet. Por nuk duhet harruar se çështja e rikthimit dhe e zbatimit në trajtën e në formën e duhur të këtyre shformimeve të frikshme, në brendi të të cilave jetojmë, nuk është punë që bëhet menjëherë. Bediuzamani bën fjalë për përpjekjet që bëhen për të restauruar një kështjellë të rrënuar prej shekujsh. [246] Mund të shihni që nga çështja e tronditjes së besimit e deri te mungesa e respektit për prindërit, te braktisja e prindërve nëpër azile, te prishja e rregullit dhe e harmonisë së përgjithshme brenda familjes e te plot vlera të tjera që i kemi shkelur me këmbë. Ndrejta e gjithë këtyre kërkon ndoshta një shekull. Mund të ndodhë që Zoti i Madhëruar të ketë mirësinë e ta mundësojë këtë përfundim brenda një periudhe më të shkurtër. Kjo mund të jetë një e mirë më tepër që na vjen prej Tij. Ne e presim prej gjerësisë së mëshirës së Tij një mirësi të tillë. Por në planin e realitetit, nuk duhet harruar se natyrshmëria e kësaj pune lidhet me një kohëzgjatje të tillë.

Të kuptosh Kuranin me një valë të re thellimi në të

Pra, para së gjithash, duhet të dimë se mangësia dhe shkarja në këtë çështje buron prej zikzakeve tona, se këto mangësi, që prej periudhës së Imam Gazaliut apo të Fatihut e gjer më sot, me kalimin e kohës, janë mbledhur e grumbulluar. Pra, me kalimin e kohës, ne jemi kthyer në përfaqësues të njerëzve me mendime të mangëta, me emocione e jetë shpirtërore të mangët. Nga ky këndvështrim,

me një dallgë që ngrihet prej thellësisë, me emrin e Allahut, duhet t'i vihemi sërish punës. Ashtu sikurse për fëmijën zbatohet një program i ushqimit sipas moshës, edhe në jetën tonë të zemrës e të shpirtit duhet të formësojmë një mënyrë e strategji të tillë të ushqyeri. Secili duhet të përpiqet sipas mundësive të veta për ta realizuar këtë. Vetëm pas kësaj, do të lindë mundësia për ta kuptuar drejt Kuranin.

Në epokën kur shpallej Zbulesa Hyjnore, kishte aq shumë lëndë për të shtjelluar në kuadrin e gjykimit të lirë, të sqarimit e të interpretimit, saqë duke i mbështetur gjykimet e interpretimet e sotme mbi to, mund ta ndriçojmë aktualitetin tonë dhe të paraqesim zgjidhje të larmishme për problemet e njeriut të ditëve të sotme. Por më së pari, te ne duhet të gjallojë një emocion i fuqishëm dhe të formësohet ndjenja e të bërit të besimit qëllim të jetës sonë. Vetëm pas kësaj, njerëzit njerëzit do ta lexojnë çdo ajet të Kuranit sikur ai t'u drejtohet atyre vetë. Për shembull, në suren “Nur”, ajeti i shenjtë që vijon, trajton shpifjen e shëmtuar, që është bërë ndaj Nënës sonë, Aishes (r.a.): “Ata që e nxorën shpifjen janë, një grup prej jush. Këtë ngjarje mos e mendoni të keqe për ju; mbase për ju, ajo është e mirë. Prej tyre, secili ka marrë mëkat.” [247] Por duke qenë se retorika e mrekullueshme e Kuranit u drejtohet të gjithë njerëzve gjer në Ditën e Gjykimit, ne mund t'i bëjmë vetes këto pyetje: “Kundrejt një shpifjeje të tillë, të bërë ndaj dritës së syve tanë, të shtrenjtës sonë, më të madhes edukatore të botës së grave në familjen e lume e njëkohësisht burimit të fesë, vallë, çfarë na mëson neve sjellja e përgjithshme e Zotërisë sonë, të Dërguarit të Nderuar? Vallë, cilat janë mësimet që duhet të nxjerrim prej atij qëndrimi të drejtë ndaj kësaj çështjeje, sikurse ndaj çdo çështjeje tjetër, të Zotërisë sonë, Ebu Bekrit të nderuar (r.a.)? [248] Çfarë mesazhi na përcjell qëndrimi i Nënës sonë të nderuar [249] kundrejt kësaj çështjeje? Shkurt, çfarë na shpreh, çfarë na tregon neve ky ajet?” E pra, duke nisur me emrin e Allahut, duhet ta lexojmë e të përpiqemi ta kuptojmë Kuranin nga fillimi gjer në fund në këtë këndvështrim.

Sërish në kuadrin e një shembulli, mund t'ju paraqes edhe këtë: në suren “Bekare”, Zoti i Madhëruar urdhëron e thotë: “Elif, Lam, Mîm. Ja (tek është) Libri, në të Cilin nuk ka kurrfarë dyshimi (se është zbritur nga Allahu, plot mrekulli nga nisja gjer në përfundim). Ai, për të përkushtuarit, është një udhërrëfyes.” [250] Në këtë ajet të shenjtë, pra, pohohet se Kurani Fisnik është burim udhëzimi për të përkushtuarit. Dijetarët e morfologjisë dhe të sintaksës thonë se udhëzimi këtu mbart kuptim të rrënjës semantike. Prandaj edhe ajo çka duhet kuptuar këtu është që Kurani është një burim i mundshëm udhëzimi. Ndërsa kthimi në një situatë praktike i kësaj çështjeje, që mund ta cilësojmë si synimin e përdorimit të kësaj rrënje, shpjegohet në ajetet që pasojnë. Kështu, ajeti vijues urdhëron e thotë: “Për ata të përkushtuar që besojnë në botën e padukshme (gajb)” [251] Në këtë mënyrë, ai ndalet tek të besuarit në Atë Qenie të Mirësishme që njihet përmes të vërtetave të fshehura, pra, të emrave të Tij, stolisur prej attributeve të Tij (sifat), që me Qenësinë e Vet ekziston dhe që në Thelbin e Vet mbetet një Ekzistencë e Panjohshme; në të njohurit e Tij përmes cilësive të Tij të madhërishtme; në të lartësuarit e në të çmuarit e Tij përmes emrave të Tij hyjnorë. Në vijim të Ajetit fisnik, urdhërohet e thuhet: “Dhe që bëjnë ikame namazin.” [252] Këtu nuk thuhet falin namaz, por përdoret fjala “ikame”, në përputhje me thelbin e vërtetë të namazit. Me këtë, shprehet se përmendorja e namazit duhet ngritur e bërë “ikame” në një formë që përshtatet me kushtet dhe ruknet e namazit dhe njëkohësisht në nënshtrim e përvuajtje, njeriu duhet të ikë prej vetes e të përjetojë vetëdijen e pranisë së lartësuar hyjnore në një ndjenjë përqendrimi të thellë ndaj Allahut.

Ndërsa më pas, urdhërohet e thuhet: “Dhe ata që prej të mirave që u kemi dhuruar, shpenzojnë në të mirë.” [253] Sipas kësaj, të mirave që Allahu na ka mundësuar prej mirësisë së Vet, u duhet dhënë haku. Nëse Zoti i Madhëruar, prej mirësisë së Vet, na ka dhuruar pasuri, ahëre prej saj u duhet dhënë haku nevojtarëve. Nëse na ka dhuruar dije, edhe kjo mirësi duhet të shpenzohet në rrugë të dijes. Nëse na ka dhuruar aftësi të mendimit e të gjykimit, ahëre duhet vuajtur dhimbja e të menduarit dhe duke lodhur mendjen, t’i jepet haku edhe mendimit. Nëse na ka dhuruar ndjenjën e dhembshurisë, ahëre për të fituar njerëzimin, asaj i duhet dhënë haku gjer në gradën e fundit.

Pas gjithë kësaj, urdhëron e thotë kështu: “Dhe ata që i pohojnë e i besojnë edhe librin që të është zbritur ty, edhe librat që janë zbritur para teje.” [254] Pra, flet për ata që besojnë në barasvlefshmërinë e zbulësës hyjnore të kohës që ata përfaqësojnë, me zbulësën hyjnore të mëhershme, të përfaqësuar në mënyrë të plotë nga njerëzit apo bashkësitë përkatëse të mëparshme. Një tjetër cilësi e të përkushtuarve shprehet kështu: “Dhe ata që i besojnë me siguri jetës tjetër.” [255] Këtu nuk thuhet Besojnë. Besojnë, por “Besojnë me siguri të plotë.” [256], çka tregon se të përkushtuarit duhe të zotërojnë një siguri të plotë në çështjen e jetës së amshuar. Të gjitha këto që i paraqita në mënyrë të përmbledhur, janë hollësi që na parashtrohen në Islamin teorik për të përmbushur në praktikë udhëzimin apo udhëzimin e mundshëm.

Zoti i Madhëruar, pasi i sqaron në këtë mënyrë cilësitë e të përkushtuarve, urdhëron e thotë: “*Ata*” Ja pra, o i Dashuri im! Këto fytyra e çehre të ndritura, këto fizionomi të jashtëzakonshme, këta personalitete monumentale, këta njerëz të mëdhenj që janë lartësuar përmes imanit dhe Islamit, “E pra, këta,”:“janë në një rrugë të drejtë prej Zotit të tyre.” [257] Këta, të vërtetat e shprehura në mënyrë teorike, i kanë përforcuar e thelluar përmes përkushtimit dhe i kanë kthyer ato në një pjesë të pandarë të jetës së tyre. Vërtetësia e besimit tek ata është shndërruar në praktikë: “E mu ata janë të shpëtuarit.” [258]

Në kontekstin e një interpretimi të ngushtë, jam përpjekur të paraqes thjesht dhe shkurt kuptimin e ajeteve të mësipërme dhe arsyeja e kësaj përpjekjeje është kjo: Duke zbritur e depërtuar në shtresat kuptimore të Kuranit, që nga “Lavdia i përket veç Allahut, Zotit të botëve.” [259] e deri te “(Qofshin ata) prej xhinëve a prej njerëzve.” [260], duke menduar thellë mbi to, me një dallgë të re që prej thellësisë, duhet të diskutojmë e të meditojmë rreth tyre nga fillimi gjer në fund. Kështu, duhet të ushqejmë mendimin: “O Allahu im, përpiqemi të lidhemi pas librit Tënd të jashtëzakonshëm, të përsosur e me kuptime të gjerësishme; bëjmë mundime e përpjekje në këtë drejtim dhe teksa e bëjmë këtë, kërkojmë mbrojtjen Tënde prej djajve ndër njerëzit e xhinët.” Me këtë mendim, duhet të shtjellojmë prej fillimit gjer në fund se çfarë i përbëjnë parimet themelore që na urdhëron feja.

Drejt horizonteve të reja në klimën e ndritur të Kuranit

Said Nursi bën fjalë për nevojën e të lexuarit të Kuranit sikur të jemi duke e dëgjuar prej Allahut apo prej Xhibril Eminut apo prej Profetit të Dashur e Besnik. [261] Njëse një njeri ndihet sikur të jetë duke e dëgjuar Kuranin prej Folësit të Pafillim, atëherë kjo është një çështje shumë serioze. Një njeri që e lexon Kuranin kësodore, kur ndien një fjalë të tij, e shtjellon atë dhjetë herë në mendje, më pas atë fjalë ia lë amanet të gjitha neuroneve. I thotë kontekstit: “Ti prit pak, se do të të drejtohem prapë.” Sikur të jetë duke rrënuar e kërkuar në një dosje, e kalon edhe një herë atë

prej fillimit gjer në fund. Kur e shihni Kuranin me këtë sy, është e mundur që të dalloni brenda tij problemet tuaja në lidhje me të gjitha fushat e jetës vetjake, familjare, shoqërore e kulturore, si dhe rrugët e zgjidhjes së tyre.

Të parët tanë të mirë -Allahu qoftë në përjetësi i kënaqur prej tyre– i kanë vlerësuar shumë mirë shkencat ekzistuese dhe dijet e natyrës në kohën e tyre dhe janë munduar ta kuptojnë Kuranin në masën që ua lejonin rrethanat e kohës. Në ato ditë nuk kishte as teleskop, as mikroskop e as rreze X. Por sot, Zoti i Madhëruar na i ka falur neve mundësi të tilla. Krahas kësaj, në mënyrë që ato çështje që ju ndieni e ushqeni për së brendshmi të mund t'i bëni bëni të dëgjohen e të ndihen në të katër anët e botës, Ai ka pasur mirësinë të na dhurojë mundësi kaq të mëdha si televizioni apo interneti. Për mendimin tim, duke i vlerësuar siç duhet të gjitha këto mundësi, duhet punuar me mish e me shpirt që të arrihen sahabët. Ata, në vitin '40 të Hixhrit, mbërritën në Sindabad, ndërsa në vitin '80 u vunë në zotërim të Horasanit. Hordhitë mongole, që u shpartalluan përballë Ahnef ibni Kajsit, thoshin: “Me këta nuk luftohet!”

Natyrisht që sot, ne nuk mund të luftojmë me shpatë e kamë, me heshtë e hark; me rregullat e smeralda të Kuranit, me vlerat tona njerëzore, të përvetësuar në karakterin tonë, me fuqinë tonë të pareshtur të përfaqësimit, me sjelljet e qëndrimet tona të drejta, që gjithmonë shpërfaqin të ecurit në të njëjtin drejtim, duhet të përpiqemi për të arritur një nivel të tillë dhe bukuritë e Kuranit duhet të mundohemi që t'ua përçojmë ndjesive të mbarë botës. Por përpara gjithë kësaj, në drejtim të kuptimit e të përmbajtjes, duhet ta shtjellojmë e ta zgjidhim çështjen në mesin tonë. Përndryshe, vetëm duke qëndruar në xhami e duke recituar atje ngandonjë mukabele të rastit, nuk e arrijmë dot një qëllim të tillë. Me këto shprehje të miat, nuk kam ndërmend ta nënvlerësoj të lexuarit e mukabelesë në xhami. Kjo është një traditë shumë e bukur. Por unë jam i mendimit se më e rëndësishmja është që të pyesim: “Cili është vullneti i Zotit dhe qëllimi hyjnor në këto ajete?” Dhe duke shtruar këtë pyetje, t'i kushtojmë rëndësinë e duhur thelbit, kuptimit dhe përmbajtjes.

E pra, të gjitha këto duhen shtjelluar në kuvende e biseda, duhen analizuar e parashtruar gjykimit të përbashkët. Nëse kjo do të mund të bëhet, atëherë horizonte të reja do të çelen dhe do të mund ta vëmë në vend atë përgjegjësi historike që na ngarkon koha.

[244] El-Hakim Et-Tirmidhi, Nevadiru'l-usul 4/98.

[245] Shih: Dharijat, 51/56.

[246] Shih: Bediuzaman, Rrezatimet f. 166-167 (Rrezatimi i shtatë, Porta e dytë).

[247] Nur, 24/11.

[248] Shih: Buhari, Shehadat 15, Megazi 34, Tefsiru sure (24) 6; Muslim, Teube 56.

[249] Shih: Buhari, Shehadat 15, Megazi 34, Tefsiru sure (24) 6; Muslim, Teube 56.

[250] Bekare, 2/1-2.

[251] “Për ata të përkushtuar që besojnë në botën e padukshme (gajb)” (Bekare, 2/3)

[252] Bekare, 2/3.

[253] Bekare, 2/3.

[254] Bekare, 2/4.

[255] Bekare, 2/4.

[256] Bekare, 2/4

[257] Bekare, 2/5.

[258] Bekare, 2/5.

[259] “Lavdia i përket veç Allahut, Zotit të botëve.” (Fâtiha, 1/2)

[260] Nas, 114/6

[261] Shih: Bediuzaman, Letrat f. 451 (Letra e Njëzetënëntë, Pjesa e gjashtë).

Paria e shoqërisë dhe pushtimi i zemrave



Pyetje: Çfarë rruge e mënyre komunikimi duhet ndjekur për t’u përçarur vlerat njerëzore atyre bashkëbiseduesve që, duke marrë parasysh hollësi si vendin ku jetojnë, ushqimin që konsumojnë, automatjetin që përdorin etj., e shohin veten në një pozitë më të ndryshme e më të lartë?

Përgjigje: Edhe në vendin tonë, sikurse ndodh rëndom në çdo skaj të botës, ekziston një mendësi që vlerëson duke marrë si bazë fuqitë dhe mundësitë materiale, që nuk sheh kurrkënd tjetër veç vetvetes, që synon ta skicojë botën sipas ëndjeve e dëshirave egoiste dhe që i sheh të tjerët me një sy nënvlerësues e qesëndisës. Kjo mendësi, madje, e ka ruajtur gjithmonë ekzistencën e saj thuajse në çdo kohë në rrjedhën e historisë dhe, me shumë gjasë, edhe në të ardhmen do të vazhdojë të ekzistojë. Por krahas kësaj, duhet të dimë se ky koncept, që mund ta quajmë sistem kaste, jo gjithmonë ka sunduar fatin e njerëzimit dhe në periudha të caktuara është rrudhur e ka humbur forcë, duke u kufizuar në një hapësirë të ngushtë; ndaj edhe nuk ka mundur ta shfrytëzojë e ta robërojë shoqërinë në vargonj. Dhe duke qenë se nuk ka gjetur hapësirë, një mendësi e tillë nuk ka infektuar apo nuk ka mundur të infektojë çdo anë të shoqërisë.

Ndërkohë, duhet pohuar se këtyre anëve negative që shfaqen, nuk duhet t’u krijojmë mundësinë që, kundrejt zvetënimeve e zemëratave të mendësisë oligarkike, të çojnë në mizori e në përdorim të dhunës dhe që, sapo t’u krijohet mundësia, të shtienë në dorë të gjitha hapësirat. Nga njëra anë, duhet ta pranojmë si një të vërtetë të hidhur se njerëzit që duhej t’i dilnin për zot së vërtetës kanë rënë në shkujdesje, shkarje, mungesë të llogaridhënies e të planifikimit dhe kjo ka shkaktuar një përfundim të tillë. Sepse pa e merituar e pa e pasur hak, kurrkush nuk shtypet nën sundimin e atyre mizorëve. Ligjërimi i Mrekullueshëm i Kuranit urdhëron e thotë: “Dhe çfarëdo fatkeqësi që t’u bjerë mbi krye, vjen prej asaj çfarë kanë bërë duart tuaja.” [262] Pra, jemi njoftuar se edhe fatkeqësitë që na ndodhin, e kanë burimin te punët e te veprat tona. Pra, në njëfarë kuptimi, Kurani na thotë se “ato çfarë ju tjerrin mendjet, ato hile e intriga, viktimitë e të cilave keni rënë, i keni bërë me duart tuaja.” Po a i bën keq njeriu vetvetes me duart e veta? Po, i bën. Sepse nëse njeriu bie në dashurinë për egon dhe e harron qëllimin për të cilin është krijuar, nëse bie në një shkujdesje që nuk i lejon të shohë as të sotmen e as të nesërmen, ahëre i bën keq vetes me duart e veta. Ndaj edhe një çështje e tillë negative nuk mund t’i ngarkohet kurrsesi paracaktimit hyjnor, por vetëm neve vetë. Nëse, pavarësisht gjithë këtyre lënieve pas dore e shkujdesjeve, mbetet ndonjë bukuri a

mirësi, ajo është prej Allahut. Jam i mendimit se çështjen duhet ta konstatojmë që nga fillimi e ta trajtojmë në këtë mënyrë.

Heronjtë e vullnetit që thonë: “Nuk e jap të drejtën time”

Nëse do t'i kthehemi çështjes sonë fillestare, është e vërtetë se sot, në shumë vende të botës, ju përballeni me të njëjtën tablo. Domethënë, ato klasa e grupe shoqërore që mbajnë në duar kapitalin, që kanë shtënë në dorë pushtetin, që i shohin të tjerët me vështrim përçmues e nënvlerësues, ndërsa veten e shohin plot krenari e mendjemadhësi, sikur të kishin kapur qiellin, duket sikur kanë në dorë fatin e shoqërive. E kundrejt kësaj tabloje të hidhur, ajo që duhet bërë është që udhëtarët e së drejtës e të së vërtetës, me largpamësi e guxim, t'i njohin të drejtën e t'i japin hakun vullnetin të tyre kundrejt padrejtësive. I ndjeri Mehmet Akifi nga Peja shkruan diku se ai që thotë: “Nuk e jap të drejtën time”, po tërheq vëmendjen që ka në zotërim një të drejtë. Kjo nuk do të thotë që kundrejt padrejtësive të bërtasim e të ulërasim. Sepse të gërthiturit e të bërtiturit i vetmuar, në drejtim të kthimit të së drejtës, nuk ka kurrfarë domethënieje. Ajo çka duhet bërë që në krye të punës është që njeriu, në çështje të ruajtjes së të drejtës së vet, të mbajë një qëndrim të zgjuar, syçelë e të vendosur. Nëse pavarësisht gjithçkaje, individit ia rrëmbejnë të tjerët të drejtën, atëherë ai, në përpjekjen për të rifituar atë që i takon, duhet të marrë parasysh çdo sakrificë, me largpamësi e guxim, brenda kufijve të drejtësisë e duke respektuar ligjin, dhe në mënyrë të vendosur, duhet të bëjë përpjekjet e veta për të rimarrë të drejtën që i takon.

Veç kësaj, në këtë çështje, kurrsesi nuk duhet të biem në humbje të shpresës. Sepse nëse merret parasysh historia e njerëzimit, do të vërehet se grupimet që kanë jetuar në kurriz të njerëzve të tjerë nuk e kanë ruajtur dot përgjithmonë pozitën e tyre dhe se gjithnjë ka ardhur dita që udhëtarët e së drejtës e të së vërtetës, pas shembujsh të bukur të përfaqësimit, e kanë kuptuar se ku kanë gabuar dhe kështu, janë rikthyer prej rrugës së gabuar e ia kanë dorëzuar vetveten drejtësisë dhe të vërtetës. Për shembull, nëse vështrojmë kohën e Profetit tonë të nderuar, bëhemi dëshmitarë të ndryshimeve e të shndërrimeve të tilla. Siç e dini, mes njerëzve të parë që i besuan të Dërguarit të Dy Botëve (s.a.s.), kishte njerëz si Bilal Habeshiu, Zejd ibni Harithe, Ammar ibni Jasiri, që prej shoqërisë së kohës nënvlerësoheshin e fyheshin. Veç kësaj, Abdullah ibni Mesudi, që mund ta cilësojmë si themelues të Mektebit të Kufës, prej të cilit kanë mësuar e përfituar imamë të shquar të tabiinëve si Ibrahim en-Nehai, Eused ibn Jezid, Akame ibni Kajsi, kur u njoh me Islamin, e siguronte jetesën duke punuar si çoban. [263] Edhe Aliu (r.a.), që ishte ndër besimtarët e parë, [264] ishte një njeri ndër më të varfrit. [265] Edhe gjendja e Xhafer ibn Ebi Talibit (radijallahu anh) nuk ishte e ndryshme nga ajo e Aliut (r.a.). Siç shihet, brenda asaj radhe të parë të njerëzve që i besuan që në fillim të Dërguarit të Allahut, kishte plot njerëz që jetonin në varfëri, që shtypeshin e dëboheshin.

Po kështu, siç tregohet në librat e hadithit e të Sijerit, kur Herakliu shkoi në Antioki, i Dashuri ynë e Kreu i Krijësive (alejhi elfu elfi salatin ues'selam) dërgoi tek ai në emër të vet Dihjen e nderuar (r.a.). Në atë kohë, atje ndodhej Ebu Sufjani. Herakliu i bëri shumë pyetje Ebu Sufjanit në lidhje me Zotërinë tonë, të Dërguarin Fisnik. Njëra prej këtyre pyetjeve ishte edhe se kush ishin ata që i besonin të Dërguarit të Allahut. Ebu Sufjani iu përgjigj kësaj pyetjeje me fjalët: “Me të bashkohen të varfrit e popullit.” [266] Ebu Sufjani, që ishte prej fisit të Beni Umejes, në atë kohë ishte armiku i betuar i të Dërguarit të Allahu (s.a.s.). Por pavarësisht kësaj, Ebu Sufjani iu përgjigj drejt e pa gënjeshtër pyetjeve që i bëri Herakliu.

Prijësit si Kozroi dhe zemrat që zbuten

Por siç do të shihet me kalimin e kohës, ata që kanë qëndruar pa u tutur, sado të varfër të ketë qenë në fillim, ka ardhur dita dhe kanë nisur të formojnë parinë e shoqërisë, individët që ne i kemi cilësuar si heronj, duke filluar të grumbullohen në rrethin e ngushtë të Kreut të Krijesave (alejhi elfu elfi salatin ues'selam). Për shembull, një njeri shumë i nderuar si Hamzai (r.a.), një ditë, kundrejt fjalëve të pahijshme e të pavend që thuheshin kundër Zotërisë sonë, Profetit, u ndez në zellin e tij njerëzor dhe, në një mënyrë, ngriti krye kundër padrejtësisë. [267] Kjo do të thotë se një prijëse e tillë ekzistonte në natyrën e një shpirtin e tij prej xhevahiri. Ndoshta kishte përjetuar një ngurrim të përkohshëm. Por kur erdhi koha, u lidh në një mënyrë të tillë pas çështjes së Allahut, sa që ju e dini se si fluturonte ai në Betejën e Uhudit. Ashtu që Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.), na bën të ditur se emri i tij në qiej është shkruar si “Luani i Allahut”. [268] Madje edhe Ebu Sufjani, që deri në çlirimin e Mekës jetoi gjatë gjithë kohës në perversitet, pas asaj dite zuri vendin e tij pranë të Dërguarit të Allahut. [269] Edhe bijtë dhe nipat e tij, po kështu, i dolën zot çështjes së Islamit.

Nga ky këndvështrim, brenda asaj pakice oligarkike që e sheh veten në shkallën më të lartë të sistemit të kastës dhe që sillet sikur të ishte e drejta e saj që të shkelë të drejtën e të tjerëve, do të dalin “sa e sa shpirtra të dëlira, sa e sa mbretër me fytyrë të trëndafilte, sa e sa prijës si Kozroi”, të cilët do t’i vënë shpatullat çështjes së njerëzimit. Edhe në ditët tona, në raste nga më të ndryshmet, mund t’i shihni shenjat e kësaj dukurie. Ndoshta edhe në mos qoftë si shi, një pikël vese e rënë mbi gjethnajë mund të shihen si shenja të tilla. Për shembull, edhe ju keni qenë dëshmitarë se si disa individë nga shtresat më të larta të shoqërisë, duke e vlerësuar lëvizjen e arsimit, të nisur prej njerëzve të Anadollit, kanë ofruar ndihmesën e tyre duke thënë: “Nëse më lejoni, do të doja edhe unë të hap dikur një shkollë që t’i shkojë për shtat kërkesave të kohës!”

Po, po. Hidhuni një sy qyteteve si Stambolli, Ankaraja, Izmiri, shkoni në Gaziantep, që andej në Ankara e pastaj në Antalja, në viset e ndryshme të vendit tonë, dhe do të shihni se njerëz nga shtresa nga më të ndryshmet u kanë dalë për zot njerëzve të vënë në shërbim të arsimit. Për shembull, pak kohë më parë, shokët tanë, në një vend diku në zonën e Mesdheut, më kishin thënë se një person kishte hapur i vetëm një universitet dhe një tjetër individ që e kishte parë atë, kishte ofruar ndihmesën e tij duke thënë: “Edhe unë dua të hap një universitet.” Me sa duket, njerëz që kishin parë se çështjes së arsimit, gjer më sot, nuk i ishte dalë për zot në mënyrë serioze, kanë vërejtur se në ditët tona, investimet e bëra në arsim janë përdorur siç duhet, nuk janë shpërdoruar, se me to është rritur një brez i ri si xhevahir, plot dashuri e tolerancë, i pajisur me dije e me edukim të mirë, ndaj edhe kanë krijuar bindjen për vlerën e kësaj pune dhe kanë lidhur zemrat me të.

Qëllimi se pse i them të gjitha këto, është ky: mbartja e paragjykimeve negative për njerëzit që kanë pasuri tokësore dhe janë të rrethuar nga të mirat materiale dhe, për këtë shkak, shmangia e vendosjes së lidhjeve me ta, nuk janë produkt i një këndvështrimi të drejtë. Për ta thënë ndryshe, është e gabuar që në një çështje që i intereson gjithë shoqërisë, siç është arsimit, t’i kërkohet ndihmesë vetëm fukasës së Anadollit apo njerëzve të shtresës së mesme. Ndoshta në një kohë të caktuar, ky ishte një orientim i domosdoshëm. Ashtu ishte e nevojshme atëherë. Ata të varfër që u kemi thënë “njeriu i Anadollit”, në krye të punëve, bënë çdo sakrificë e vullnetarizëm; në fillim, ata e pëlqyen e i dolën për zot lëvizjes së dijes e të edukimit. Por sot, për mendimin tim, duhet të lartësojmë edhe më përpjekjen dhe duhet të bëjmë që çështja e arsimit, që mund ta cilësojmë si çështje kryesore të kombit, të mbërrijë te gjithkush.

Në mos Ebu Xhehli, shpëtoi Ikrimja

Për ta përmendur si shembull, po them: Tabloja e Krenarisë Njerëzore (alejhi elfu elfi salatin ues'selam), kush e di sa herë ka trokitur në derë të “Atit të Injorancës”, siç i kemi thënë Ebu Xhehli, dhe pavarësisht të gjitha të këqijave, sa e sa herë ia ka paraqitur atij mesazhin e vet. Sepse Ebu Xhehli i përkiste parisë së Beni Mahzumit. [270] Nëse ndodhte që ai të pranonte Islamin, i gjithë fisi do ta ndiqte atë nga pas. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (alejhi ekmelut'tehaja), në emër të idealit që mbartte, nuk u thye kurrë përpara tij dhe politeistëve të tjerë, punoi me mish e me shpirt dhe duke vlerësuar çdo rast që i jepej, shfaqej vazhdimisht në prag të derës së tyre. Po, po. Ai sulltan i botëve, Prijësi i Dy Botëve, që yjet do t'i shtroheshin si gurë kalldrëmi nën këmbë, vente e vinte për t'u përcjellë atyre mesazhin. Po edhe pse nuk ishte e shkruar që Ebu Xhehli të fitonte besimin, Zotëria i Zotërinjve (alejhi salauatullahu ues'selamuh), me mirësjelljen, dashamirësinë dhe dhembshurinë e tij, ndikoi te biri i tij, Ikrimja, dhe ky i fundit një ditë besoi. [271] Pastaj deshi të vinte në vend atë burrëri, që në kohën e vet nuk kishte mundur ta përmbushte. Si për t'i fshirë të gjitha gjurmët e papastërtisë së të shkuarës, shpërfaqti një guxim e trimëri të tillë duke marrë, ndoshta, pesëdhjetë plagë gjersa në Betejën e Jermukut ra dëshmor. [272] Unë habitem se si është e mundur që një njeri, brenda dy a tri vitesh, të arrijë një përsosje të tillë njerëzore? Siç e dini, përpara se të ndërronte jetë, Ikrimen e plagosur e mbartën në çadër dhe e shtrinë aty. Mbi krye i qëndroi nusja e tij, që qe bërë shkak për pranimin e Islamit prej tij dhe pastaj e kishte marrë për dore e e kishte dorëzuar te Zotëria ynë, I Dërguari Fisnik. Për një çast, Ikrimja (r.a.) e drejtoi pak trupin, ngriti kryet dhe tha: “Ti erdhe, o i Dërguar i Allahut? A e kreu detyrën?” Sepse ai, kur ishte dorëzuar bashkë me shpatën e vet te Zotëria ynë, Profeti (salallahu alejhi ues'sel'lem), i kishte dhënë Atij fjalën se do t'ia jepte shpatës hakun.

Pranimi i Islamit prej asaj partie njerëzish që mund t'u themi heronj, pati ndikim edhe te njerëzit e tjerë dhe kjo gjendje u bë shkak që ata të hyjnë turma turma në Islam. Kështu, pas çlirimit të Mekës, kur i panë krejt grupimet e fiset të bashkohen në mënyrë të veçantë rreth Kreut të Krijimit (alejhi efdalut'tahij'jat ue ekmelut'teslimat), edhe fiset më të largëta thanë: “Meqë paria e Mekës, udhërrëfyesit, krerët e pishtarët tanë kanë pranuar Islamin, atëherë edhe neve na ka ardhur radha të hyjmë në Islam.” Dhe kështu, u bënë myslimanë. [273] Nga ky këndvështrim, individit mysliman e ka për detyrë që t'i vlerësojë të gjitha mundësitë, të ecë me shumë alternativa dhe pa u mërzhitur, pa u zhgënjyer, pa u hidhëruar e pa u ndier keq, të ndalet e të trokasë në portën e gjithkujt. Ndoshta kur ju ta bëni këtë, dikush mund t'ju quajë të prapambetur apo fanatikë, apo ndoshta edhe me fyerje të tjera. Por kjo është një çështje e tillë, që ka të bëjë drejtpërdrejt me të fituarit apo me humbjen e jetës së përjetshme prej njerëzve.

E pra, nëse mesazhi juaj është një shkak i fshehtë i i magjishëm, një çelës që ata të fitojnë jetën e Parajsës, në mënyrë që ta vëmë këtë çelës në duart e tyre, për mendimin tim, ia vlen edhe që të puthen pesëdhjetë herë duar e kinde rrobash. Nga kjo pikëpamje, shërbëtorët e Kuranit, duke u sjellë “pa duar ndaj atij që i godet, pa gjuhë e pa zemër ndaj atij që i fyen”, nuk duhet të kapen pas këtyre gjërave. Nuk mund të mendohet që zemrat që kanë besuar të mos ndihen keq kur shahen Allahu apo Zotëria i Zotërinjve (alejhis'salatu ues'selam). Por për t'i shkukur kësi lloj negativitetesh, kësi lloj sharjesh nga zemrat e atyre njerëzve që nuk i njohin Allahun dhe të Dërguarin e Tij, duhen përpjekje e mundime të mëdha dhe lipset të qëndrojmë të vendosur. Ju, pa ditur të zhgënjeheni e të mërzhiteni, duhet të tregoheni aq këmbëngulës në këtë çështjes, sa që ndoshta bashkëbiseduesit tuaj të mund të thonë: “Prapë ju?” Dhe ju, duke buzëqeshur, do të thoni:

“Po, prapë erdhëm ne!” Gjithmonë do të trokisni në dyert e tyre me diçka të re. Në paçi shkuar një herë me një pjatë supë, për së dyti të shkoni me një tas hashure. Një tjetër herë trokituni në derë me një enë me byrek. E një tjetër herë shkoni e u thoni: “Dëgjova diçka të bukur për ty. Erdha të ta them që të të gëzojë zemra.” Shkurt, duke përdorur gjithmonë nganjë argument të ri, për t’u bërë shkak për shpëtimin e atyre njerëzve dhe në këtë mënyrë, për të fituar kënaqësinë dhe dashamirësinë e Zotit të Madhëruar, pa u mërzhitur, pa u zhgynjyer, do të vijoni të trokisni.

[262] Shura, 42/30.

[263] Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 1/379; Ibn Hibban, Es-Sahih 15-536.

[264] Tirmidhi, Menakib 20; El-Bezzar, El-Musned 9/322; Ibn Ishak, Es-Sire 2/118.

[265] Shih: Et-Taberani, El-Mu’xhemu’l-kebir 7/174.

[266] Buhari, Bed’u’l-vahj 6; Muslim, Xhihad 74.

[267] Shih: Ibn Ishak, Es-Sire 2/151-152; Ibn Hisham, Es-Siratu’n-nebeviyye 2/129.

[268] Et-Taberani, El-Mu’xhemu’l-kebir 3/149; el-Hâkim, El-Mustedrek 3/149.

[269] Shih: El-Bejhaki, Delailu’n-nubuvve 5/102; Ibn Asakir, Tarihu Dimashk 23/458.

[270] Shih: Ibn Ishak, Es-Sire 4/191; Ibn Ebi Shejbe, El-Musanef 7/255-256.

[271] Shih: Ibn Asakir, Tarihu Dimashk 41/55-56.

[272] Shih: Ibn Ebi Shejbe, El-Musanef 4/227; El-Hakim, El-Mustedrek 3/270; Ibn Abdilberr, el-Istiab 3/1084.

[273] Shih: Ibn Hisham, Es-Siratu’n-nebeviyye 5/248-249; Ibnu’l-Esir, El-Kamil fi’t-tarih 2/157-161.

Lojërat e pista dhe burrëria e besimtarit



Pyetje: Qoftë brenda vendit, qoftë jashtë, vihet re se, me pretekst të ngjarjeve të dhunës e të terrorit, ekziston synimi, që myslimanët, me një qasje kolektive, të vihen në pozitën e të dyshuarit. Si i vlerësoni këto ngjarje dhe cili është qëndrimi që besimtari duhet të mbajë kundrejt tyre?

Përgjigje: Së pari, po e pohoj sakaq, se unë nuk e kam besuar kurrë që këto ngjarje t'i ketë përgatitur, planifikuar e vënë në jetë ndonjë organizatë e përbërë prej myslimanësh. Kam bindjen se çdo njeri me mendje e shëndoshë, që, në njëfarë mënyre, i analizon këto ngjarje në tërësinë e tyre, nga fillimi e gjer në fund, me anën e tyre të dukshme e të padukshme dhe me një gjykim të drejtë, do të jetë i të njëjtit mendim me mua. Sepse nëse shihen figurantët e ngjarjeve të tilla, që ndodhin nga Perëndimi në Lindje, nga Veriu në Jug dhe synohen të tregohen si të lidhura me myslimanët, vërehet se figurantët në fjalë, sado që të mbartin emra myslimanësh, nuk janë veçse vrasës gjakatarë, të marrë me qira për një lojë shahu që luhet nga rrjetet e së keqes, të qendrave të pushtetit e të shërbimeve që duan ta formësojnë botën sipas mendësisë së tyre, ose thjesht shpirta të robotizuar që ua kanë marrë mendtë me ndonjë bar, që ua kanë hequr nga duart vullnetin e vet dhe që ua kanë paralizuar mendimet.

Islami nuk e ligjëron kurrsesi terrorin

Për të ardhur te lidhja e çështjes me Islamit, duhet ditur mirë se që në krye të punës, parimet themelore të Islamit nuk lejojnë që të shkaktohen të tilla ngjarje. Po, po. Edhe një njeri me njohuri krejt sipërfaqësore, që ka njëfarësoj informacion rreth Islamit, e di se asnjë mysliman, nëse vendi i tij pushtohet apo i merret liria, nuk mund të ngrihet e të shpallë luftë i vetëm, as nuk mundet që, në emër të luftës për liri, të vërë në shënjestër njerëzit e pafajshëm. Një mendësi të tillë, është e pamundur ta shpjegosh me logjikën e një myslimani. Në fenë tonë, lufta mund të bëhet vetëm në përmasat e krejt vendit, me organizimin e gjithë kombit dhe vetëm duke mos cenuar rregulla të caktuara. Kurrkush nuk mund të paraqesë një formë luftimi që bie në kundërshtim me parimet dhe disiplinat e vendosura prej fesë. Nga ky këndvështrim, siç e kam shprehur shumë herë edhe më parë, me lejen tuaj, po e përsëris edhe një herë: Terroristi nuk mund të jetë mysliman dhe po kështu, myslimani nuk mund të jetë terrorist. Për ta shprehur në mënyrën më absolute e më të plotë, duke thënë se “terroristi mysliman e myslimani terrorist nuk mund të jetë”, duam të shpjegojmë se një njeri që është i hapur ndaj shpirtit dhe thelbit të Islamit nuk mund të bëjë kurrë diçka të tillë.

Nëse një njeri, edhe pse thotë të jetë mysliman, bën një punë të tillë, atëherë në të qenët e tij mysliman ka një mangësi e boshllëk, që nuk mund të shpjegohet në thelbin e në perspektivën e Islamit. Për ta shprehur më mirë atë që kam në mendje, po ju sjell një hadith nga Zotëria ynë, Profeti (s.a.s.), në lidhje me një tjetër çështje. Tabloja e Krenarisë Njerëzore (alejhis'salatu ues'selam) urdhëron e thotë: “Ai që bën imoralitet, kur është besimtar, nuk bën imoralitet; ai që pi, kur është besimtar, nuk pi; dhe ai që vjedh, kur është besimtar, nuk vjedh.” [274] Ky hadith shpjegon se një njeri që beson, kur është në vetëdijen e besimit, nuk bën dot imoralitet, nuk vjedh dot, nuk pi dot alkool. Për ta shprehur ndryshe, hadithi tërheq vëmendjen se ai që bën imoralitet, që vjedh e që pi alkool, së paku gjatë kohës që i kryen këto mëkate, nuk është besimtar i vërtetë.

Për ta shpjeguar këtë hadith, vërejmë se janë bërë disa interpretime të rënda. Unë nuk do të hyj në to. Por sipas mendimit tim, çështjen mund ta kuptojmë në këtë formë: Ai që i beson Allahut (xh.xh.) siç i duhet besuar, që beson se në jetën tjetër do t'i japë llogari Allahut për mëkatet e kryera, që pranon ringjalljen, Xhenetin dhe Xhehenemin, për sa kohë që tek ai mbizotërojnë këto ndjenja, nuk mund të mendohet që të bëjë mëkate. E pra, në këtë kuptim, një terrorist, në çastin që ushtron terror, nuk është besimtar. Po, po. Një njeri, për sa khë që është besimtar në kuptimin e pastër e të plotë, kurrësi nuk përzihet, nuk mund të përzihet me terrorizmin.

Prandaj edhe unë nuk e kam besuar kurrë që aktet e terrorit që ndodhin andej këtej të jenë organizim i myslimanëve të vetëdijshëm. Madje edhe për figurantët e frikshëm të këtyre ngjarjeve, jam i mendimit se ata tani nuk janë në jetë. Sepse edhe disa emra që disa i nxehin e i nxehin dhe na i servirin në pamje e në video nga interneti, as që e dimë nëse tani ekzistojnë apo jo.

Papastërtia e informacionit dhe njerëzit naivë

Nga ana tjetër, si në të djeshmen, ashtu edhe në të sotshmen, rrjetet e së keqes dhe vatrave e errësirës nëpër botë, veçanërisht ata që kanë një qëndrim të qartë kundër Islamit, gjithmonë kanë përdorur të njëjtat armë dhe kanë luajtur të njëjtën lojë. Këta, për të përballuar nevojat e paranojës, në një atmosferë frike e paniku që krijojnë, nxisin tmerr te njerëzit dhe bëjnë që ata të jetojnë me zemër të drithëruar. Le të themi se ata bëjnë atë çka ua kërkon karakteri i tyre, por nga ana tjetër, sa e hidhur është që edhe në vendin tonë ngjarjet nuk i nënshtrohen shqyrtimit të kujdeshëm e të guximshëm dhe ka njerëz që mund t'i quajmë naivë, të cilët i besojnë në çast lajmet dhe fjalët e prodhuara prej vatrave e qendrave të caktuara të pushtetit nëpër botë.

Në të shkuarën, kur ndodhi një ngjarje e tillë, u pata thënë njerëzve që kisha pranë: “Ndërsa ka qindra mundësi në lidhje me autorësinë e ngjarjes, ndërsa ka një perde të thellë mjegulle në lidhje me mënyrën se si është zhvilluar ngjarja, pse ndodh që disa njerëz e besojnë dhe e vlerësojnë atë menjëherë siç është hedhur nëpër faqe internet apo në gazeta dhe gjykojnë sipas kësaj? Për hir të Zotit, pse këta njerëz nuk e çojnë farë nëpër mend se gjërat mund të kenë ndodhur edhe krejt ndryshe?” Sepse në botën e njerëzve mizorë, nuk ka ndonjë standard vlere veç forcës, fuqisë e interesit. Në jetën e tyre të mendimit e të besimit nuk ekziston fare një koncept si gënjeshtër! Përkundrazi, ata i shohin gënjeshtërën dhe mashtrimin si mençuri dhe e jetojnë jetën e tyre sipas kësaj. Ne, si njerëz që besojmë, edhe kur themi në prani të një grupi njerëzish, “ai njeri gënjen”, pra, kur shpjegojmë për gënjeshtërën e tjetërkujt, ndiejmë turp; e nëse jemi të detyruar ta shpjegojmë këtë situatë, themi duke kërkuar ndjesë: “Të më falni që një fjalë të shëmtuar si gënjeshtër e

përmenda në praninë tuaj.” Kjo buron prej edukatës që na ka dhënë Islami dhe është nevojë e kulturës që buron prej Islamit. Po, po. Duke qenë se në kulturën tonë është turp që një njeriu që thotë, t’i thuhet drejtpërdrejt “gënjeshtar”, çështja paraqitet duke thënë se ai “dëshmon në kundërshtim me ç’ka ndodhur”. Por – të më ndjeni – përse i besojmë menjëherë asaj që thonë ata të cilët gënjeshtren dhe mashtrimin i kanë kthyer në stil jetese dhe përse nuk e marrim parasysh që ata mund të na gënjejnë? Për shkak të gënjeshtreve që këta njerëz kanë nxjerrë gjer më tash dhe për shkak të atij karakteri që na kanë treguar gënjeshttrat e tyre, a nuk duhet ta çojmë nëpër mend se gjithçka mund të jetë krejt ndryshe nga ç’pritet? Por fatkeqësisht, fjalëve që thuhet, lajmeve që lexojmë, u besojmë menjëherë dhe çështjet i interpretojmë e i vlerësojmë po sipas kësaj. Nuk e harroj asnjëherë, kur një person që kishte qenë ambasador diku, një a dy orë pas një ngjarjeje tragjike që kishte ndodhur, doli e tha “këtë punë e bëri filani”. Ai person, megjithëse ishte aq i paditur në atë fushë, saqë edhe emrin e njeriut që fajësonte, e shqiptonte gabim, prapëseprapë nuk ngurronte fare që të jepte gjykimin e vet.

E pra, për shkak të papastërtisë së informacionit dhe të keqduhëzimit, për fat të keq, në përfundim të çdo ngjarjeje, imazhi i dëlirë i Islamit është përbaltur, në fytyrën e tij të ndritur është hedhur dhe vazhdohet të hidhet katran. Sipas asaj fjalës që qarkullon ndër njerëzit, “shpif, shpif, se diçka do të mbetet.” Sa e dhimbshme është që në imazhin e myslimanit të ditëve tona është hedhur një baltë e tillë dhe sa keq që gjurma që ka mbetur është e madhe!

Kjo është ajo që ka ndodhur. Përballë asaj që ka ndodhur, ajo çfarë duhet bërë është që pavarësisht të gjitha keqinformimeve dhe shpifjeve, të shpjegohen e të tregohen kudo, me përfaqësim të mirë e të bukur, kuptimi dhe identiteti i vërtetë i Islamit. Duhet të përmendim pa u lodhur se ngjarjet me autorësi të panjohur janë vepër e njerëzve që nuk përfaqësojnë thelbin e Islamit. Duhet të tregojmë se një mysliman i vërtetë ia zgjat dorën gjithkujt, ia hap zemrën gjithkujt. Thirrjen e mëshirës së Islamit, që vjen prej paqes e shpëtimit, duhet t’ia përçojmë mbarë njerëzimit nga Amerika në Evropë, nga Lindja e Largët në Afrikë.

Urat e dialogut dhe largimi i frikës së pabazë

Llogarisni që përcjellja e kësaj të vërtete në të gjitha zemrat nuk është punë që bëhet në çast, por është e lidhur me një proces që zgjat. Ato çka kanë shkarravitur prej vitesh kundër Islamit qoftë një pjesë prej pjesëtarëve të disa feve, qoftë prej orientalistëve, i ka përbaltur aq frikshëm mendjet e gjykimet, saqë nuk mundeni ta fshini e ta pastroni brenda menjëherë. Fundja edhe nëse ju i ekspozoni në çast të gjitha bukuritë e Islamit si në një ekspozitë, njerëzit nuk i asimilojnë dot ato në çast. Duhet t’u njihni atyre mundësinë që, teksa qëndroni mes tyre, ata të mund t’ju njohin e të mësojnë. Pikëpyetjet që kanë në kokë, si për shembull, “tani thonë kështu, por a do të thonë vallë të njëjtat gjëra pasi të forcohen e të kenë në dorë disa gjëra?”, duhet t’ua davarisni me veprat qëndrimet e me sjelljet tuaja konkrete. Për dhjetë vite me radhë le të ndiejnë pulsën tuaj e të shohin se si rreh zemra juaj. Le të kalojnë dhjetë vite e t’jua masin sërish pulsën, të shohin se ai rreh njëlloj. Kështu, dhjetë, njëzet, tridhjetë vite do t’ju vënë në provë. Nëse ju, gjatë këtij procesi, qëndroni në të njëjtin vend, nuk ndryshoni asgjë nga mënyra e të shprehurit tuaj, ata do ta shohin këtë dhe do të krijojnë një gjykim e qëndrim për ju në përputhje me këtë.

Po, po. Nga njëra anë, do të shpjegoni thelbin dhe parimet e vërteta të Islamit; nga ana tjetër, do t'ju mundësoni atyre që t'ju dëgjojnë, t'ju shikojnë e t'ju vënë në provë. Ndoshta do të vijnë në shtëpitë tuaja, në institucionet tuaja, në vendet tuaja të punës, do t'ju njohin brenda botës suaj dhe do të krijojnë, në këtë mënyrë, një mendim për ju. Nëse mendoni që të largoni prej mendjeve të njerëzve një imazh që e kanë të ngulitur apo ua kanë ngulitur në kokë, për mendimin tim, rruga që duhet ndjekur është kjo.

Po ju jap një shembull: unë e kam shprehur sa e sa herë që nuk kam vlarë as edhe një milingonë. Po, po. Në jetën tim, as edhe një milingonë nuk kam vlarë. Madje një herë, një shok më fshiu nga rroba një milingonë, me mendimin se ajo po më shqetësonte. Megjithëse kaluan vite, nuk e harrova këtë ngjarje. Pyes veten se si ndodhi që vrau një gjallesë. Në një rast tjetër, një shoku ynë, në një kamp, zuri një gjarpër që po shkonte të pinte ujë dhe pasi e shkundi për bishti, e këputi në mes. Atij s'i fola për dy a tre muaj me radhë. Çfarë të drejte ke ti, që i heq atij të drejtën për të jetuar? Kafsha nuk po vinte të të kafshonte, po shkonte të pinte ujë. Nëse do të hapte gojën dhe do të të drejtohej si një kobër, atëherë do të ishte fjala për vetëmbrojtje. Të mos flasim, pastaj, që unë edhe në një situatë të tillë nuk do të zgjidhja ta vrisja, por të largohesha me vrap. Në fenë tonë, vetëm nëse jemi të detyruar, na është lejuar që të vrasim një gjë të gjallë, por nuk është thënë që kjo është diçka e shpërblyeshme.

Tani, një njeri, zemra e të cilit është e kyçur në të tilla mendime, a është e mundur që t'i bëjë dëm një njeriu tjetër? Të mos keqkuptohemi, nuk po rrekem të flas për veten time këtu, por vetëm po mundohem të bëhem përkthyes i botës tuaj të ndjenjave, i ndjenjave dhe i mendimeve të zemrave që besojnë. Por pavarësisht nga të gjitha këto, nëse disa njerëz ende hyjnë në fantazi të ndryshme lidhru me ju, ajo që duhet bërë përballë kësaj gjendjeje është që të bëhet durim brenda një pritjeje aktive. Karakterin tuaj, ndërtimin tuaj shpirtëror, ndjesitë tuaja, botën tuaj të brendshme, do t'i shfaqni e do t'i ekspozoni porsia në një "showroom". Gjithkush do të vijë, do të hyjë, do të shëtisë, do të shohë, do të vështrorë dhe do të çlirohet prej fantazive të këqija për ju. Ju, ndoshta, as që do ta vini re këtë proces. Ata do të vijnë, do t'ju vënë një sheshë dhe më pas, kur të vijnë sërish, do të kontrollojnë nëse e keni apo jo atë shenjë në vendin e vet. Pastaj do të vijnë prapë dhe do të shohin nëse i njëjti dizajn e e njëjta trajtë është ende aty dhe kështu, do ta shohin qenien tuaj myslimane në thellësinë e në gjerësinë e saj.

Si përfundim, largimi i një imazhi të keq që synohet të krijohet për myslimanët e ditëve tona kërkon njëfarë kohe. Çështja duhet lidhur me një kalendar dhe duhet rregulluar shumë mirë, duhen bërë përpjekje që gjërat e pahijshme e të papëlqyeshme, me anë të një procesi vazhdimësie e serioziteti, të largohen një nga një. Nëse zemrat besimtare të ditëve të sotme veprojnë me gjallëri e durim në këtë proces që kërkon një kohë të caktuar, nëse bëjnë mundime e përpjekje në përmasat e seriozitetit të çështjes, do të vijë dita që edhe kundërshtarët e tyre do të thonë për ta atë që thuhej për Tablonë e Krenarisë Njerëzore (alejhis'salatu ues'selam) dhe për sahabët e tij të shquar: "Këta njerëz janë të besës, janë përfaqësues të besimit e të sigurisë."

[274] Buhari, Mezalim 30, Eshribe 1, Hudud 1, 6, 20; Muslim, Iman 100.

Ftesë me urtësi



Pyetje: Në ditët e sotme, teksa kulturat dhe konceptet e larmishme janë trazuar me njëri-tjetrin dhe bota është kthyer në një fshat të përbashkët, në përpjekje për t’u përçarur të tjerëve frymëzimet e shpirtit tonë, në cilat çështje duhet bërë kujdes për të mos u keqkuptuar dhe për të mos shkaktuar reagime negative? A mund të na e sqaroni këtë?

Përgjigje: Kurani Fisnik, në ajetin që vijon, në suren “Jusuf”, urdhëron e thotë: “Thuaj: Kjo është rruga ime! Unë ftoj për tek Allahu me urtësi (e jo verbërisht); edhe ata që më pasojnë mua, gjithashtu...” [275] Me këtë ajet, tërhiqet vëmendja e Zotërisë sonë, të Dërguarit të Nderuar (s.a.s.), për kryerjen me urtësi e përkujdesje të detyrës së udhërrëfimit e të thirrjes në besim. Në ajet, pasi pohohet, “Kjo është rruga ime!”, urdhërohet e thuhet: “Unë ftoj për tek Allahu me urtësi.” Këtë shprehje mund ta kuptojmë në këtë formë: “Ftesa ime për tek e vërteta, udhërrëfimi dhe thirrja ime, mundësitë që kam paraqitur për të nxitur e frymëzuar mirësitë dhe bukuritë, nuk janë të kundërta me mendjen njerëzore, me logjikën njerëzore, me të kuptuarit dhe me vetëdijen njerëzore.” Domethënë që kur u bëjmë thirrje njerëzve për në besim, nuk duhen lënë pa marrë parasysh nivelet e tyre të vetëdijes, aftësitë e tyre për të kuptuar, mjediset kulturore ku ata janë zhvilluar, qëndrimi i tyre vetjak. Për ta shprehur ndryshe, të lexuarit e saktë të karakterit të përgjithshëm të shoqërisë së cilës i drejtohem, si dhe të shpjeguarit e çështjeve në përshtatje me gjendjen e tyre të veçantë dhe me nivelin e tyre kulturor, janë shumë të rëndësishme në udhërrëfim e në ftesën për në besim.

Mësuesi i nderuar, Bediuzamani, në lidhje me Kuranin, përdor shprehjen: *njerëzit*, duke tërhequr, kështu, vëmendjen se fjala hyjnore u drejtohet njerëzve duke marrë parasysh e respektuar nivelin e njeriut. [276] Pra, në Kuranin e Shenjtë, në mënyrë që ne të mund ta kuptojmë atë, është përdorur një stil i tillë, që ne të mund ta kuptojmë, që mendimtarët me dije të gjera dhe kërkimtarët e thellë të kuptojnë shumë prej tij dhe njëkohësisht ta vlerësojnë atë shumë e shumë më lart sesa niveli i tyre i të kuptuarit dhe po ashtu, edhe njerëz fillestarë si ne, të kuptojnë njëfarësoj diç prej tij sipas nivelit të tyre; të kuptojnë dhe të përfitojnë prej tij në të mirë të lumturisë së tyre në këtë jetë dhe në jetën e amshuar. Ndaj edhe çdo njeri pa paragjykime, pavarësisht nga niveli i tij, përfiton prej Kuranit dhe, për të arritur në të vërtetat e tij, ndien nevojën e vazhdueshme për të kapërcyer një shkallë më lart e për të rritur nivelin e vet.

Në vazhdim të ajetit, urdhërohet e thuhet: "*Mua dhe atyre që më ndjekin mua.*" Sipas një interpretimi, kuptimi i kësaj është ky: "Ashtu sikurse unë thirrem në urtësi, edhe ata që më pasojnë mua bëjnë thirrje në urtësi." Nisur nga ky interpretim, mund të themi se sado trashëgimtarë të çështjes profetike që të vijnë gjer në Ditën e Gjykimit, sado njerëz të ketë si interpretues të së vërtetës e të hakikatit, të gjithë këta duhet ta ushtrojnë me urtësi thirrjen e tyre në besim.

Për çfarë thonë zemrat "po" dhe për çfarë "jo"

Në ditët tona, njerëzit që janë shpërndarë në të katër anët e botës, pa dyshim që përballen me njerëz të rritur në mjedise shumë të ndryshme kulturore. Madje edhe kur biem në kontakt me shoqëritë me të cilat në të shkuarën, për një kohë të gjatë, kemi ndarë të njëjtin fat e të njëjtat të vërteta, nuk duhet të harrojmë se kemi apo mund të kemi disa ndryshime. Për shembull, sot, në gjeografinë e Lindjes së Mesme, në drejtim të shërbimeve të arsimit e të dialogut, ka një lulëzim, ka sipërmarrje shumë të bukura. Kur përballë kësaj tabloje që e mbush zemrën me gëzim, më kërkuan mendim edhe mua të varfrit, unë shpreha këto mendime: Në çdo strukturë, kundrejt të huajt ka një ndjenjë reaguese. Unë bëj dy-tri herë në ditë injeksione në trupin tim. Pavarësisht kësaj, sa herë që agia depërton, organizmi reagon dhe thotë: "Nuk mund të hysh." Pasi depërton dhe qëndron aty për një dy minuta, ahëre nuk e lëshon e thotë: "Këtë e zgjidh unë, ti mos dil." Kjo çështje, siç ndodh në ndërtimin fizik të një njeriu, është e njëjtë edhe në shoqëri. Domethënë, kur në një shoqëri hyn një mendim a botëkuptim nga një tjetër shoqëri, dashur pa dashur, do të ketë në mënyrë të pashmangshme një reagim të caktuar. Por kur vihen në dukje anët e përbashkëta, kur i bëhet thirrje arsyes së përbashkët, në masën që arrihet pajtim, ky reagim ndodh në nivelin minimal. Tani, nëse edhe shoqëritë shumë të afërta me ju, edhe më të afërta se afërsia vetë, janë të hapura për të tilla mundësi, atëherë, sipas mendimit tim, në gjeografi e kultura më të ndryshme ka shumë gjasë që të përballeni me një numër reagimesh edhe më të ndryshme. Nga ky këndvështrim, për arsye të vlerave universale njerëzore, në shoqëritë e ndryshme në të cilat zhvendoseni, duhet të jeni në kërkim të pikave të përbashkëta e të hapësirave të pajtimit. Për shembull, drejtimin dhe administrimin e një shkolle, të një universiteti, të një qendre kulture apo të institucioneve të ngjashme që mund të hapni, mund t'i delegoni me rastin më të parë në përgjegjësinë e njerëzve të atij vendi. Po, po. Në cilëndo shoqëri ku keni dërguar një shërbim, lërin shoqërinë vendëse dhe njerëzit e saj që ta çojnë më tutje atë punë. Në këtë mënyrë, tregoni edhe se në punët që bëni, nuk keni kurrfarë pretendimi a ambicieje që mund të vlerësohet si materiale dhe u prisni rrugën keqkuptimeve dhe perceptimeve të gabuara. Sipas mendimit tim, kjo lloj lëvizjeje është një mundësi e mirë për të mos u bërë shkak për reagime.

Është e vërtetë se sot, "Lëvizja e Zemrave" gjendet bashkë me shoqëritë e ndryshme që nga thellësitë e Afrikës e deri në Lindjen e Largët dhe nga vendet në kufijtë më të largët, nga Amerika e Jugut deri në Kanada, mes gjuhësh, besimesh e kulturash të ndryshme. Kështu, ajo çka duhet pasur kujdes përballë një tabloje të tillë, është që kur t'ua bëjmë të tjerëve çështjet të njohura, të mos biem në mangësi në mënyrën e prezantimit. Shoqëria së cilës i drejtohem, duhet kuptuar mirë; duhet vepruar jo përmes qasjes së një njeriu të standardizuar e të njësuar, por duke futur në llogari ndjesitë e njerëzve që gjenden në mjedise të ndryshme gjeografike e kulturore. Njerëzit me të cilët bashkëbisedojmë, kur thonë "po" dhe kur thonë "jo"; kujt ia hapin zemrat dhe kujt ia mbyllin; nëse i llogaritim të gjitha këto, kjo është shprehje e të vepruarit me urtësi.

“Erdhi dita të lë nam, po ia nis me bakllavanë!”

Kur isha me detyrë në Kërklareli, kisha dëgjuar një histori prej Furrxhi Ahmet Efendiut: na paskësh qenë një kuzhinier që përgatiste ushqime aq të shijshme, sa që po t’i vije në gojë, të vinte të kafshoje gishtat. Mirëpo ky kuzhinier nuk kishte shërbyer kurrë në jetë të vet si kamerier. Një ditë, meqë kamerieri nuk kishte ardhur, atij i ra që të shërbente. Dhe ai, pasi vuri duart në bel, tha: “Or mik, erdhi dita të lë nam; po ia nis me bakllavanë!” Edhe pse është veç një anekdotë, kjo histori shpreh shumë kuptime. E pra, ajo çka ju servirmi mund të jetë një ushqim i shijshëm si bakllavaja dhe atë bakllava ju mund ta paraqisni me ndjesi njerëzore e qëllime të mira që ju burojnë prej shpirtit. Mirëpo nuk duhet të harroni se gjithçka ka një radhë dhe se njerëzit përballë jush kanë zakone të caktuara. Nga ky këndvështrim, është shumë e rëndësishme që të bëni rregullimin kohor të thënieve e të punëve tuaja. Pra, të llogarisësh fillimin dhe fundin e punës, t’i vëresh çështjet edhe në planin e tyre të pasëm, t’i shohësh ato me një vështrim të gjerë e tërësor dhe nga fillimi gjer në fund të veprës sipas parimit shkak-pasojë, të gjitha këto janë hollësi të asaj cilësie të lartë që e quajmë urtësi.

Krahas kësaj, në kryerjen e veprimtarive shumë të rëndësishme për njerëzimin, siç janë arsimit apo dialogu, krahas planit A, gjithmonë duhet të keni edhe një plan B; kundrejt papriturave të pakëndshme që mund të shfaqen në mënyrë befash, duhet të gjeni rrugët alternative. Edhe kjo është pjesë e urtësisë. Sot, njerëzit tanë janë mirëpritur në gjeografi shumë të ndryshme, duke përçuar gëzim në zemra. Por kundrejt kësaj tabloje të bukur, është e mundur që të shfaqen një pjesë shpirttrash të pakarakter që mund të ndiejnë shqetësim prej saj dhe të mundohen të bëjnë keq. Kundrejt një ere të tillë të kundërt që mund të shfaqet, si do t’i ruajmë këto veprimtari të bukura? Si do të mund ta pengojmë shpërndarjen e këtyre të vjelave? Nganjëherë ju përpiqeni, mundoheni dhe në përfundim mund të keni grumbulluar mullarë me grurë e drithëra. Por një erë e kundërt që mund të fryjë, mund të marrë me vete gjithë të korrat që keni mbledhur dhe t’i shpërndajë ato tej. Apo një breshër që mund të bjerë, mund t’i prishë të gjithë kallinj të tuaj. Për të mos rënë viktimë e fatkeqësive të tilla, gjithçka duhet ta mendoni gjerë e gjatë dhe krahas ndjesive tuaja të mund të lexoni drejt edhe ndjesitë e të tjerëve. Ja pra, të gjitha këto duhet t’i lexoni brenda kategorisë *së atyre që i shohin gjërat me largpamësi*. Për shembull, nëse në një vend keni për qëllim që të shtrini veprimtarinë tuaj në një fushë të caktuar, para së gjithash duhet të studioni terrenin dhe të veproni sipas kësaj. Edhe shokëve që duan të bëjnë tregti, para së gjithash, unë i pyes nëse e kanë hulumtuar apo jo terrenin në vendin ku do të shkojnë. U them: “Në ç’masë paraqitet gjendja e kërkesës në atë vend për prodhimin apo mallin që doni të shisni? Në fushën që keni menduar të investoni, a mos vallë atje ka konkurrentë të fuqishëm? Nëse niseni për rrugë pa i futur këto në llogari, mund t’ju shkojë puna dëm!” Edhe në shërbimin ndaj besimit dhe ndaj Kuranit, unë e gjykoj si shumë të rëndësishëm një vlerësim të tillë paraprak të terrenit. Pra, sigurimi paraprak i terrenit, shmangia e rënies në gabime që mund t’i shqetësojnë njerëzit dhe të zgjojnë tek ata ndjesinë se po u imponohet diçka, janë rezultati i të vepruarit me urtësi.

Kujdesi maksimal për të mos u bërë shkak për shqetësime të pavend

Së fundi, më lejoni të pohoj edhe këtë: njerëzit në shekuj kanë vuajtur thellësisht e kanë qenë dëshmitarë të lëvizjeve përfituese e shfrytëzuese në vende të ndryshme të botës, nganjëherë drejtpërdrejt dhe nganjëherë në rrugë të tërthorta. Këto ngjarje që janë përjetuar, kam mendimin

se e shtojnë edhe më tepër rëndësinë e të vepruarit me urtësi. Sepse ata që janë bërë shkak për ngjarje të tilla të hidhura, siç kanë ecur vetë në këso rrugësh, mund ta interpretojnë në këtë mënyrë edhe ecjen tuaj të pafajshme. Ata mund të thonë: “Me sa duket, edhe këta duan të bëjmë si kemi bërë ne!” Më lejoni që ta përsëris edhe një herë një shembull që jua kam dhënë edhe më parë: një hajdut që shëtit para qepenave, gjithmonë sheh gjendjen e drynave dhe mendon: “Vallë, cili prej këtyre është më i dobët, cili më i kyçur, cilin prej këtyre e kam më lehtë që ta hap dhe të hyj e të zbraz dyqanin?” I zoti i dyqanit, gjithashtu, kalon atypari dhe mendon në mënyrë të pafajshme për dyqanin e vet: “Vallë, a e kyça derën e dyqanit tim?” Por hajduti, që e kap këtë vështrim të të zotit të dyqanit, thotë në çast me vete: “Me sa duket, edhe ky është prej tanëve!” Dhe e ndan mendjen se edhe ai është hajdut. Tani, nëse në një periudhë të caktuar, disa janë marrë me punë të liga, janë vendosur në ndjenjat e në mendjet e njerëzve e janë vendosur mbi to si baloz, do ta vlerësojnë po kështu edhe qasjen tuaj ndaj njerëzve me mendime krejt të pafajshme dhe do t’ju shohin si konkurrentë. Natyrshëm, si rrjedhim i kësaj, ata do të përpiqen të pengojnë çdo mirësi e bukuri që ju dëshironi të realizoni pa të keq e në mënyrë të pafajshme. Nga ky këndvështrim, shpirtrat e përkushtuara të ditëve tona janë të detyruar të veprojnë me sa më shumë përkujdesje, vetëpërmbytje e urtësi. Nëse nuk tregohet një ndjeshmëri e tillë, atëherë, Zoti na ruajtë, i bëni dëm shportës së vezëve që mbani të ngarkuar mbi kurriz dhe e tradhtoni amanetin.

[275] Jusuf, 12/108.

[276] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 419 (Fjala e Njëzetepetë, Drita e Parë, Rrezatimi i parë).

Martesa dhe jeta familjare



Pyetje: Në ditët tona vihet re se prishja e harmonisë në familje dhe prishjet e martesave janë shtuar. Çfarë këshilloni për vënien e martesave mbi themele të sigurta dhe për ta bërë lumturinë familjare të vazhdueshme dhe të qëndrueshme?

Përgjigje: Në ditët e sotme, sikurse në shumë drejtime, fatkeqësisht, edhe në institucionin e familjes ka një ikje prej vetvetes, një ikje prej vlerave tona. Ndërkohë që në kohët kur gjithçka e jetonim sipas mënyrës sonë, nuk kishim ndonjë problem serioz në këtë çështje. Mirëpo më vonë, ndodhi si ndodhi dhe ne, duke i quajtur “zakone” vlerat që na përkisnin, i hoqëm ato porsì një rrobë e vjetër dhe i hodhëm mënjane. Pikërisht pas kësaj, sikurse edhe në fusha të tjera, ndodhi që në institucionin e familjes filluan të shfaqen vështirësi serioze.

Pajtimi në bazë të vlerave të përbashkëta

Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në një hadith, urdhëron e thotë: “Gruaja martohet prej katër gjërash: prej pasurisë, prej prejardhjes së fisme, prej bukurisë dhe prej besimit fetar; zgjidh besimtaren, që të gjesh prehje.” [277] Kështu, ndër cilësitë e bashkëshortes që do të zgjidhet për martesë, këshillohet që t’i jepet përparësi anës fetare. Në këtë mënyrë, për një besimtar që mendon të martohet, vlera më jetike që ai duhet të marrë parasysh dhe të ruajë si etalon fjalët e vyera e të paçmuara të Profetit. Po kështu, edhe gruaja, kur bën zgjedhjen e bashkëshortit të saj, duhet të marrë parasysh këtë standard që vendoset në këshillën e Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (alejhis'salatu ues'selam). Sepse një martesë e lidhur vetëm mbi bazë të statusit e të pozitës shoqërore, të parasë, të rrogës, të bukurisë e të vlerave të tjera të ngjashme të kësaj bote, do të thotë humbje në brezin e fitores. Po, po. Një çerdhe që do të mund të ishte një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, nëse ngrihet e mbështetur vetëm mbi vlera të përkohshme e kalimtare, mund të kthehet në një gropë prej gropave të Xhehenemit. Për këtë arsye, mund të thuhet se vijueshmëria e prehjes brenda familjes është e lidhur me një harmoni të plotë mes bashkëshortëve. Pra, për një harmoni të përhershme, para së gjithash ka nevojë për lidhje serioze e vlera të përbashkëta që t’i mbajnë bashkëshortët së bashku përgjithmonë.

Së dyti, lidhja martesore është një institucion që duhet ngritur mbi parime të qëndrueshme si arsyeja, logjika dhe gjykimi i shëndoshë. Për këtë arsye, një njeri që mendon të martohet, krahas mendimit të vet, duhet të marrë edhe mendimin e prindërve dhe të më të mëdhenjve me përvojë tek të cilët ka besim. Përndryshe, nëse njeriu mendon e vepron duke thënë me vete: “Kjo punë ka të bëjë vetëm me mua dhe vetëm unë duhet të interesohem për të”, atëherë mund të bjerë në gabime, korrigjimi i të cilave mund të jetë i vështirë. Në të vërtetë, në një çështje të tillë kaq të rëndësishme, që mund të shërbejë për të siguruar lumturinë në këtë jetë dhe në jetën e amshuar, sa më shumë mendime e këshilla të merren prej njerëzve që kanë më shumë përvojë, aq më i mbështetur është përfundimi në të cilin arrihet.

Njeriu nuk është një qenie e përbërë vetëm prej trupit dhe prej lëndës. Ai ka, gjithashtu, edhe shpirtin, zemrën, ndjenjat, ndërgjegjen, arsyen, gjykimin, idealet dhe pritshmëritë për të ardhmen. Veç kësaj, prej martesës do të lindë një brez. Ndaj edhe një njeri që ndodhet në procesin e martesës duhet t’i fusë në llogari të gjitha këto dhe të marrë një vendim sipas kësaj.

Prandaj, një njeri që gjenden në procesin e martesës, duhet të vendosë duke marrë parasysh pikërisht këto kritere Maturia është prej të Gjithëmëshirshmit. [278] Zoti i Madhëruar e krijon gjithçka duke i njohur kohë. Edhe kur shpërblen, edhe kur dënon, i jep kohë njeriut. Nga ana tjetër, ngutja është prej shejtanit. [279] Puna e kryer prej ngutjes, në shumë raste na bëhet bela mbi krye. Nga ky këndvështrim, nuk duhet harruar martesën nuk është një punë për t’u kryer me ngut, por për të duhet marrë vendim me arsye të shëndoshë, vetëm pasi të jetë menduar mirë rreth saj.

Njerëzve që më rrethojnë, gjithmonë u kam thënë: Unë, kur përgatitem të bëj një punë, u kushtoj shumë rëndësi mendimeve të njerëzve që më duan e që i dua si sytë e ballit. Sepse në punën që planifikoj të bëj, unë mund ta shoh çështjen nga një këndvështrim i ngushtë, për një çast mund të veproj sipas ndjesive të çastit. Kurse ata njerëz mendojnë për mua më mirë nga sa mendoj unë për veten, ndaj edhe bëjnë për mua një zgjedhje më të sigurt e më të shëndetshme. I njëjti mendim vlen edhe në çështjen e martesës. Sepse duke qenë se martesë përqafon një jetë të tërë, nuk duhet të vendoset për të mbi bazë të ndjesive të çastit; ajo patjetër duhet të mbështetet në një parim logjik. Një jetë të tërë do të jeni bashkë, do të ecni dorë për dorë, do të kaloni së bashku një jetë. Teksa jetoni jetën, do të jetoni edhe fenë dhe do t’ua lini atë si trashëgim fëmijëve tuaj. Në një çështje kaq të rëndësishme, unë zgjedh t’i lë pas dorë dëshirat e mia vetjake dhe të pranoj vështrimin, pikëpamjen, vlerësimin dhe gjykimin e njerëzve më të mëdhenj, tek të cilët kam besim.

Sa njerëz ka që mund të thonë: “E kam lexuar ilmihalin tri herë”?

Fatekqësisht, sot myslimanët nuk i njohin në masën e duhur Islamin dhe parimet e tij themelore, që rregullojnë jetën tonë. Për më tepër që për ta ndier Islamin në kuptimin e tij të vërtetë, nuk mjaftojnë vetëm njohuritë doktrinare. Feja duhet të bëhet jetë prej jetës dhe duke u jetuar, të kthehet në pjesë të karakterit. Por ja që duke qenë se Islami nuk njihet në thellësinë dhe në gjerësinë e tij dhe nuk jetohet një jetë e mbështetur në të, njerëzit nuk e dinë e as mund ta dinë se ç’vështirësi duhet t’u nënshtrohen në çështjet për të cilat kanë marrë përgjegjësi me vullnetin e tyre. Ta zëmë se në marrëdhëniet brenda familjes, njëri nga bashkëshortët ka një të metë, një dobësi. Kundrejt një problemi të tillë, individit duhet të pyesë veten: “Si mundem unë, vallë, ta largoj këtë të metë dhe me ç’mënyrë mund të çlirohem prej këtij problemi?” E në këtë pikë, duhet të hulumtojë për

urdhëresat, këshillat dhe porositë që jep feja. Por në këndvështrimin tim, nuk më duket se për këtë çështje ka ndonjë shtjellim serioz mendimi. Po. Fatkeqësisht, në ditët tona askush nuk mendon me seriozitet që të mësojë fenë e vet. Sa njerëz prej nesh, vallë, ka që mund të dalin e të thonë, “Për të mësuar fenë time, e kam lexuar ilmihalin tri herë”? Sa njerëz ka që të mund të thonë, “Unë i kam lexuar ato çfarë thuhet në lidhje me martesën në veprat *“Multeka”* dhe *“Nimetu’l-Islam”*”?

Po. Fatkeqësisht, ne nuk i njohim vlerat tona themelore. Si rrjedhim i kësaj, një moral i huaj për vlerat tona ka ardhur e ka shtrirë sundimin në shpirtin tonë. Një herë e një kohë diskutohej në formën: “Nëse hyjmë në Bashkimin Evropian, a prishemi apo jo?” Por ndërkohë që merreshim me këso diskutimesh, ne paskëshim qenë prishur me kohë. Dhe në ditët e sotme, puna erdhi në një pikë të tillë që burra e gra bëjnë një jetë të lëshuar. Shtëpitë janë kthyer në mensa. Nëpër shtëpi, babai është në rolin e rojës, nëna në rolin e kuzhinieres dhe fëmijët në atë të njerëzve që ushqehen në mensë. Natyrisht që në një çerdhe të tillë nuk gjenden vlera shpirtërore si vetëdija e përgjegjësisë, e durimit, e përballimit, e pranimit të njëri-tjetrit, e të sakrifikuarit për njëri-tjetrin, e të jetuarit për njëri-tjetrin, si dhe dashuria, vlerësimi e respekti që lindin prej këtyre. Kur të gjitha këto nuk gjenden, në atë çerdhe nuk ka as prehje të qëndrueshme e të përhershme.

Përshtatja e bashkëshortëve me natyra të ndryshme

Unë, në kohë të shkuara, kam qenë dëshmitar se si burra e gra kanë jetuar si individë e anëtarë familjesh të lidhur fort me çerdhen e tyre familjare. Nëse më lejoni, po ju jap nja dy shembuj: Gjyshi im mund të thuhet se ishte një njeri i rëndë dhe shumë i ashpër. Nuk e kam parë kurrë gjyshin të qeshte. Ishte shumë serioz. Kur dilte nga shtëpia dhe shkonte në xhami, të gjithë druheshin prej hijes së tij të rëndë dhe thoshin: “Po vjen Shamil Agai!” Jetonte një jetë prej asketi. Ndoshta çdo natë falte nga 50-100 rekate namaz. Ndërsa gjyshja ime, ishte një zonjë e butë porsim emri i vet, Munise, që do të thotë e dashur, e ëmbël. Ajo e jetonte jetën me drojë prej Allahut. Një herë të thoshit nga shpirti në prani të saj “Allah!”, lotët e saj i njomnin rrobat. Mirëpo këta dy njerëz, që për nga natyra mund të quhen të ndryshëm, ishin aq të lidhur me njëri-tjetrin, saqë, siç rrëfente ime më, gjyshja lutej gjithmonë: “O Allahu im! Mos më lër as edhe një orë pas këtij burri! Të përgjërohem, unë s’jetoj dot pa të.”

Kur iu afrua vdekja, gjyshja u sëmur. Lëngoi në shtrat për një periudhë prej më se dhjetë muajsh. Edhe në atë gjendje nuk la pa falur as edhe një vakt të namazit. Siç më tregonte nëna, pak para vdekjes, gjyshja kërkoi që t’i sillnin ujë për abdest. Pasi mori abdest, qeshi dhe pastaj iu drejtua gjyshit duke i thënë: “S’paskemi fituar gjë prej dynjasë. Sonte do të na falin xhenazën të dyve.” Gjer atë ditë, gjyshi nuk kishte ndonjë shqetësim për nga shëndeti. Nuk kaloi shumë dhe gjyshja ndërroi jetë. Ndërsa ime më i mbyllte sytë gjyshes, nga dhoma tjetër u dëgjua vajtim. “Gjyshi vdiq!” E pra, mes gjyshit dhe gjyshes sime kishte një harmoni e lidhje të këtillë.

Me lejen tuaj, po ju jap edhe një shembull tjetër: Një ditë, im atë, për shkak të një meseleje, u zemërua me nënën. Në jetën time, ndoshta, veç një herë e kam parë babanë ashtu. Atë çast, gjyshja ndodhej aty. Babai ngrysi vetullat dhe mori qëndrim ndaj nënës. Mirëpo nëna aq shumë i kishte hyrë në zemër vjehrrës së vet, saqë gjyshja ndërhyri e i bëzajti babait: “Ramiz! Në e preksh me dorë, t’i kam bërë haram qumështin e mundin tim!”

Ja pra, kjo është kultura jonë në përgjithësi dhe në këtë kulturë, bashkëshortët janë amanet për njëri-tjetrin. Secila nga palët duhet ta ruajë këtë vetëdije. Ndërsa kjo lidhet me një edukim të shëndoshë. Sot, ky edukim nuk përçohet në rrugë e në shkollë. Për këtë arsye, vërehet se disa prej të rinjve e prej motrave tona e marrin përsipër këtë nismë të rëndësishme pa qenë të vetëdijshëm për pjekurinë që kërkon martesë. Për këtë arsye, unë i varfuri prej kohësh kam këmbëngulur që njerëzit të edukohen e të mësojnë duke u pajisur edhe më dëshmi në formë diplome a certificate për dy çështje. Njëra është haxhi dhe tjetra martesë.

Po, po. Për njerëzit që do të shkojnë në haxh ose që do të martohen, pa u lëshuar një dëshmi që të vërtetojë se “Ky individ mund të shkojë në haxh” apo “Ky individ mund të martohet”, jam i mendimit që atyre s’u duhet lejuar të shkojnë në haxh ose të martohen. Ndoshta ndaj këtij propozimi mund të propozohet e të thuhet se “për nga forma e stili, në fe diçka e tillë nuk ka vend.” Mirëpo duhet ditur se në fe as nuk ka lejim për padijen dhe për të kaluarit e jetës si i paditur.

Fëmijët e mbetur jetimë me prindërit gjallë

Për këtë arsye, dua ta shpreh edhe një herë se një njeri duhet të jetë i pajisur me aftësi së paku në nivelin më minimal që t’i vërë në vend përgjegjësitë dhe detyrat që mbart martesë; nëse nuk është i pajisur kështu, atëherë nuk duhet të martohet. Në të kundërt, në institucionin e martesës ndodhin thyerje e krisje që në krye të herës. Sepse struktura, për më tepër, ngrihet mbi një themel që mund të thyhet lehtë. Në përfundim, gjithë ç’ndodh u ndodh fëmijëve dhe ata mbeten në mes të një dyzimi të thellë.

Nëse në një shtëpi ka një nënë dhe një baba që grinden, kjo do të thotë se ata i shpërbëjnë e i konsumojnë vazhdimisht vlerat, respektin dhe besueshmërinë e vet në kurthin e zënkave e të përplasjes. Fëmijët, sikurse mësojnë prej nesh jetën, po ashtu mësojnë prej nesh edhe moralin. Gjatë këtyre debateve, fjalët zemërthyesë që nxjerrin nga goja sjellin ndikime shumë negative në shpirtrat e fëmijëve. Kundrejt një panorame të tillë, fëmija fillon t’i shohë prindërit si të pavlerë. Si pasojë e kësaj, na shfaqen plot e plot fëmijë me nënë e babë, por që kanë mbetur në mes të një dyzimi të tillë, që i ka bërë t’i humbasin prindërit për së gjalli.

Si hollësi të fundit, po shpreh edhe këtë: Një çështje e rëndësishme si martesë duhet ngritur mbi ato parime e baza të mendimit e të logjikës që feja i ka përcaktuar që në krye. Mirëpo individ, pavarësisht gjithçkaje, në disa çështje mund të gabohet. Atëherë individ duhet të përdorë urtësinë dhe mençurinë, të përpiqet ta zbusë çështjen duke pyetur veten: “Ku bëra gabim, vallë?” Dhe në këtë mënyrë, duhet të gjejë mangësitë e boshllëqet e veta, të përcaktojë pikat e thyerjes dhe më pas, me udhërrëfimin e përvojës së më të mëdhenjve, duhet të përpiqet t’i zgjidhë problemet.

Kur dëgjoj për shqetësimet familjare, veçanërisht për lëndimin që pësojnë gratë, hidhërohem shumë. Në ditët tona, gruaja, për fat të keq, nga njëra anë synohet të kthehet në idhull prej një grupi feministësh dhe për pasojë, kjo e bën atë që të ndeshet me një numër handicapësh në kundërshtim me natyrën e saj. Nga ana tjetër, disa të tjerë sillen rëndë ndaj gruas; i kthejnë paditurinë, zbrazëtinë dhe dobësitë e veta në një mllef e zemërim dhe ia zbrazin asaj. Kjo gjendje më prek aq shumë, sa që duke parë butësinë dhe delikatesën e tyre, më vjen të qaj. Nëna ime, për çdo të shtypur e të dhunuar, thoshte: “E varfra!” Ta keqtrajtosh bashkëshorten, më pas edhe ta kërcënos! Kjo s’është

gjë që mund të pranohet. Askush s'ka të drejtë ta bëjë këtë. Ata që shkaktojnë një mizori të tillë, duhet t'ia kenë frikën Allahut e t'i drejtohen Atij me pendesë, të kërkojnë falje me kryet përdhe. Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në "Hutben e Lamtumirës", për bashkëshortet, urdhëron e thotë: "Ato janë amanet pranë jush." [280] Dhe çfarëdo lloj fjale e shëmtuar e thënë ndaj tyre, çdo vepër e shëmtuar e kryer ndaj tyre, janë shkelje e amanetit. Ahere njeriu duhet të mendojë drejt, të sillet drejt dhe të mos e shkelë amanetin e Allahut.

[277] Buhari, Nikah 15; Muslim, Rada 53.

[278] Shih: Tirmidhi, Birr 66; Er-Rujani, El-Musned 2/227; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 6/122.

[279] Shih: Tirmidhi, Birr 66; Er-Rujani, El-Musned 2/227; Et-Taberani, El-Mu'xhemu'l-kebir 6/122.

[280] Ebu Davud, Menasik 56; Ibn Maxhe, Menasik 84.

Namazi dhe nijeti



Pyetje: Si duhet të bëjmë nijet kur nisim namazin? Cilat janë mendimet e dijetarëve të Islamit për këtë çështje? A mund të na e shpjegoni?

Përgjigje: Siç shprehet në hadithin e Xhibrilit, namazi është një ndër pesë bazat themelore të Islamit. [281] Po, ai është shtyllë e fesë, [282] është thelbi dhe baza e adhurimeve, [283] është mjeti më i rëndësishëm, i mbështetur në miraxhin, [284] që e afron njeriun tek Allahu. [285] Një ibadet kaq i rëndësishëm për besimtarin, pa dyshim që nuk është dhe nuk duhet të jetë një punë që do t'i gjendet një vend shkel e shko mes angazhimesh të tjera të kësaj bote. Jo vetëm që namazi nuk duhet lënë pas dore apo nuk duhet falur me ngut për shkak të një pune, por nëse është nevoja, gjithçka duhet sakrifikuar për të.

Një kënaqësi e pafund

Përmbajtja e namazit, në marrëdhënien e njeriut me Zotin e vet, ndihet në shkallë e cilësi të ndryshme, sipas horizontit të zemrës e të shpirtit. Namazi, i falur me një zemër të fisme dhe në dashuri e këndellje, ka cilësi e shkallë të ndryshme të të përjetuarit që nga ndjesia se gjendesh në prani të Allahut, tek të shikuarit e vetvetes duke qëndruar në saf mes engjëjve, të përfytyruarit e vetvetes si një individ që është rreshtuar pas Zotërisë së Zotërinjve (alejhis'salatu ues'selam), deri tek të ngriturit në një lëvizje të drejtpërdrejtë gjer në botët sublime dhe në vënien e kokës në mbulesën e Arshit. Që njeriu të gëzojë një arritje të tillë, kushti i parë është që namazi të kuptohet njëjloj si një miraxh apo si hija e miraxhit. Në të vërtetë, çdo namaz është për besimtarin një mundësi miraxhi. Ndaj edhe në këtë pikë, besimtarit i mbetet si detyrë që në çdo namaz, qoftë edhe në dimensione nga më të ndryshmet, të plotësojë miraxhin e vet. Për këtë arsye, në namaz, çdo tel i shpirtit duhet të tingëllojë porsin një tel basi, ashtu që sexhdja të kthehet në një kënaqësi me të cilën nuk nginjesh asnjëherë; duatë në një ushqim që nuk i mërzhitet kurrë njeriut; rukuja në një ton të veçantë; kirati në një harmoni të renditjes njëra pas tjetrës të fjalëve të gjalla. Ajeti që thotë: “Ai që kur ngrihesh (në namaz nate), të sheh ty; e po ashtu edhe kur drithërohesh mes atyre që përulen në sexhde.” [286], krahas përshkrimit të namazit të Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (alejhis'salatu ues'selam), na mëson edhe neve se si duhet ta falim namazin. Në një kohë, mësova prej dikujt diçka në lidhje me zbrazëtinë e zemrës. Pas kësaj, me frikën se mos të gjitha namazet

që kisha falur gjer në atë ditë mund të m'i përplasnin në fytyrë në ahiret, i fala sërish kaza. Sepse në një hadith, Zotëria ynë, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi Të) është shprehur se namazi, në jetën e varrit, do të trupëzohet dhe nëse njeriu i ka falur namazet me mangësi, këto namaze të mangëta e të paralizuara do t'i shfaqen si një shoqërues dhe njeriu do ta kalojë jetën e berzahut bashkë me këtë mik të paralizuar. Për këtë arsye, falja e kazasë së namazeve të mangëta e të paplota, në një kuptim, nuk përbën ndonjë meritë. Në daçi, atyre mund t'u thoni "imponuar prej mangësisë". Pra, kjo do të thotë që të lidhësh me fashë një të thyer a të krisur.

Nuk ka dy pikësnyime me një qëllim

Siç e shpreha pak më parë, nijeti i gjithsecilit është i ndryshëm, sipas masës së marrëdhënies me Zotin e Madhëruar. Në bazë të nijetit, sipas ixhmasë së fakihëve, është qëllimi apo kasti i zemrës. Pra, nijeti nuk përbëhet vetëm prej shprehjes: نَوَيْتُ... نَوَيْتُ... نَوَيْتُ... [287]. Është e vërtetë se fukahaja ka shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me këtë temë. Disa e kanë vlerësuar si më të pëlqyeshme nijetin e shprehur me fjalë, ndërsa disa të tjerë kanë pohuar se është më mirë që nijeti të mos thuhet. Sipas këtyre të fundit, të shprehurit përmes gjuhës pengon përqendrimin e zemrës. Edhe i Përnderuari Imam Rabani, që është fakih i medhhebit hanefi dhe pranohet si muxhedid i mijëvjeçarit të dytë, e sheh si problematik të shprehurit e nijetit me fjalë dhe unë besoj se gjykimi i tij mbi këtë çështje na sjell një mendim me rëndësi. [288] Por për mendimin tim, nëse disa besimtarë e shprehin nijetin e tyre me fjalë, mjafton të thuhet se "një pjesë e fukahasë e bëjnë nijetin të mbështetur në fjalën" dhe nuk duhet ndalur mbi këtë çështje në një mënyrë që u hap rrugë debateve.

Për ne, si fillestarë e jospecialistë, me konceptin për besimin dhe për Islamin të trashëguar prej prindërve përmes imitimit, shkalla e parë e nijetit në nivele të ndryshme është qëllimi apo kasti i zemrës. Pra, që njeriu ta ketë në mendje e në zemër se do të falë namazin. Ndërsa sipas zotëruesve të dijes e të përkushtimit të lartë, nijeti është të kyçurit e njeriut në punën që do të kryejë, të qëndruarit e tij i lidhur vetëm pas atij mendimi dhe përqendrimi në të me të gjitha ndjenjat dhe mendimet. Mbështetur në këtë, për sa i përket nijetit të njerëzve, që mund ta cilësojmë si privatësi të privatësive, mund të pohojmë se nijeti i tyre duhet të ruajë vazhdimësinë edhe brenda namazit dhe kjo do të thotë që zemra të jetë e zbrazur prej gjithçkaje tjetër veç Atij. Sepse në qoftë Ai pikësnyimi, në një qëllim nuk mund të ketë dy pikësnyime. Pra, nëse njeriu ka pasur për qëllim Atë dhe vetëm Atë, sado pikësnyime të tjera relative e reale që të ketë veç Tij, të gjitha duhet t'i nxjerrë nga mendja e t'i hedhë tutje. Nëse në këto e sipër i vjen në mend një tjetër mendim, njerëzit e atyre niveleve kthehen e marrin sërish tekbiir dhe e shtrëngojnë veten gjersa në çastin që e çlirojnë zemrën prej gjithçkaje tjetër. Te Bediuzzamani i Nderuar dhe te nxënësit që e pasonin atë në rresht të parë vërehet një përpjekje e tillë. Por nuk duhet harruar se kjo përpjekje duhet të prekë vetëm formën dhe anën e jashtme. Nëse në një sjellje të tillë hyhet me imitim, në formë e në dukje të jashtme, kjo nuk do t'i sjellë kurrëgjë individit përkatës.

Brenda shkallëve të nijetit, në shkallët e të qenit profan përballë Allahut dhe të fituarit të përjetësisë në Allahun, ekziston edhe gjendja e harrimit të vetvetes. Po, po. Nijetet e njerëzve që, duke e kaluar qarkun e emrave (esma) dhe të attributeve (sifat), janë shkrirë përballë fytyrës së Tij hyjnore, ndoshta në një horizont të tillë shkojnë deri në formën që njeriu s'e sheh, s'e dëgjon, s'e ndien më vetveten. Sipas atyre që gëzojnë arritjen e një horizonti të tillë, nëse e ndien vetveten, atëherë do

të thotë se ende po merresh me shqetësime e pengesa tokësore. Edhe nëse unë bëj shumë kujdes që të mos them “shirk”, ata, sipas nivelit të tyre, këtë e shohin edhe me shqetësimin e të rënit në shirk. Shkurt, gjerësia e nijetit është gradë-gradë e shkallë-shkallë. Gjithsecili, sipas masës në të cilën e njih Allahun dhe në masën në të cilën e zotëron horizontin e dijes për Allahun, kur nis namazin, edhe marrëdhënien me zemrën duhet ta sigurojë e ta ndërtojë sipas kësaj, edhe namazin duhet ta falë sipas kësaj.

Nijeti është shpirti i veprës

Bediuzamani i nderuar, në epilogun e Letrës së Njëzetë, nën dritën e ajetit: “A pëlqen ndonjëri prej jush të kafshojë kufomën e vëllait të vet të vdekur? E pra, kjo ju neveriti në çast!” [289], teksta shpjegon fjalë pas fjale se sa vepër e shëmtuar është përgojimi, përmend se “hemzja” në krye të ajetit që përçon kuptim pyetës, shpërhapet si ujë në të gjitha fjalët e ajetit. Apo ndoshta edhe si një dritë e frymë. Edhe nijeti është pikërisht kështu. Besimtari, me nijetin e tij, shpërhap e duhet të shpërhapë dashurinë ndaj Zotit të Madhëruar në çdo rukën të namazit, duke pohuar: “Vetëm Ai është i Synuari i vërtetë, i Dashuruari i Vërtetë, i Adhuruari i Vërtetë!...” Në çdo recitim të namazit, ai duhet t’i qëndrojë besnik këtij nijeti. Veçanërisht në namazet nafile që falen individualisht, qoftë edhe në përmasa të vetështrëngimit, duhet të tregojë kujdes në këtë çështje. Ndërsa në namazet me xhemat nuk është e drejtë që të hyhet në një sjellje të tillë, sepse kjo do të nënkuptonte vështirësim në fe dhe imponim të një barre që s’mbartet dot. Por në namazet nafile që i falim vetëm për vetëm, nuk duhet të ketë ndonjë problem nëse i qëndrojmë përpjekjes dhe kërkimit për nijetin me sa të kemi në dorë, për ta kryer këtë punë nga fillimi gjer në fund duke e lidhur atë me mendimin e pranisë hyjnore. Namazi është miraxhi i besimtarit. [290] Zoti i Madhëruar, në ajetin ku tregon për miraxhin, urdhëron e thotë: إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ “Nuk ka kurrfarë dyshimi se Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.” [291] Këtu, përemri هُ (hu) mbart në referimin e tij dy interpretime. Në njërin interpretim, përemri i referohet Zotit të Madhëruar. Por në një tjetër interpretim, cilësorët Dëgjues i gjithçkaje dhe Shikues i gjithçkaje shprehin gjendjen e Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik. Tani, nëse me dy emra prej emrave të bukur, si “Semi” dhe “Basir”, është cilësuar Kreu i Qenieve të Krijuara (alejhis'salatu ues'selam), do të thotë se këtu tërhiqet vëmendja te një e vërtetë e rëndësishme. Do të thotë se Zotëria ynë (s.a.s.), gjatë Miraxhit, gjithçka që i është paraqitur syrit dhe veshit të tij, përmes aftësisë për të perceptuar e ndier, e ka përthithur më së miri. Nuk ka humbur as sekondën, as të dhjetën e as të qindtën e Miraxhit. Që prej fillimit e gjer në fund, gjithçka ka kaluar thajse nëpër kullësën apo filtrin e ndërjegjes së Tij.

Sulejman Çelebija thotë: “Miraxhin e umetit e fala namaz.” Ndërsa Imami Allvarit shprehet: “Anijen e fesë e bën të ecë namazi, namazi në krejt ibadetin është i pari.” Duke qenë se namazi është miraxhi i besimtarit, në namaz besimtari duhet të ketë në zotërim veshin dhe syrin e vet. Ai vesh e sy duhet të dëgjojë vetëm ç’duhet dëgjuar, të shohë vetëm ç’duhet shikuar. Said Nursiu e shpjegon këtë në “Fjalën e Shtatëmbëdhjetë” me këtë shprehje të Mevlana Xhamit: “Vetëm Njërin të duash, vetëm Njërin të thërrasësh, vetëm Njërin të kërkosh, vetëm Njërin të shohësh, vetëm Njërin të dish, vetëm Njërin të thuash.” [292] Sipas kësaj, besimtari duhet të shohë Njëshin, të njohë Njëshin, të dëgjojë Njëshin, të kërkojë Njëshin, të thërrasë Njëshin, të ndiejë Njëshin, të qëndrojë i mbyllur kundrejt gjithçkaje tjetër veç Njëshit dhe të përpiqet ta arrijë këtë në të gjitha etapat e namazit. E pasi ta arrijë, duhet të thotë: “Kjo nuk duhej arritur kështu. Duhet ta arrija duke

arritur vetveten, duke mos e ndier fare veten. Duhej ta harroja nëse ekzistoj apo jo.” Dhe në këtë masë, duhet thujse të dalë prej vetes.

Ushtrim, sforcim dhe përfitim

Po e përsëris edhe një herë se të gjitha këto janë një çështje niveli. Dhe pa ushtrim, nuk është e mundur që të arrihen nivele të tilla. Pra, po s’pati sforcim në fillim, nuk ka përfitim më pas. Nga ky këndvështrim, një njeri që ua ka ngulur syrin niveleve të tilla, duhet ta shtrëngojë veten me një përpjekje të jashtëzakonshme. I Përnderuari Xhunejd el Bagdadi përdor diku një shprehje që ka pak a shumë kuptimin: “Unë e shtrëngova veten gjashtëdhjetë vite. Pas gjashtëdhjetë vitesh Allahu e dha bekimin, ahëre fillova të fal namaz.” Kështu, ata si puna jonë, që nuk e arrijnë në jetë shijen e namazit të vërtetë, së paku le ta sforcjnë veten që të mund të falin nja pesë a dhjetë vite namaz.

Ndërkohë, po sjell në vëmendje një çështje të ndërmjetme. Të mos mendohet që, për shkak të hollësive që përmendëm, namazet tona gjysmake nuk janë pranuar e nuk do të pranohen nga Allahu (xh.xh.). Ne shpresojmë që Zoti ynë, që zotëron mirësi e mëshirë të pafundme, urdhëron e i pranon edhe namazet e falura në këtë nivel. Kështu që edhe me namazet tona, ai na çon në Xhenet, na i bën ata shoqërues në botën e varrit, na i kthen në Burak në urën e siratit, ndoshta edhe na i bën vetëtimë e na ndriçon me to horizontin tonë. Nga ky këndvështrim, kurrsesi nuk duhet lënë pas dore namazi, kurrsesi nuk duhet marrë namazi lehtë. Por nga ana tjetër, përpjekjet duhen mbajtur gjithnjë në shkallë të larta. Adhurimi që kryejmë ndaj Zotit tonë, Zotërues i Fuqisë e i Madhësisë, duhet të jetë të jetë në përpjesëtim të drejtë me Madhësinë e Tij. Ibadeti që i bëjmë Atij duhet të mbartë kuptimin e një qëllimi të mirënjohjes e të falënderimit për bekimet e mirësitë e shumta e të panumërta që Ai na dhuron. Ndaj edhe një besimtar, gjatë gjithë jetës së vet, duhet të përpiqet të gjejë hakikatin e namazit.

Një tjetër hollësi e rëndësishme në rastin e nijetit është që ibadeti, në të gjitha ruknet dhe pjesët e tij, ta bëjë të ndihet qenien e vet në një gjendje të gjallë e plot jetë. Besimtari, nijetin e nisur në përqendrim të plotë, pra, atë kast absolut, prirje absolute e vështrim absolut, ta ndiejë në ndërgjegjen e vet në çdo rukën të namazit dhe të ngrejë krye kundër gjithçkaje tjetër veç këtyre. Po, po. Besimtari, në namazin e vet, duhet të shqetësohet prej çdo lloj mendimi tjetër veçse për Atë dhe këtë shqetësim duhet ta tregojë përmes reagimit në botën e vet të jashtme. Për shembull, nëse një njeri, duke thënë: “Ai është Bamirësi i Pashoq, Mëshiruesi i Pashembullt.” [293], nuk ndien në vetëdijen e vet që prej mëshirës së pafundme hyjnore të ngrihen dallgë të shpërfaqura në lartësi të ndryshme që vijnë e përqafojnë gjithçka, atëherë duhet të mund t’i thotë vetes: “Shumë keq, burracak!”

Asnjëra prej këtyre nuk është e përealizueshme. Sepse të gjitha këto i kanë përjetuar me mijëra e miliona njerëz. Mijëra e miliona të tjerë, gjithashtu, pritët t’i përjetojnë. “Nëse dikush i vihet pas diçkaje dhe tregon seriozitet në këtë çështje, pa tjetër që e arrin atë që kërkon.” [294] Ndërsa sjellja e kundërt në marrëdhënie me këtë fjalë nënkupton: “Nëse nuk e ka gjetur, ahëre nuk i është vënë pas; edhe në i qoftë vënë pas, nuk ka treguar seriozitet.”

[281] Buhari, Iman 37, Tefsiru sure (31) 2; Muslim, Iman 5, 7.

[282] El-Bejhaki, Shuabu'l-iman 3/39; El-Hakim Et-Tirmidhi, Nevadiru'l-usul 3/135, 136.

[283] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 132 (Fjala e Njëmbëdhjetë).

[284] Shih: Fahrudin er-Razi, Mefatihu'l-gajb 1/214; Es-Sujuti, Sherhu Suneni Ibn Maxhe f. 313.

[285] Shih: Muslim, Salat 215; Ebu Davud, Salat 148; Nesai, Meuakit 35, Tatbik 78.

[286] Sirka Shuara, 26/218-219.

[287] E bëra nijet... E bëra nijet... E bëra nijet...

[288] Shih: Imam Rabbani, El-Mektubat 1/160 (Letra 186).

[289] Huxhurat, 49/12.

[290] Shih: Fahrudin er-Razi, Mefatihu'l-gajb 1/214; Es-Suyûtî, Sherhu Suneni Ibn Maxhe f. 313.

[291] Isra, 17/1.

[292] Bediuzaman, Fjalët f. 231 (Fjala e Shtatëmbëdhjetë, Mekami i dytë).

[293] Fatiha, 1/3.

[294] Shih: Ibnu'l-Xheuzi, El-Mud-hish f. 490; Ibn Haxher, Mukaddimetu Fet'hu'l-bari f. 14.

Prehja e besimit dhe shqetësimi për fatin



Pyetje: Ne besojmë se besimi mbart farën e një peme shpirtërore prej Parajse. Nga ana tjetër, shqetësimi për fatin është një hollësi shumë e rëndësishme në fenë tonë. Si duhet kuptuar në rastin e një shpirti besimtar të ndjerët e njëkohshëm edhe të prehjes së premtuar prej besimit, edhe të shqetësimit të fatit? A mund të na e shpjegoni?

Përgjigje: “Besimi mbart farën e një peme shpirtërore prej Parajse.” [295] Fjala “besim” (iman), e përdorur në këtë fjali, për shkak të të përdorurit në trajtë të plotë, shpreh besimin e plotë. Por nuk duhet harruar se cilado qoftë shkalla e besimit që njeriu ka brenda vetes, ai besim ka vlerën e një xhevahiri. Sepse besimi e bën njeriun që ta lexojë ekzistencën ashtu siç duhet. Po, po. Njeriu, nëpërmjet besimit, e sheh ekzistencën në plan të dytë dhe e vlerëson atë bashkë me anën e përparme dhe të pasme të perdes. Në përfundim të këtij këndvështrimi e vlerësimi, ai e di se ekzistenca ndodhet nën administrimin e një Qenieje që zotëron fuqi absolute dhe mëshirë të pafundme; e di se pa lejen e Tij, askush dhe asgjë nuk mund t’i shkaktojë asfarë dëmi. Njëkohësisht, në sajë të besimit në jetën e amshuar, sado e vështirë dhe me telashe qoftë jeta e kësaj bote, duke qenë se e sheh këtë botë vetëm si një sallon pritjeje për në Parajsë, ai e përballon gjithçka me kënaqësi, duron gjithçka, ndihet mirënjohës. Për ta shprehur ndryshe, besimtari arrin nga besimi te monoteizmi, nga monoteizmi te nënshtrimi, nga nënshtrimi te lënia e gjithçkaje në dorë të Zotit dhe nga ky dorëzim i plotë te lumturia e dy botëve, siç i kemi thënë arritjes së lumturisë në këtë jetë dhe në jetën pas vdekjes. [296] Ndërsa një vështrim i zhveshur prej besimit e sheh ekzistencën në formën e qenieve të errëta e të pakuptimta që kanë shpërthyer prej toke e më pas janë derdhur në një gropë a asgjë. Nga ky këndvështrim, besimi jo vetëm që i tregon njeriut fillimin dhe fundin, por i premtton edhe sigurinë e itinerarit. Po, po. Besimi është një xhevahir i tillë që, qoftë edhe një njeri analfabet, që nuk thellohet dot në hulumtimin e në analizimin e çështjeve që duhen besuar, por që gjithsesi u beson atyre, mbështetur në njohuritë e mësuara që në fillim prej ilimihalëve, mund ta ndiejë e ta kuptojë se imani është vërtet një farë e një peme shpirtërore të Xhenetit, [297] ndërsa kufri fsheh farën e një bime shpirtërore zakumi nga të Xhehenemit. [298] Por nëse ky iman është edhe në kuptimin e tij të përsosur, atëherë ai njeri mbërrin në një gjendje thuajse sikur po ecën vërtet në një korridor të Parajsës.

Shqetësimi për fatin në përpjesëtim të drejtë me besimin

Besimtarët e vërtetë, që këtë prehje të falur prej imanit e ndiejnë sikur të jenë duke pirë gllënjka keutheri, njëkohësisht, tremben e drithërohen prej shqetësimit: “Si do ta jap llogarinë kur të vdes? Në ç’mënyrë do të shkoj në jetën tjetër?” Sepse, në fakt, duhet t’i trembemi fatit të dikujt që nuk shqetësohet për fatin e vet. Zotërinjtë tanë, sahabët e nderuar, që e kuptonin shumë mirë fenë dhe që i jepnin asaj jetë prej jetës së tyre, vërejmë se mbusheshin me frymë paqeje e sigurie në atmosferën e imanit, por njëkohësisht ndiheshin të shqetësuar për fatin e vet. Për shembull, fjalët e përdorura nga Zotëria ynë, Ebu Bekër es-Sidiku (r.a.), teksa i lutej e i përgjerohej Zotit të Madhëruar, përbëjnë një shembull të bukur e mbresëlënës për këtë:

“Mirësinë mos ia kurse, o Zot, këtij robi të mjerë,

Rrënuar, por besnik, o i Madh, të erdh’ në derë!

Vjen me mëkate plot; e fale Ti, o Zot!

I çuditshëm është, mëkatar e rob i përbuzur.

Prej tij rebelim e harresë, prej tij gabim mbi gabim,

Prej Teje veç mirë e më mirë, prej Teje falje plot hir!”

Nëse Zotëria ynë, Ebu Bekri (r.a.), është një njeri që ka konsumuar e mbaruar gjithçka, atëherë ne kemi qenë të mbaruar që nga fillimi. Omeri (r.a.), me gjasë nisur nga një sihariq që mund të ketë dëgjuar prej Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (alejhi elfu elfi salatın ue selam) [299], në lidhje me të urdhëron e thotë: “Nëse imani i Ebu Bekrit do të peshohej me imanin e të gjithë njerëzve, me siguri që imani i tij do të ishte më i rëndë.” [300] E pra, Zotëria ynë, Ebu Bekri (r.a.), pavarësisht se kishte një besim të tillë në zemër, gjithmonë shqetësohej për fatin e vet para Allahut. Sepse ka pasur njerëz që patën prekur arritjen e të ulurit gju më gju me Tablonë e Krenarisë Njerëzore dhe më pas, në radhët e Museljime Kedhabit, janë rrokullisur në Xhehenem. [301] Nga ky këndvështrim, askush nuk zotëron garanci absolute dhe nuk i dihet se si do të dalë në prani të Allahut.

Mes zotërinjve tanë, sahabëve e tabiinëve të nderuar, kishte njerëz shumë të mëdhenj që, pavarësisht se jetonin një jetë të përsosur, shqetësoheshin tejmase për fatin e tyre.

Po përpiqem ta shtroj çështjen me një shembull që përdoret shpesh: Ibrahim ibni Et’hemi, që jetoi në një epokë që lidh tabiinët me tebeitabiinët, teksa ishte sundimtar, braktisi kurorën e fronin dhe u vendos në Mekën e Përnderuar, ku iu përkushtua krejtësisht rrugës së Allahut. Kur njihemi me duatë e këtij njeriu të madh, që me mënyrën se si jetoi paraqet një panoramë marramendëse, përballemi me një thellësi të veçantë, të mbushur me drojë e frikë. Për shembull, në një dua, ai i përgjerohet Zotit të Madhëruar kështu:

“O Allahu im! Robi yt rebel, mizor e mëkatar, duke pranuar mëkatet e veta, u kthye tek Ti. Po i çel duart para Teje, po kërkon falje prej Teje. O Allahu im, që sheh e vëzhgon gjithçka! Ky rob, edhe në qoftë rebeluar shumë herë, nuk iu përul kujt në sexhde veç Teje.”

Në lidhje me këtë temë, le të japim një shembull edhe prej prijësit e kreut të familjes Nehai, Esved ibni Jezid en-Nehai: Kur po ndërronte jetë, hiqte e vuante dhe në fytyrë i krijoheshin tkurrje të tilla, saqë Hazreti Akame i erdhi pranë dhe e pyeti: “Ke frikë nga mëkatet?” Përgjigja e Esved ibn Jezidit tërheq vërtet vëmendjen. Ai u përgjigj: “Si të mos kem frikë? Kujt i takon më tepër se unë që të ketë frikë prej Allahut? Veç kësaj, edhe nëse Zoti i Madhëruar m’i fal ato që kam bërë, ndjenja e turpit prapë më bën të shqetësohem.” [302] Esued ibni Jezidi, që dridhej e vuante prej shqetësimit në përmasa të tilla, sikur të kishte jetuar në kohët para Zotërisë sonë, të Dërguarit Fisnik (s.a.s.), ka të ngjarë që të ishte nderuar edhe me mirësinë e profetësisë. Megjithëse ishte në një lartësi të tillë, ai gjendej në një ndjenjë shumë serioze të drojës e të frikës. Nga kjo pikëpamje, mund të themi se nëse një njeri shqetësohet gjer në drithërima për fatin e vet, kjo tregon përkryerjen e besimit të tij. Imani është një xhevahir i tillë, saqë besimtari i vërtetë, që ia di atij vlerën e vërtetë e thelbësore, qoftë duke u zvarritur, qoftë duke u rrokullisur, ka frikë ta humbasë këtë xhevahir që mban në kurriz. Mësuesi i Nderuar tërheq vëmendjen tek kjo hollësi duke thënë: “Ruaju, shih ku e vë këmbën, ruaju prej mbytyjes. Me një kafshatë, me një fjalë, një farëz, me një shkëndijë, me një shenjë me një puthje mos u mbyt.” [303] Pra, teksa edhe vetëm njëra prej këtyre vogëlsive mund ta marrë njeriun tutje porsia vërshim uji, njeriu që beson duhet të jetë gjithmonë në frikën e shqetësimit se mos e humbet besimin.

“Mos ki frikë, drithërohu!”

Siç e dini, Shteti Osman, në një kohë, u shtri në një gjeografi të stërmadhe e u bë mbrojtësi e rojtësi i fundit i Islamit. Po, në atë periudhë shumë të gjatë, ai kreu detyrën e ruajtjes së nderit, të emrit e të respektit për botën islame. Por më pas ngjarjet rrodhën ashtu siç dihet dhe erdhi një kohë e tillë, që në gjeografinë ku ndodhej ai, megjithëse u shprehën tallje me Kuranin, me Profetin, me Qaben, veshët bënë sikur s’i dëgjuan këto të shara që kishin si pasojë femohimin. Po, po. U përjetua një periudhë e tillë, që ndaj këtyre ideve që mund t’i kushtonin njeriut besimin aq që u reagua; nuk u reagua dhe në këtë kohë, sa e sa njerëz dolën nga kufijtë e besimit dhe e humbën fenë. Domethënë, për asnjë njeri e për asnjë shoqëri nuk ka një siguri absolute.

Në çështjen e frikës e të shpresës, ka një fjalë të bukur që i është atribuar Zotërisë sonë, Omerit të nderuar (r.a.): “Në më thënshin se të gjithë njerëzit do të shkojnë në Parajsë dhe vetëm një në Ferr, do të shqetësohem se mos ai jam unë. E në më thënshin se veç profetëve, të gjithë do të shkojnë në Ferr e vetëm një në Parajsë, unë prapë, prej mëshirës së Allahut, shpresoj e pyes veten se mos jam unë ai.” E pra, një baraspeshë e tillë mes fikës dhe shpresës është shumë e rëndësishme.

Këtu po hap një parantezë dhe po risjell mendimin e Gazaliut: Imam Gazali thotë se para pleqërisë, para se krahët e vdekjes të jenë qasur për të pushtuar trupin, duhet të mbizotërojë më së shumti frika; ndërsa në periudhën e pleqërisë, duhet të jetë më e fuqishme shpresa. Pra, në kohën kur njeriu gëzon shëndet të plotë, njeriu duhet të dridhet e të jetojë me frikën prej Allahut. Ndërsa në ditët që ndien frymëmarrjen e vdekjes, për të mos rënë në dëshpërim, duhet të mbizotërojë tek ai ndjenja e shpresës. [304]

Një ditë, vëlla Zybejiri i tha Bediuzamanit të nderuar: “Mjeshtër, kam shumë frikë për fatin tim!” Dhe mori këtë përgjigje: “Mos ki frikë! Drithërohu!” Pra, të jetosh me një shqetësim aq të madh, saqë të të ngecë edhe ushqimi në grykë. Kundrejt kësaj, në prag të vdekjes, njeriu duhet të mbushet e të gufojë me mendimet: “O Allahu im, po vij tek Ti. Ti gjer më tash kurrë s’ e ke kthyer mbrapsht prej asaj dere asnjërin prej njerëzve që kanë ardhur me shpresë tek Ti. Ti kurrë s’ i ke thënë “jo” askujt që të ka trokitur në derë. Askujt s’ ia ke përplasur turpin në fytyrë. Edhe ata njerëz që, me fare pak gjë, t’u drejtuan Ty, Ti i pranove si vizitorë me plot mal e pasuri dhe i nderove.” Edhe përmendja e emrit “rexha” (shpresë) në marrëdhënie me pleqërinë në veprën Shkëndijat, të Bediuzamanit, mund të ketë lidhje me një mendim të tillë.

Kapitali i madh dhe shqetësimi i rrëmbimit

Po, është e vërtetë se besimi mbart farën e një peme parajsore. Krahas kësaj, është shumë e rëndësishme që njeriu të mbartë shqetësimin se mos e humbet këtë kapital të madh. Këtë mund ta ilustrojmë me një shembull: Ta zëmë se pesë a dhjetë punonjës po mbartin me automjet nga Banka Qendrore një trilion lira nga një vend në një tjetër. Këta njerëz e kryejnë detyrën plot shqetësim, duke menduar: “Aman, se mos e merr vesh kush që po transportojmë parà në këtë masë!”, “Po sikur të na presin rrugën diku!”, “Po sikur në ndonjë vend, për shkak të problemit të trafikut, të na ndalojnë e të na i grabisin këto parà!” E ç’vlerë kanë trilionat e katrilionat përpara kapitalit të imanit, që është i lidhur drejtpërdrejt me lumturinë e përjetshme! Po, po. Imani është një kapital i pashoq, që na mundëson të rezervojmë lumturinë e përjetshme. Nga ky këndvështrim, ai mbart një farë të një peme Parajse. Domethënë, Parajsa do të rritet e do të hedhë shtat prej asaj farëze, që do të kthehet në një pemë, do të lartohet drejt përjetësisë dhe do të mundësojë që ju të gëzoni e të galdoni në përjetësi nën hijen e saj. Tani, nëse njeriu ka në zotërim një kapital kaq të madh dhe nëse ka edhe armiq si shejtani, pasuesit e shejtanit, egoja e lëndorja dhe nëse gjendet, njëkohësisht, përballë rrezikut që këta armiq në çdo çast të mund ta shmangin nga rruga, a duhet apo s’ duhet që ky njeri të trembet? E pra, kjo është ajo frikë që e quajmë shqetësimi për fatin. Kjo është frika që karakterizonte zotërinjtë tanë, sahabë si Ebu Bekri i nderuar (radijallahu anh), apo e miqve të Allahut si të përnderuarit Ibrahim ibn Et’hemi, Esued ibni Jezidi, që i kemi përmendur si shembuj.

[295] Bediüzzaman, Fjalët f. 16 (Fjala e Dytë).

[296] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 335 (Fjala e Njëzetetretë, Nënkreu i parë).

[297] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 16 (Fjala e Dytë).

[298] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 16 (Fjala e Dytë).

[299] Shih: Tirmidhi, Ruja 10; Ebu Davud, Sunnet 8.

[300] El-Bejhaki, Shuabu’l-iman 1/69; Ibn Asakir, Tarihu Dimashk 30/127.

^[301] Shih: Ibn Sa'd, Et-Tabakatu'l-kubra 3/377-378.

^[302] Shih: Ebu Nuajm, Hilyetu'l-evlija 2/103-104; Edh-Dhehebi, Sijeru a'lami'n-nubela 4/52.

^[303] Bediuzaman, Shkrepëtimat f. 169-170 (Shkrepëtimat e Shtatëmbëdhjetë).

^[304] el-Gazzâlî, İhjàu ulûmi'd-dîn 4/142.

Më hipokriti i mëkateve: Përgojimi



Pyetje: Zotëri i Nderuar! Dihet nga të gjithë se përgojimi është një krimb i fshehtë shqetëson shoqërinë dhe një mëkat që prish marrëdhëniet mes njerëzve. Pavarësisht kësaj, si mund të shpjegohet që ai ende ekziston ende në shoqëri?

Përgjigje: Përgojimi (gijbet) është një ndër mëkatet e mëdha. [305] Ashtu që Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në një hadith, thotë kështu në lidhje me përgojimin: “Ndaluni prej përgojimit! Sepse përgojimi është më i rëndë se zinaja. Nëse dikush bën zina, pastaj pendohet, Allahu ia pranon pendesën. Por ai që përgojon, për sa kohë që nuk ia falin përgojimin, nuk gjen mëshirë.” [306] Nëse do të shihet qasja e Hazreti Ustadit ndaj kësaj çështjeje, përgojimi ka lloje të tilla, në të cilat ai është më i madh se zinaja. [307] Për shembull, në këtë kategori mund të bëjë pjesë të përgojuarit e një grupimi njerëzish të mirë apo të një individi që përfaqëson një xhemat, apo të njerëzve që, për arsye se kanë ndërruar jetë, nuk mund t’u kërkohet ndjesë.

Një krim që merr karakter kolektiv

Disa dijetarë, në lidhje me fjalët fyese, thonë se një njeriu që flet keq për Zotërinë tonë, të Dërguarin Fisnik (s.a.s.) ose shpreh gjëra negative për të, nuk i pranohet pendesa. [308] Pse? Sepse Zotëria ynë, Profeti (alejhis'salatu ues'selam), është larguar për në jetën e amshuar, ndaj edhe nuk ekziston më mundësia që Shpirti i Dashur i Krijimit (s.a.s.) të takohet dhe t’i kërkohet ndjesë me fjalët: “Ma bëj hallall.”

Po kështu, për të qarë hallin është edhe gjendja e atyre që, për shkak të çështjeve të kalifatit, flasin me tepri – mos e thëntë Zoti! – gjer në një masë refuzimi, për personalitete të jashtëzakonshme të sahabëve të nderuar si Ebu Bekri (r.a.), Omeri (r.a.), Osmani (r.a.), Aishja (radijallahu anhum). Sepse ata që kryejnë një mëkat të tillë të madh, përgojnë një grupim të madh njerëzish të mirë dhe mendojnë keq për ta. Ata nuk kanë mundësi që, për shkak të përvojimeve të tyre, të shkojnë e t’u kërkohen ndjesë atyre duke u thënë: “Meqë thamë fjalë të pahijshme e të papërshtatshme për ju, na e bëni hallall!” Ndaj edhe për fatin e atyre që kanë bërë një faj të tillë është për të pasur frikë. Nuk e dimë, ndoshta mund të përfitojnë ndonjë mirësi më tepër nga Zoti i Madhëruar. Por po të

mbahen parasysh hadithi që përmendëm më parë dhe tekstet e ngjashme – Allahu e di më së miri –, mundësia që ata të përfitojnë ndjesë duket e largët.

Në të njëjtën mënyrë, përgojimi, shpifja, fyerja, fajësimi dhe mëkate të tjera, nëse e kapërcejnë individin dhe kryhen ndaj një xhemati, atëherë këto mëkate nuk mund të falen pa u kërkuar ndjesën dhe hallallin një për një të gjithë pjesëtarëve të xhematit. Për shembull, në lidhje me kadirinjtë dhe shadilinjtë, një njeri që flet kundër tyre duke fajësuar një xhemat të tërë, kryen një përgojim të tillë të frikshëm, sa që për faljen e atij njeriu duhen kërkuar ndjesa dhe hallalli prej mijëra apo ndoshta prej miliona njerëzve që kanë jetuar që nga Abdulkadir Gejlani apo Ebu Hasan Shadili e gjer në ditët tona. Nëse do të shkonim edhe pak më tutje, nëse njeriu që ka folur keq për një xhemat të tërë nuk i gjen të gjithë ata njerëz, nuk sqarohet dhe nuk i thotë secilit prej tyre: “Unë për xhematin në të cilin ndodhesh edhe ti, kam thënë kështu. Edhe ti ke hakun tënd në këtë punë. Ma bëj hallall!”, atëherë – Allahu na ruajtë! – ai njeri nuk mund të shpëtojë. Sikurse duaja pranohet kur fiton kolektivitet, po kështu edhe përgojimi, kur prek një tërësi njerëzish, kthehet në përgojim kolektiv dhe nëse nuk kërkohet ndjesa e të gjithë të cenuarve, atëherë njeriu nuk e ka të mundur që t’u ikë pasojave. Zoti na ruajtë, pasi përgojuesi merr gjynahet e sa e sa njerëzve, që i ngarkohen në kurriz. Ndaj edhe mund të thuhet se ky është një mëkat që rëndon sa kufri.

Përveç kësaj, duhet të dihet se edhe përgojimi i njerëzve që përfaqësojnë një bashkësi apo një xhemat është si të përfolurit e një xhemati të tërë. Për shembull, nëse dikush ngrihet dhe flet kundër meje, si një njeri i thjeshtë e i zakonshëm, dhe thotë “ky njeri është kështu e ashtu”, ky mbetet veç një përgojim individual. Por ka personalitete të tillë, që kanë marrë natyrë kolektive. Po, po. Ata janë porsì një pol që përfaqësojnë një xhemat të tërë. Vlera dhe nderi i atyre personaliteteve është njësuar me vlerën dhe nderin e xhematit që ata përfaqësojnë. Kur përmenden emrat e tyre, vijnë menjëherë në mend të gjithë njerëzit që mendojnë sipas linjës së tyre. E pra, kur thuhet fjalë kundër këtyre personaliteteve, përgojohet një xhemat i tërë. Për shembull, nëse dikush ngrihet e thotë për një njeri: “atij s’i punon mendja”, mbi këtë mendim – Allahu na ruajtë! – është kryer një mëkat më i rëndë se zinaja. [\[309\]](#)

Përgojimi apo sjellja prej korbi

Për të qëndruar larg përgojimit, para së gjithash duhet njohur shumë mirë vendi i përgojimit në fe. Kurani i Shenjtë, në lidhje me këtë çështje, ka urdhëruar e thënë: “A mos ndonjëri prej jush pëlqen të hajë kufomën e vëllait të vet të vdekur?” [\[310\]](#) Kështu, pavarësisht gjuhës së tij të pastër, Kurani Fisnik e krahason këtë çështje me ngrënien e mishit të vëllait të vdekur dhe me këtë shëmbëlltynë, na thotë: “Mos hani kërmë!” Një tjetër kuptim i kësaj do të ishte: “Mos u sillni si korba që hanë kërmë!” Nëse do t’i qasëshim kësaj çështjeje brenda përkufizimeve të këndshme të Ustadit, mund të thoshim kështu: “Çfarë ju ka ndodhur juve që, megjithëse jeni njerëz, shfaqni një sjellje të tillë prej korbi? Çfarë ka ndodhur kështu me sjelljen tuaj shoqërore, që i përket jetës suaj shoqërore, si dhe me frymën tuaj të përbashkët, teksa e cenonin kështu sjelljen tuaj?” [\[311\]](#)

Sikurse Kurani e përqs përgojimin me ngrënien e mishit të të vdekurit, edhe interpretuesit e ëndrrave, për një njeri që sheh në ëndërr të hajë mish, e interpretojnë gjendjen e tij si përgojim. Pra, çfarëdo lloj mishi qoftë, një njeri që, në ëndërr, vë në gojë mish, sipas interpretimit të tyre, ka cenuar dikë, ka kafshuar mishin e tij. Domethënë që çështja e të përfolurit, nga bota e

shëmbëlltyrës, kalon kësisoj në ëndrën e tij. Që këtej, mund të themi kështu: dikush që, në jetën e kësaj bote, bën përgojim, në botën e varrit do të shëmbëllehet me një kafshë të egër. Sepse vetëm kafshët e egra kafshojnë e hanë kërmë.

Përgojimi nganjëherë ndodh në formën e të kafshuarit të një njeriu, nganjëherë, pors i ujqërit e tërbuar, duke sulmuar një xhemat të tërë. S'e di, a keni parë ndonjëherë ujqër që lëshohen brenda një kopeje? Kur lëshohen në një kope, në vend që të sulmojnë një kafshë të vetme e të ngopen, ata njëerës i këpusin bishtin, tjetrës i kafshojnë këmbën, tjetrës i hapin gurmazin dhe kështu, këto kafshë ndjellakeqe plagojnë pesëdhjetë prej asaj kopeje. Pikërisht kështu, disa përgojues të pakujdesshëm, që s'njohin vetveten, sa herë hapin gojën, flasin aq rëndë, saqë me gjuhët e tyre lëndojnë njerëz të panumërt dhe në përfundim, shkatërrojnë me themel jetën e tyre shpirtërore dhe errësojnë yjet e ahiretit të vet.

Kur u njoha me nxënësit e afërt të Bediuzamanit, prej tyre mësova shumë gjëra. Për shembull, tek ata pashë një ndjeshmëri shumë të madhe ndaj istibrasë. Po ashtu, edhe në çështjen e pastërtisë së rrobës, vura re se ata ishin shumë të ndjeshëm. Tek ata pashë edhe të hanin pak, të pinin pak, të flinin pak dhe të mbërrinin hajretin. Shkurt, në vendet e bukura si Haxhi Bajrami dhe Sulejmania, në të cilat kam banuar, u bëra dëshmitar i një jete prej myslimani nga ana e tyre. Kur i njoha ata, thashë me vete: "Po rizgohem sërish në jetë, po përjetoj një ringjallje në shpirt." Ata ua përçuan këto tipare të bukura njerëzve në mjedisin përreth. Unë, sipas aftësive të mia, mund të marr disa prej atyre tipareve. Por, me lejen dhe mirësinë e Allahut, kush e di se sa e sa njerëz të tjerë mund të ketë që kanë përfituar prej tyre dhe, nëpërmjet tyre, kanë arritur një ringjallje më të thellë.

Po ashtu, një hollësi shumë e rëndësishme që më tërhiqte vëmendjen tek ata njerëz, ishte ndjeshmëria e jashtëzakonshme që ata tregonin në të ndalurit prej përgojimit. Për shembull, nëse në prani të vëlla Tahirit do të thoshit në lidhje me dikë që, po të mund të dëgjonte, do të bezdisej: "Filani, kur fliste, e ulte kryet" apo "kur i flisje, shihte pa thënë një fjalë", ai menjëherë do të reagoonte: "Pse përgojon? Ty duhet të ta presin gjuhën me rrënjë!" Këta personalitete, siç i ndalnin të tjerët prej përgojimit, natyrisht që edhe vetë qëndronin larg tij. Për shembull, as prej vëlla Tahirit, as prej Hulusi Efendiut, as prej Mustafa Gylit, as prej vëlla Sungurit, nuk kam dëgjuar kurrë as përgojimin më të vogël. Po ju paraqes gjendjen e njerëzve që kam njohur. Por fatkeqësisht, për sa i përket gjendjes sonë, nuk do të mund t'i them të njëjtat gjëra.

Ujk dinak i veshur me lëkurë qengji

Në ditët tona, brenda lëvizjeve të dijes, të besimit e të kulturës, me lejen e Allahut, është arritur përparim deri në njëfarë mase në kontrollin të besimit dhe në jetësimin e tij. Për shembull, në njëfarë mase, kemi largim prej imoralitetit. Them në njëfarë mase, sepse nuk e di se sa larg qëndrojnë prej këtij mëkati të shëmtuar organe si syri apo veshi. Për këtë arsye, nuk flas dot kot e me hamendje. Por në kuptim të përgjithshëm, mund të thuhet se prej këtij mëkati të madh është qëndruar larg. Po kështu, edhe në paçin mbetur të uritur, njerëzit nuk kanë zgjatur dorën në mallin e tjetërkujt dhe kanë qëndruar larg asaj që nuk u përket. Prej veprave si cenimi i sigurisë së jetës së tjetrit, janë milje e milje të tëra larg. Po. Megjithëse kanë vuajtur e u janë nënshtruar shpesh ndodhive që të bëjnë të humbasësh toruan, kurrë nuk ka ndodhur që t'i kenë prekur kurrkujt as edhe një qime. Mund të thuhet, gjithashtu, se edhe adhurimet i zbatojnë dhe se, në njëfarë mase, i

nënshtrohen Zotit të Madhëruar me vetëpërmbajtje. Mirëpo, ja që për përgojimin nuk i them dot të njëjtat gjëra. Sepse kur hapet kjo temë, shihni se, sikur të ishte e drejta jonë e natyrshme, nisim të përmendim sakaq dikë. Për shembull, duke folur për dikë tjetër, një shoku mund të thotë edhe: “Lëre atë!” Ndërkohë që nëse ti thua për vëllanë tënd “lëre atë!”, në jetën e përjetshme, për ty, në gjendjen më kritike, do të thonë: “Lëre atë!” Po, po. Një njeri që e fëlliq gjuhën në këtë jetë, në jetën tjetër e trajtojnë si njeri të pistë e të fëlliqur. Nëse ti në këtë jetë thua për dikë “varja atij”, në jetën tjetër do të ta varin ty. Apo nëse ti thua në këtë botë “njeri i keq” për dikë, në botën tjetër, me të njëjtat fjalë, si njeri të keq, do të të gjykojnë ty.

Më herët jua pata përmendur. Gjyshja ime nga nëna jetonte në një gjendje sikur të kishte vdekur. Aq sa, duke e gjykuar veten të vdekur, shtrihet e, madje, i mbyllte edhe sytë. Nuk e di sa zgjati ajo gjendje, por pas njëfarë kohe, thujse u rilind për së dyti dhe jetoj me vite më pas. Ishte një grua shumë e dëlirë e shumë e bekuar. Thoshte: “Isha sikur të gjendesha në botën tjetër. Dy engjëj erdhën e thanë për mua, “Kjo e përdor gjuhën shumë pisët, duhet t’ia qërojmë gjuhën.” Dhe ma qëruan lëkurën e gjuhës.” Do të thotë që çështja është shumë delikate dhe dënimi shumë i rëndë.

Po. Tani për tani, në pastë një mëkat dinak që nuk po e pengojmë dot dhe që po e vijon ekzistencën e vet brenda një veshjeje të pafajshme, ai është përgojimi. Ai ujk i egër, në një gjendje thujse i veshur me lëkurë qengji, vazhdon të na gërryjejë. Ndaj edhe përgojimi, në ditët tona, është shndërruar në një gjendje më të rrezikshme se zinaja. Sepse mes zemrave që besojnë, i qëndrohet larg zinasë, duke e njohur atë si mëkat të madh – dhe natyrisht që i duhet qëndruar larg; po, mes njerëzve besimtarë, qëndrohet larg një veprë të tillë të shëmtuar, që hedh në erë themelet e shoqërisë, sepse dihet se ç’mëkat i madh është ajo dhe çfarë dënimi të rëndë meriton –por sa keq që ndaj një mëkati mizor si përgojimi, me të cilin gjithkush duket se është mësuar, që duket si i zakonshëm dhe, në njëfarë mënyre, të gjithë marrin pjesë në të, nuk mbahet qëndrim dhe trajtohet sikur të ishte ndonjë mëkat i thjeshtë. Kështu që njerëzit, pa iu skuqur fare faqja dhe pa u turpëruar, po e ushtrojnë këtë mëkat djallëzor. Për këtë arsye, mund të thuhet se përgojimi në ditët tona është kthyer në mëkatin më hipokrit dhe me anë të kësaj hipokrizie, vazhdon ta ruajë gjallërinë mes nesh.

Kurani Fisnik, për njerëzit që fyejnë e ngacmojnë të tjerët duke bërë shenja me sy e me mimikë, urdhëron e thotë kështu: “Mjerë ata që fyejnë e përqeshin!” [312] Por sidoqoftë, pavarësisht këtyre paralajmërimeve të Kuranit të Shenjtë, që do të duhej të drithëronin zemrat, ky mëkat kryeneç ka fituar mes nesh pafajësi dhe me qetësonë më të madhe po pëlqehet në kuvendet tona. Në të njëjtën mënyrë, mund të flasim me shumë lehtësi pas krahëve të një shoku. Për shembull: “Ky shok nuk ia jep hakun punës.”, “Ky shok është përtac.”, “Ky shok nuk e merr vesh këtë çështje.”, “Ky shok nuk ka përfutuar asgjë prej vepra në lidhje me të vërtetat e besimit.” dhe shprehje të tjera të ngjashme, me të cilat mund ta fyejmë me lehtësi tjetrin në mungesë. Të lexosh veprat në lidhje me besimin është një cilësi shumë e mirë. Prandaj edhe mund të keni shprehur pakënaqësinë tuaj duke thënë: “Këta shokë nuk e lexojnë siç është për t’u lexuar tekstin e Risaleve.” Por kjo është një përgojim dhe e keqe e tillë, që atë të mirë që i vjen njeriut prej të lexuarit të atyre veprave ia merr pesëdhjetë herë prej duarsh e ia largon tutje.

Po. Duket se me ato anë të tij që duken si të pafajshme, ky mëkat i pabesë ende e ruan ekzistencën e tij brenda nesh. Edhe njerëzit që duken si më të pastrit, kur e hapin gojën, shihni se menjëherë ia nisin përgojimit. Për fat të keq, përgojimi në ditët tona duket sikur ka fituar liri qarkullimi dhe

thua jse sikur të ketë marrë vizë kudo, mund të hyjë në çdo vend e nga çdo derë. Njerëzit nuk neveriten e nuk u vjen ndot prej tij. Kur përgojnë, as që bien në gjendjen shpirtërore për të menduar: “Bëra diçka të turpshme.” Gjithkush i bashkohet këtij mëkati dhe me këtë anë, ai po bëhet më i mallkuar se mëkatet e tjera dhe më i rëndë se zinaja.

Guxim fetar kundër përgojimit

Kur nëna jonë, Aishja e nderuar (r.a.), tha për një grua, në mungesë të saj, se e kishte qafën të shkurtër, I Nderuari Prijës i Qenieve të Krijuara (alejhis’salatu ues’selam) urdhëroi e tha: “E përgojove!” [313] Prej këtij dhe prej teksteve të tjera të ngjashme, kuptojmë se nëse një njeri, në mungesë të dikujt, thotë për të fjalë si, për shembull: “E paska lidhur shaminë pak ngushtë” apo “e ka jakën pakëz të çelë” e të tjera të ngjashme, e ka përgojuar atë. Sepse Tabloja e Krenarisë Njerëzore (alejhi elfu elfi salatin ue selam), kur bën përshkrimin e përgojimit, urdhëron e thotë: “Çdo fjalë, që do ta shqetësonte vëllanë tënd po ta dëgjonte t’i thuhej në sy, është përgojim.” [314]

Sipas këtyre standardeve, kur mes nesh thuhet një fjalë që shpreh përgojim, atëherë duhet të bëjmë siç bënin disa prej sahabëve dhe ta braktisim atë kuvend duke thënë: “Në këtë kuvend nuk rrihet më. Sepse këtu u bë mëkat, u bë rebelim ndaj Allahut!” Po, po. Pavarësisht se kush mund ta bëjë përgojimin, atyre që ulen aty u takon të ngrihen menjëherë dhe ta braktisin kuvendin. Kjo ka vetëm një përjashtim: Nëse brenda xhematit ka njerëz që nuk i njohin metodën, etikën dhe mënyrat se si duhet trajtuar përgojimi, atëherë për t’u shpjeguar këtyre fillestarëve çështje, kuvendi mund të mos braktiset. E pra, nëse gjithsecili shfaq një qëndrim të tillë kundër përgojimit, besoj se vetëm atëherë mund t’i dilet përpara kësaj të keqeje.

Po e shpreh edhe një herë se për të arritur një përfundim të tillë, para së gjithash duhet ta pranojmë të gjithë në ndërgjegjen tonë se çfarë mëkati i frikshëm e i shëmtuar është përgojimi. Po, po. Gjer në çastin kur të ndiejmë neveri prej përgojimit dhe ta shohim atë si një mëkat të shëmtuar, ai, me vizën e pafajësisë që ka marrë prej nesh, gjithmonë do të gjejë hapësirë për të shëtitur mes nesh dhe do të pëlqehet nga ana jonë.

Nëse duam që përgojimi të mos na zërë vend si kërmë në krye të varrit, të mos e fëlliqë horizontin tonë të varrit dhe të mos kthehet në shkak vuajtjeje për ne me erën e tij të fëlliqur dhe me pamjen e tij të shëmtuar, [315] atëherë që tani, të gjithë bashkë, duhet të mbajmë qëndrim kundër tij.

Për këtë arsye, njerëzve që kam rreth meje u them se nëse ndodh që, kur të hap gojën, të bëheni dëshmitarë qoftë edhe të një gjysmë fjale përgojim, menjëherë mbani qëndrim kundër kësaj dhe duke e ndërruar fjalën, mundohuni ta tërhiqni bisedën te dashuria hyjnore. Ju lutem, mos qëndroni pas në këtë çështje dhe për t’ia prerë rrugën kësaj vepre të shëmtuar, tregoni gjithë guximin tuaj qytetar, apo më saktë, guximin tuaj fetar.

Palaçollëku, bufonëria, serioziteti dhe dinjiteti

Pyetje: Cilat janë hollësitë që duhen mbajtur parasysh për të qëndruar larg paturpësisë e karagjozllëkut dhe për të zotëruar seriozitet e dinjitet? A mund të na i shpjegoji?

Përgjigje: Palaçollëku apo, siç quhet në gjuhën e tasavufit, bufonëria, ndryshon sipas horizontit të besimit e të dijes dhe të nivelit të lidhjes së individit me Allahun. Te disa, nëse u vjen në mendje diçka e lidhur me mosbesimin dhe me çudhëzim, edhe në qoftë një çast i vetëm sa një vetëtimë, kjo gjendje ata i tmerron e i trondit rëndë. Ndërsa fillestarët si ne, vetëm në raste shprehjesh të përdorura në lidhje me Qenien Hyjnore apo me profetësinë, mbartin shqetësimin: “Mos vallë kam rënë në femohim e në humbje?”

Për ta shprehur ndryshe, kufijtë e palaçollëkut e të karagjozllëkut janë shumë të gjerë. Për shembull, ka karagjozllëqe e fjalë të pahijshme që nënkuptojnë mungesë respekti ndaj Allahut dhe këto bien erë mohim. Në përfundim të të tilla fjalëve të pahijshme, njeriu, pa e kuptuar as vetë, mund të rrëshqasë në mohim. Nga ky këndvështrim, edhe në qoftë nivel fillestar, njeriu duhet të përpiqet ta ndiejë në ndërgjegjen e vet të vërtetën se Zoti i Madhëruar di e sheh gjithçka dhe këtë ndjesi duhet ta pasqyrojë në sjelljen e tij. Nga ana tjetër, kam njohur njerëz të tillë që s’i kam parë kurrë të mos e kontrollojnë gojën. Këta njerëz, gjatë gjithë jetës së tyre, ecnin përherë me kryet ulur. Janë vështrimi i thellë dhe serioziteti i tyre ato çka kanë ushtruar një ndikim shumë serioz në zemra.

Jetë shpirtërore e zbehur me gajasje

Nuk ka kurrfarë dyshimi se jo gjithkush mund të bëhet pjesë e këtij horizonti. Për shembull, nisur nga mjedisi ku kemi lindur, ne jemi si barinj të në shkretëtirë. Nuk kemi horizont, zemra nuk na është zgjeruar, truri dhe mendimet tona kanë mbetur të dobëta. Por pavarësisht gjithë kësaj, sërish njeriu duhet të përpiqet përmes konceptimit të vet. Tani, nisur nga pajimet, aftësia dhe horizonti, mund të duket sikur për ne është paracaktuar që të ndalemi në një vend para derës së haremit. Por njeriu kurrsesi nuk duhet të kënaqet me kaq. Përkundrazi, ashtu sikurse ai udhëtar i së vërtetës që përmendet në Ajetin Madhështor, *“A s’ka edhe më?”* duhet të thotë përherë. [316] Madje edhe nëse futet në vendin e haremit, sërish aty duhet të kërkojë më tutje duke thënë me vete: “Si mundem, vallë, ta forcoj edhe më marrëdhënien time me Atë?” Dhe gjithmonë të rendë pas lutjes: *“A s’ka edhe më?”* Po, po. Besimtari, që nga çasti që, me *“La ilahe il-lall-llah”*, hedh hapin në brendi, gjithmonë duhet të kërkojë horizontin më të largët. Pra, cilido qoftë ai horizont që e lë gojëhapur, që e bën të zbehët krejt, që e mbush me frikë e respekt dhe e bën t’i drithërohet zemra, pikërisht atë horizont duhet të përpiqet që të arrijë. Ndoshta edhe në iu shfaqte në buzë vende vende një buzëqeshje me burim prej shprese, pa kaluar shumë, ai duhet të mblidhet në një atmosferë të frikës e të respektit dhe ta mbështjellë unin e vet me ndjenjën e tutës e të drojës. E pra, këta janë heronjtë e vërtetë të migrimit. Sepse pavarësisht se me pamjen e tij të bekuar e plot nur, Zotëria ynë, Nderi i Gjithësisë (s.a.s.), gjithmonë rrezatonte shpresë me buzëqeshjen e tij të përherëshme, është regjistruar vetëm tri herë që ai të ketë qeshur. [317] Edhe mes sahabëve të nderuar dhe tabiinëve të mëdhenj ka sa e sa njerëz të lartësuar në këtë gjendje. Madje disa dalloheshin e njiheshin prej këtyre cilësive. Ahere njeriu, në thelb, duhet të vendosë distancë me

palaçollëkun dhe duke u ushtruar vazhdimisht, të përpiqet për seriozitet e vetëpërmbajtje. Nëse kjo realizohet, me kalimin e kohës, një gjendje e tillë përcillet në të gjithë sjelljen e tij.

Çfarë kuptoni ju me fjalët e Mevlana Xhamit, që Bediuzamani i nderuar i citon në Fjalën e Shtatëmbëdhjetë:

“Vetëm Njërën të duash, vetëm Njërën të thërrasësh, vetëm Njërën të kërkosh, vetëm Njërën të shohësh, vetëm Njërën të dish, vetëm Njërën të thuash.” [318] E pra, njeriu njeriu zbret në thellësinë e këtyre të vërtetave, nëse i përvetëson ato, nëse gjithmonë vepron me dëshirën e dashurinë për ta parë Atë, për ta njohur Atë, për ta thirrur Atë dhe për ta kërkuar Atë, me kalimin e kohës, kjo gjendje kthehet në pjesë të natyrës e të karakterit të tij.

Siç u shpreh pak më parë, për ne fillestarët, një gjendje e tillë mund të duket e largët. Por edhe ne, së paku, duhet të qëndrojmë larg gajasjeve të pahijshme vend e pavend, në qëndrimet e në sjelljet tona nuk duhet të tregohemi joseriozë. Sidomos nëse gjendemi në një pozitë në përfaqësim të fesë, çështja fiton ndjeshmëri shumë më të lartë. Sepse njerëzit në rrethin tuaj presin prej jush një gjendje e qëndrim të tillë. Meqë jeni besimtarë, ahëre në këtë çështje duhet të keni një dallim nga të tjerët, duhet të tregoni një ndryshim, ashtu që njerëzit, duke ju parë ju, të shohin me lakmi fenë dhe vlerat tuaja fetare. Nëse edhe ju silleni si të tjerët, veproni si të tjerët, flisni si të tjerët, gajaseni e argaliseni si të tjerët, atëherë bashkëbiseduesit tuaja nuk janë në gjendje t’i shikojnë besimin dhe bukuritë e besimit brenda jush. Për ndryshim, mbeten veç ca informacione teorike, të cilat nuk se tregojnë për besimin e vërtetë. Po, po. Të dhënat teorike kanë një funksion si prerja e rrugës së femohimit, por nuk duhet harruar se vendosja e imanit në zemrën e njeriut bëhet me vepra.

Vetëdija e mirësisë që përfaqon jetën

Një njeri që ka mbërritur në një pikë në përfundim të rrugëtimit të tij shpirtëror, aty duhet ta përgatisë veten për vetëpërmbajtje e syçeltësi. Te një udhëtar i tillë i së vërtetës, edhe në qoftë ai në një gjendje të dehjes hyjnore e të përsosjes, gjithmonë vërehen shenjat e syçeltësisë e të kthjelltësisë. Ai, duke thënë “Ka Zot!”, u shmanget veprimeve të pamenduara dhe mbushet në çdo sjellje me frymëmarrjen e vetëpërmbajtjes. Madje edhe në kryerje të nevojave personale, ai skuqet e ndihet i turpëruar, sepse edhe pse engjëjt nuk janë të pranishëm në këso rastesh, gjithmonë njeriu duhet të jetë në ndërgjegjen e të qenit nën shikimin e Zotit). [319] Ndaj edhe ky mendim, e gjithë kjo gjendje, prek qëndrimet dhe sjelljet e tij.

Sua kam treguar edhe më parë. Kur Imami i Allvarit u shpërngul për në jetën tjetër, isha ende gjashtëmbëdhjetë vjeç. Për këtë arsye, nuk mund të them se i kuptoja fjalët e thella e plot kuptim, që dilnin prej gojës së tij. Por ulur a ngritur qoftë, në çdo qëndrim e veprim, ai kishte një ndikim të tillë, që e kapërcente ligjërimin me fjalë. Pavarësisht se kishte mbërritur të nëntëdhjetat, qëndronte tetë orë i ulur në gjunjë. Nuk e di në i mpiheshin këmbët apo jo. Veç kësaj, kishte edhe shqetësime nga prostata. Pavarësisht kësaj, nuk e ndryshonte kurrë sjelljen. Edhe sikur kurrë të mos thoshte, por veç të shqiptonte një herë “Allah!” në praninë tënde, të bënte të të drithërohej zemra. Nganjëherë dridhej në çast sikur ta kishte zënë korrenti. E pra, ajo gjendje, ai qëndrim e ajo sjellje plot thellësi, seriozitet e mirësi, vështrimet dhe rrudhat e fytyrës, të gjitha pasqyroheshin në shpirtin e të pranishmëve.

Një tjetër prej atyre njerëzve që, me gjendjen e me qëndrimet e tyre, me uljet e me ngritjet e tyre, ndikonin te njerëzit, ishte edhe Salih Efendiu. Kurrë nuk e pashë të gajasej me dhëmbë jashtë. Në kohën që e njoha, isha në moshën e më të voglit prej fëmijëve të tij. Por pavarësisht kësaj, kur vinte për vizitë, nuk e ulja dot në ndonjë divan. Gjithmonë ulej në gjunjë. E pra, në këtë masë ishte ai njeri i kujdesshëm e i vetëpërbajtur. Besoj se sikur një njeri të tillë ta merrnit e ta çonin në prani të Allahut dhe ai të dëgjonte drejtpërdrejt, pa sa e si, fjalën e Zotit të Madhëruar e të merrte urdhra prej Tij, sërish ai njeri do të thoshte: “O Zot! Mos vallë këto janë gjëra që burojnë prej nefsit tim? Në qofshin kështu, mbështetem në mbrojtjen Tënde. Ti je i madh. Një rob mëkatar, rebel e i vogël si unë nuk mund ta ketë të merituar një mirësi të tillë. Ahere ç’është kjo gjendje, o Allahu im?” E pra, një njeri me një mendësi të tillë, për shkak se është i mësuar me vetëpërbajtjen, frymëmerr me vetëpërbajtje, vepron me vetëpërbajtje, ulet e ngrihet me vetëpërbajtje, dhe kurrë nuk e ndërron sjelljen e vet. Ndaj edhe prej një njeriu të tillë nuk shfaqet kurrë sjellje prej karagjozi.

Nga ana tjetër, disa njerëz që kanë vënë pak kamje prej disa dhuratave që u janë dhënë apo nëse u janë hapur qoftë edhe pakëz rrugët e të ardhurave, gëzojnë si magrebasi që ka rënë në mall dhe e humbasin toruan. Vetëm personalitete si Shah Gejlani, Muhammed Bahaudin Nakshibendi apo Imam Rabbaniu, as edhe për një çast nuk i janë ndarë vetëpërbajtjes. Imam Rabbani, në veprën me titull “Letrat”, përdor shprehje me përbajtjen: “Gjendem në një pikë të tillë, që nuk e kuptoj nëse më prek apo nuk më prek këmba në tokë.” Por pavarësisht se ndodhet në këto shkallë, ai thekson me këmbënguljen rrugën e gjerë të Sunnetit të Lartë dhe rrugën e sahabëve të nderuar dhe në çfarëdolloj niveli qoftë, këshillon milimetër më milimetër për sheriatin e jashtëm. [\[320\]](#)

Por për ne, si myslimanë të ditëve të sotme, njëra prej mangësive më serioze është se nuk e besojmë me zemër të qenët e Allahut në çdo çast e në çdo vend pranë nesh. Informacioni ynë në lidhje me këtë çështje është më së shumti i përbërë prej njohjes teorike. Dhe kur informacioni teorik nuk bëhet jetë me jetën, prej gjendjes e prej sjelljeve tona derdhet palaçollëk dhe mungesë serioziteti. Po, po. Fatkeqësisht, sjellja jonë nuk është prej besimtari; për këtë arsye, nuk depërtojmë dot në shpirtra. Ndërkohë që unë, brenda këtij rrethi, ata të parë të mirë i kam parë gjithmonë seriozë dhe të dinjitetshëm. Ata e dinin se ku kishin ndalur. Ata e jetonin jetën sikur të ishin duke qëndruar përballë haremit, në këmbë, në respekt e nderim të thellë. Kështu, duhet ta dimë se palaçollëku, mungesa e seriozitetit dhe bufonëria nuk kanë vend në vokacionin tonë. Një orë e më parë, ndaj kësaj cilësie duhet të mbajmë qëndrim, duhet të ruajmë largësi prej saj dhe të mos i lejojmë që të mos bëhet pjesë as edhe në ëndrrat tona.

Ndërsa për sa i përket largimit prej palaçollëkut dhe arritjes së vetëpërbajtjes në jetën tonë të adhurimit, mund të thuhet, se nëse besimtari e kërkon seriozitetin në gjithë jetën e vet, edhe në adhurime e në rituale do ta kapë atë me të njëjtën lehtësi. Për këtë arsye, vetëpërbajtja dhe dinjiteti duhet të bëhen pjesë e gjithë jetës së besimtarit. Kreu i Qenieve të Krijuara (alejhi elfu elfi salatın ue selam) edhe kur ishte i shtrirë në shtrat, vendoste dorën e djathtë nën krye, i tërhiqte këmbët në kraharor, mblidhej dhe ashtu pushonte. Nëse do të shohim historinë profetike, do të vërejmë se në çdo pikë e në çdo centimetër të jetës së Tij të bekuar ka një vetëpërbajtje e një kujdes të tillë.

Nëse edhe ju përpiqeni të arrini një seriozitet të tillë në të gjitha faqet e jetës suaj, duke qëndruar larg karagjozllëqeve edhe në namaz e në ritet e tjera, atëherë mund ta arrini vetëpërbajtjen,

përvuajtjen dhe respektin. Po, po. Nëse edhe ju përpiqeni që në çdo vend, me sa të keni në dorë, të veproni me ndërgjegjen e të gjendurit në prani të Tij dhe t'i planifikoni sjelljet tuaja sipas kësaj, pa rënë në artificialitete dhe në sjellje të panatyrshme, prej gjendjes dhe sjelljeve tuaja do të pikojë thjeshtësi, ndrojtje e respekt. Mos e harroni se nëse bini në artificialitet, njerëzit do ta kuptojnë që sjelljet tuaja janë të pavërteta dhe do të shprehin mospëlqimin e tyre. Kështu, ndahen modestët e natyrshëm prej modestëve të stisur e artificialë. E njëjta gjendje vlen edhe për njerëzit e vetëpërmbytur dhe ata që hiqen si të tillë, për ata që janë seriozë dhe ata që hiqen si të tillë. Njeriu që në një mjedis hiqet sikur qëndron larg palaçollëkut dhe sikur është serioz, kur largohet që andej, gjendet në veprime aq të papërshtatshme, bie në shkërbime e palaçollëqe aq vulgare, shpreh fjalë aq të pahijshme, sa që kur i shihni me sytë tuaj këtë gjendje, këto veprime e këto fjalë të tij, skuqeni gjer te veshët. Sepse serioziteti ende nuk është bërë pjesë e natyrës së tij. E pra, që të mos biem në një dyzim të tillë, duhet t'i shtrijmë në praktikë në çdo pikë të jetës vlerat të cilave u besojmë dhe kështu, t'i kthejmë ato në një thellësi të karakterit tonë.

“Të lutem, o Allahu im! Shpallja praninë dhe madhëstinë Tënde unit tim!”

Prej Zotit të Madhëruar duhet kërkuar që të jemi seriozë. Nuk është e drejtë të mendohet: “E dëshiroj, por nuk e bëj dot pjesë të thellësisë së natyrës sime. Sërish jam joserioz, sërish jam karagjoz, sërish jam i pavëmendshëm kundrejt Allahut.” Për atë Zot, për të rregulluar gjendjen tonë plot dobësi, sa net të javës jemi ngritur dhe jemi përgjërur me gjithë zemër: “Të lutem, o Allahu im! Shpallja praninë dhe madhëstinë Tënde unit tim!” Sa herë ia kemi kërkuar këtë Atij e Ai s'na e paskësh dhënë! Jo, nëse mëtojmë diçka të tillë, veç bëhemi gënjeshtarë. Nëse Ai nuk na e dhuron këtë dhe ne ende ndodhemi në gjendjen ku jemi, atëherë do të thotë se kësaj çështjeje me rëndësi jetike për jetën tonë të zemrës e të shpirtit nuk i kemi dhënë dhe nuk i japim rëndësinë e duhur.

Libri ynë i lartë, Kurani i Shenjtë, me një stil më shumë se serioz, është një bekim qiellor e tokësor që i erdhi njeriut më serioz në faqe të dheut, për të institucionalizuar në tokë pikërisht seriozitetin. Përndryshe, Kurani, siç shprehet edhe në ajetin e shenjtë, وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ “Ai nuk është shaka” [321], nuk është një lojë e dëfrim.

Për ta rifituar seriozitetin që e kemi humbur, duhet ta këshillojmë njëri-tjetrin vazhdimisht. Për këtë, si në një marrëveshje shoqërore, duhet t'i japim njëri-tjetrit fjalën dhe autoritetin e nevojshëm. Për shembull, kur të shohim ndonjë vëlla tonin që ka rënë në mungesë serioziteti, duhet të mund ta paralajmërojmë: “Ç’është kjo gjendje, o vëllai im! A mos vallë të erdhi sihariqi i jetës së amshuar? A mos u përgëzove me Xhenetin?” Të mos themi, pastaj, se edhe një njeri që do të ishte përgëzuar me Parajsën, gjer në çastin që do të hidhte hapin aty brenda, do të duhej të ruante seriozitetin. Sepse gjer në çastin që do të hyjmë aty, askush nuk është nën garanci. Nëse Nderi i Gjithësisë, Zotëria ynë (alejhis’salatu ues’selam), për të na dhënë mësim vetëpërmbytjeje, urdhëron e thotë: “As unë nuk hyj dot në Parajsë me veprën time!” [322], atëherë a nuk duhet që gjithkush ta vërë kryet në duar e të meditojë? Nëse edhe Zotëria i Zotërinjve (s.a.s.), që në një rekat të namazit recitonte suret madhështore “Bekare”, “Ali Imran”, “Maide” dhe “Nisa”, urdhëron e shprehet se nuk do të mund të hynte në Xhenet me veprën e vet, atëherë a nuk është për t’u pyetur njeriu: “Për çfarë gajasesh e bën ende palaçollëqe?”

Zgjidhja për të mos rënë në lodhjen e rrugës: Përpjekja për ripërtëritje

Pyetje: Cilat janë çështjet për të cilat udhëtarët e idealit duhet të bëjnë kujdes që, me kalimin e kohës, të mos mposhten prej vendnumërosë, rutinës dhe mpirjes? A mund të keni mirësinë të na e shpjegoni?

Përgjigje: Para së gjithash, duhet ditur se nuk është një punë e lehtë që njeriu t'i ruajë për një jetë të tërë përfitimet, gjallërinë dhe hijeshinë shpirtërore që i ka shtënë në dorë në një periudhë të caktuar; madje kjo është edhe më e vështirë sesa shtënia e tyre në dorë herën e parë. Po, është e vërtetë se që të ruash gjatë gjithë jetës fjalët dhe ngjarjet, ndjesitë e dëlira, tensionin metafizik që shkaktojnë drithërima në shpirtra dhe prodhojnë ndikim shokues kur përjetohen për herë të parë, është një çështje më e vështirë se çdo vështirësi. Ndaj edhe në çdo fillim të ri, njerëzit që kanë përbërë safin e parë, edhe në paçin qenë shumë dinamike, në periudhat e mëpasme nuk e kanë vijuar dot të njëjtën gjallëri. Ashtu që edhe në rishtarët që, fillimisht, me plot vull e dëshirë, kanë shpërfaqur heroizëm për hir të vlerave në të cilat kanë besuar, me kalimin e kohës, kanë nisur të vërehen shenjat e konsumimit e të lodhjes. Edhe nëse koha, që përbën një mirësi të madhe që Zoti i Lartësuar i ka dhuruar njeriut, në vetvete nuk konsumohet, kur nuk i njihen pesha e vlera, kur, për pasojë, nuk vlerësohet siç duhet për të ruajtur gjallërinë e freskinë, në çdo ditë që kalon, freskia, ëmbëlsia, gjallëria e joshja në ndjenja e në mendime i nënshtrohen një konsumi e shpërbërjeje në një masë të caktuar. Për shembull, në namazet që falen, shpirtrat në të cilat që kanë mbetur larg ndërgjegjes së të qenit në praninë e Allahut, janë përmalluar për emocionet e drithërimat e brendshme. Po kështu, agjërimet që pritet ta fusin njeriun në portën e Rejjanës dhe ta bëjnë të fitojë gjendjet shpirtërore të të ecurit nëpër korridoret e Xhenetit, [323] janë kthyer në një gjendje të urisë në pritje të konsumimit të darkës. Për këtë arsye, po e pohoj edhe një herë se ruajtja e përfitimeve të marra në fillim, bashkë me vlerën e përpjekjes, me thellësinë e me hijeshinë, me përmasat joshëse, është më e vështirë sesa marrja e tyre në fillim.

Përpjekja e paprerë për ripërtëritje

Ajo çfarë duhet bërë kundrejt një gjendjeje që duket si e pashmangshme për çdo individ dhe shoqëri është që njeriu të gjendet vazhdimisht në një mundim e përpjekje për përtëritje, ta thurë jetën me këtë vetëdije. Sepse syri dhe zemra juaj, në një periudhë të caktuar, mund t'u jenë hapur bukurive të caktuara dhe ju mund t'i keni përqaftuar me sinqeritet e me shpirt ato bukuri. Por më pas, në mënyrë që ato bukuri të mos zbehen, të mos vriten dhe të mos ndryshken në botën tuaj të mendimit, por të ruhen me gjithë shkëlqimin e tyre, kërkohen një mundim e përpjekje shumë serioze. Këtë gjendje mund ta sqarojmë me një shembëlltyrë të tillë: Një njeri, duke u mbajtur pas litarit, me këmbët të lidhur me kanxhë, me duart të veshura me dorashka dhe duke u munduar në rrugë të ngjashme, mund ta gjejë një rrugë e të ngjitet në majë. Por më pas, që të mund të qëndrojë në këtë majë, që ta vazhdojë ekzistencën e tij atje, që t'u përshtatet kushteve, atmosferës së asaj maje dhe njëkohësisht, ta përvetësojë atë vend, ta përngjasojë vetveten me të, është një punë më e vështirë nga ç'ishte arritja në majë. Për këtë arsye, puna është që të qëndrosh në majë, të mos i humbasësh ato që ke fituar dhe veç kësaj, t'i shumëfishosh ato. Dhe kjo është e mundur vetëm me një përpjekje të vazhdueshme për ripërtëritje.

Siç thuhet në një hadith, I Dërguari i Allahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i këshillon sahabët fisnikë kështu: “Ripërtërijeni besimin tuaj!” Pas kësaj, kur e pyesin: “O i Dërguari i Allahu! Si ta ripërtërijmë besimin?”, Tabloja e Krenarisë Njerëzore (alejhissalatu vesselam) urdhëron e thotë: “Fjalën “La ilahe il-lall-llah” (me mendje, me zemër, me gjuhë) përkujtojeni së shumti.” [324] Atëherë edhe ju, duke shtuar vazhdimisht diçka në basenin e njohurive tuaja, duhet të përpiqeni ta ripërtërijni mendimin tuaj mbi Islamin e *ihsanin*. Kështu, informacione të shumëfishta krahasuar me dijet që në botën tuaj të zemrës kanë avulluar e i keni humbur, do të vërshojnë sërish nga kanale të ndryshme; dhe kështu, ju do ta mbushni sërish zbrazëtinë e krijuar. Do të analizoni urdhëresat hyjnore, do të endeni në luginat e meditimit, do të krahasoni dijet tuaja të shkuara me të sotmet dhe do të mbërrini vazhdimisht në analiza e sinteza të reja, do të hulumtoni e do të arrini përfundime dhe kështu, me dijet që do të përfitonit çdo ditë, do ta ripërtërijni edhe një herë besimin tuaj.

Në trupin e njeriut gjithmonë shfaqen ndryshime dhe tjetërsime. Të gjitha qelizat e trupit, të gjitha atomet në qeliza, të gjitha elektronet në to u nënshtrohen ndryshimeve. Atëherë njeriu, që ka një trup që vazhdimisht tjetërsohet e zhvillohet, duhet t’i shtjerë prapë në dorë pajimet e vërteta që do t’ia zhvillojnë e ripërtërijnë sërish besimin. Nëse njeriu vepron kështu, do ta shfaqë e provojë edhe një herë veten si një kryengritës që i ka shpallur luftë stanjacionit e rutinës.

Eliksiri i jetës: biseda për të Dashurin

Krahas mendimit, meditimit dhe përkujtimit individual, një tjetër mjet që siguron vazhdimin rrugës së qëndrimit në majë dhe të ruajtjes së asaj çka është fituar, është edhe biseda për të Dashurin e zemrës. Kjo është një dashuri, një pasion e një ndezulli e jashtëzakonshme dhe një mik i së vërtetës, me shprehjet e tij plot emocion, i jep zë kështu kësaj ndjesie:

“Sikur Atë që dua unë ta donte bota mbarë!

E për kurrkënd tjetër të mos flitej një fjalë...!”

(Tashllëxhallë Jahja)

Po. Edhe njerëzit që ua rrëmben zemrën një qenie kalimtare, qoftë edhe ata që zemra u lidhet pas një dashurie simbolike, nuk shohin e nuk njohin më kurrkënd tjetër veç së dashurës. Ndërsa ajo që ne duam, që ndiejmë pasion e jemi të dashuruar është Allahu, është i Dërguari i Allahut. Prandaj edhe kemi dëshirë që e gjithë bota t’ua falë zemrën këtyre të vërtetave. Gjithkush ta përmendë emrin e Allahut tim; të kujtojë emrin e madh të Zotërisë sim (alejhi elfu elfi salatin ue selam).

Nga ky këndvështrim, ne, teksa mblidhemi e rrimë së bashku, ngado që ta vërtisim e ta vërtisim bisedën, patjetër duhet ta sjellim fjalën tek i Dashuri e të flasim për të. Nëse ndieni një lidhje të thellë të zemrës me Allahun, nëse keni dëshirë që Atë ta njohë gjithkush dhe në çdo përkujtim të Tij të këndelleni sikur freskoheni me një enë ujë që e nxirrni prej një burimi parajsor, atëherë vërtitini bisedat tuaja rreth së vërtetës “La ilahe il‘lallah Muhamedun Resulullah”.

Njeriu, në kohën e rinisë, bën një jetë të gjallë e energjike. Ndërsa në periudhën e pjekurisë, gjithçka nis e zë vendin e vet dhe logjika e gjykimi nisin të mbizotërojnë në jetën e njerëzve. Por vjen edhe një periudhë, që ndjenjat dhe mendimet nisin të zbehen, të fikën e të ndryshken. Kjo nuk do të thotë që pjekuria është stanjacion në shpirt. Në të kundërt, kjo gjendje do të jetë zbehje e zbardhje e linjave që më herët kanë pasur domethënie të madhe për ju. E pra, në një gjendje të tillë, në bisedat për të dashurin e zemrës, në mendim, meditim e përkujtim, duhet të zgjoheni edhe një herë në çadrën e oksigjenit, të ecni edhe një herë drejt ringjalljes dhe kështu, ta nderoni, ta thëlloni e ta kurorëzoni pjesën e mbetur të jetës duke përmendur Atë. Duhet të dihet se kthimi i një përpjekjeje e mundimi të tillë për ripërtëritje do të jetë shumë i ndryshëm në jetën e amshuar.

Vullnetet e gjalla dhe Shteti Osman

Njëri prej shteteve më jetëgjata në botë është Devleti Alije apo Shteti Osman. Nëse shohim themelin e Shtetit Osman, që u ngrit mbi baza më të sigurta sesa shteti i emevive dhe ai i abasidëve, do të vërejmë se thelbi dhe përmbajtja e tij janë besimi në Allahun, njohja e Allahut, dashuria për Allahun dhe kënaqësia shpirtërore. Nëse doni të dini se çfarë ndjenjash e mendimesh zotëronte së pari ky shtet, duhet të shihni se si gjykonte Murat Hydavendigjari para se të binte dëshmor në Luftën e Fushë-Kosovës. Në mbrëmjen para betejës, Murat Hydavendigjari u tërhoq në çadrën e vet dhe pasi e kaloi natën zgjuar, në rite e adhurim ndaj Allahut, para se të ngrihej prej sixhades, ngriti duart kah qielli dhe iu lut Zotit të Madhëruar kështu: “O Zoti im! Në qoftë shfaqur kjo furtunë prej mëkateve të këtij robit tënd të varfër, Muratit, mos i ndëshko ushtarët e mi të pafajshëm. Fali ata! O Allahu im! Ata, gjer këtu, kanë ardhur vetëm për të lartësuar emrin Tënd dhe për t’i bërë njerëzit që ta dëgjojnë fenë e Islamit. Largoje fatkeqësinë e kësaj furtune prej kokave të tyre. Bëji të arrijnë një fitore që t’i shkojë për shtat Famës Tënde, ashtu që të gjithë myslimanët të festojnë. Ndhimoji e dhuroju fitore myslimanëve! Dhe nëse ke dëshirë, në atë ditë të festës, ky robi yt, Murati, u bëftë kurban për ty! Së pari më bëre mua luftëtar, paskëtaj më bëj dëshmor!” Dhe ç’gojë paskësh qenë ajo që e bëri këtë dua! Pasi dëshira e tij u përmbush shpejt dhe ai i arriti shkallët e flijimit e ra dëshmor.

Allahu, këtyre njerëzve, që kanë dhënë shpirtin e kanë vepruar vetëm për hir të Allahut dhe brenda sferës së kënaqësisë së Tij, ua ka shndërruar sekondat e jetës në rend të viteve. Kjo këmbëngulje dhe ky përfaqësim i Islamit në vlera të larta nga ana e tyre ka vazhduar për një kohë të gjatë. Sepse ata i kishin sytë vazhdimisht në front e në përhapjen e fjalës së Allahut. Jahja Kemal, në poezinë e tij “Ezan”, thotë kështu për Jauz Sulltan Selimin:

“Sulltan Selimit fundi sa pa i mbërritur,

Duhej që botën ta pushtonte famë e Muhamedit.

Qielli kridhet në dritë prej qindra mijëra minaresh,

Flatrat teksa çelte frymë e Muhamedit.”

Këta njerëz, duke e kaluar jetën e tyre si të dashuruar pas kësaj, i thëllonin dashurinë dhe emocionet e tyre dhe kështu, e parandalonin zbehjen, fikjen e ndryshkjen, dhe, me leje të Allahut, patën jetë

të gjatë. Përndryshe, siç thonë historianët shoqërorë dhe filozofikë, njëlloj si individët, edhe shoqëritë lindin, kalojnë rininë, përjetojnë një periudhë të pjekurisë, më pas plaken dhe së fundi rrokullisen e përfundojnë në gropë. Për shoqëritë, kjo gjendje është e pashmangshme. Domethënë, për çdo komb, është e vlefshme e vërteta: “Gjithçka në faqe të dheut është zhdukur; dhe mbetet veç Fytyra e Zotit tënd të Madhëruar e të Lartësuar.” [325] Në daçi, nisur nga e vërteta se “Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen” [326], mund të thoni edhe se “Çdo komb do ta shijojë vdekjen.” Po, po. Kombet, njëlloj si individët, lindin, rriten dhe vdesin. Por për ta ruajtur qëndrueshmërinë që gëzojnë, në përfundim të disa përpjekjeve të bëra, me lejen dhe mirësinë e Allahut, ndoshta në reanimacion, ndoshta në karrige me rrota, ndoshta në çadrën e oksigjenit, mund të gjejnë një rrugë e ta zgjasin jetën tyre; mund ta zgjasin dhe të bëhen shkak për të mundësuar plot e plot shërbime të dobishme. E pra, ajo që na mbetet neve, është që, pavarësisht gjithçkaje, të mbetemi të gjallë në shpirt e në qenie; të ruajmë gjallërinë dhe të ushtrojmë qëndresë ndaj mungesës së emocionit, ndaj stanjacionit e dobësimit.

[305] Shih: Ebu Davud, Edeb 35; El-Bezzar, El-Musned 4/93; Abdurrezzak, El-Musanef 11/176.

[306] Et-Taberani, El-Mu’xhemu’l-eusat 6/348; El-Bejhaki, Shuabu’l-iman 5/306.

[307] Shih: Bediuzaman, Fjalët f. 371 (Fjala e Njëzetekatërt, Dega e tretë).

[308] Ibn Kudame, El-Kafi 4/159; Ibn Abidin, Hashije 4/232.

[309] Shih: Et-Taberani, El-Mu’xhemu’l-evsat 6/348; El-Bejhaki, Shuabu’l-iman 5/306.

[310] Huxhurat, 49/12.

[311] Shih: Bediuzaman, Letrat f. 312-313 (Letra e Njëzetedytë, Përfundim).

[312] Humeze, 104/1.

[313] Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 6/136, 206; El-Bejhaki, Shuabu’l-iman 5/303.

[314] Muslim, Birr 70; Tirmidhi, Birr 23; Ebu Davud, Edeb 35.

[315] Shih: Buhari, Xhenaiz 89; Muslim, Taharet 111.

[316] Shih: Bediüzzaman, Rrezatimet f. 101 (Rrezatimi i Shtatë, Rrezja e parë).

[317] Buhari, Tefsiru sure (39) 2, Tevhid 19, 36, Rikak 44, 51; Muslim, Iman 308-310, Sifatu’l-munafikin 19, 30.

[318] Bediüzzaman, Fjalët f. 231 (Fjala e Shtatëmbëdhjetë, Mekami i dytë).

[319] Shih: Buhari, Iman 37, Tefsiru sure (31) 2; Muslim, Iman 1.

[320] Shih: Imam Rabbani, El-Mektubat 1/15 (Letra 9), 1/34 (Letra 25), 1/134 (Letra 255)...

[321] Tarik, 86/14.

[322] Buhari, Merda 19, Rikak 18 ; Muslim, Sifatu'l-munafikin 71-78.

[323] Shih: Buhari, Saum 4; Muslim, Zekat 85.

[324] Ahmed ibn Hanbel, El-Musned 2/359; Abd ibn Humejd, El-Musned f. 417.

[325] Rahman, 55/26-27.

[326] Ali İmran, 3/185; Enbija, 21/35; Ankebut, 29/57.

FUND